



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2921/6 prot.

Tiranë, më 27.02.2026

**RAPORT**

**PËR**

**KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: “MBI PLANIFIKIMIN  
DHE ZHVILLIMIN E SEANCAVE NË DISA GJYKATA TË SHKALLËS SË  
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM”**

Në zbatim të vendimit nr. 57, datë 20.10.2025, “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

*Tiranë, Shkurt 2026*

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

### Titulli:


Raporti i inspektimit tematik me objekt "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm", të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

### Data e përgatitjes:

27.02.2026

### Përgatitur nga Inspektorët:

Znj. Daniela Sulaj  
Znj. Joana Sorraj  
Znj. Elena Pelushi  
Z. Periand Teta  
Znj. Lindita Ziguri  
Znj. Elsa Miha  
Z. Julian Zonja  
Z. Eugen Nasufi  
Znj. Erjena Bashari  
Z. Albert Kazia



### Për shqyrtim nga:

### Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Z. Artur Metani

Miratoi  Ndryshoi  Ktheu

Datë 27.02.2026



## 1. Hyrje

- 1.1. Arsyet e inicimit të inspektimit
- 1.2. Qëllimi i inspektimit
- 1.3. Burimet relevante të së drejtës
- 1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit
- 1.5. Objekti i inspektimit
- 1.6. Metodologjia e inspektimit
- 1.7. Periudha e kryerjes së inspektimit
- 1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit
- 1.9. Problematikat e hasura gjatë kryerjes së inspektimit

## 2. Objekti i kontrollit dhe drejtimit e inspektimit

- 2.1. Objekti i kontrollit
- 2.2. Drejtimit e inspektimit

## 3. Parashikimet ligjore/nënligjore përsa i përket rregullave standarde për eficiencën në tërësi

## 4. Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

☞ Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë


☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

☞ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

## 5. Konkluzione

## 6. Rekomandime

## 7. Aneks (kalendari i planifikimeve të seancave dhe tabelat me të dhëna për secilën gjykatë)



## 1. Pjesa hyrëse

### 1.1. Arsytet e inicimit të inspektimit

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyra të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenet 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, me vendimin nr. 57, datë 20.10.2025 ka vendosur kryerjen e inspektimit tematik me temë "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm" të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

Ky inspektim është iniciuar duke marrë në konsideratë disa rrethana:

- **Së pari**, numrin e lartë të ankesave të paraqitura nga qytetarët me objekt "Tej zgjatjen në kohë të proceseve gjyqësore".
- **Së dyti**, nevojën për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes faktike të veprimtarisë administrative dhe gjyqësore në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave.
- **Së treti**, praktikën e konsoliduar në vijimësi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e cila ka konstatuar shkelje për mosrespektimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, ndër të cilat përmendim çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Bara & Kola kundër Shqipërisë si dhe ARB sh.p.k kundër Shqipërisë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Bara & Kola kundër Shqipërisë (2021), ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave duke arsyetuar në mënyrë të përsëritur (shih § 70 dhe § 94 të vendimit) se: "*Duke e marrë në konsideratë vonesën e kuptueshme të shkaktuar nga reformat e thella në sistemin e drejtësisë dhe nga procesi i vetting-ut, gjykata vëren se shtetet kanë detyrim të përgjithshëm që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për të garantuar respektim të kushteve të parashikuara në nenin 6, duke përfshirë edhe një seancë të drejtë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm (shih Krastanov kundër Bullgarisë 30 shtator 2004)".*

Gjithashtu në vendimin ARB sh.p.k kundër Shqipërisë (2025), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut thekson se arsyetimi i kohëzgjatjes se procedurave përcaktohet mbështetur në rrethanat e çështjes dhe referuar kritereve të përcaktuara në praktikën

gjqësore të gjykatës, veçanërisht kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për kërkuarin në fjalë.

## 1.2. Qëllimi i inspektimit:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet këtij inspektimi synon të tërheqë vëmendjen e gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë gjykatave subjekt inspektimi, si dhe pranë të gjitha gjykatave të tjera, mbi rëndësinë që paraqet planifikimi i seancave si një element thelbësor për menaxhimin e ngarkesës si dhe zhvillimin e rregullt dhe efikas të procesit gjyqësor.

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm përbën një të drejtë kushtetuese. Pavarësisht gjendjes në të cilën ndodhet sistemi i drejtësisë, veçanërisht në drejtim të organikës së paplotësuar të gjykatave, gjyqtarët duhet të tregojnë një kujdes dhe dilgjencë të shtuar që të marrin të gjitha masat e nevojshme në drejtim të planifikimit dhe organizimit të proceseve gjyqësore në mënyrë që gjykimet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

## 1.3. Burimet relevante të së drejtës

Burimet e të drejtës së brendshme, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile i RSH, me ndryshimet përkatëse;
- Kodi i Procedurës Penale i RSH, me ndryshimet përkatëse;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH, me ndryshimet përkatëse;
- Ligji nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në RSH<sup>[1]</sup>, me ndryshimet përkatëse;
- Ligji nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”<sup>[2]</sup>, me ndryshimet përkatëse;
- Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor;
- Rregulloret e brendshme për organizimin dhe funksionimin e gjykatave.

### Burimet e së drejtës ndërkombëtare:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut përsa i përket “Shkeljes së afatit të arsyeshëm” në kuptim të nenit 6 të kësaj konvente.

<sup>1</sup> Neni 5, pika 4 “Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase”.

<sup>2</sup> Neni 2 “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës”.

- Opinionet e Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropianë.
- Opinionet dhe Raportet e Komisionit Evropian për Eficiencën në Drejtësi (CEPEJ).

#### 1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit

Inspektimi tematik përfshin veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

#### 1.5. Objekti i inspektimit

Objekt i këtij inspektimi është veprimtaria administrative dhe gjyqësore në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave nga gjyqtarët të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

#### 1.6. Metodologjia e inspektimit

Duke iu referuar veprimtarisë gjyqësore në tërësi kemi përzgjedhur një metodologji të përshtatshme inspektimi me qëllim analizimin e të gjithë elementeve të rëndësishëm që kanë të bëjnë me planifikimin/zhvillimin e seancave analizuar ky planifikim në raport me gjendjen e gjykatave objekt inspektimi përsa i përket organikës dhe ngarkesës gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025.

Kjo lloj metodologjie vjen në harmoni dhe me “Metodologjinë e inspektimit” të miratuar me Urdhrin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 121, datë 30.12.2022 përsa i përket qëllimit në tërësi të inspektimeve tematike dhe vlerave që duhet të përcjellin këto inspektime.

#### 1.7. Periudha e kryerjes së inspektimit

Ky inspektim është kryer gjatë periudhës kohore 20.10.2025-28.02.2026<sup>[3]</sup>, dhe realizimi i tij është zhvilluar në disa faza.

#### 1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit

1) Faza e parë “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimi i verifikimeve apo vizitave pranë gjykatës”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

<sup>3</sup> Sipas vendimit të ILD-së nr. 57, datë 20.01.2025, fillimisht afati për hartimin e raportit përfundimtar ishte data 31.12.2024. Ky afat është shtyrë në kushtet kur për shkak të pasaktësive të konstatuara në të dhënat e administruara, rezultoi i nevojshëm verifikimi i këtyre të dhënave.

- i) Përgatitja e planit të punës
- ii) Përgatitja e shkresave drejtuar institucionit objekt inspektimi
- iii) Administrimi i dokumentacionit ardhur në përgjigje të kërkesave të ILD-së
- iv) Kryerja e verifikimeve dhe vizitave në terren në ato raste kur është vlerësuar nga inspektori, e shoqëruar me kryerje të intervistave gjysmë të strukturuar me Kryetarin e Gjykatës/Kancelarin/Kryesekretarin si dhe janë këqyrur, sistemi i menaxhimit të çështjeve, sallat gjyqësore si dhe shpalljet në këndin e njoftimeve të gjykatës

2) Faza e dytë “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

- i) Përpunimi i dokumentacionit administrativ dhe studimi i materialit
- ii) Kryerja e vizitave në ambientin e gjykatës dhe marrja me procesverbal e dokumenteve dhe e të dhënave që kanë rezultuar të nevojshme nga studimi i materialit të vënë në dispozicion me shkresë nga gjykata

3) Faza e tretë “Hartimi i raportit të inspektimit”

- i) Hedhja e të dhënave, hartimi i pjesëve të veçanta të raportit nga inspektorët përgjegjës
- ii) Hartimi i raportit, i cili dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të drejtësisë

Pas shqyrtimit dhe miratimit të Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

4) Faza e katërt: “Ndjekja e rekomandimeve”

- i) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit sipas afatit të vendosur për ndjekjen e rekomandimeve përkatëse

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 57, datë 20.10.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u angazhuan të gjithë inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Përkatësisht:

Znj. Daniela Sulaj dhe znj. Joana Sorraj për gjykatat si më poshtë:

- i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat
- ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

Znj. Elena Pelushi dhe z. Perian Teta për gjykatat si më poshtë:

- i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër
- ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

Znj. Lindita Ziguri dhe znj. Elsa Miha për:

- i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

Z. Julian Zonja dhe z. Eugen Nasufi për gjykatat si më poshtë:

- i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier
- ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Znj. Erjena Bashari dhe z. Albert Kazia për gjykatat si më poshtë:

- i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë
- ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Gjithashtu me qëllim rritjen e eficiencës së grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektore znj. Daniela Sulaj.

### **1.9. Problematikat e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre në funksion të procesit të inspektimit**

Gjatë inspektimit u konstatua pasaktësi në të dhënat e informacionit të përcjellë nga gjykatat në lidhje me “kalendarin e seancave të planifikuara” për secilin gjyqtar, me përjashtim të informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në të cilin nuk është konstatuar një problematikë e tillë.

Gjithashtu për të gjitha gjykatat subjekt inspektimi evidentohet ndër të tjera se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk pasqyron të dhëna të sakta përsa i përket “kalendarit të planifikimit të seancave” në rastet e çështjeve të rishortuara. Problematika konsiston në faktin se sistemi ia përlllogarit gjyqtarit të caktuar së fundmi të gjitha planifikimet e seancave, përfshirë edhe ato të kryera përpara rishortimit të çështjes, duke krijuar kështu një pasqyrim jo të saktë të ngarkesës dhe planifikimit real të seancave për secilin gjyqtar.

## **2. Objekti i kontrollit dhe drejtimit e inspektimit**

### **2.1. Objekti i kontrollit**

Objekti i kontrollit është inspektimi i Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm përkatësisht Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, (më poshtë referohen edhe shkurt: “gjykata ose gjykatat”), përsa i përket veprimtarisë administrative dhe gjyqësore në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

### **2.2. Drejtimit e inspektimit**

Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në këto drejtime kryesore:

- i) Numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara gjyqtarit për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025;

- ii) Numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025 – 20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe;
- iii) Organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve.
- iv) Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025;
- v) Numri i sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025;
- vi) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar.

### 3. Parashikimet ligjore/nënligjore përsa i përket rregullave standarde për eficiencën

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj<sup>[4]</sup>.

E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është një e drejtë themelore që garanton që çdo person të mos qëndrojë për një kohë të gjatë në pasiguri juridike. Gjykata ka për detyrë të zhvilloj një proces të rregullt ligjor.

**3.1. Kodi i Procedurës Civile** përcakton rregulla të detyrueshme për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të cilat janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, gjykata vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme<sup>[5]</sup>.

Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata<sup>[6]</sup>.

Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadsisë me shkrim<sup>[7]</sup>.

Ndonëse Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 ka pësuar ndryshime ndër vite, vlerësojmë të ndalemi tek ndryshimet që ka pësuar ky kod në vitin 2017. Ndryshimet dhe shtesat që pësoi Kodi i Procedurës Civile me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 38/2017, kishin për qëllim të evitonin problematikat e konstatuara dhe të nxisinin

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 42, pika 2.

<sup>5</sup> Neni 4 i K. Pr. Civile.

<sup>6</sup> Neni 171/a i K. Pr. Civile: "Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprime të tjera të kërkuara prej saj".

<sup>7</sup> Neni 153 i K. Pr. Civile.

eficiencën dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë<sup>[8]</sup>. Në këtë kontekst, u parashikuan në Kodin e Procedurës Civile rregullime të detajuara që kanë të bëjnë me: veprimet e nevojshme për t'u kryer nga gjyqtari përsa i përket: vlerësimit të kushteve të kërkesëpadsisë; njoftimit të të paditurit për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesëpadsisë; veprimet e nevojshme paraprake para caktimit të seancës përgatitore.

Gjithashtu Kodi i Procedurës Civile pësoi ndryshime edhe përsa i përket dispozitave në lidhje me seancën përgatitore dhe seancën gjyqësore.

Në lidhje me “të drejtat e gjykatës për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe mjetet për zbatimin e tyre”, K. Pr. Civile, në nenin 171/a, parashikon: *“Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprime të tjera të kryera prej saj”*.

Neni 181 i K. Pr. Civile parashikon gjithashtu se:

*“Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues.*

*Kur për shkaqe të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari ose anëtarët e rinj duhet të njihen me përmbajtjen e procesit gjyqësor. Anëtari ose anëtarët e rinj mund të kërkojnë që hetimi gjyqësor të përsëritet pjesërisht ose tërësisht”*.

**3.1.1.** Në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017 është shtuar “Kreu X” “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Neni 399/2, pika 1 i K. Pr. Civile parashikon se afati i arsyeshme i kohëzgjatjes së një gjykimi civil në shkallë të parë është dy vjet ndërsa afati i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një gjykimi penal në shkallë të parë për krimet është 2 vjet, ndërsa për kundërvajtjet është 1 vit.

Pavarësisht palët në referim të nenit 399/2, pika 3 mund të kërkojnë konstatimin e kohëzgjatje së procedurave edhe pa kaluar këto afate të përcaktuara si afate të arsyeshme duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që kryen procedurat si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritjen e gjykimit.

Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim<sup>[9]</sup>.

<sup>8</sup> Shiko raportin për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 datë 29.03.2016 “Kodi i procedurës civile i RSH”, i ndryshuar.

<sup>9</sup> Neni 399/2 pika 3 i K. Pr. Civile.

**3.2. Kodi i Procedurës Penale.** Edhe për sa i përket këtij kodi i cili është miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, vlerësojmë të ndalemi tek ndryshimet që ka pësuar ky kod në vitin 2017 (me ligjin nr. 35/2017), duke pasur parasysh se këto ndryshime u iniciuan si rezultat i gjetjeve në Dokumentin e Analizës për Sistemin e Drejtësisë në RSH, që kishin të bënin në mënyrë të posaçme me problemet e theksuara për fazën e gjyqimit përsa i përket mungesës së eficiencës së gjyqimit.

Ndryshimet e propozuara synonin ndër të tjera: Zhvillimin e gjyqimit në mënyrë të pandërprerë; rritjen e autoritetit të gjykatës në disiplinimin dhe zhvillimin normal të gjyqimit penal; përmirësimin e rregullimeve për njoftimin e palëve.

Në këtë kontekst në Kodin e Procedurës Penale u parashikuan rregullime të detajuara që kanë të bëjnë me njoftimet procedurale, ndërsa përsa i përket drejtimit të procesit u parashikuan rregulla më të detajuara në drejtim të disiplinimit të subjekteve dhe palëve të tjera pjesëmarrës në proces si: e drejta e gjykatës për të vendosur gjobjë apo për të marrë masa të tjera (neni 341, 350 i K. Pr. Penale).

Kodi i Procedurës Penale në RSH për shkak të natyrës së procesit penal në drejtim të cenimit të të drejtave dhe lirive personale, në nenin 342 të tij, parashikon “gjykimin e pandërprerë”. Konkretisht në nenin 342 të K. Pr. Penale<sup>[10]</sup> parashikohet se:

1. *“Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasshme të punës.*
2. *Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.*
3. *Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor shpallen nga kryetari në seancë. Shpallja zëvendëson njoftimin për ata që janë të pranishëm ose që duhet të quhen të pranishëm.*
4. *Kur për shkaqe të përlegjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se tre nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para”.*

**3.3. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH<sup>[11]</sup>,** me ndryshimet përkatëse në nenin 23, pika 11 përcakton ndër të tjera se: “Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre”.

<sup>10</sup> Ky nen ka pësuar ndryshime vetëm përsa i përket pikës 4, e cila është shtuar me ligjin nr. 8813 datë 13.06.2002 dhe ka pësuar ndryshime (fjalë) me ligjin nr. 35/2017.

<sup>11</sup> Neni 74 “*Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.*

**3.4. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.** Përveç parashikimeve ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij raporti (shih burimet relevante të së drejtës) si dhe normave procedurale, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 89, shkronja “b”, në lidhje me funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor përsa i përket administrimit të gjykatave, përcakton ndër të tjera se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:... b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë”.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor gëzon autoritetin në bazë të ligjit<sup>[12]</sup> për të miratuar rregulla standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Rregullat standarde të gjykatave përmbajnë norma në lidhje me **strukturën e gjykatave, eficiencën dhe cilësinë e drejtësisë.**

Rregullat standarde për eficiencën në sistemin e drejtësisë, në referim të nenit 94, pika 4 të ligjit nr. 115/2016, përfshijnë ndër të tjera parashikimet për:

*“a) afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, përfshirë, kur është e mundur, edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale;*

*b) rregullat standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve, me qëllimin për të përmirësuar në vijimësi sistemin e menaxhimit të çështjeve”;....*

*dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;*

*e) udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;*

*ë) udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore;*

*g) udhëzues për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor.*

### **3.5. Akte nënligjore**

**Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>[13]</sup>, ka miratuar vendimin nr. 25, datë 07.02.2019, i ndryshuar, me vendimin nr. 115, datë 09.07.2019 “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”.** Referuar nenit 1, pikat “d” dhe “e” të këtij vendimi Kryetari i Gjykatës duhet të informojë periodikisht Këshillin e Lartë Gjyqësor ndër të tjera në lidhje me: d). *Funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelin e përdorimit të tij nga secili gjyqtar. Paraqitjen në përqindje të numrit të seancave gjyqësore që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve*

<sup>12</sup> Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 89 dhe neni 94, pika 2.

<sup>13</sup> Bazuar edhe në nenin 89 të ligjit nr. 115/2016.

për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim). Evidentimin në përqindje të seancave gjyqësore të filluara me vonesë nga secili gjyqtar. e) Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar **vendimin nr. 149, datë 29.03.2023** (për gjykatat pa zyra shërbimi) dhe **vendimin 150, datë 29.03.2023** (për gjykatat me zyra shërbimi) “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me **vendimin nr. 353, datë 11.07.2024** ka miratuar udhëzimin “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audi/audivizive në procesin gjyqësor”. Ky udhëzim përcakton ndër të tjera rregullat mbi mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore në referim të nenit 118 “Procesverbali” sipas K. Pr. Civile si dhe në referim të nenit 115 “Procesverbali i seancës” sipas K. Pr. Penale. Në pikën 4 të këtij udhëzimi përcaktohet se: “Procesverbali audi/audiviziv, i seancave gjyqësore përbën procesverbalin zyrtar të seancës në përputhje me nenin 118 të K. Pr. Civile dhe nenin 115 të K. Pr. Penale. Për lehtësi përdorimi, procesverbalit audio/audiviziv të seancave gjyqësore i bashkëngjitet edhe seksioni i shënimeve të përmbledhura (indeksi-lognotes) i mbajtur nga sekretari gjyqësor sipas pikës 7 të këtij udhëzimi. Kur regjistrimi audio është i pamundur të realizohet për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara në Kodet sipas përcaktimit të kryetarit të gjykatës. Në këtë rast, në procesverbal shënohet shkaku i mbajtjes së procesverbalit në mënyrën tjetër dhe ai firmoset nga kryetari i seancës gjyqësore dhe sekretari gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në muajin korrik të vitit 2025 (që i përket periudhës objekt inspektimi) ka miratuar **vendimin nr. 433, datë 22.07.2025** “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve”.

### 3.6. Kuadri rregullator në lidhje me të dhënat statistikore

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në referim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe konkretisht të nenit 89, shkronja “b”<sup>[14]</sup> dhe nenit 94, pika 4, shkronja “dh”<sup>[15]</sup>, me **vendimin nr. 47, datë 11.02.2021**, ka miratuar “Udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”. Ky udhëzues ofron një tërësi

<sup>14</sup> Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:.. b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë.

<sup>15</sup> Rregullat standarde për eficiencën e drejtësisë përfshijnë parashikime për: dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore.

rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat.

Në seksionin 1 të këtij udhëzimi janë miratuar tabelat standarde për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të cilat përmbajnë të dhëna statistikore në lidhje me: Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; gjendjen e backlog-ut; prurjet e çështjeve të reja; ngarkesën mesatare të gjyqtarëve; normën e eficiencës; raportin e qarkullimit të çështjeve; kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes; normën e zgjidhjes së çështjes; vjetërsinë e çështjes etj.

Në seksionin “udhëzime të përgjithshme” parashikohet si më poshtë:

*“Sekretaritetë gjyqësore në çdo gjykatë ndihmojnë me mirëmbajtjen e regjistrave dhe regjistrimeve të sakta në regjistra si dhe në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Udhëzim, përfshirë saktësinë e të dhënave ( neni 44 i ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”).*

*Kancelari, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës, mban përgjegjësi, mes të tjerave, edhe për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) në gjykatë. Kancelari mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave si dhe orienton dhe mbikëqyr punën e nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës që përfshihen në regjistrimin e të dhënave dhe në përpilimin e statistikave. Kancelari dërgon raporte periodike në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përdorimin dhe funksionimin e CMS, si dhe raporton pa vonesë mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të CMS (neni 39 i ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”).*

Në respektim të këtij udhëzimi, duke u kufizuar tek të dhënat që kanë lidhje me “Planifikimin dhe zhvillimin e seancave”, referuar tabelës 1 dhe tabelës 2 “statistikat për çështjet civile/penale sipas llojit të çështjes, të dhënat statistikore përsa i përket çështjeve duhet të përmbajnë të dhëna në lidhje katër tregues sikurse janë: “administrimi i çështjeve”; “kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara: “Eficienca”; “Seancat gjyqësore”.

Përsa i përket treguesve statistikore në lidhje me seancat gjyqësore, në këtë tregues përfshihet:

- Kolona 25: “numri i seancave” përfshin numrin e seancave gjyqësore të mbajtura në prani të palëve, duke përjashtuar seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.
- Kolona 26: “Numri i seancave gjyqësore për çështje” është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes<sup>16</sup>.

<sup>16</sup> Numri mesatar i seancave për çështje llogaritet si raport i numrit të seancave në kolonën 25 me numrin total të çështjeve të mbyllura (gjykuara) në kolonën 3 të tabelës.

#### **4. Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm**

Gjykatat subjekt inspektimi kategorizohen në dy grupe, të përcaktuara si të tilla nëpërmjet vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 147, datë 29.03.202. Përkatësisht:

- Gjykatat e kategorisë së dytë (të mesme): Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë, Berat, Lezhë, Lushnjë;
- Gjykatat e kategorisë së tretë (e ulët): Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjirokastrë, Kukës dhe Sarandë.

Në funksion të realizimit të inspektimit janë administruar të dhënat nga gjykatat subjekt inspektimi.

Në vijim janë parashtruar të dhënat e administruara, faktet e konstatuara në lidhje me veprimtarinë administrative dhe gjyqësore, analiza e fakteve/gjetjet/konkluzionet e inspektimit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër:

#### **4.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**

##### **1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara**

##### **1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit.**

Në kuadër të kryerjes së inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresë<sup>[17]</sup> Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nëpërmjet së cilës është kërkuar informacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) Statistikat e secilit gjyqtar në lidhje me:
  - i. numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara secilit gjyqtar për periudhën 01.01.2025-20.10.2025;
  - ii. numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe;
- b) Kalendari i seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar;
- c) Organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve,
- d) Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025-31.10.2025;
- e) Numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në përgjigje të kërkesës për informacion dhe dokumentacion, ndër të tjera ka përcjellë<sup>[18]</sup>;

<sup>17</sup> Shkresa e ILD-së nr. 2928 prot., datë 20.10.2025.

<sup>18</sup> Shkresa me nr. 2117/1 prot., datë 11.11.2025.

*Lidhur me pikën a)* - Nga gjykata është përcjellë informacion statistikor, në format tabelor për secilin gjyqtar, lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024, numrin e çështjeve të reja të regjistruara për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e vendimeve të shpallura gjatë kësaj periudhe.

*Lidhur me pikën b)* - Në lidhje me kalendarët e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, për secilin gjyqtar janë paraqitur “listat e çështjeve për gjykim” në format fizik dhe elektronik.

*Lidhur me pikën c)* - Sa i përket organikës së miratuar dhe asaj faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve në detyrë, është paraqitur dokumentacioni përkatës dhe konkretisht pasqyra e numrit të punonjësve sipas strukturës organizative dhe organikës në fakt për muajin shtator dhe muajin tetor 2025.

*Lidhur me pikën d)* - Në lidhje me kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre gjatë periudhës 01.01.2025–31.10.2025, gjykata ka përcjellë urdhrat përkatës të zëvendëskryetarit për miratimin e lejeve të gjyqtarëve.

*Lidhur me pikën e)* - Sa i përket numrit të sallave të gjyqimit të vëna në dispozicion për zhvillimin e seancave, gjykata na ka përcjellë urdhrin për ndarjen e sallave nr. 1, datë 11.01.2024;

*Gjithashtu me shpresën e sipërcituar, gjykata na ka përcjellë dhe analizën vjetore për vitin 2024; raportet drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024 si dhe rregulloren e brendshme të gjykatës.*

Në vijim, grupi i punës së inspektimit ka zhvilluar një vizitë në ambientin e gjykatës me qëllim verifikimin e të dhënave të përcjella, si dhe kryerjen e intervistave gjysmë të strukturuar me Kancelaren, Kryesekretaren dhe punonjës të specialist të sektorit të informatikës. Grupi i punës këqyri në ambientin e sekretarisë, në prani të Kancelares së gjykatës, materialin e vënë në dispozicion për periudhën objekt inspektimi 01.01.2023-31.05.2023, si dhe administroi me procesverbalet përkatëse<sup>[19]</sup> materialet si më poshtë:

- Kopje të tre “formateve të raportimeve tremujore” për gjatë vitit 2025 drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>[20]</sup>;
- Kopje të raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio (RDA) për gjyqtarët Ardiola Çela, Ilirjan Hysa, Renis Bega dhe Lumturi Zhupa;
- Shkresa nr. 972 prot., datë 13.05.2025 mbi shpërndarjen e shortit, bashkëlidhur lista e çështjeve të rishortuara;
- Shkresa nr. 992 prot., datë 15.05.2025 mbi shpërndarjen e shortit, bashkëlidhur lista e çështjeve të rishortuara;

<sup>19</sup> Procesverbali nr. 2928/2 prot., - nr. 2928/5 prot., datë 18.11.2025.

<sup>20</sup> Shiko pikën “6” niveli i përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar.

- Kopje të pasqyrës së numrit të punonjësve, sipas strukturës organizative dhe organike në fakt për periudhën Janar - Gusht 2025. (Gjithsej 8 pasqyra);
- Kopje të raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio (RDA), për gjyqtaren K. Meçi dhe E. Koxhaj;
- Kopje të listës së çështjeve për gjykim të gjyqtarit R. Bega për muajin qershor 2025 (e cila nuk na ishte dërguar më parë nga gjykata);
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor për çështjen nr. 21017-01203-63-2024 dhe nr. 21017-01201-63-2024 me gjyqtare K. Meçi (10 faqe);
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor për çështjen nr. 951/424 Regj. Them., datë 11.04.2024, me nr. 21298 – 00391-63-2024 (12 fletë);
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor civil me nr. 147/3, datë 22.12.2024, me nr. 21017-01203-63-2024 (10 fletë);
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor civil nr. 1011(264/175/109/103) Regj. Them., datë 01.03.2021, me nr. 11118-00203-63-2021 (16 fletë);
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor civil nr. 145 Regj. Them., datë 20.12.2024, me nr. 21017-01201-63-2024;
- Kopje të akteve të fashikullit gjyqësor civil nr. 7 Regj. Them., datë 03.01.2025, me nr. 21017-00001-63-2025;
- Kopje e vendimit nr. 56, datë 30.09.2025 të Këshillit të Gjykatës në lidhje caktimin e kancelarit;
- Kopje e Urdhrit nr. 98, datë 26.12.2024 të Zv/Kryetares Klejda Meçi “për pezullimin e shortit”.

Në kushtet kur nga shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit të administruar si më lartë, janë konstatuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të pasqyruara në “listat e çështjeve për gjykim” me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar nga gjykata<sup>21</sup> informacion në lidhje me arsyen e mospërputhjes së të dhënave, saktësimin dhe ridërgimin e tyre në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, kryetarit, anëtarit); seancat e zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025. Gjithashtu është kërkuar dërgimi i RDA-ve (raportet për përdorimin e sistemit audio në lidhje me seancat) për çdo muaj për secilin gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, si dhe lista e gatishmërisë për secilin gjyqtar gjatë kësaj periudhe.

**Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat** në përgjigje të kërkesës së sipërcituar ka përcjellë pranë ILD-së informacionin përkatës, si dhe dokumentacionin si vijon: a) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për çdo muaj për gjyqtarët Ilirjan Hysa, Klejda Meçi dhe Ardjola Çela; b) Kopje të raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio (RDA) për çdo muaj për secilin gjyqtar; c) Urdhrat për miratimin e listës së gatishmërisë për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025; d) Urdhrin për rishortimin e çështjeve të

<sup>21</sup> Me shkresën nr. 2928/6 prot., datë 25.11.2025.

gjyqtares Lumturi Zhupa dhe lista e çështjeve të rishortuara; e) CD me materialet përkatëse.

Në mënyrë që analizimi i të dhënave të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, përveç të dhënave të sjella nga gjykata si dhe të dhënave të marra pranë kësaj gjykate, nga grupi i inspektimit u morën dhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në RSH, dhe konkretisht raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024 dhe 2025.

## **2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative**

### **2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>[22]</sup> është gjykatë e kategorisë së dytë (e mesme) e përcaktuar si e tillë me vendimin e KLGJ-së me nr. 147, datë 29.03.2023<sup>[23]</sup>.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 149, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë pa zyrë shërbimi”, në nenin 14 të këtij vendimi ka parashikuar ndër të tjera se: “*Këshilli i gjykatës pritëse, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës*”.

Këshilli i Gjykatës me **vendimin nr. 34, datë 17.12.2024** ka miratuar “**Rregulloren e brendshme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**”, e cila është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr. 209, datë 27.10.2017.

“Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Berat” në nenin 20 të saj, përcakton llojet e “regjistrave” (në të cilat regjistrohen kërkesat nga sekretaria gjyqësore që merret me regjistrimin) dhe konkretisht: regjistrin e çështjeve civile të themelit; regjistrin e çështjeve të veçanta pa palë; regjistrin e urdhrave të mbrojtjes; regjistrin e urdhrave të ekzekutimit; regjistrin e çështjeve penale themeli; regjistrin e seancave paraprake; regjistrin e vleftësimit të ndalimit dhe arrestit; regjistrin e kërkesave penale administrative.

Sipas kësaj rregulloreje përcaktohet se sekretari gjyqësor (sekretari regjistruar) kryen: regjistrimin në mënyrë manuale në regjistrat themeltarë si dhe në indeksin civil/penal; krijon fashikujt përkatës si dhe bën regjistrimin e këtyre çështjeve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore duke zbatuar manualin e sistemit ICMIS dhe në

<sup>22</sup> Shkurt do të citohet edhe: “Gjykata Berat”.

<sup>23</sup> Ky vendim, i cili hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare, është publikuar në fletoren zyrtare në datë 29.03.2023.

vijim dorëzon paditë dhe kërkesat tek kryetari për hedhjen e tyre në short në mbikëqyrjen e kancelarit.

Referuar rregullores, sekretari gjyqësor regjistruar pas hedhjes së shortit, printon RIV dhe fletën e kalimit të praktikës të nënshkruar nga kancelari dhe vijon me procesin e mëtejshëm të pasqyrimin të gjyqtarëve në regjistrat manual dhe në dosje, si dhe dorëzimin e tyre tek gjyqtarët ose sekretaria gjyqësore kundrejt nënshkrimit. Më pas këto praktika i kalojnë gjyqtarit i cili planifikon kohën e shqyrtimit të tyre, ndërsa sekretari gjyqësor i seancës kryen të gjitha veprimet teknike dhe procedurale për çdo fashikull gjyqësor, bën njoftimet për shpalljen e datës së gjykimit të vendosur nga gjyqtari si dhe kryen veprime në sistemin elektronik të gjykatës në lidhje me shtyrjen e seancës dhe datën e radhës së seancës.

Sekretari gjyqësor përveç të tjerash hedh manualisht numrin total të seancave për çështjet e përfunduara, në regjistrin “numërori i vendimeve civile/penale”.

Në nenin 21 dhe nenin 22 të kësaj rregulloreje përshkruhen detyrat e sekretarit gjyqësor, ndër të cilat përmendet se misioni i sekretarit gjyqësor është të dokumentojë saktë dhe qartë diskutimet në seancë gjyqësore, të ndihmojë gjyqtarin gjatë seancave deri në përfundim të çështjes, të përgatisë njoftimet si dhe të kryejë veprimet në sistemin elektronik të gjykatës.

Gjithashtu, në nenin 22, shkronja “t”, parashikohet se një nga detyrat e sekretarit gjyqësor është: *“të pasqyrojë në sistemin elektronik arsyet e shtyrjes së seancës dhe datën e radhës së seancës”.*

## **2.2. Organika e Gjykatës**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025 për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, ka funksionuar me një seksion të vetëm, i cili shqyrton të gjitha çështjet civile dhe penale. Përsa i përket çështjeve penale me të mitur, ka funksionuar seksioni penal me tre gjyqtarë.

Fillimi i vitit 2025 e ka gjetur gjykatën me 6 gjyqtarë efektivë, për shkak se në muajin tetor të vitit 2024 në këtë gjykatë janë emëruar dy gjyqtarë.

Gjatë periudhës së inspektimit, në Gjykatën Berat kanë ushtruar funksionin 6 gjyqtarë efektivë nga 8 gjyqtarë që është organika e miratuar.

Në këtë periudhë, gjyqtare Lumturi Zhupa ka ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak të lejes së lindjes, ndërsa gjyqtari Vladimir Cjapi ka qenë i komanduar vetëm për një çështje.

Trupa gjykuese efektive përgjatë periudhës objekt inspektimi është pasqyruar në tabelën si më poshtë:

<b>Gjyqtarët</b>	Renis Bega	Ardiola Çela	Ilirjan Hysa	Ervis Koxhaj	Klejda Meçi	Lumturi Zhupa	Vladimir Cjapi
<b>Shënime</b>	Caktuar në tetor 2024			Caktuar në tetor 2024	Rikthyer nga leja e lindjes në nëntor 2024	Ndërprerë punën për shkak të lejes së lindjes datë 12.05.2025	I komanduar për 1 çështje.

### 2.3. Gatishmëria

Gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025, konstatohet se caktimi i gjyqtarëve në listën e gatishmërisë është kryer nëpërmjet urdhrave të Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat Znj. Klejda Meçi.

Gatishmëria sipas muajve për vitin 2025 është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

		Urdhër nr. 99 datë 26.12.2024	Urdhër nr. 17 datë 20.01.2025	Urdhër nr. 42 datë 24.02.2025	Urdhër nr. 64 datë 19.03.2025	Urdhër nr. 89 datë 23.04.2025	Urdhër nr. 103 datë 09.05.2025	Urdhër nr. 129 datë 17.06.2025	Urdhër nr. 143 datë 07.07.2025	Urdhër nr. 167 datë 08.08.2025	Urdhër nr. 204 datë 30.09.2025
Nr.	Gjyqtari	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
1	Renis Bega	1-5	10-16	24-30	-	1-4	2-8	7-13	-	1-7	1-5, 27-31
2	Ardiola Çela	6-12	17-23	31	1-6	5-11	9-15	14-20	22-31	8-14	6-12
3	Ilirjan Hysa	13-19	24-28	1-2	7-13	12-18	16-22	21-27	11-21	15-21	13-19
4	Ervis Koxhaj	20-26	-	3-9	14-20	19-25	23-29	28-31	11-21	22-28	20-26
5	Klejda Meçi	27-31	1-2	10-16	21-27	26-31	1,30	1-6	1-10	29-31	-
6	Lumturi Zhupa	-	3-9	17-23	28-30	-	-	-	-	-	-

Referuar materialit të përcjellë nga ana e gjykatës, rezulton se për periudhën objekt inspektimi të ketë pasur ndryshime përsa i përket grafikut të mësipërm të gatishmërisë. Këto ndryshime janë pasqyruar në urdhrat e mëposhtëm të nxjerrë nga zëvendëskryetarja e gjykatës, ku situata për secilin gjyqtar paraqitet si vijon:

- Nëpërmjet urdhrat nr. 25, datë 27.01.2025 janë caktuar të gatshëm gjyqtarët Klejda Meçi për datat 03.02.2025-09.02.2025 dhe Lumturi Zhupa për datat 27.01.2025-02.02.2025;
- Nëpërmjet urdhrat nr. 29, datë 03.02.2025 janë caktuar të gatshëm gjyqtarët Renis Bega për datat 03.02.2025-09.02.2025 dhe Klejda Meçi për datat 10.02.2025-16.02.2025;

- Nëpërmjet urdhrit nr. 77, datë 07.04.2025 është vendosur përjashtimi nga kryerja e gatishmërisë për gjyqtaren Lumturi Zhupa;
- Nëpërmjet urdhrit nr. 141, datë 04.07.2025 janë caktuar të gatshëm gjyqtarët Renis Bega për datat 21.07.2025-27.07.2025, Ardiola Çela për datat 07.07.2025-13.07.2025 dhe Ilirjan Hysa për datat 14.07.2025-20.07.2025;
- Nëpërmjet urdhrit nr. 201, datë 26.09.2025 janë caktuar të gatshëm gjyqtarët Renis Bega për datat 29.09.2025-05.10.2025.

#### 2.4. Lejet vjetore dhe raportet mjekësore

Në ligjin nr. 96/2016 në nenin 23, pika 11, është përcaktuar ndër të tjera se: “Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre”.

##### 2.4.1. Kërkesat për miratimin e lejes vjetore për vitin 2025

Nëpërmjet urdhrit nr. 143, datë 07.07.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Klejda Meçi është miratuar dhënia e lejes për kryerjen e pushimeve vjetore për gjyqtarët aktivë dhe administratën gjyqësore për vitin 2025, si edhe është caktuar kalendari për caktimin e gjyqtarëve të gatshëm përgjatë gjithë vitit sipas tabelës më poshtë:

Përmbajtja e këtij urdhri pasqyrohet në mënyrë të përmblodhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Gjyqtari	Urdhër nr. 143, datë 07.07.2025	
		Periudha e lejes për muajin Gusht	Periudha e gatishmërisë
1	Ardiola Çela	01.08.2025-21.08.2025	22.08.2025-31.08.2025
2	Ervis Koxhaj	22.08.2025-31.08.2025	11.08.2025-21.08.2025
3	Ilirjan Hysa	22.08.2025-31.08.2025	11.08.2025-21.08.2025
4	Renis Bega	04.08.2025-22.08.2025	-
5	Lumturi Zhupa	Leje Lindje	
6	Klejda Meçi	11.08.2025-31.08.2025	01.08.2025-10.08.2025

##### 2.4.2. Kërkesat për leje gjatë vitit

Nga ana e gjyqtarit Ervis Koxhaj, kërkesa për miratimin e lejes vjetore të papërdorur për vitin 2024, specifikisht për datën 13.03.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës, mban datën 03.03.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 48, datë 03.03.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes përkatëse për 1 ditë kalendarike.

Në ana e gjyqtarit Ilirjan Hysa, kërkesa për miratimin e një pjese të lejes vjetore për shkak të punës në muajin gusht, specifikisht në datat 19.05.2025-23.05.2025, mban datën

05.05.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 97, datë 05.05.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes për 5 ditë kalendarike.

Gjithashtu, kërkesa për miratimin e lejes për shkak të mosparaqitjes në punë për periudhën 07.03.2025 - 09.03.2025 e cila lidhet me angazhime profesionale, specifikisht me pjesëmarrjen e gjyqtarit në konferencë ndërkombëtare, mban datën 04.03.2025. Në vijim, rezulton që kjo kërkesë të jetë miratuar nëpërmjet urdhrit nr. 50, datë 04.03.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës Klejda Meçi, për dhënien e lejes për 3 ditë kalendarike.

Nga ana e gjyqtares Lumturi Zhupa, kërkesa për miratimin e lejes vjetore të papërdorur për vitin 2024, specifikisht në periudhën 28.04.2025 - 07.05.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës, mban datën 01.04.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 72, datë 01.04.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes përkatëse për 7 ditë kalendarike.

Nga ana e gjyqtarit Renis Bega, kërkesa për miratimin e lejes vjetore të papërdorur për vitin 2024, specifikisht në datën 13.03.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës, mban datën 03.03.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 47, datë 03.03.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes përkatëse për 1 ditë kalendarike.

Gjithashtu, kërkesa për miratimin e lejes vjetore të papërdorur për vitin 2024, specifikisht në datat 07, 08, 10, 14, 15 korrik 2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës, mban datën 04.07.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 139, datë 04.07.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes përkatëse për 5 ditë kalendarike.

Nga ana e gjyqtares Ardiola Çela, kërkesa për miratimin e lejes vjetore të papërdorur për vitin 2024, specifikisht në periudhën 10.03.2025-16.03.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës, mban datën 06.02.2025. Në vijim, ka dalë urdhri nr. 35, datë 07.02.2025 mbi miratimin e kësaj kërkesë dhe dhënien e lejes përkatëse për 5 ditë kalendarike.

### **2.4.3. Raportet mjekësore.**

**Përsa i përket raporteve mjekësore**, nga ana e gjykatës bëhet me dije se për periudhën 27.01.2025 - 29.01.2025 nga ana e gjyqtares Klejda Meçi është paraqitur raport mjekësor.

Ndërsa duke filluar nga data 12.05.2025 gjyqtarja Lumturi Zhupa ka përfitur lejen e lindjes.

Gjetje:

1. Nga shqyrtimi i të dhënave përsa i përket kërkesave dhe vendimeve për miratimin e lejes vjetore konstatohet se gjyqtarët Ilirjan Hysa, Lumturi Zhupa, Renis Bega në rastin kur kanë kërkuar më tepër se tre ditë leje, nuk e kanë paraqitur kërkesën për leje të paktën një muaj para marrjes së lejes.
2. Referuar kalendarit të seancave të planifikuara konstatohet se gjyqtarët kanë planifikuar seanca edhe në ato data për të cilat kanë kërkuar dhe është miratuar leja vjetore.

## 2.5. Sallat e gjykimit

Në këtë gjykatë funksionojnë 5 salla gjykimi. Sipas analizës vjetore të gjykatës të vitit 2024, në këto 5 salla gjatë vitit 2024 është bërë i mundur instalimi dhe funksionimi i pajisjeve të kamerave audiovizive. Referuar materialit të përcjellë nga gjykata, përsa i përket ndarjes së sallave sipas gjyqtarëve dhe trupave gjykues që do zhvillojnë seanca në to, situata në këtë gjykatë është rregulluar sipas Urdhrit nr. 01, datë 11.01.2024.

Ndarja e sallave sipas gjyqtarëve në gjykatë, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Nr. i sallës	Gjyqtari	Shfrytëzimi i sallave në funksion të gjykatës
1	Ardiola Çela	Do të punojë gjyqtare Ardiola Çela si dhe do të zhvillohen seanca gjyqësore për vleftësimin e masave të arrestit dhe caktim mase sigurimi si dhe gjykime penale me të arrestuar
2	Lumturi Zhupa	
3	Klejda Meçi	
4	Entela Gjoni	Si dhe do të zhvillohen të gjitha gjyqet penale me të pandehur të arrestuar, në seancë paraprake dhe në seancë gjyqësore
5	Ilirjan Hysa	

*Gjetje:* Pas daljes së Urdhrit nr. 1, datë 11.01.2024 në përbërjen e gjykatës ka pasur ndryshime si në drejtim të ndryshimit të gjyqtarëve, ashtu edhe në drejtim të numrit të gjyqtarëve. Këto ndryshime nxisin nevojën e rregullimit të përdorimit të sallave sipas organikës koherente.

## 2.6. Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS, i cili përveç të tjerash mundëson dhe ndarjen e çështjeve me short. Në gjykatë funksionon edhe Sistemi i Regjistrimit Audio (RDA).

**2.6.1. Fakte të konstatuara në lidhje me saktësinë e “kalendarit të seancave të planifikuara” të përcjellë nga gjykata<sup>24</sup> krahasuar me të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve përsa i përket “RIV” dhe “procesverbaleve të seancave”**

Duke qenë se inspektimi do të mbështetet kryesisht tek të dhënat e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga gjykata përsa i përket planifikimit të seancave gjyqësore nga secili gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, është vlerësuar fillimisht të verifikohet saktësia e të dhënave të vendosura në dispozicion nga gjykata.

Saktësia e të dhënave statistikore është shumë e rëndësishme, jo vetëm në drejtim të matjes së performancës dhe efikasitetit të gjykatës por edhe në drejtim të transparencës, llogaridhënies, evidentimit të problematikave si dhe identifikimit të nevojave për përmirësime të vazhdueshme të veprimtarisë gjyqësore. Statistikat jo të plota apo me gabime, shtrembërojnë panoramën reale të gjendjes së gjyqësorit dhe sjellin si pasojë vlerësime jo të sakta dhe strategji joefektive të cilat nuk përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë, efektivitetit edhe eficiencës së gjykatës.

Me qëllim verifikimit të të dhënave në lidhje me planifikimet përsa i përket çështjeve të rishortuara gjatë periudhës së inspektimit është përzgjedhur një çështje për secilin gjyqtar.

Këto çështje paraqiten si më poshtë:

1. Çështja nr. 50547-01236-63-2024 Regj., datë 25.09.2024.

Përsa i përket informacionit të ardhur nga gjykata rezulton se të gjitha seancat në lidhje me këtë çështje janë planifikuar nga gjyqtari Renis Bega.

Referuar Regjistrin të Veprimeve (RIV) dhe procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve rezulton se kjo çështje i është caktuar gjyqtarës Lumturi Zhupa nëpërmjet shortit datë 25.09.2024 e cila ka vijuar me planifikimet e seancave. Në vijim çështja është rishortuar në datën 13.05.2025 dhe i kaluar për t'u trajtuar gjyqtarit Renis Bega.

Konstatim: Jo të gjitha seancat janë planifikuar nga gjyqtari Renis Bega.

2. Çështja nr. 59121-00606-63-2024 Regj., datë 25.04.2024.

Përsa i përket informacionit të ardhur nga gjykata rezulton se të gjitha seancat në lidhje me këtë çështje janë planifikuar nga gjyqtare Klejda Meçi.

Referuar Regjistrin të Veprimeve (RIV) dhe procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve, rezulton se kjo çështje i është caktuar gjyqtarës Lumturi Zhupa nëpërmjet shortit datë 25.04.2024. Në vijim, çështja është rishortuar në datën 13.05.2025 dhe i kaluar për t'u trajtuar gjyqtarës Klejda Meçi.

Konstatim: Jo të gjitha seancat janë planifikuar nga gjyqtare Klejda Meçi.

<sup>24</sup> Me shkresën nr. 2117/1, datë 11.11.2025.

3. Çështja nr. 52810-00216-63-2025 Regj., datë 12.02.2025.

Përsa i përket “kalendarit të planifikimit të seancave” të përcjellë nga gjykata rezulton se të gjitha seancat në lidhje me këtë çështje janë planifikuar nga gjyqtari Ilirjan Hysa. Referuar Regjistrin të Veprimeve (RIV) dhe procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve, rezulton se kjo çështje i është caktuar gjyqtarës Lumturi Zhupa nëpërmjet shortit të datës 12.02.2025. Në vijim çështja është rishortuar në datën 13.05.2025 dhe i kaluar për t’u trajtuar gjyqtarit Ilirjan Hysa.

Konstatim: Jo të gjitha seancat janë planifikuara nga gjyqtari Ilirjan Hysa.

4. Çështja nr. 520005-00237-63-2025 Regj., datë 17.02.2025.

Përsa i përket informacionit të ardhur nga gjykata rezulton se të gjitha seancat në lidhje me këtë çështje janë planifikuar nga gjyqtare Ardiola Çela.

Referuar Regjistrin të Veprimeve (RIV) dhe procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve rezulton se kjo çështje i është caktuar gjyqtarës Lumturi Zhupa nëpërmjet shortit të datës 17.02.2025 e cila ka vijuar me planifikimet. Në vijim çështja është rishortuar në datën 13.05.2025 dhe i kaluar për t’u trajtuar gjyqtarës Ardiola Çela.

Konstatim: Jo të gjitha seancat janë planifikuara nga gjyqtare Ardiola Çela

5. Çështja nr. 520003-00037-63-2025 regj., datë 17.01.2025.

Përsa i përket informacionit të ardhur nga gjykata rezulton se të gjitha seancat në lidhje me këtë çështje janë planifikuar nga gjyqtare Ervis Koxhaj.

Referuar Regjistrin të Veprimeve (RIV) dhe procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve, i cili është administruar nëpërmjet faqes elektronike të menaxhimit të çështjeve të gjykatës (ICMIS), rezulton se kjo çështje i është caktuar gjyqtarës Lumturi Zhupa nëpërmjet shortit datë 20.01.2025 e cila ka vijuar me planifikimet. Në vijim është rishortuar në datën 13.05.2025 dhe i kaluar për t’u trajtuar gjyqtarës Ervis Koxhaj.

Konstatim: Jo të gjitha seancat janë planifikuara nga gjyqtari Ervis Koxhaj

### Gjetje në lidhje me “kalendarin e planifikimit të seancave” të përcjella nga gjykata:

1. Ka pasaktësi të të dhënave të informacionit të përcjellë nga gjykata në lidhje me “kalendarin e seancave të planifikuara” për secilin gjyqtar;

2. Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk pasqyron të dhëna të sakta përsa i përket “kalendarit të planifikimit të seancave” në lidhje me çështjet e rishortuara. Problematika konsiston në faktin që sistemi ia përllëgarit vetëm gjyqtarit të caktuar së fundmi të gjitha planifikimet e seancave.

2.7. Në vijim të verifikimit të të dhënave të hedhura në sistemin elektronik janë përzgjedhur në mënyrë rastësore 5 fashikuj gjyqësor fizik, të cilat ndodheshin në ambientin e gjykatës, si më poshtë:

1. Çështja nr. 21017-01201-63-2024 Regj, datë 20.12.2024

**Fakte të konstatuara:**

Për këtë çështje, referuar kalendarit të planifikimeve të përcjellë nga gjykata, figuron të jetë planifikuar në datë 08.01.2025, ora 10:00, seanca nga gjyqtare Klejda Meçi.

Në përmbajtjen e dosjes fizike me objekt padie “Urdhër Mbrojtje i menjëhershëm” është administruar procesverbali datë 08.05.2025, RIV (Regjistrit të veprimeve) i çështjes dhe Skeduli çështjes. Referuar këtij procesverbali, konstatohet se kjo seancë është çelur në orën 10:56.

2. Çështja nr. 21017-01203-63-2024 Regj., datë 22.12.2024

**Fakte të konstatuara:**

Për këtë çështje, referuar kalendarit të planifikimeve të përcjellë nga gjykata, figuron të jetë planifikuar në datë 08.01.2025, ora 10.00, seanca nga gjyqtare Klejda Meçi.

Në përmbajtjen e dosjes fizike me objekt padie “Urdhër Mbrojtje i menjëhershëm i menjëhershëm”, disponohen procesverbalet e seancave të datës 23.12.2024 dhe 08.01.2025, RIV (Regjistri i veprimeve) i çështjes dhe Skeduli çështjes.

Në procesverbalin e datës 08.01.2025, ora 10:33, të mbajtur nga gjyqtarja Klejda Meçi, konstatohet se kjo seancë është çelur në orën 10:23.

3. Çështja nr. 21298-00391-63-2024 Regj., datë 11.04.2024

**Fakte të konstatuara:**

Për këtë çështje, referuar kalendarit të planifikimeve të përcjellë nga gjykata figuron të jetë planifikuar në datë 08.05.2025, ora 13:30, seanca nga gjyqtari Ilirjan Hysa.

Në përmbajtjen e dosjes fizike me objekt padie “kallëzimi i një punimi të ri dhe sigurim padie” është administruar procesverbali i mosçeljes së seancës të datës 08.05.2025, RIV (Regjistrit të veprimeve) i çështjes dhe Skeduli çështjes. Referuar këtij procesverbali figuron se seanca e datës 08.05.2025 është planifikuar nga gjyqtarja Lumturi Zhupa, por kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore bazuar në raportin mjekësor të administruar në dosje.

4. Çështja nr. 11118-00203-63-2021 Regj., datë 02.03.2021

**Fakte të konstatuara:**

Për këtë çështje, referuar kalendarit të planifikimeve të përcjellë nga gjykata figuron të jetë planifikuar në datë 08.05.2025, ora 13:30, seanca nga gjyqtari Ilirjan Hysa.

Në përmbajtjen e dosjes fizike me objekt padie “Urdhër Mbrojtje i menjëhershëm” është administruar procesverbali i mosçeljes së seancës të datës 08.05.2025, RIV (Regjistrit të veprimeve) i çështjes dhe Skeduli çështjes. Referuar këtij procesverbali figuron se seanca e datës 08.05.2025 është planifikuar nga gjyqtarja Lumturi Zhupa por kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore bazuar në raportin mjekësor të administruar në dosje.

5. Çështja nr. 21017-00001-63-2025 regj., datë 03.01.2025

**Fakte të konstatuara:**

Për këtë çështje, referuar kalendarit të planifikimeve të përcjellë nga gjykata figurojnë të jenë planifikuar 2 seanca nga gjyqtari Renis Bega në datë 04.01.2025, ora 10.50

Në përmbajtjen e dosjes fizike me objekt padie “Urdhër Mbrojtje i menjëhershëm” është administruar procesverbali i seancës të datës 04.01.2025, RIV (Regjistrit të veprimeve) i çështjes dhe Skeduli çështjes. Në procesverbalin e datës 04.01.2025, konstatohet se kjo seancë është çelur në orën 11:05:51.

**Gjetje:** Konstatohen raste me një diferencë me më tepër se 15 minuta midis orës së planifikimit të seancës referuar “kalendarit të planifikimit të seancave” dhe orës së çeljes së seancës referuar “Procesverbaleve të seancave” të administruar ne fashikujt gjyqësor përkatës.

**3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi**

**3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja**

Referuar raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2024, Gjkata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat rezulton se është gjykata e cila ka mbartur rreth 2.7 - 2.9% të stokut të përgjithshëm, konkretisht ka mbartur 1265 çështje nga numri total prej 43853 çështje, duke u renditur gjykata e katërt me numrin më të pakët të çështjeve.

Gjithashtu edhe në lidhje me çështjet e reja të regjistruara konstatohet se në këtë gjykatë gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 2868 çështje duke u renditur në vendin e 5-të për sa i përket numrit më të ulët të çështjeve të regjistruara.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2024 ka qenë 750 çështje për gjyqtar. Ndërkohë që ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për vitin 2024 ka qenë 961 çështje për gjyqtar, duke qenë gjykata e cila ka nivelin më të lartë të rritur me 35 % më shumë se një vit më parë për sa i përket ngarkesës mesatare. Konstatohet se ka gjykata të cilat kanë një ngarkesë mesatare më pak se gjysmën e kësaj ngarkese sikurse është Gjykata Kukës me 396 çështje dhe Gjykata Dibër me 418 çështje.

**Gjykata e Beratit e ka filluar vitin 2025 me 1224 çështje të mbartura. Gjatë periudhës 01.01.2025-20.10.2025 janë regjistruar gjithsej 1853 çështje të reja.**

Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në total është 3082 çështje. Ngarkesa për secilin gjyqtar pasqyrohet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Gjyqtari	Nr. i çështjeve të mbartura nga viti 2024	Nr. i çështjeve të reja për periudhën 01.01.2025-20.10.2025	Nr. i çështjeve gjithsej në datë 20.10.2025
1	Renis Bega	219	332	551
2	Ardiola Çela	274	372	646
3	Ilirjan Hysa	277	377	654
4	Ervis Koxhaj	229	378	607
5	Klejda Meçi	94	325	419
6	Lumturi Zhupa	130	74	204
7	Vladimir Cjapi (komanduar)	1	0	1
	<b>TOTALI</b>	<b>1224</b>	<b>1858</b>	<b>3082</b>

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi

Referuar raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësorë për vitin 2024, konstatohet se rendimenti mesatar i punës<sup>[25]</sup> për gjyqtar në vitin 2024, për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, është 516 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës Berat ka gjykuar mesatarisht 676 çështje. Ky tregues jo vetëm që është mbi mesataren, por përbën vlerën më të lartë në krahasim me gjykatat e tjera në drejtim të përmirësimit të ndjeshëm të rendimentit të vetë kësaj gjykate krahasuar me një vit më parë me një rritje prej 37 %. Gjithashtu, kjo gjykatë gjatë vitit 2024 ka pasur rendimentin më të lartë në punë për gjyqtar duke u ndjekur nga Gjykata e Gjirokastrës me 657 çështje për gjyqtar.

Në lidhje me çështjet penale, treguesit e kësaj gjykate janë mbi mesataren përse i përket normës mesatare të likuidimit të çështjeve penale<sup>[26]</sup> si dhe kohës mesatare për zgjidhjen e çështjeve. Ndërsa, përse i përket çështjeve civile në lidhje me këtë tregues, kjo gjykatë nuk ka arritur nivelin mesatar. Konkretisht, ndonëse norma mesatare e likuidimit të çështjeve civile për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është 103 %, për Gjykatën Berat ky tregues është 95%, që do të thotë se është shtuar stoku i çështjeve të pashqyrtuara. Ndonëse vlera mesatare për evadimin e çështjeve në vitin 2024 është 256 ditë, ky tregues për Gjykatën Berat është 275 ditë.

<sup>25</sup> Rendimenti mesatar i punës (treguesi ER) si tregues i rëndësishëm i eficiencës - Raporti ndërmjet çështjeve të zgjidhura dhe numrit të gjyqtarëve efektivë gjatë periudhës së raportimit.

<sup>26</sup> Norma e likuidimit të çështjeve (treguesi CR) – Raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja dhënë në përqindje.

Referuar të dhënave statistikore, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 janë shpallur gjithsej 2158 vendime, përkatësisht 2157 vendime nga 6 gjyqtarë si dhe 1 vendim nga gjyqtari Vladimir Cjapi i cili është komanduar vetëm për 1 çështje.

Numri i vendimeve të shpallura për secilin gjyqtar është pasqyruar sipas tabelës së mëposhtme:

Gjyqtari	Renis Bega	Ardiola Çela	Ilirjan Hysa	Ervis Koxhaj	Klejda Meçi	Lumturi Zhupa
Nr. i vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025	320	459	484	407	283	204

### 3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore për gjykatën dhe secilin gjyqtar

Numri total i planifikimit të seancave gjyqësore në nivel gjykate për gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është 6522 seanca.

Referuara të dhënave përsa i përket planifikimeve të seancave brenda një dite pune, u konstatuan ndër të tjera problematika të llojit si:

- E njëjta çështje figuron të jetë planifikuar dy herë në të njëjtën orë dhe në të njëjtën sallë<sup>27</sup>.
- Dy çështje të ndryshme figurojnë të jenë planifikuar në të njëjtën datë, orë dhe sallë nga i njëjti gjyqtar. Disa raste të cilat pasqyrojnë këtë lloj problematike janë paraqitur më poshtë:

**Rast nr. 1:** Çështja me nr. 110002-00379-63-2024, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtarja Lumturi Zhupa, në datën 25.03.2025, në orën 11:00:00, në sallën nr. 1. Çështja me nr. 61000-00374-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtarja Lumturi Zhupa, në datën 25.03.2025, në orën 11:00:00, në sallën nr. 1.

**Rast nr. 2:** Çështja me nr. 70110-00211-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Renis Bega, në datën 03.03.2025, në orën 13:30:00, në sallën nr. 2. Çështja me nr. 21001-01138-63-2024, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Renis Bega, në datën 03.03.2025, në orën 13:30:00, në sallën nr. 2.

<sup>27</sup> Çështja me nr. 21001-01219-63-2024, është planifikuar të zhvillohet, në datën 27.01.2025, në orën 13:00:00, në sallën nr. 4.

**Rast nr. 3:** Çështja me nr. 21017-00127-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtarja Klejda Meçi, në datën 03.03.2025, në orën 10:45:00, në sallën nr. 3.

Çështja me nr. 520005-01647-63-2024, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtarja Klejda Meçi, në datën 03.03.2025, në orën 10:45:00, në sallën nr. 3.

**Rast nr. 4:** Çështja me nr. 520005-00356-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Ilirjan Hysa, në datën 03.04.2025, në orën 10:15:00, në sallën nr. 5.

Çështja me nr. 21001-00822-63-2024, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Ilirjan Hysa, në datën 03.04.2025, në orën 10:15:00, në sallën nr. 5.

- Planifikime seancash me një diferencë shumë të shkurtër kohore nga njëra-tjetra deri edhe prej 2 minutash brenda të njëjtës ditë. Më poshtë po paraqesim për ilustrim një rast të konstatuar:

#### **Rasti nr. 1:**

Çështja me nr. 21001-00029-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Ervis Koxhaj, në datën 03.04.2025, në orën 13:28:00, në sallën nr. 4.

Çështja me nr. 11213-00314-63-2025, është planifikuar të zhvillohet nga gjyqtari Ervis Koxhaj, në datën 03.04.2025, në orën 13:30:00, në sallën nr. 4.

#### **3.3.1. Shpërndarja e planifikimeve në nivel ditor**

Nga vëzhgimi i shpërndarjes së seancave gjatë ditëve të punës, konstatohet një variacion ekstrem si përsa i përket planifikimeve brenda një ditë ashtu edhe përsa i përket shpërndarjes së planifikimeve në ditë të caktuar të javës.

Konkretisht, në lidhje me përqendrimin e ngarkesës së planifikimeve brenda një dite pune, konstatohet variacion ekstrem nga 24 seanca në një ditë deri në 0-1 seanca në një ditë. Konkretisht:

- Gjyqtari Ilirjan Hysa: **24 seanca** (25 mars; 8 korrik), **22 seanca** (6 shkurt), **20-21 seanca** (në disa ditë në mars dhe qershor).
- Gjyqtari Renis Bega: deri në **22 seanca** (8 prill).
- Gjyqtare Ardiola Çela dhe Lumturi Zhupa: deri në 20-21 seanca në disa ditë.
- Gjyqtare Klejda Meci: deri në **19 seanca**.

Gjithashtu, konstatohet se ka ditë të punës në të cilat të gjithë gjyqtarët kanë mundësi planifikimi ose vetëm 1 seancë të planifikuar.


Nga përpunimi i të dhënave për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025 rezulton se gjyqtarët kanë planifikuar seanca sipas tabelës së mëposhtme:

Gjyqtaret	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë	Totali
Renis Bega	410	425	88	417	3	6	3	1352
Ardiola Çela	384	365	404	119	32	6	2	1312
Ilirjan Hysa	454	482	105	526	54	9	6	1636
Lumturi Zhupa	83	98	5	36	1	3	2	228
Klejda Meçi	233	32	217	13	86	8	37	626
Ervis Koxhaj	467	425	265	175	25	4	7	1368
<b>Totali</b>	<b>2031</b>	<b>1827</b>	<b>1084</b>	<b>1286</b>	<b>201</b>	<b>36</b>	<b>57</b>	<b>6522</b>

Nga analiza e të dhënave në nivel gjyqate, konstatohet se numri më i lartë i seancave të planifikuara përkon me ditën e hënë me 2031 seanca të planifikuara (31.1% e seancave totale), ndjekur nga dita e martë me 1827 seanca të planifikuara. Ky rit planifikimesh ulet dy ditët e tjera të javës, përkatësisht ditën e mërkurë me 1084 seanca dhe ditën e enjte (me një rritje të lehtë) prej 1286 seanca. Numri i planifikimeve pëson një rënie drastike ditën e premte me 201 seanca.

Dita e shtunë dhe dita e diel janë ditë pushimi dhe për këtë arsye numri i planifikimeve në këto ditë lidhet vetëm me çështjet të cilat gjyqtarët planifikojnë dhe zhvillojnë për shkak të përfshirjes në listën e gatishmërisë.

**Planifikimi i shprehur në %, në nivel gjyqate, referuar ditëve të tjera të javës pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:**



### 3.3.2. Faktet e konstatuara dhe analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor.

Gjatë periudhës së inspektimit 01.01.2025 - 31.10.2025 janë planifikuar në total në nivel gjyqate 6522 seanca.

Referuar planifikimeve të seancave në nivel mujor konstatohet se shpërndarja e seancave nga muaji në muaj për këtë gjykatë karakterizohet nga një variacion shumë i madh konkretisht nga 455 seanca në një muaj deri në 949 seanca të planifikuara në një muaj tjetër (një diferencë më shumë se dyfish). Në këtë analizë nuk kemi marrë parasysh muajin gusht.

Seancat e planifikuara në total dhe nga secili gjyqtar pasqyrohen sipas tabelës së mëposhtme:

Gjyqtari Muaji	Renis Bega	Ardiola Cela	Ilirjan Hysa	Lumturi Zhupa	Klejda Meci	Ervis Koxhaj	Totali i seancave për periudhën e inspektimit
Janar	93	121	105	35	37	64	455
Shkurt	169	171	209	71	97	138	855
Mars	153	117	203	79	86	146	784
Prill	208	207	211	43	78	202	949
Maj	152	173	178		85	147	735
Qershor	164	198	218		77	167	824
Korrik	120	145	169		72	146	652
Gusht	0	15	1		10	42	68
Shtator	124	98	161		38	139	560
Tetor	169	67	181		46	177	640
Totali seancave për periudhën e inspektimit	1352	1312	1636	228	626	1368	6522

- Nga analiza e të dhënave përse i përket planifikimeve të seancave përgjatë muajve në nivel gjykate konstatohet se:

Muaji janar: Në total gjatë këtij muaji janë planifikuar 455 seanca në nivel gjykate. Fillimi i vitit 2025 fillon me ritëm më të ngadaltë në krahasim me muajt në vijim. Tre javët e para të muajit janar janë pothuajse bosh (përveç çështjeve të planifikuara për shkak të gatishmërisë), ndërkohë që viti i ri i punës përse i përket planifikimeve fillon realisht në datë 20 janar.

Mungesa e planifikimit gjatë kësaj periudhe është si rrjedhojë e përkimit të kësaj periudhe me festat e Vitit të Ri, si dhe mbartjeve të dosjeve nga viti paraardhës. Praktikisht rezulton se, një e treta e muajit janar është periudhë joaktive përse i përket planifikimeve.

Muaji shkurt: Gjatë këtij muaji gjykata rrit ritmin e planifikimeve: 855 seanca të planifikuara, pothuajse dyfishi i muajit janar.

Muaji mars: Gjatë këtij muaji janë planifikuar 782 seanca që do të thotë se ka qenë një muaj aktiv planifikimesh, megjithëse festat (Dita e Verës, Nevruzi, Bajrami) kanë krijuar ndërprerje të planifikimeve.

Muaji prill: Ky është muaji me interesant nga pikëpamja analitike. Me 949 seanca, muaji prill ka numrin më të lartë të seancave të planifikuara.


Muaji maj, qershor, korrik: Pas muajit prill konstatohet ulje - ngritje në ritin e planifikimeve, konkretisht muaji maj ul ritmin në 735 seanca, pëson rritje në qershor me 824 seanca dhe përsëri ritmi i planifikimeve ulet në muajin korrik me 652 seanca duke kulmuar me ritmin më të ulët me muajin gusht me 68 seanca.

Muaji gusht është faktikisht muaj joaktiv përse i përket planifikimeve me vetëm 68 seanca për shkak se gjyqtarët planifikojnë lejen vjetore gjatë kësaj periudhe. Për këtë arsye gjatë këtij muaji në gjykatë planifikohen dhe zhvillohen vetëm çështjet e ngutshme nga gjyqtarët e caktuar si gjyqtarë të gatshëm për muajin gusht.

Muaji shtator, tetor: Ndonëse në lidhje me muajin gusht është e natyrshme që të planifikohen më pak seanca për shkak të lejes vjetore, ajo çfarë konstatohet është se në lidhje me muajin shtator planifikimet rikthehen në nivel më të ulët se numri i planifikimeve të korrikut, pra nga 652 seanca në total për gjykatën, për muajin shtator janë planifikuar 560 seanca.

Muaji shtator dhe tetor janë muaj rikthimi gradual në ritin e zakonshëm të punës. Tetori rritet pak (640 seanca) por përsëri gjykata nuk e arrin ritmin e shkurtit apo prillit.

Numri i seancave për çdo muaj paraqitet në grafikun më poshtë:



**Gjetje:**

**Muaji më i ngarkuar:** Muaji prill ka qenë muaji më i ngarkuar me seanca të planifikuara si në nivel gjykate me numrin maksimal 949 seanca, ashtu edhe për secilin gjyqtar që varion nga 202 deri në 211 seanca të planifikuara.

**Muajt e ngarkuar** (mbi 700 seanca): Muajt më shumë të ngarkuar me planifikime seancash pas muajit prill, janë muaji shkurt me 855 seanca, muaji mars me 784 seanca, muaji maj me 735 seanca, muaji qershor me 824 seanca.

**Muajt më pak të ngarkuar:** Muajt më pak të ngarkuar me planifikime seancash janë muaji shtator me 560 seanca, muaji janar me 455 seanca dhe muaji gusht me 68 seanca.

- **Nga analiza e të dhënave përse i përket planifikimeve sipas gjyqtarëve konstatohet se:**

Gjyqtarët Renis Bega<sup>[28]</sup>, Ardiola Çela<sup>[29]</sup> dhe Ervis Koxhaj<sup>[30]</sup> kanë një shifër të përafërt planifikimesh mbi 1300 seanca. Ndërsa gjyqtari Ilirjan Hysa ka planifikuar 1636 seanca duke u dalluar për numrin më të lartë të planifikimeve në krahasim me gjyqtarët e tjerë.

**Gjyqtari i cili ka planifikuar më shumë:** Gjyqtari Ilirjan Hysa ka planifikuar numrin më të madh të seancave dhe konkretisht 218 seanca të cilat i ka planifikuar në muajin qershor.

**Gjyqtarët me planifikime mbi 200 seanca në muaj:** Gjyqtari Ilirjan Hysa 209 seanca në muajin shkurt; 203 seanca në muajin mars; 211 seanca në muajin prill; 218 seanca në muajin qershor.

Gjyqtarët e tjerë të cilët kanë planifikuar më shumë se 200 seanca janë gjyqtari Renis Bega, gjyqtare Ardiola Cela dhe gjyqtari Ervis Koxhaj. Këtë numër seancash gjyqtarët e kanë planifikuar vetëm gjatë muajit prill ndërsa gjatë muajve të tjerë këta gjyqtarë kanë planifikuar më pak se 200 seanca.

**Gjyqtari me planifikime më pak për çdo muaj:** Gjyqtarja Lumturi Zhupa e cila ka punuar vetëm katër muaj për shkak të përfitimit të lejes së lindjes si dhe gjyqtarja Klejda Meci e cila ka cilësinë e Zv/Kryetares së Gjykatës.

### **3.3.3. Korrelacioni strukturor midis ngarkesës, planifikimit/zhvillimit dhe vendimmarrjes.**

- **Ngarkesa/Rishortimet**

Referuar të dhënave në lidhje me ngarkesën totale në datë 20.10.2025, rezulton se gjyqtari më i ngarkuar është gjyqtari Ilirjan Hysa me 654 çështje ndjekur nga gjyqtare Ardiola Çela me 646 çështje, gjyqtari Ervis Koxhaj me 607 çështje dhe gjyqtari Renis Bega me

<sup>28</sup> Ka planifikuar 1352 seanca.

<sup>29</sup> Ka planifikuar 1312 seanca.

<sup>30</sup> Ka planifikuar 1368 seanca.

551 çështje. Gjyqtarja më pak e ngarkuar është gjyqtare Klejda Meçi njëkohësisht Zv/Kryetare e Gjykatës, me 419 çështje.

Në lidhje me ngarkesën konstatohet se gjyqtarët përveç ngarkesës përse i përket çështjeve të shortuara për herë të parë, kanë marrë edhe ngarkesën e cila është krijuar si rezultat i rishortimeve. Nga informacioni i përcjellë nga gjykata ka rezultuar se përgjatë periudhës objekt inspektimi, në këtë gjykatë rezulton të jenë rishortuar çështjet e gjyqtarës Lumturi Zhupa. Kjo shpërndarje është bërë në datat 15.05.2025 ku përkatësisht janë shortuar 204 çështje dhe 13.05.2025 për 83 çështje<sup>[31]</sup>.

Rishortimi i çështjeve te magjistratët pasqyrohet sipas tabelës së mëposhtme:

Shorti i datës 13.05.2025			Shorti i datës 15.05.2025		
Nr.	Magjistrati	Shortuar	Nr.	Magjistrati	Shortuar
1	Ilirjan Hysa	18	1	Ilirjan Hysa	44
2	Ervis Koxhaj	13	2	Ervis Koxhaj	40
3	Ardiola Çela	18	3	Ardiola Çela	40
4	Klejda Meçi	15	4	Klejda Meçi	42
5	Renis Bega	19	5	Renis Bega	38
	<b>Totali</b>	<b>83</b>		<b>Totali</b>	<b>204</b>

**Gjetje e përsëritur:** Në lidhje me çështjet e sipërcituara të cilat kanë kaluar nga gjyqtare Lumturi Zhupa nëpërmjet rishortimit tek gjyqtarët e tjerë është konstatuar se referuar “kalendarit të seancave të planifikuara”, Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të gjykatës ia përllongarit gjyqtarit të fundit të gjitha seancat e planifikuara, ndonëse para datës 12.05.2025 seancat janë planifikuar nga gjyqtare Lumturi Zhupa.

- **Regjistrimi audio i seancave të zhvilluara.**

Gjykata ka përcjellë pranë ILD-së të dhënat në lidhje me numrin e seancave audio të zhvilluara nga secili gjyqtar si dhe % që zënë këto seanca kundrejt totalit të seancave. Nga analiza e të dhënave rezulton se jo të gjitha seancat janë zhvilluar me regjistrim audio. Konkretisht, për periudhën objekt inspektimi janë zhvilluar me regjistrim audio në total 5629 seanca ose 76%.

<sup>31</sup> Gjithashtu janë edhe 3 çështje për të zgjedhur kryesuesin midis dy anëtarëve bazuar në vendimin e KLGJ nr. 724/2023.

**Të dhënat e përcjella nga gjykata në lidhje me këtë tregues pasqyrohen sipas tabelës së mëposhtme:**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Kalendari i totalit të seancave audio sipas raportimit të RDA

Gjyqtari	Renis Bega		Ardiola Cela		Iirjan Hysa		Lumturi Zhupa		Klejda Meci		Ervis Koxhaj		Totali	
	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Nr. Seancave Audio	% e seancave audio	Seanca në muaj	% e seancave audio për muajin
Janar	73	96.1%	96	82.1%	106	98.1%	64	100.0%	25	67.6%	53	89.8%	417	89.0%
Shkurt	149	100.0%	119	71.3%	200	97.1%	75	97.4%	71	76.3%	142	98.6%	756	90.1%
Mars	133	89.9%	78	63.9%	195	94.2%	79	90.8%	76	88.4%	129	91.5%	690	86.5%
Prill	134	68.0%	157	78.1%	173	84.0%	36	83.7%	79	88.8%	168	86.2%	747	81.5%
Maj	137	93.8%	117	70.5%	158	84.9%	0	0	63	78.8%	129	92.1%	604	70.0%
Qershor	151	98.7%	177	93.7%	204	98.6%	0	0	69	93.2%	160	98.8%	761	80.5%
Korrik	72	58.1%	131	91.0%	194	99.0%	0	0	54	75.0%	159	100.0%	610	70.5%
Gusht	0	0.0%	13	86.7%	1	100.0%	0	0	7	70.0%	40	97.6%	61	59.1%
Shtator	85	68.5%	82	82.8%	147	90.7%	0	0	13	38.2%	128	91.4%	455	61.9%
Tetor	145	88.4%	44	77.2%	157	83.1%	0	0	41	97.6%	141	83.9%	528	71.7%
<b>Total</b>	<b>1079</b>	<b>76.2%</b>	<b>1014</b>	<b>79.7%</b>	<b>1535</b>	<b>93.0%</b>	<b>254</b>	<b>37.2%</b>	<b>498</b>	<b>77.4%</b>	<b>1249</b>	<b>93.0%</b>	<b>5629</b>	<b>76.1%</b>

Referuar të dhënave të përcjella nga gjykata pranë ILD-së krahasuar me të dhënat e përcjella nga gjykata pranë KLGJ-së, referuar raporteve 3-mujore, konstatohet se këto të dhëna nuk përputhen. Konkretisht, në total për periudhën janar 2025 - tetor 2025 sipas raportimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë numri i seancave audio është 5101, ndërsa sipas raportimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor është 5490 seanca.

**Gjetje:** Nga analiza e të dhënave për gjykatën rezulton se për periudhën objekt inspektimi janë zhvilluar me regjistrim audio në total 5629 seanca ose 76%. Nga inspektimi rezultoi se ka mospërputhje të të dhënave të përcjella nga gjykata pranë ILD-së krahasuar me të dhënat e përcjella nga gjykata pranë KLGJ-së referuar raporteve tre-mujore mbi numrin e seancave audio.

Mospërputhjet e konstatuara janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Gjyqtari	Renis Bega		Ardiola Cela		Iirjan Hysa		Lumturi Zhupa		Klejda Meci		Ervis Koxhaj		Totali	
	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. seancave Audio raportuar në KLGJ	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. e seancave Audio raportuar në KLGJ	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. e seancave Audio raportuar në KLGJ	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. e seancave Audio raportuar në KLGJ	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. e seancave Audio raportuar në KLGJ	Nr. Seancave Audio dërguar ILD	Nr. e seancave Audio raportuar në KLGJ	Seanca audio në total për gjykatën, sipas Raportimit në ILD	Seanca audio në total për gjykatën, sipas Raportimit në KLGJ
Janar-Mars	355	331	293	320	501	476	218	322	172	157	324	303	1863	1910

Prill-Qershor	422	418	451	576	535	533	36	36	211	281	457	457	2112	2301
Korrik-Shtator	157	151	226	339	342	337	-	-	74	130	327	322	1126	1279
Seanca audio në total për gjyqtar për periudhën Janar-Shtator	934	900	970	1235	1378	1346	254	358	457	568	1108	1082	5101	5490

• **Korrelacioni**

Ndonëse planifikimi i seancave është instrumenti kryesor i menaxhimit të ngarkesës, për të kuptuar efikasitetin e një procesi gjyqësor, nuk mjafton vetëm shqyrtimi i numrit të seancave të planifikuara, por është e nevojshme të analizohet edhe korrelacioni midis treguesve thelbësorë si: ngarkesa totale e çështjeve - numri i seancave të planifikuara - numri i seancave produktive - numri i çështjeve të përfunduara - procesi i arsyetimit të vendimeve.

Në kuadër të këtij inspektimi kemi analizuar vetëm korrelacionin midis ngarkesës, planifikimit dhe përfundimit të çështjeve (vendimet e shpallura).

Këta tregues për secilin gjyqtar janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Gjyqtari	Çështje të mbartura (31.12.2024)	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025	Seanca të planifikuara (Janar-Tetor)	Vendime të shpallura Janar-20 Tetor 2026
<b>Renis Bega</b>	219	332	<b>551</b>	1352	320
<b>Ardiola Cela</b>	274	372	<b>646</b>	1312	459
<b>Ilirjan Hysa</b>	277	377	<b>654</b>	1636	484
<b>Lumturi Zhupa</b>	130	74	<b>204</b>	228	204
<b>Klejda Meci</b>	94	325	<b>419</b>	626	283
<b>Ervis Koxhaj</b>	229	378	<b>607</b>	1368	407

Referuar analizës së të dhënave përse i përket treguesve të punës në lidhje me katër gjyqtarët, duke përfshirë nga analiza gjyqtaren Lumturi Zhupa<sup>[32]</sup> dhe Zv/Kryetaren e Gjykatës znj. Klejda Meci, konstatohet se:

- Gjyqtari Ilirjan Hysa, i cili ka numrin më të lartë të planifikimeve përkatësisht 1,636 seanca të planifikuara, ka gjithashtu edhe treguesit më të lartë si përse i përket ngarkesës edhe përse i përket vendimeve të shpallura.

<sup>32</sup> Gjyqtare Lumturie Zhupa ka ushtruar detyrën vetëm për 4 muaj për shkak të lejes së lindjes.

- Gjyqtarja Ardiola Çela, e cila ndonëse ka planifikuar më pak në raport me tre gjyqtarët e tjerë renditet e dyta përse i përket treguesve më të lartë në lidhje me ngarkesën edhe numrin e vendimeve të shpallura.
- Gjyqtari Ervis Koxhaj, renditet i dyti përse i përket numrit të lartë të planifikimeve me 1386 seanca, ndërsa në lidhje me ngarkesën dhe numrin e vendimeve të shpallura renditet i treti.
- Gjyqtari Renis Bega renditet i treti përse i përket planifikimeve, ndërsa përse i përket vendimeve të shpallura renditet i katërti.

**Gjetje:** Vetëm tek gjyqtari Ilirjan Hysa konstatohet një lidhje e fortë midis ngarkesës-planifikimit dhe përfundimit të çështjeve (numrit të vendimeve).

Tek gjyqtarët e tjerë, konstatohet një lidhje relativisht e qëndrueshme midis ngarkesës dhe planifikimeve ndërsa në mënyrë të veçantë lidhja midis planifikimit dhe përfundimit të çështjeve paraqitet më e dobët.

### 3.4. Fakte të konstatuara lidhur me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar.

Nga përpunimi i të dhënave të përcjella nga gjykata konstatohet se numri mesatar i planifikimit të seancave në nivel gjykate për periudhën janar-tetor 2025 është 1087 seanca, ndërsa në nivel mujor kjo mesatare luhetet nga 76 seanca deri në 158 seanca. (në këtë analizë nuk merret parasysh muaji gusht).

Numri mesatar i planifikimit të seancave gjyqësore në nivel gjykate për secilin muaj dhe për gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Berat, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Gjyqtari Muaji	Renis Bega	Ardiola Çela	Ilirjan Hysa	Lumturi Zhupa	Klejda Meci	Ervis Koxhaj	Totali seancave për periudhën e inspektimit	Nr. Mesatar në nivel gjykate
Janar	93	121	105	35	37	64	455	76
Shkurt	169	171	209	71	97	138	855	142
Mars	153	117	203	79	86	146	784	131
Prill	208	207	211	43	78	202	949	158
Maj	152	173	178	-	85	147	735	147
Qershor	164	198	218	-	77	167	660	132
Korrik	120	145	169	-	72	146	652	130
Gusht	-	15	1	-	10	42	68	17
Shtator	124	98	161	-	38	139	560	112
Tetor	169	67	181	-	46	177	640	128
Totali seancave	1352	1312	1636	228	626	1368	6522	1087

Nga analiza e të dhënave mujore konstatohet se gjyqtaret Lumturi Zhupa dhe Klejda Meçi kanë planifikuar poshtë mesatares mujore dhe kjo ka ndodhur për shkak se ato kanë pasur më pak ngarkesë në raport me gjyqtarët e tjerë. Nga analiza e planifikimeve në total për periudhën objekt inspektimi konstatohet se katër gjyqtarët e tjerë kanë planifikuar mbi mesataren totale në nivel gjykate.

Në vijim të kësaj analize rezultoi se nuk mund të konkludojmë të njëjtën gjetje referuar mesatares së planifikimeve mujore. Përveç gjyqtarit Ilirjan Hysa i cili ka planifikuar për çdo muaj mbi nivelin mesatar në nivel gjykate, tek tre gjyqtarët e tjerë përkatësisht gjyqtari Renis Bega, Ardiola Çela dhe Ervis Koxhaj, konstatohen se në një muaj specifik ata kanë planifikuar poshtë mesatares mujore në nivel gjykate (në lidhje me këtë konstatim nuk është analizuar muaji gusht).

#### 4. KONKLUZIONE

Inspektimi tematik përfshin veprimtarinë administrative dhe gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>[33]</sup> në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar problematika që lidhen kryesisht me mospërputhjen e të dhënave midis kalendarit të seancave të planifikuara, me të dhënat e ndodhura në procesverbalet e seancave, të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës, çka ndikoi që të përsëriteshin kërkesat drejtuar gjykatave për të na përcjellë sqarimet përkatëse si dhe informacion dhe dokumentacion shtesë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat kategorizohet si gjykatë e kategorisë së dytë (e mesme) pa zyrë shërbimi<sup>[34]</sup>. Këshilli i Gjykatës me vendimin nr. 34, datë 17.12.2024 ka miratuar “Rregulloren e brendshme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat” e cila normon strukturën, organikën si dhe përkrahjet e punës për nëpunësit civilë gjyqësorë të gjykatës.

Gjatë periudhës së inspektimit në Gjykatën Berat kanë ushtruar funksionin 6 gjyqtarë efektivë nga 8 gjyqtarë që është organika e miratuar. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtare Lumturi Zhupa ka ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak të lejes së lindjes ndërsa gjyqtari Vladimir Cjapi ka qenë i komanduar vetëm gjykimin e një çështjeje.

Në këtë gjykatë funksionojnë 5 salla gjykimi, në të cilat janë instaluar pajisjet e kamerave audiovizive. Urdhri nr. 1, datë 11.01.2024 i Kryetarit të Gjykatës për ndarjen dhe përdorimin e sallave nuk i përgjigjet organikës koherente të gjykatës e cila ka ndryshuar si përsa i përket përbërjes së trupës gjyqësore, ashtu edhe numrit të gjyqtarëve.

<sup>33</sup> Shkurt do të citohet edhe: “Gjykata Berat ose Gjykata”.

<sup>34</sup> Vendimi nr. 147, datë 29.03.2023 dhe vendimi nr. 149, datë 29.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Përditësimi i këtij urdhri do të mundësonte një organizim më të qartë dhe më funksional të sallave të gjyqimit.

Referuar materialit të dërguar nga gjykata përse i përket listës së gatishmërisë për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025, konstatohet se caktimi i gjyqtarëve në listën e gatishmërisë është kryer nëpërmjet urdhrave të Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat znj. Klejda Meçi. Seancat e planifikuara gjatë ditëve të pushimit janë ato seanca të cilat gjyqtarët i kanë planifikuar për shkak se kanë qenë të përfshirë në listën e gatishmërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me përfitimin e lejeve vjetore konstatohet se kërkesat për leje janë paraqitur nga gjyqtarët pranë Zv./Kryetares së Gjykatës. Megjithatë, rezulton se në disa raste nuk është respektuar afati i paraqitjes së kërkesës për leje vjetore pasi gjyqtarët Ilirjan Hysa, Lumturi Zhupa, Renis Bega, në rastin kur kanë kërkuar më tepër se tre ditë leje, nuk e kanë paraqitur kërkesën të paktën një muaj përpara datës së fillimit të lejes.

Gjithashtu, nga verifikimi i kalendarit të seancave të planifikuara rezulton se në disa raste janë planifikuar seanca edhe në datat për të cilat gjyqtarëve u është miratuar leja vjetore duke evidentuar mungesë koordinimi nëpërmjet planifikimit të seancave dhe periudhës së lejes.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS i cili përveç të tjerash mundëson dhe ndarjen e çështjeve me short. Në gjykatë funksionon edhe Sistemi i Regjistrimit Audio (RDA).

Gjatë inspektimit u konstatua pasaktësi në të dhënat e informacionit të përcjellë nga gjykata në lidhje me “kalendarin e seancave të planifikuara” për secilin gjyqtar.

Gjithashtu evidentohet se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk pasqyron të dhëna të sakta përse i përket “kalendarit të planifikimit të seancave” në rastet e çështjeve të rishortuara. Problematika konsiston në faktin se sistemi ia përllorarit gjyqtarit të caktuar së fundmi të gjitha planifikimet e seancave, përfshirë edhe ato të kryera përpara rishortimit të çështjes, duke krijuar kështu një pasqyrim jo të saktë të ngarkesës dhe planifikimit real të seancave për secilin gjyqtar.

Gjykata e Beratit e ka filluar vitin 2025 me 1224 çështje të mbartura. Gjatë periudhës 01.01.2025-20.10.2025 janë regjistruar gjithsej 1853 çështje të reja. Ngarkesa e gjykatës në total deri në datë 20.10.2025 është 3082 çështje. Për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 janë shpallur gjithsej 2158 vendime, përkatësisht 2157 vendime nga 6 gjyqtarë si dhe 1 vendim nga gjyqtari Vladimir Cjapi i cili është komanduar vetëm për 1 çështje.

**Numri total i planifikimit të seancave gjyqësore në nivel gjykate për gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Berat është 6522 seanca.**

Referuara të dhënave përsa i përket planifikimeve të seancave brenda një dite pune konstatohen raste të tilla si:

- E njëjta çështje figuron të jetë planifikuar dy herë në të njëjtën datë, në të njëjtën orë dhe në të njëjtën sallë nga i njëjti gjyqtar;
- Dy çështje të ndryshme figurojnë të jenë planifikuar në të njëjtën datë, orë dhe sallë nga i njëjti gjyqtar;
- Planifikime seancash me një diferencë shumë të shkurtër kohore nga njëra tjetra deri edhe prej 2 minutash brenda të njëjtës ditë.
- Konstatohen raste në të cilat evidentohet një diferencë prej më shumë se 15 minutash ndërmjet orës së planifikimit të seancës referuar “kalendarit të planifikimit të seancave” dhe orës së çeljes së seancës referuar “Procesverbaleve të seancave”.

Planifikimi dy herë në të njëjtën datë dhe orë për të njëjtën çështje rrit në mënyrë fiktive numrin e planifikimeve për gjyqtarin përkatës. Po ashtu, planifikimi në intervale shumë të afërta kohore të seancave nga njëra-tjetra vë në dyshim mundësinë reale të zhvillimit efektiv të tyre.

Nga vëzhgimi i shpërndarjes së seancave gjatë ditëve të punës konstatohet një variacion i theksuar si në aspektin e numrit të planifikimeve brenda një ditë te vetme ashtu edhe në shpërndarjen e tyre përgjatë ditëve të javës. Në veçanti përqendrimi i seancave brenda një brenda një ditë pune paraqitet i pabalancuar, duke variuar nga 24 seanca në një ditë deri në 0-1 seanca në një ditë tjetër.

Nga analiza e të dhënave në nivel gjykate konstatohet se numri me i lartë i seancave të planifikuara përkon me ditën e hënë me 2031 seanca të planifikuara (31 % e seancave totale), ndjekur nga dita e martë me 1827 seanca të planifikuara. Ky rit planifikimesh ulet dy ditët e tjera të javës përkatësisht ditën e mërkurë me 1084 seanca dhe ditën e enjte me në rritje të lehtë prej 1286 seanca. Numri i planifikimeve pëson një rënie drastike ditën e premte me 201 seanca. Dita e shtunë dhe e diel janë ditë pushimi dhe për këtë arsye numri i planifikimeve në këto ditë lidhet vetëm me çështjet të cilat gjyqtarët i planifikojnë dhe zhvillojnë për shkak të përfshirjes në listën e gatishmërisë.

Përsa i përket përqendrimit të ngarkesës dhe modeleve të organizimit të punës referuar një dite të caktuar të javës në mënyrë të përmbledhur rezultoi sa më poshtë vijon:

- **Modeli A - Planifikim pothuajse çdo ditë pune (5 ditë/javë):** Nuk evidentohen gjyqtarë që të kenë si model të qëndrueshëm pune planifikimin gjatë të pestë ditëve të javës. Konstatohet se vetëm për muajin maj gjyqtari Ilirjan Hysa të ketë planifikuar për 5 ditët e javës.
- **Modeli B - Planifikim 3 ditë në javë:** Ky model paraqitet si modeli tipik organizativ. shpërndarje ndërmjet planifikimit të seancave dhe kohës për arsyetim.

Konstatohet se gjyqtarët planifikojnë seanca të hënë, të martë dhe të enjte ndërsa dita e mërkurë dhe e premte lihet e lirë. Ky model pune konstatohet te gjyqtarët Renis Bega, Ilirjan Hysa.

- Ndërsa tek gjyqtarët Ervis Koxhaj dhe Klejda Meçi konstatohet modeli i planifikimit në tre ditët e para të javës, ndërsa nuk planifikojnë seanca të enjte dhe të premte.
- **Modeli C -Planifikim 4 ditë në javë.** Gjyqtare Ardiola Çela ka si model pune planifikimin katër ditë të javës (të hënë, të martë, të mërkurë, të enjte), por konstatohet se në njërin nga këto ditë ajo planifikon vetëm 1 seancë.
- **Modeli D - Planifikim 1-2 ditë në javë.** Ky model është zakonisht i pranishëm tek gjyqtarët me volum të ulët seancash. Në këtë grup përfshihen gjyqtarët Lumturi Zhupa.

Përsa i përket planifikimeve të seancave në nivel mujor në mënyrë të përmblodhur rezultoi se:

Shpërndarja e seancave nga muaji në muaj për këtë gjykatë karakterizohet nga një variacion i konsiderueshëm duke filluar nga 455 seanca në një muaj deri në 949 seanca të planifikuara në një muaj tjetër, pra me një diferencë më shumë se dyfish. Në këtë analizë nuk është përfshirë muaji gusht gjatë të cilit gjyqtarët përfitojnë lejen vjetore.

- **Muaji më i ngarkuar:** Muaji prill rezulton muaji më i ngarkuar me numrin maksimal prej 949 seancash të planifikuara në nivel gjykate. Në këtë muaj planifikimet për secilin gjyqtar variojnë nga 202 deri në 211 seanca të planifikuara.
- **Muajt e ngarkuar** (mbi 700 seanca): Pas muajit prill, muajt më të ngarkuar me planifikime seancash rezultojnë të jenë shkurti me 855 seanca, marsi me 784 seanca, maji me 735 seanca, qershori me 824 seanca.
- **Muajt më pak të ngarkuar:** Muajt me numrin më të ulët të seancave të planifikuara janë shtatori me 560 seanca, janari me 455 seanca dhe gushti me 68 seanca.

Referuar analizës së korrelacionit midis ngarkesës, planifikimeve dhe përfundimit të çështjeve rezultoi se:

Nga analiza e të dhënave për gjykatën rezulton se për periudhën objekt inspektimi janë zhvilluar me regjistrim audio në total 5629 seanca ose 76%. Nga inspektimi rezultoi se ka mospërputhje të të dhënave të përcjella nga gjykata pranë ILD-së krahasuar me të dhënat e përcjella nga gjykata pranë KLGJ-së referuar raporteve për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat. Konkretisht në total për periudhën janar 2025 - tetor 2025 sipas raportimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë numri i seancave audio është 5101 seanca ndërsa sipas raportimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor është 5490 seanca.

Vetëm tek një gjyqtar u konstatua një lidhje e fortë ngarkesë – planifikim - përfundimi i çështjeve. Tek gjyqtarët e tjerë konstatohet një lidhje relativisht e qëndrueshme midis ngarkesës dhe planifikimeve ndërsa në mënyrë të veçantë lidhja midis planifikimit dhe përfundimit të çështjeve paraqitet më e dobët.

Përsa më sipër analizuar vlerësojmë ndër të tjera se ka vend për përmirësimin e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në drejtim të shmangies së mungesës së planifikimeve por edhe mirë menaxhimit të ngarkesës nëpërmjet një planifikimi efektiv të seancave të shoqëruar me marrjen e masave të nevojshme që këto seanca të jenë realisht produktive.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet “aneksi” i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat).*

A series of handwritten signatures in blue ink are located at the bottom of the page, below the footer text. The signatures vary in style and length, with some appearing to be initials or full names. There are also some faint, illegible stamps or markings interspersed among the signatures.

**Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm**  
**Gjirokastër**

**1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara**

**1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit**

Në kuadër të kryerjes së inspektimit tematik Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2929 prot., datë 20.10.2025 Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me të cilën ka kërkuar informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

- f) Statistikat e secilit gjyqtar në lidhje me:
  - iii. numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025;
  - iv. numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe.
- g) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar.
- h) Organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve.
- i) Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025.
- j) Numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 423 prot., datë 12.11.2025, protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2929/3 prot., datë 14.11.2025, duke dërguar:

Pikën a.i me formatin e tabelës të kërkuar të plotësuar + raportimi 3-3-2025 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pikën a.ii me formatin e tabelës së kërkuar të plotësuar pjesërisht (mungojnë të dhënat si numri i seancave të zhvilluara (para dhe pas 2025), të dhënat që mund të gjenerohen vetëm manualisht dhe duan kohë fizike) + raporti i gjeneruar nga sistemi mbi çështjet e mbyllura me dispozitiv.

Pika b. Planifikimi sipas gjyqtarëve për periudhën kohore 01.01.2025-31.10.2025.

Pika c. Struktura organizative Janar-Tetor 2025.

Pika d. Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Pika e. Urdhrat e titullarit mbi përdorimin e 5 sallave gjyqësore (urdhri nr. 98, datë 08.10.2024 si edhe urdhër nr. 62, datë 02.09.2025).

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për dërgimin e informacionit të plotë ka kërkuar kohë deri më datë 30.11.2025.

- Në vijim, grupi i punës (inspektore dhe ndihmës) ka shkuar në ambientet e Gjykatës dhe në prezencë të gjyqtarës-Zv/Kryetares Entela Selmanaj dhe kancelares D. K., në zbatim të vendimit nr. 57 datë 20.10.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 si dhe të nenit 80 të Kodit të Procedurës Administrative, kanë mbajtur procesverbal për të dokumentuar marrjen dhe administrimin e dokumenteve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër si më poshtë:

- Formati i Raportimit 3-mujor periudha janar-mars 2025; prill-qershor 2025; korrik-shtator 2025;
- Analiza vjetore për vitin 2024 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;
- Rregullore e Brendshme e miratuar me vendimin nr. 112, datë 19.11.2024;
- Lista e gjyqeve për gjykim datë 31.10.2025, etj.

- Më tej, nga ILD me shkresën nr. 2929/3 prot., datë 14.11.2025, është kërkuar të përcillet informacion dhe dokumentacion shtesë, konkretisht është kërkuar të saktësohen mospërputhjet e të dhënave të përcjella nga gjykata, me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit, informacion në lidhje me arsyen e këtyre mospërputhjeve si edhe ridërgimin e të dhënave në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, kryetarit, anëtarit) si dhe seancat e zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Përveç informacionit të sipërcituar është kërkuar edhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) RDA (raportet për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat) për çdo muaj për secilin gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.
- b) Lista e çështjeve të rishortuara për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025.
- c) Urdhrat për gatishmërinë e gjyqtarëve për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 etj.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 477/1 prot., datë 27.11.2025 protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2929/5 prot., datë 02.12.2025 duke vendosur në dispozicion:

Sqarime lidhur me mospërputhjet e të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara të gjeneruar nga kalendari elektronik i seancave Paks + dhe të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi ICMIS.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka risjellë informacion me shkresën nr. 09 prot, datë 07.01.2026 protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2929/6 prot., datë 09.01.2026, duke vendosur në dispozicion:

- Pikën a.i me formatin e tabelës të kërkuar të plotësuar + raportimi 3-3-2025 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Pikën a.ii me formatin e tabelës së kërkuar të plotësuar + raporti i gjeneruar nga sistemi mbi çështjet e mbyllura me dispozitiv.
- Pika b. Planifikimi sipas gjyqtarëve për periudhën kohore 01.01.2025-31.10.2025 e saktësuar, e njëjtë me atë të nisur në përgjigje të shkresës nr.2929/4., datë 20.11.2025).
- Pika c. Struktura organizative Janar- Tetor 2025.
- Pika d. Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025-31.10.2025
- Pika e. Urdhrat e titullarit mbi përdorimin e 5 sallave gjyqësore (urdhri nr. 98, datë 08.10.2024 si edhe urdhër nr. 62, datë 02.09.2025.

## 2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

### 2.1 Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi

#### ➤ Rregullorja e Brendshme

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër organizohet dhe funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër” nr. 112/3 prot., datë 19.11.2024.

Në nenin 1 “Objekti”, citohet se: “Kjo rregullore, së bashku me Anekset bashkëlidhur saj, parashikojnë rregulla standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë gjyqësor dhe punonjësit e tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, Kategoria e tretë, me Zyra Shërbimi.

Gjithashtu në pikën 2, të nenit 5 parashikohet se: Kryetari është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përgjithshëm gjyqësor të Gjykatës sipas nenit 37<sup>[35]</sup> të ligjit

<sup>35</sup> Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra: a) përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët; b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; c) mban kontakt me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera shtetërore, njihet me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijon atyre mundësi për ushtrimin e detyrës; ç) mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me

nr. 98/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe kësaj rregulloreje.

Pjesë e rregullores së brendshme janë edhe përshkrimet e punës, ku vlen të përmendet pozicioni i sekretarit gjyqësor i cili ndihmon gjyqtarin/trupën gjykuese gjatë seancave deri në përfundimin e çështjes, duke përfshirë zbardhjen e vendimit sipas rastit të përgatisë njoftimet për palët, si dhe të hedhë të dhënat në regjistrat, si dhe sistemin elektronik të gjykatës.

➤ Në lidhje me organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës mbi numrin e gjyqtarëve për çdo muaj Janar - Tetor 2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka vendosur në dispozicion të ILD pasqyrën e numrit të punonjësve, sipas strukturës organizative dhe organikës në fakt në gjykatë nga ku rezultoi si më poshtë:

- Janar sipas strukturës 7 magjistratë<sup>[36]</sup>, në fakt 5 magjistratë efektive 4<sup>[37]</sup>
- Shkurt sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë, efektive 4
- Mars sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë, efektive 4
- Maj sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë, efektive 4
- Qershor sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë<sup>[38]</sup>
- Korrik sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë
- Gusht sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë
- Shtator sipas strukturës 7 magjistratë, në fakt 5 magjistratë

Në tetor me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 765, datë 22.10.2025 dhe nr. 766, datë 22.10.2025, gjyqtarët e emëruar Arnaldo Biçoku dhe Romena Qamo janë caktuar në

vlërësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve; d) mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre; dh) kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj; e) thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj; ë) udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin; f) verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit; g) kryen veprimet dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç parashikohet në këtë ligj; gj) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore; h) garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; i) ushtron çdo detyrë tjetër që lidhet me veprimtaritë jogjyqësore të gjykatës, siç përcaktohet me ligj ose vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

<sup>36</sup> Sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm” numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër është 7 (shtatë) gjyqtarë.

<sup>37</sup> Magjistratja Blerta Çibuku Marku është shkarkuar me vendimin e KPK nr. 565, datë 26.09.2022.

<sup>38</sup> Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin e datës 15.05.2025 që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 565, datë 26.09.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Blerta Marku (Çibuku).

pozicion pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe ushtrimi i funksionit ka filluar në datën 23.10.2025.

Përsa i përket organigramës dhe numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën në periudhën objekt inspektimi, konstatohet se, gjykata nuk ka funksionuar me organigramë të plotë.

➤ **Lidhur me periudhën e gatishmërisë me të cilën ka funksionuar kjo gjykatë rezulton se:**

- Me urdhrin e zëvendëskryetares nr. 125, datë 27.12.2024 "Mbi planifikimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë kërkesat e ngutshme për periudhën Janar-Dhjetor 2025" është përcaktuar ndër të tjera se gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimeve paraprake, kërkesave të tjera me karakter të ngutshëm përfshirë kërkesat me shtetas të mitur, kërkesat me objekt vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, kërkesat për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe kërkesat për papajtueshmërinë e gjyqtarëve që do të paraqiten pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, do të shqyrtohen si vijon:

Gjyqtare Ermira Bushi 01-08 të çdo muaji

Gjyqtare Orinda Lloshi 09-16 të çdo muaji

Gjyqtare Nertila Përrallaj 17-24 të çdo muaji

Gjyqtare Entela Selmanaj 25-30/31 të çdo muaji

- Me urdhrin e zëvendëskryetares nr. 51, datë 30.06.2025 "Për një ndryshim mbi urdhrin nr.125, datë 27.12.2024 "Mbi planifikimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë kërkesat e ngutshme për periudhën Janar-Dhjetor 2025", është përcaktuar ndër të tjera se gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimeve paraprake, kërkesave të tjera me karakter të ngutshëm përfshirë kërkesat me shtetas të mitur, kërkesat me objekt vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, kërkesat për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe kërkesat për papajtueshmërinë e gjyqtarëve që do të paraqiten pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën Korrik-Dhjetor 2025, do të shqyrtohen si vijon:

Ermira Bushi: nga data 01.07.2025 deri më 07.07.2025

nga data 01.08.2025 deri më 06.08.2025

nga data 01.09.2025 deri më 06.09.2025

nga data 01.10.2025 deri më 06.10.2025

Ervin Kore: nga data 08.07.2025 deri më 13.07.2025

nga data 07.08.2025 deri më 13.08.2025

nga data 07.09.2025 deri më 12.09.2025

nga data 07.10.2025 deri më 12.10.2025

Orinda Lloshi: nga data 14.07.2025 deri më 19.07.2025

nga data 14.08.2025 deri më 19.08.2025

nga data 13.09.2025 deri më 18.09.2025

nga data 13.10.2025 deri më 19.10.2025

Nertila Përrallaj nga data 20.07.2025 deri më 25.07.2025

nga data 20.08.2025 deri më 25.08.2025

nga data 19.09.2025 deri më 24.09.2025

nga data 20.10.2025 deri më 25.10.2025

Entela Selmanaj nga data 26.07.2025 deri më 31.07.2025

nga data 26.08.2025 deri më 31.08.2025

nga data 25.09.2025 deri më 30.09.2025

nga data 26.10.2025 deri më 31.10.2025

Gjithashtu zëvendëskryetarja ka nxjerrë urdhrin nr. 76, datë 31.10.2025 "Për një ndryshim mbi urdhrin nr. 51, datë 30.06.2025 "Mbi planifikimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë kërkesat e ngutshme për periudhën Janar- Dhjetor 2025" por ky urdhër rregullon gatishmërinë për një periudhë jashtë objektit të inspektimit.

Periudha e gatishmërisë me të cilën ka funksionuar Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjatë periudhës objekt inspektimi është pasqyruar në formë tabelore në Aneksin 2 bashkëlidhur këtij raporti.

Referuar të dhënave të administruara rezulton se urdhrat e gatishmërisë janë kronologjik, të vazhdueshëm dhe pa mbivendosje të periudhave të gatishmërisë për magjistratët.

➤ **Lejet vjetore të gjyqtarëve**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka përcjell pranë ILD urdhrat për dhënien e lejeve dhe bashkëlidhur tyre edhe kërkesën me shkrim të magistratit për periudhën objekt inspektimi nga ku rezulton si më poshtë vijon:

Nr.	Nr. dhe data e urdhrat	Gjyqtari	Periodha e lejes nga pushimet vjetore	Nr. ditëve
1	Urdhri nr. 1, datë 17.01.2025	E. B	20.01.2025 – 23.01.2025	4 ditë
2	Urdhri nr. 13 datë 23.01.2025	N. P	27.01.2025-31.01.2025	5 ditë
3	Urdhri nr. 15/1, datë 27.01.2025	E. B	28.01.2025	1 ditë
4	Urdhri nr. 27/1, datë 28.01.2025	O. LI	29.01.2025	1 ditë
5	Urdhri nr. 18, datë 03.02.2025	E. S	04.02.2025-07.02.2025	4 ditë
6	Urdhri nr. 13/1, datë 11.02.2025 (për një ndryshim në urdhrin nr. 13 datë 02.01.2025)	N. P	11.02.2025-14.02.2025 25.03.2025-28.03.2025	4 ditë 4 ditë
7	Urdhri nr. 11/2, datë 11.02.2025	E. B	12.02.2025-13.02.2025	2 ditë pune
8	Urdhri nr. 13/2, datë 13.02.2025	O. LI	25.02.2025-26.02.2025	2 dite pune
9	Urdhri nr. 13/2, datë 13.02.2025	E. S	17.02.2025-21.02.2025	5 ditë pune
10	Urdhri nr. 21 datë 26.02.2025	E. S	04.03.2025-06.03.2025 13.03.2025 17.03.2025-20.03.2025 26.03.2025	3 ditë 1 ditë 4 ditë 1 ditë
11	Urdhri nr. 27/2 datë 27.02.2025	O. LI	03.03.2025	1 ditë
12	Urdhri nr. 21/2 datë 06.03.2025	E. S	04.03.2025-06.03.2025 13.03.2025 17.03.2025-20.03.2025 21.03.2025 26.03.2025	3 ditë 1 ditë 4 ditë 1 ditë 1 ditë
13	Urdhër nr. 11/3 datë 11.03.2025	N. P	13.03.2025	1 ditë
14	Urdhër nr. 12/03 datë 12.03.2025	E. B	19.03.2025	1 ditë
15	Urdhër nr. 17/3 datë 17.03.2025	O. LI	18.03.2025-19.03.2025	2 ditë
16	Urdhër nr. 21/3 datë 20.03.2025 (për një ndryshim në urdhrin nr. 21/2 datë 06.03.2025)	E. S	Data 20 mars 2025 e programuar leje vjetore do caktohet një datë tjetër për shkak të PBA-së	
17	Urdhër nr. 22/4 datë 22.04.2025	O. LI	25.04.2025 28.04.2025 29.04.2025	1 ditë 1 ditë 1 ditë
18	Urdhër nr. 23/4, datë 23.04.2025	E. B	24.04.25025	1 ditë
19	Urdhër nr. 24/4 datë 24.04.2025	N. P	30.04.2025 02.05.2025	1 ditë 1 ditë
20	Urdhër nr. 23/06 datë 26.06.2025	E. B	24.06.2025	1 ditë
21	Urdhër nr. 53 datë 01.07.2025	O. LI	07.07.2025-08.07.2025	2 ditë
22	Urdhër nr. 64 datë 22.09.2025	O. LI	23.09.2024-24.09.2025	2 ditë
23	Urdhër nr. 71 datë 08.10.2025	E. B	13.10.2025-16.10.2025	4 ditë

➤ Referuar akteve të administruara gjatë inspektimit nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, përsa i takon caktimit të sallave dhe orareve lidhur me zhvillimin e seancave me sistemin RDA, rezulton se:

Me urdhrin e Zv/Kryetares nr. 98, datë 08.10.2024 “Për ndryshimin e urdhrit mbi caktimin e sallave dhe orareve të zhvillimit të seancave me sistemin RDA” është përcaktuar administrimi i veprimtarisë gjyqësore në lidhje me sallat e gjyqimit dhe oraret e seancave gjyqësore duke urdhëruar se:

Gjyqtarët	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
E. S	Salla 1	Salla 1	Salla 1	Salla 1	Salla 1
N. P	Salla 2	Salla 2	Salla 2	Salla 2	Salla 2
E. B	Salla 5	Salla 5	Salla 5	Salla 5	Salla 5
O. LL	Salla 3	Salla 3	Salla 3	Salla 3	Salla 3
<b>Gjyqtarët e deleguar</b>	Salla 4	Salla 4	Salla 4	Salla 4	Salla 4

Me urdhrin e Zv/Kryetares nr. 62, datë 02.09.2025 “Mbi caktimin e sallave dhe orareve të zhvillimit të seancave me sistemin audio/audioviziv”, është urdhëruar përcaktimi i ditës, orarit dhe sallës së gjyqit për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastër që do të zhvillojë seancat gjyqësore me sistemin audio/audioviziv si më poshtë:

Dita	Orari	E. S	N. P	O. LI	E. K	E. B
<b>E hënë</b>	08:00-12:00 12:00- 16:00	Salla nr. 1 Salla nr. 2	Salla nr. 2 Salla nr. 3	Salla nr. 3 Salla nr. 4	Salla nr. 4 Salla nr. 5	Salla nr. 5 Salla nr. 1
<b>E martë</b>	08:00-12:00 12:00- 16:00	Salla nr. 3 Salla nr. 4	Salla nr. 4 Salla nr. 5	Salla nr. 5 Salla nr. 1	Salla nr. 1 Salla nr. 2	Salla nr. 2 Salla nr. 3
<b>E mërkurë</b>	08:00-12:00 12:00- 16:00	Salla nr. 5 Salla nr. 1	Salla nr. 1 Salla nr. 2	Salla nr. 2 Salla nr. 3	Salla nr. 3 Salla nr. 4	Salla nr. 4 Salla nr. 5
<b>E enjte</b>	08:00-12:00 12:00- 16:00	Salla nr. 2 Salla nr. 3	Salla nr. 3 Salla nr. 4	Salla nr. 4 Salla nr. 5	Salla nr. 5 Salla nr. 1	Salla nr. 1 Salla nr. 2
<b>E premte</b>	08:00-12:00 12:00- 16:00	Salla nr. 4 Salla nr. 5	Salla nr. 5 Salla nr. 1	Salla nr. 1 Salla nr. 2	Salla nr. 2 Salla nr. 3	Salla nr. 3 Salla nr. 4

Në urdhrin nr. 62, gjithashtu citohet se këto ndarje janë të përkohshme, të filluara sipas sallave aktuale që ka gjykuar secili gjyqtar deri në këto momente dhe do të ndryshojë me shtimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatë.

## **2.2 Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS që prej vitit 2011, i cili përdoret për regjistrimin e çështjeve gjyqësore, hedhjen e çështjeve në çdo rast në short elektronik, mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore hedhjen e vendimeve etj.

Referuar formatit të raportimit tremujor nr. 14/4 prot., datë 14.04.2025 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër e ka nisur vitin 2025 me një server të ri, në të cilin është instaluar Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve, Kalendari elektronik PAKS + dhe aplikacioni Kiosk.

## **2.3 Fakte të konstatuar në lidhje me përputhjen e të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara me të dhënat e procesverbaleve të seancave të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve**

Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, konstatohet se ka mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit.

Referuar informacionit të pasqyruar në listën e seancave të planifikuara për gjykim rezulton se për çështjen me nr. 53817-00504-21-2025, seanca e datës 26.05.2025, është planifikuar nga gjyqtarja E. B., ndërkohë që sipas RIV-it të çështjes nr. 53817-00504-21-2025 dhe procesverbalit të seancës së datës 26.05.2025 të kësaj çështjeje, rezulton se kjo seancë është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtarja O. Ll.

E njëjta situatë është konstatuar edhe në lidhje me planifikimin e seancës për çështjen me nr. 72012-01065-21-2025, datë 22.09.2025 ora 12.00. Referuar procesverbalit të seancës, gjyqtare rezulton magjistratja E. B., ndërkohë sipas kalendarit të planifikimeve të sjellë nga ju, kjo seancë është e planifikuar nga gjyqtar E. K.

Për sa më sipër, është kërkuar informacion dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka dhënë sqarime lidhur me mospërputhjet e të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara të gjeneruar nga kalendari elektronik i seancave Paks + dhe të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi ICMIS, përsa i përket emrit të gjyqtarit, duke bërë me dije se: *“Pas verifikimeve të kryera nga ana e tyre ky fenomen ndodh vetëm në ato çështje gjyqësore të cilat i janë nënshtruar procesit të rishortimit. Për shembull, nëse një çështje gjyqësore i ka rënë në short normal një gjyqtari që po e emërtojmë për ilustrim GJYQTARI 1, i cili ka planifikuar dhe zhvilluar një ose më shumë seanca lidhur me këtë çështje. Në momentin që, kjo çështje rishortohet për shembull për arsyen që është pranuar kërkesa për heqje dorë e gjyqtarit ose çdo arsye të parashikuar ligjërish, çështja do ti kalojë një gjyqtarit tjetër GJYQTARI 2 po e emërtojmë.*

*Nga ky moment e në vijim si në listën e planifikimeve të kalendarit elektronik si të sistemit ICMS çdo planifikim lidhur me këtë çështje del në raporte si seance e zhvilluar nga gjyqtari aktual pra GJYQTARI 2 në rastin tonë. Në mënyrë që të diferencohen seancat që ka planifikuar dhe zhvilluar GJYQTARI 1 dhe GJYQTARI 2 ose çdo gjyqtar paraardhës ndryshe nga ai i fundit duhet të hapet çështja në sistemin ICMS te rubrika gjyq dhe të verifikohet manualisht. Pra është një problematikë teknike e sistemit që ndodh vetëm te çështjet e rishortuara”.*

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për periudhën e inspektuar është kryer rishortim sipas vendimit nr. 54, datë 18.07.2025 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”.

Rishortimet janë paraqitur në formë tabelare në aneksin nr. 5 bashkëlidhur këtij raporti.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit rezulton se ka pasaktësi në të dhënat e gjeneruara nga sistemi pasi kur një çështje rishortohet (rindahet) tek një gjyqtar i ri, të gjitha planifikimet e mëparshme të bëra nga gjyqtari i parë kalojnë automatikisht në llogarinë e gjyqtarit të ri. Kjo prodhon të dhëna jo reale mbi ngarkesën e gjyqtarëve.

### **3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi**

#### **3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 konstatohet se nga viti 2024 janë mbartur 1198 çështje dhe janë regjistruar 1773 çështje. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi për secilin gjyqtar pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Nr.	Gjyqtari	Çështje të mbartura (31.12.2024)	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025
1	E. S	320	387	707
2	E. B.	304	412	716
3	N. P	285	395	680
4	O. LL	289	419	708
5	E. K.	0	160	160

6	A. B	0	0	0
7	R. Q	0	0	0
	Totali	1198	1773	2971

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Referuar të dhënave statistikore rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 janë shpallur 1508 vendime

Numri i vendimeve të shpallura për secilin gjyqtar është pasqyruar sipas tabelës<sup>[39]</sup> në vijim:

Nr.	Gjyqtari	Nr. i vendime të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025
1.	E. S	406
2.	N. P	387
3.	O. LL	298
4.	E. B	318
5.	E. K	99
6.	A. B	0
7.	R. Q	0
	<b>TOTALI:</b>	<b>1508</b>

Referuar informacionit të pasqyruar në listën e çështjeve të gjykuara rezulton se, në periudhën 01.01.2025–31.10.2025, gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, kanë gjykuar dhe dalë me vendim për çështje sipas kategorive: Civile themeli 276; kërkesa civile 75; kërkesa penale 519; masa sigurimi 404; penale themeli 149; urdhra ekzekutimi 85.

### 3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar

#### 3.3.1. Analiza e planifikimit të seancave brenda një dite

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me shkresën nr. 423 prot., datë 12.11.2025 konstatohet se nga magjistratja E. S., rezulton të jenë planifikuar 2 seanca gjyqësore, për 2 çështje të ndryshme (nr. 23004-00799-21-2024 dhe nr. 23004-00043-21-2023), në të

<sup>39</sup> Përveç të dhënave në formë tabelare Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, bën me dije se të dhënat janë marrë nga formati i raportimit 3-mujor (03.03.2024), bazuar në vendimin e KLGJ-së nr. 25, datë 07.02.2019, si dhe Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS për periudhën 01.10.2025-20-10.2025. Gjithashtu sqarohet se gjyqtarët Arnaldo Biçoku dhe Romena Qamo janë bërë pjesë e shortit më datë 27.10.2025 me urdhër të Zv/Kryetarit të Gjykatës.

njëjtën sallë, në të njëjtën datë 27.02.2025 dhe në të njëjtën orë 12.00), ndërkohë referuar procesverbaleve gjyqësore të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se për çështjen nr. 23004-00799-21-2024, ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12.00 dhe e mbarimit 12.18 , ndërsa për çështjen nr. 23004-00043-21-2023 ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12:01 dhe e mbarimit 12:29.

E njëjta situatë konstatohet edhe në raste të tjera si për shembull për çështjet nr. 76010-00899-21-2024 dhe nr. 23004-00826-21-2024 të cilat rezultojnë të dyja të planifikuara nga magjistratja E. S., në të njëjtën sallë, në të njëjtën datë 27.02.2025 dhe në të njëjtën orë 12:30, ndërkohë referuar procesverbaleve gjyqësore të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se për çështjen nr. 76010-00899-21-2024 ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12:31 dhe e mbarimit 13:00, ndërsa për çështjen 23004-00826-21-2024 ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12:30 dhe e mbarimit 12.59.

Për sa më sipër pas kërkesës për informacion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me shkresën nr. 2929/5 prot., datë 02.12.2025 sqaron se: *“Planifikimi në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë ka ndodhur për shkak të ngarkesës tepër të madhe në punë të magistrates E. S., ku mesatarja e numrit të seancave në ditë gjatë gjithë javës/muajit është në minimum 14-15 dhe në maksimum 16-17, pa llogaritur këtu grafikun e gatishmërisë, kërkesat me karakter të ngutshëm apo zëvendësimet e masave të sigurimit. Këto të fundit nuk mund të planifikohen nga magistrati pasi një gjë e tillë nuk mund të parashikohet.*

*Magjistratja E. S., në fundin e muajit shkurt të vitit 2025 ka pasur një ngarkesë totale prej 361 dosjesh gjyqësore dhe nga data 01.01.2025 deri në datën 28.02.2025 ka disponuar me vendim përfundimtar për 80 çështje gjyqësore civile dhe penale. Sqarojmë gjithashtu se nga data 01.01.2025 deri 15.01.2025 është kryer mbartja e dosjeve gjyqësore dhe në datën 27.02.2025, ditë e enjte magjistratja E. S., ka pasur të planifikuara në total 15 seanca.*

*Kjo magjistrate ushtron gjithashtu funksionin e zëvendëskryetares së gjykatës, me kompetenca të kryetarit të gjykatës, ku kryen edhe punë administrative në lidhje me drejtimin e gjykatës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.*

*Kjo përplasje oraresh për këto seanca është konstatuar edhe nga vetë magjistratja E.S, e cila ka vijuar fillimisht me gjykimin e çështjes 23004-00799-21-2024, çështje e planifikuar më parë në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (në vijim ICMIS) se çështja tjetër.*

*Seanca për këtë çështje në sistemin ICMIS është hapur nga sekretarja në 12:00, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 12:02:28 pas thirrjes dhe akomodimit të palëve në sallën e gjykimit. Kjo seancë është deklaruar e mbyllur, pas përfundimit të gjykimit të çështjes dhe dhënies së vendimit përfundimtar nga*

*grykata, në orën 12:19:33 dhe jo në orën 12:18 që tregon sistemi ICMIS, konstatuar nga ana juaj.*

*Seanca në lidhje me çështjen nr.23004-00043-21-2023 është hapur në sistemin ICMIS 12:01 min., nga sekretarja gjyqësore, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtarës, në orën 12:22:35 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Pas çeljes së seancës në sistemin audio/video gjyqtarja ka sqaruar palën prezente në lidhje me faktin e planifikimit të dy seancave në të njëjtën orë për shkak të ngarkesës tepër të madhe në punë. Kjo seancë ka përfunduar në orën 12:27:22 dhe jo në orën 12:29 që tregon sistemi ICMIS, konstatuar nga ana juaj.*

*Planifikimi në sistemin ICMIS bëhet nga sekretarja me orë fillimi dhe kërkon detyrimisht orën e mbarimit të seancës, minutazh që shënohet me përafërsi nga sekretarja pasi nuk mund të parashikohet saktësisht sa mund të zgjasë seanca përkatëse. Gjithashtu, sistemi ICMIS nuk pengon planifikimin e dy ose më shumë seancave për faktin që është planifikuar më parë një e tillë apo hapjen e tyre si veprim administrative të kryer nga sekretarja. Sistemi ICMIS dhe sistemi i regjistrimit audio/video janë dy sisteme të ndara nga njëri-tjetri, të cilët nuk hapen njëherësh me një klik. Zhvillimi i këtyre dy seancave nuk ka penguar zhvillimin seancave pasardhëse, të cilat kanë filluar në orarin e caktuar nga gjykata” .*

Gjykata bashkëlidhur përgjigjes dërgon fotokopje të agjendës/kalendarit fizik të magjistrates E. S., për datën 27.02.2025 dhe procesverbalet e seancave të printuara nga sistemi ICMIS për dy çështjet e mësipërme, së bashku me përmbajtjen e tyre.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë në shkresën nr.2929/5 prot., datë 02.12.2025 gjithashtu shprehet se: “Në lidhje me konstatimin e të njëjtës situatë edhe në raste të tjera, si për shembull për çështjet nr. 76010-00899-21-2024 dhe nr. 23004-00826-21-2024, të cilat rezultojnë të dyja të planifikuara nga magjistratja E. S në të njëjtën sallë, në të njëjtën datë 27.02.2025 dhe në të njëjtën orë 12.30), ndërkohë referuar procesverbaleve gjyqësore të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se për çështjen nr. 76010-00899-21-2024 ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12.31 dhe e mbarimit 13.00, ndërsa për çështjen 23004-00826-21-2024 ora e fillimit të zhvillimit të seancës ka qenë 12.30 dhe e mbarimit 12.59, është sqaruar si vijon:

*Planifikimi në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë ka ndodhur për shkak të ngarkesës tepër së madhe në punë të magjistrates E. S., ku mesatarja e numrit të seancave në ditë gjatë gjithë javës/muajit është në minimum 14-15 dhe në maksimum 16-17, pa llogaritur këtu grafikun e gatishmërisë, kërkesat me karakter të ngutshëm apo zëvendësimet e masave të sigurimit. Këto të fundit nuk mund të planifikohen nga magjistrati pasi një gjë e tillë nuk mund të parashikohet.*

Magjistratja E. S., në fundin e muajit shkurt të vitit 2025 ka pasur një ngarkesë totale prej 361 dosjesh gjyqësore dhe nga data 01.01.2025 deri në datën 28.02.2025 ka disponuar me vendim përfundimtar për 80 çështje gjyqësore. Sqarohet se nga data 01.01.2025 deri 15.01.2025 është kryer mbartja e dosjeve dhe në datën 27.02.2025, ditë e enjte magjistratja E.S ka pasur të planifikuara 15 seanca.

Kjo magjistrate ushtron gjithashtu funksionin e zëvendëskryetares së gjykatës, me kompetenca të kryetarit të gjykatës, ku kryen edhe punë administrative në lidhje me drejtimin e gjykatës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Kjo përplasje oraresh për këto seanca është konstatuar edhe nga vetë magjistratja E. S., e cila ka vijuar fillimisht me gjykimin e çështjes 23004-00826-21-2024, çështje e planifikuar më parë në sistemin ICMIS se çështja tjetër.

Seanca për këtë çështje në sistemin ICMIS është hapur nga sekretarja në 12:30, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 12:32:21 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Kjo seancë është deklaruar e mbyllur në orën 12:36:30 dhe jo në orën 12:59 që tregon sistemi ICMIS konstatuar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Seanca në lidhje me çështjen nr. 76010-00899-21-2024 është hapur në sistemin ICMIS 12:31 min., nga sekretarja gjyqësore, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 12:51:05 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Pas çeljes së seancës në sistemin audio/video gjyqtarja ka sqaruar palën prezente në lidhje me faktin e planifikimit të dy seancave në të njëjtën orë për shkak të ngarkesës në punë. Kjo seancë ka përfunduar në orën 12:54:06 dhe jo në orën 13:00 që tregon sistemi ICMIS, konstatuar nga ana juaj.

Planifikimi në sistemin ICMIS bëhet nga sekretarja me orë fillimi dhe kërkon detyrimisht orën e mbarimit të seancës, minutazh që shënohet me përafërsi nga sekretarja pasi nuk mund të parashikohet saktësisht sa mund të zgjasë seanca përkatëse. Gjithashtu, sistemi ICMIS nuk pengon planifikimin e dy ose më shumë seancave për faktin që është planifikuar më parë një e tillë apo hapjen e tyre si veprim administrativ që kryhet nga sekretarja. Sistemi ICMIS dhe sistemi i regjistrimit audio/video janë dy sisteme të ndara nga njëri-tjetri, të cilët nuk hapen njëherësh me një klik. Zhvillimi i këtyre dy seancave nuk ka penguar zhvillimin e seancave pasardhëse, të cilat kanë filluar në orarin e caktuar nga gjykata”.

Bashkëlidhur shkresë gjykata përcjell fotokopje të agjendës/kalendarit fizik të magistrates E. S., për datën 27.02.2025 dhe procesverbalet e seancave të printuara nga sistemi ICMIS për dy çështjet e mësipërme, së bashku me përmbajtjen e tyre.

Gjithashtu sipas sqarimeve të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, lidhur me konstatimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

rezulton se "...është kryer verifikimi fizik në kalendarin agjendën fizike të magistrates E. S., ku përveç 2 rasteve të marra si shembull nga ana juaj për datën 27.02.2025, janë konstatuar në total 10 raste me 2 çështje të planifikuara në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë. Nga këto 5 raste janë çështje të magistrates E. S., të cilat janë planifikuar në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë, për shkak të ngarkesës tepër të madhe në punë, për të cilat vlen i njëjti sqarim si më sipër cituar. Numri total i seancave të planifikuara dhe të zhvilluara nga magistrata E. S., për periudhën 01.01.2025 deri në 31.10.2025 ka qenë 1581 seanca.

Magjistratja E. S., e cila ka vijuar fillimisht me gjykimin e çështjes nr. 72012-00334-21-2025, çështje e planifikuar më parë në sistemin ICMIS se çështja tjetër.

Seanca për këtë çështje në sistemin ICMIS është hapur nga sekretarja në 10:00, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 10:26:14 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Kjo seancë është deklaruar e mbyllur në orën 10:31:47 dhe jo në orën 10:32 që tregon sistemi ICMIS konstatuar nga ana juaj.

Seanca në lidhje me çështjen nr. 58405-01012-21-2024 është hapur në sistemin ICMIS në 10:00 nga sekretarja gjyqësore, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 10:34:27 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Pas çeljes së seancës në sistemin audio/video gjyqtarja ka sqaruar palën prezente në lidhje me faktin e planifikimit të dy seancave në të njëjtën orë për shkak të ngarkesës në punë. Kjo seancë ka përfunduar në orën 10:36:23 dhe jo në orën 10:29 që tregon sistemi ICMIS, konstatuar nga ana juaj.

Magjistratja E. S., e cila ka vijuar fillimisht me gjykimin e çështjes nr. 21234-00648-21-2024, çështje e planifikuar më parë në sistemin ICMIS se çështja tjetër.

Seanca për këtë çështje në sistemin ICMIS është hapur nga sekretarja në 13:30, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 13:31:34 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Kjo seancë është deklaruar e mbyllur në orën 13:34:16 dhe në orën 13:36 që tregon sistemi ICMIS konstatuar nga ana juaj.

Seanca në lidhje me çështjen nr. 75013-00874-21-2025 është hapur në sistemin ICMIS 13:30 min., nga sekretarja gjyqësore, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtares, në orën 13:41:31 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Pas çeljes së seancës në sistemin audio/video gjyqtarja ka sqaruar palën prezente në lidhje me faktin e planifikimit të dy seancave në të njëjtën orë për shkak të ngarkesës në punë. Kjo seancë ka përfunduar në orën 14:03:56 dhe jo në orën 13:49 që tregon sistemi ICMIS, konstatuar nga ana juaj.

*Magjistratja E. S., e cila ka vijuar fillimisht me gjykimin e çështjes nr. 76011-00688-21-2024, çështje e planifikuar më parë në sistemin ICMIS se çështja tjetër.*

*Seanca për këtë çështje në sistemin ICMIS është hapur nga sekretarja në 13:33, ndërsa në sistemin audio/video seanca është çelur nën drejtimin e gjyqtarës, në orën 13:43:12 pas thirrjes së palëve dhe akomodimit të tyre në sallën e gjykimit. Kjo seancë është deklaruar e mbyllur në orën 13:48:07 dhe jo në orën 13:49 që tregon sistemi ICMIS konstatuar nga ana juaj.*

*Seanca në lidhje me çështjen nr. 69105-00606-21-2025 është hapur në sistemin ICMIS 13:32 min., nga sekretarja gjyqësore dhe mbyllur në 13:35. Çështja u shqyrtua nga gjyqtari në dhomë këshillimi pasi është çështje me karakter sekret.*

*Ndërsa 5 raste, çështjet e tjera, ku është konstatuar që 2 çështje janë programuara në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë kanë ardhur për shkak të pjesëmarrjes të magistrates E. S në cilësinë e gjyqtarit anëtar në gjykimet me trup gjykues të përbërë nga 3 anëtarë dhe caktimit të datës dhe orës së seancës nga gjyqtari kryesues i çështjes”.*

Bashkëlidhur sqarimeve gjykata dërgon fotokopje të agjendës/kalendarit fizik të magistrates E. S., për datat 14.04.2025, 29.04.2025, 19.06.2025, 26.06.2025, 07.07.2025, 29.09.2025, 01.10.2025 dhe 02.10.2025 dhe procesverbalet e seancave të printuara nga sistemi ICMIS për çështjet e mësipërme, së bashku me përmbajtjen e tyre.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë në raportimet 3 mujore, bazuar në vendimin e KLGJ nr. 25, datë 07.02.2019 shprehet se arsyet e çeljes me vonesë të seancave për të gjithë gjyqtarët janë zgjatja e seancave të mëparshme, vonesa e paraqitjes së të pandehurit/ të arrestuar në rastet kur ndodhen në IEVP Tepelenë, IEVP Sarandë, por edhe kur shoqërohen nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, vonesat e avokatëve mbrojtës në rastet e caktuara pasi marrin pjesë në gjykime me gjyqtar të tjerë, vonesat e prokurorëve kjo edhe për shkak se i njëjti prokuror duhet të marrë pjesë në 2 gjykime të planifikuara njëkohësisht nga gjyqtar të ndryshëm. Në disa raste, çelja me vonesë e seancave penale (me të mitur në konflikt me ligjin ose me viktimë të mitur) mund të shkaktohen për shkak të mos paraqitjes në kohë të psikologes, prania e të cilës është e detyrueshme në të tilla gjykime. Nuk konstatohet në asnjë rast që vonesat të jenë shkakuar nga pakujdesia e gjyqtarëve. Gjykimet janë të planifikuara në vijueshmëri, vonesa në një gjykim mund të passjell që gjykimet në vazhdim të mos fillojnë në orën e përcaktuar.

Nga analiza e të dhënave të administruara gjatë inspektimit rezulton se ka raste kur planifikohen 2 seanca gjyqësore, nga i njëjti gjyqtar për 2 çështje të ndryshme në të njëjtën sallë, në të njëjtën datë dhe orë dhe se gjyqtari i ka zhvilluar seancat në datën e planifikuar por në orare të ndryshme.

Gjithashtu konstatohet se ka raste që 2 çështje të jenë të programuara në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë me të njëjtin gjyqtar për shkak të pjesëmarrjes të magjistratit në cilësinë e gjyqtarit anëtar në gjykimet me trup gjykues të përbërë nga 3 anëtarë dhe caktimit të datës dhe orës së seancës nga gjyqtari kryesues i çështjes.

### 3.3.2 Analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor

➤ Planifikimi i seancave sipas ditëve të javës

Gjyqtarët	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel	Total
Entela Selmanaj	365	407	421	337	17	20	14	1581
Nertila Përallaj	323	386	401	294	19	11	11	1445
Orinda Lloshi	391	358	323	193	40	15	9	1329
Ermira Bushi	405	321	299	317	62	16	12	1432
Ervin Kore	45	59	51	60	12	12	8	247
Arnaldo Biçoku**								
Romena Qamo**					1			1
<b>Totali</b>	1529	1531	1495	1201	151	74	54	<b>6035</b>

Nga përpunimi i të dhënave të përcjella nga gjykata rezulton se planifikimi i seancave është i shpërndarë kryesisht në 4 ditët e para të javës (nga e hëna në të enjte) dhe ditën e premte numri i seancave të planifikuara është i ulët si dhe vihet re që në disa ditë të premte nuk janë planifikuar seanca nga asnjë gjyqtar, si në datat 10 janar, 17 janar, 24 janar, 11 prill, 16 maj, 23 maj, 13 qershor, 27 qershor.

➤ Nga verifikimi i kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore si dhe i disa procesverbaleve të seancave gjyqësore dhe RIV-e të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezultoi si më poshtë:

- Çështja nr. 21234-00318-21-2024 e gjykuar nga magjistrate N. P. Seanca e datës 11.02.2025 nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja ka qenë me leje.
- Çështja nr. 21249-00239-21-2024, e gjykuar nga magjistratja O. LL., me objekt "Dëshmëpërbllim për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës". Seanca e datës 03.03.2025 nuk është zhvilluar pasi magjistratja ka qenë me leje.
- Çështja nr. 21001-00835-21-2024 e gjykuar nga magjistratja E. B., disa seanca (datë 13.10.2025; 17.11.2025; 24.12.2025) nuk janë zhvilluar pasi gjyqtarja ka qenë me leje.

Në rastet e sipërcituara ku gjyqtaret kanë qenë me leje në ditët në të cilat janë planifikuar seanca procesverbali është mbajtur nga sekretarja gjyqësore për njoftimin se seanca nuk do të zhvillohet pasi magjistratja është me leje.

Nga verifikimi i kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, si dhe i dokumentacionit shoqërues administrativ (vendime për miratimin e lejes së zakonshme vjetore dhe procesverbale seancash), rezulton se ka raste ku gjyqtarët kanë planifikuar seanca edhe kur kanë qenë me leje dhe në këto raste seancat e planifikuara nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit, duke u shtyrë për një datë të mëvonshme, sipas pasqyrimit në procesverbalet përkatëse.

➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka përcjell të dhënat e përdorimit audio referuar raportimit RDA të cilat janë pasqyruar në formë tabelore në aneksin 3 bashkëlidhur këtij raporti.

Nga analiza e të dhënave të përdorimit audio referuar raportimit RDA rezulton se numri i seancave të planifikuara në kalendar është më i lartë se numri i seancave sipas raportit mbi përdorimin e sistemit audio (RDA) pasi si shprehet gjykata në raportet 3 mujore drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër i zhvillon gjykimet vetëm në sallat e gjyqimit me sistemin audio, përjashtim bëjnë vetëm gjykimet që zhvillohen në dhomë këshillim për shkak të parashikimeve ligjore dhe nuk ka asnjë gjykim të zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve apo në mënyrë tjetër të regjistrimit të procesverbalit veç regjistrimit audio. Me urdhrin nr. 67, datë 13.10.2021 përcaktohen se kërkesat civile me objekt: “Lëshim urdhër ekzekutimi”, të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve përjashtohen nga shqyrtimi në RDA.

### 3.3.3 Korrelacioni strukturor midis ngarkesës, planifikimit dhe vendimmarrjes

Tabelë përmbledhëse:						
Ngarkesa/Planifikimi/shpalljet e vendimeve						
Nr.	Gjyqtari	Çështje të mbartura 31.12.2024	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025	Seanca të planifikuara (Janar-Tetor)	Vendime të shpallura 01.01.2026-20.10.2025
1	E. S	320	387	707	1581	406
2	E. B	304	412	716	1432	318
3	N. P	285	395	680	1445	387
4	O. LI	289	419	708	1329	298
5	E. K	0	160	160	247	99
6	A. B	0	0	0	0	0
7	R. Q	0	0	0	0	0

### 3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar

Numri mesatar i planifikimit të seancave gjyqësore në nivel gjykate për secilin muaj dhe për gjithë periudhën e inspektimit 01.01.2025-31.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Kalendar lidhur me seancat e planifikuara për secilin gjyqtar pas verifikimit të tabelave të ridërguara									
Gjyqtari Muaji	E. S	E. B	N. P	O. LI	E. K	A. B	R. Q	Totali seancave për periudhën e inspektimit	Nr. mesatar i seancave në nivel gjykate
Janar	96	108	86	79	0	0	0	369	92
Shkurt	163	157	141	144	0	0	0	605	151
Mars	142	155	138	150	0	0	0	585	146
Prill	191	171	252	157	0	0	0	771	193
Maj	190	182	208	148	0	0	0	728	182
Qershor	224	170	163	194	1	0	0	752	150
Korrik	222	172	166	177	59	0	0	796	159
Gusht	4	11	2	11	10	0	0	38	8
Shtator	129	107	94	102	77	0	0	509	102
Tetor	220	199	195	167	100	0	0	881	176
<b>Totali i seancave për periudhën e inspektimit</b>	<b>1581</b>	<b>1432</b>	<b>1445</b>	<b>1329</b>	<b>247</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6034</b>	<b>1207</b>

## 4 Konkluzione

- i. Pasaktësia e Sistemit Elektronik (ICMIS): Sistemi aktual nuk pasqyron në mënyrë reale volumin individual të punës për çdo gjyqtar pasi në rastet e rishortimeve planifikimet e mëparshme kalojnë automatikisht në llogarinë e gjyqtarit të ri duke rritur artificialisht ngarkesën e gjyqtarit të ri dhe duke ulur ngarkesën e gjyqtarit të mëparshëm.
- ii. Ka raste ku gjyqtarët planifikojnë dy seanca për çështje të ndryshme në të njëjtën datë dhe orë dhe seancat gjyqësore rezultojnë që të mos zhvillohen në orën e planifikuar.
- iii. Ka raste ku gjykimi i 2 çështjeve programohet në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë me të njëjtin gjyqtar për shkak të pjesëmarrjes të magjistratit në cilësinë e

gjqtarit anëtar në gjykimet me trup gjykues të përbërë nga 3 anëtarë dhe caktimit të datës dhe orës së seancës nga gjyqtari kryesues i çështjes.

- iv. Ka raste kur gjyqtarët kanë planifikuar seanca edhe kur kanë qenë me leje dhe seancat e planifikuara nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit, duke u shtyrë për një datë të mëvonshme, sipas pasqyrit në procesverbalet përkatëse.
- v. Numri i seancave të planifikuara në kalendar është më i lartë se numri i seancave sipas raportit mbi përdorimin e sistemit audio (RDA).
- vi. Planifikimi i seancave është i shpërndarë kryesisht në 4 ditët e para të javës (nga e hëna në të enjte) dhe ditën e premte numri i seancave të planifikuara është i ulët si dhe vihet re që ka raste kur ditën e premte nuk planifikohet asnjë seancë nga asnjë gjyqtar.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër)*

## Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

### 1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

#### 1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

Në funksion të realizimit të inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresë nr. 2931 prot., datë 20.10.2025, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me anë të të cilës është kërkuar informacioni dhe dokumentacioni, lidhur me:

- a) statistikave të secilit gjyqtar në lidhje me: I. numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025; II. numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave përse i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe.
- b) kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar.
- c) organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve.
- d) kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025.
- e) numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve.

Në përgjigje të kërkesës, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka dërguar shkresën nr. 1126/1 prot., datë 10.11.2025, e protokolluar në ILD me nr. 2931/1 prot., datë 14.11.2025 dhe komunikimin në rrugë elektronike (email) të datave 11.11.2025, 12.11.2025 dhe 30.01.2026.

Nga përpunimi i informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, ka lindur nevoja për akte dhe dokumentacion shtesë për periudhën objekt inspektimi, të lidhur me rregulloren e veprimtarisë administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, listën e gatishmërisë, analizën vjetore të punës për vitin 2024, formatet e raportimit tremujor sipas vendimit nr. 25, datë 07.02.2019 të KLGJ-së, çështjet e rishortuara për secilin gjyqtar, ndarjen e sallave të gjyqimit, urdhrat e gatishmërive të gjyqtarëve, duke iu drejtuar sërish me shkresë nr. 2931/2 prot., datë 20.11.2025, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Kjo e fundit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1275/1 prot., datë 02.12.2025, të protokolluar në ILD me nr. 2931/3 prot., datë 02.12.2025 dhe me komunikimin në rrugë elektronike (email) të datave 27.11.2025, 16.12.2025, 02.02.2026, 03.02.2026, 05.02.2026 dhe 11.2.2026.

## 2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

### 2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi

Për periudhën objekt inspektimi, gjykata ka funksionuar me organikë të plotë, në përbërje të së cilës kanë qenë 7 gjyqtarë. Në këtë gjykatë për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka pasur dhe nuk ka ndarje në seksione civile apo penale, por me vendim të Këshillit të Gjykatës, me nr. 4, datë 30.01.2025, janë caktuar katër gjyqtarë për shqyrtimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë.

Në periudhën objekt inspektimi pozicioni i Kryetarit të gjykatës ka qenë vakant dhe gjykata është drejtuar nga Zv/Kryetari z. Romeo Merruko, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas vendimit nr. 03, datë 30.09.2024 të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Gjithashtu, nga kjo gjykatë, nëpërmjet dërgimit të vendimit nr. 01, datë 30.09.2025 të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, jemi vënë në dijeni se në datën 30.09.2025 është caktuar në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës, gjyqtari z. Orald Hoxha.

Referuar akteve të përcjella nga gjykata si dhe komunikimi i vazhdueshëm me gjykatën, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në periudhën objekt inspektimi është zbatuar Urdhri nr. 202/1 prot., datë 04.06.2014 i nxjerrë nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjqësor Dibër i kohës, ndërsa po punohej për hartimin e rregullores së re të gjykatës. Gjithashtu nga kjo gjykatë është informuar se është zbatuar vendimi me nr. 150 datë 29.03.2023 i KLGJ-së, dhe urdhrave të kryetarit të gjykatës për organizimin e shortit, miratimin e listës së gatishmërisë, për gjykimin e rasteve urgjente, gjatë pushimeve vjetore, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, të dërguar bashkëlidhur.

Referuar urdhrin të ish-kryetarit të sipërcituar, lidhur me disiplinën në punë, në nenin 8 është parashikuar se të gjithë punonjësit, ndër të cilët edhe gjyqtarët kanë detyrimin të respektojnë orarin zyrtar ditor, nga ora 08:00 deri në orën 16.00. Për mungesat në punë për shkaqe shëndetësore duhet të bëhet fillimisht njoftimi telefonik tek Kryetari i Gjykatës e në mungesë të tij tek Kancelari, shoqëruar më pas dhe me raport mjekësor. Në vijim, lidhur me planifikimin e seancave në të njëjtën dispozitë, është parashikuar se "4. Gjyqtarët marrin masa që të realizojnë një planifikim të përshtatshëm të seancave gjyqësore, të tillë, që të mund të maksimizohet mundësia e shfrytëzimit të sallave të gjykimit. Për këtë kërkohet aftësi planifikuese, gjë që përbën edhe element të vlerësimit përshkrues të tij prej kryetarit, si dhe shfrytëzim serioz të kalendarit elektronik, me qëllim evitimin e mbivendosjes së gjykimeve në të njëjtën ditë, orë dhe sallë gjykimi. Gjyqtarët marrin masa që të fillojnë zhvillimin e seancave gjyqësore në orarin e parashikuar. Në çdo rast kur kjo nuk ndodh, sekretarja e seancës, edhe kryesisht apo me njoftimin e gjyqtarit duhet të pasqyrojë në procesverbalin e seancës shkakun e vonesës. Po kështu,

sekretarja e seancës shënon në procesverbal edhe kohën e përfundimit të seancës. 5. Të gjitha seancat gjyqësore që zhvillohen në sallat e gjykimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër regjistrohen në audio, duke ndjekur të gjitha parashikimet e udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë për këtë qëllim. Në raste, përjashtimore të veçanta, nisur nga natyra e çështjes në gjykim, kur rezulton se sallat e gjykimit janë të zëna me gjykime, pamundësi e shtyrjes së gjykimit pasi sjell vonesa të dëmshme për interesat e palëve ndërgjyqëse, gjyqtarët mund të zhvillojnë gjykimet në zyrë”.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër rezultojnë 5 salla gjykimi, nga të cilat vetëm 4 salla gjykimi janë funksionale. Nga këto salla, njëra është për gjykimin e çështjeve penale dhe tre të tjerat për gjykimet e çështjeve civile.

Nga analiza e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për vitin 2024 (në kushtet kur kjo analizë nuk është bërë ende për vitin 2025) rezulton se salla nr. 1 është e përshtatshme për zhvillimin e gjykimeve penale me pjesëmarrje të personave të ndaluar, arrestuar apo dënuar. Referimi i këtij informacioni në analizën vjetore, është vijuar me parashtrimin e faktit se infrastruktura e gjykatës përbën shkak për zhvillimin jo në orar të proceseve gjyqësore, për shkak të përplasjeve të orareve ndërmjet gjyqtarëve. Lidhur me këto seanca në të njëjtin raport citohet se: “Nuk janë evidentuar problematika në lidhje me fillimin e seancave me vonesë, për shkaqe të pajustificuara. Përsa i përket seancave të filluar me vonesë për shkaqe të justifikuara ndodh pasi zgjaten tej afateve të planifikuar të seancave paraardhëse si dhe për shkak se në Gjykatë është vetëm një sallë penale ku për shkak të ngarkesës ndonjëherë sjellë fillim me vonesë të seancave gjyqësore”.

Lidhur me llojin e gjykimit që zhvillohen në salla, citohet se: “Gjatë këtij viti ashtu si edhe në vitet e mëparshme, të gjitha seancat gjyqësore efektive, janë regjistruar në procesverbale audio, duke u zhvilluar gjykimet në salla, përveç atyre që ligjet përkatëse procedurale kërkojnë që të zhvillohen në dhomë këshillimi (për lejimin e përgjimeve dhe gjykime të tjera me karakter sekret).”

Gjithashtu lidhur me sallën jofunksionale, sipas të njëjtit dokument të analizës së punës për vitin 2024 të sipërcituar, është parashtruar se “salla e krijuar për gjykimin e çështjeve penale me të mitur nuk është funksionale pasi aktualisht po përdoret si zyrë arkivi, një problem që duhet adresuar dhe mundësisht dhënies zgjidhje për vitin në vazhdim”.

## **2.2. Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS dhe janë të dhënat e gjeneruar nga ky sistem për planifikimin e seancave që janë përcjellë nga ana e gjykatës në fjalë, si dhe të cilat janë përdorur për efekt të këtij inspektimi.

Në sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykatë në një zë të veçantë “Menaxhimi i gjykatës” tek pjesa “Raporte të përgjithshme” është përfshirë planifikimi i seancave gjyqësore, ndërsa rezulton se në të njëjtin sistem është i përfshirë në zë të veçantë pjesa e procesverbaleve të seancave. Zëri i planifikimit të seancave gjyqësore pasqyron për secilën çështje, sallën dhe datën e planifikuar për t’u zhvilluar, si dhe për të vijuar me të dhënat në mënyrë tabelare: numrin rendor, ora e fillimit dhe e mbarimit, numri i çështjes, objekti, palët dhe gjyqtarin e çështjes. Në planifikimin e seancave gjyqësore përfshihen planifikimet e seancave e çështjeve gjyqësore sipas gjyqtarit respektiv ku ai shfaqet si kryetar i trupit gjykues.

Nga informacioni i marrë nga gjykata mbi planifikimin e seancave gjyqësore u evidentuan se në seksionin përkatës të sistemit ICMIS nga ku gjeneroheshin të dhëna në këtë drejtim, në rastin e rishortimeve siç është përmendur më sipër, nuk pasqyroheshin të gjitha seancat gjyqësore të planifikuara respektivisht nga gjyqtari, por raportimi në fakt lidhej me çështjen duke pasqyruar vetëm emrin e gjyqtarit të fundit për të gjitha seancat gjyqësore. Problematika si më sipër në këtë gjykatë, lidhur me rishortimet u evidentua në 15 çështje të cilat përfshinin 6 gjyqtarë nga 7 gjyqtarë në organikë të kësaj gjykate në periudhën objekt inspektimi Këto të dhëna u rregulluan nga ana e vetë gjykatës, duke informuar në drejtim të saktësimit të numrit faktik të seancave gjyqësore të planifikuara/zhvillim nga secili gjyqtar, me pasqyrimin si më poshtë:

Gjyqtari	Planifikimi		Zhvillimi	
	Numri i seancave sipas sistemit zërit “planifikimi i seancave gjyqësore” (si kryetar i trupit gjykues	Numri i seancave gjyqësore pas përpunimit/rregullimit nga gjykata	Numri i seancave sipas sistemit (si kryetar i trupit gjykues	Numri i seancave gjyqësore pas përpunimit/rregullimit nga gjykata
Anxheina Shkopi	767	753	756	742
Enkeleda Halilaj	879	877	829	826
Megi Anxhela Muhaj	746	739	729	722
Mevlute Çausi	687	684	685	683
Orald Hoxha	638	645	628	634
Romeo Merruko	586	591	565	581

Gjithashtu, nga të dhënat e planifikimit të seancave gjyqësore të përcjellë nga ana e gjykatës, u konstatuan edhe pasaktësi në drejtim të numrit të seancave të planifikuara

brenda një dite referuar të dhënave të përcjellë nga ana e gjykatës, kjo u evidentua nga verifikimi rastësor i një grupimi çështjesh (gjithsej 6 raste) për të cilat rezultonte se ishin planifikuar më shumë se një seancë gjyqësore në të njëjtën orë. Në këto raste u evidentua se ishin të pasqyruar si planifikim nga i njëjti gjyqtar dy herë në të njëjtën orë të të njëjtës datë i të njëjtës çështje. Për këto raste nga verifikimi në sistemin ICMIS, për secilën nga këto çështje është gjetur i mbajtur një procesverbal për ditën e planifikimit. Më konkretisht çështjet si më poshtë:

- Çështja me nr. 21250-00579-33-2024 planifikimi datë 17.02.2025 fillimi ora 13:00 dhe mbarimi 14:00 – (me numër rendor 116 dhe 117);
- Çështja me nr. 71018-01294-33-2024 planifikimi datë 12.03.2025 fillimi ora 10:00 dhe mbarimi 11:00 (me numër rendor 167 dhe 168);
- Çështja me nr. 71018-01307-33-2024 planifikimi datë 12.03.2025 fillimi ora 10:30 dhe mbarimi 11:00 (me numër rendor 169 dhe 170);
- Çështja me nr. 11232-00022-33-2025, planifikimi datë 25.04.2025 fillimi ora 11:00 dhe mbarimi 12:00 – (me numër rendor 259 dhe 260);
- Çështja me nr. 60005-00320-33-2025 planifikimi datë 25.06.2025 fillimi ora 11:00 dhe mbarimi 12:00 - (me numër rendor 391 dhe 392);
- Çështja me nr. 21234-0069-33-2024 planifikimi datë 27.10.2025 fillimi ora 11:00 dhe mbarimi 12:00 - (me numër rendor 568 dhe 569);

### 3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

#### 3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në nivel gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nga përpunimi i dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 konstatohet se nga viti 2024 janë mbartur **606** çështje dhe janë regjistruar **1276** çështje, të shpërndara si më poshtë për secilin gjyqtar:

Nr.	Gjyqtari	Numri i çështjeve të:		Totali:
		<i>mbartura nga viti 2024</i>	<i>reja për periudhën 01.01.2025-31.10.2025</i>	
1	Arxheina Shkopi	72	172	244
2	Flutura Çuko	88	181	269
3	Mevlute Çausi	95	182	277
4	Orald Hoxha	77	189	266

5	Megi Anxhela Muhaj	83	177	260
6	Enkeleda Halilaj	99	194	293
7	Romeo Merruko	90	181	271
8	Aurel Arapi	1	0	1
9	Artan Çupi	1	0	1
	<b>Totali:</b>	<b>606</b>	<b>1276</b>	<b>1882</b>

Për t'u saktësuar, lidhur me çështjet e mbartura, referuar informacionit të sjellë nga Gjykata Dibër, janë përfshirë edhe çështjet me status të pezulluar për periudhën objekt inspektimi.

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në nivel gjykate dhe për secilin gjyqtar.

Për periudhën objekt inspektimi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të dhënat mbi numrin e vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi, rezultojnë si më poshtë:

Gjyqtari	Numri i vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-31.10.2025
Artan Çupi	1
Arxheina Shkopi	167
Enkeleda Halilaj	197
Flutura Çuko	153
Megi Anxhela Muhaj	155
Mevlute Çausi	183
Orald Hoxha	183
Romeo Merruko	209
Aurel Arapi	0
<b>TOTALI:</b>	<b>1248</b>

Referuar informacionit të pasqyruar në listën e çështjeve të gjykuara me vendim, për periudhën objekt inspektimi, çështjet janë sipas kategorive: 1 kërkesë tregtare, 2 kërkesa Administrative, 3 kërkesa për lëshimin e urdhër ekzekutimi, 73 kërkesa civile të veçanta, 286 çështje familjare, 105 çështje civile të përgjithshme, 1 kërkesë penale me të mitur, 173 kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake, 428 kërkesa penale dhe 176 çështje penale themeli.

### 3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas Raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 në nivel gjykate dhe secilin gjyqtar

#### 3.3.1. Shpërndarja e seancave të planifikuara sipas gjyqtarëve, për të gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 duke e përcaktuar për çdo muaj

Gjatë periudhës janar-tetor 2025, referuar zërit të planifikimit të seancave gjyqësore të gjeneruar nga sistemi ICMIS sipas informacionit të gjykatës subjekt inspektimi, rezultojnë se janë planifikuar gjithsej **5027 seanca, me pasqyrimin si më poshtë:**

Gjyqtari Muaji	Arxheina Shkopi	Flutura Çuko	Mevlute Çausi	Orald Hoxha	Megi Anxhela Muhaj	Enkeleda Halilaj	Romeo Merruko	Totali i seancave për periudhën e inspektimit
Janar	69	59	58	53	53	79	68	439
Shkurt	71	77	77	75	77	104	83	564
Mars	73	47	66	55	73	80	60	454
Prill	91	105	94	83	123	103	71	670
Maj	101	73	65	68	114	89	57	567
Qershor	82	50	56	80	88	105	70	531
Korrik	73	110	93	82	96	107	64	625
Gusht	15	5	13	2	4	14	3	56
Shtator	77	88	53	62	51	88	55	474
Tetor	101	124	109	85	60	108	60	647
Totali seancave për periudhën e inspektimit	753	738	684	645	739	877	591	5027

### 3.3.2. Shpërndarja e seancave të planifikuara sipas gjyqtarëve, për të gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 duke e përcaktuar për ditët e javës

Nga gjykata objekt inspektimi, është informuar për planifikime të gjykimeve nga ana e gjyqtarëve sipas një ndarje të sallave të dakordësuar në Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Kjo ndarje sipas të njëjtit informacion konstatohet të jetë dakordësuar në parim si rregull i përgjithshëm, pasi nuk është respektuar gjithmonë nga gjyqtarët. Këta të fundit për shkak të respektimit të afateve ligjore apo standardeve minimale kohore për shqyrtimin e çështjeve, kanë planifikuar seanca edhe gjatë ditëve të ndryshme nga ato të përcaktuara të mëposhtme.

Gjithashtu është informuar se në planifikimet për sallat, janë përfshirë edhe gjykimet në dhomë këshillimi, duke shpjeguar *“Lidhur me çështjet civile dhe penale që parashikojnë kodet përkatëse për zhvillimin e gjykimeve në dhomë këshillimi ju informojmë se këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, por nga ana e sekretarisë gjyqësore në momentin që planifikon çështjen dhe zgjedh gjendja e gjykimet “Dhomë Këshillimi” duhet me patjetër të zgjidhet edhe salla e gjyqit pasi sistemi nuk e lejon që salla e gjyqit të jetë bosh. Po ashtu edhe në momentin kur hidhet procesverbali edhe pse seanca është zhvilluar në dhomë këshillimi duhet me patjetër ta zgjedhësh sallën e gjyqit pasi sistemi nuk të lejon të bësh “save” procesverbalin e përfunduar”.*

Ndarja e sallave respektivisht sipas ditëve të një jave, referuar informacionit pasqyrohet si më poshtë:

Gjyqtarët		E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
Romeo Merruko	Salla 1		Salla 1		
Orald Hoxha	Salla 2		Salla 2		
Enkeleda Halilaj	Salla 4		Salla 4		
Arxheina Shkopi		Salla 4		Salla 4	
Megi Anxhela Muhaj		Salla 2		Salla 2	
Flutura Çuko		Salla 3		Salla 3	
Mevlute Çausi		Salla 1		Salla 1	

Referuar planifikimit në salla të seancave sipas ditëve të javës, është konstatuar për periudhën objekt inspektimi planifikim përveç ditëve të javës, edhe në ditët e pushimit, kryesisht të shtunë dhe të diel. Seancat e planifikuara për këto ditë pushimi i përkasin kategorisë së çështjeve të konsideruara të ngutshme civile dhe penale, referuar afateve ligjore procedurale të gjykimet dhe të cilat sipas rastit planifikohen në salla gjykimi ose dhomë këshillimi, por që gjithsesi siç e cituam më sipër ka planifikim në një sallë të

caktuar. Në këtë gjykatë për periudhën objekt inspektimi ka funksionuar lista e gjyqtarëve të miratuar me urdhër të zëvendëskryetarit, për gjykimin e çështjeve të kategorisë urgjente.

Sallat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Total
Salla 1 (penale)	172	199	174	229	179	185	226	41	184	246	
Salla 2	80	126	97	164	144	129	154	1	79	106	
Salla 3	61	79	48	105	71	45	102	6	82	120	
Salla 4	126	160	135	172	173	172	143	8	129	175	
<b>Totali</b>	<b>439</b>	<b>564</b>	<b>454</b>	<b>670</b>	<b>567</b>	<b>531</b>	<b>625</b>	<b>56</b>	<b>474</b>	<b>647</b>	<b>5027</b>

Nga përpunimi i të dhënave lidhur me seancat gjyqësore të planifikuara gjatë ditëve të javës, nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, **për të gjithë periudhën objekt inspektimi**, shpërndarja paraqitet si më poshtë:

Gjyqtarët	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Dielë	Total
Romeo Merruko	230	11	292	21	25	9	3	591
Orald Hoxha	264	28	323	19	10	1	2	645
Enkeleda Halilaj	310	84	347	68	51	8	9	877
Arxheina Shkopi	110	282	76	260	20	1	4	753
Megi Anxhela Muhaj	42	304	51	331	5	0	6	739
Flutura Çuko	30	403	2	249	35	8	11	738
Mevlute Çausi	21	312	9	322	6	5	9	684
<b>Totali</b>	<b>1007</b>	<b>1424</b>	<b>1100</b>	<b>1270</b>	152	32	44	<b>5027</b>

Nga të dhënat e shpërndarjes së seancave referuar tabelës së fundit, evidentohet që në ditë të caktuara jave nga e hëna në të enjte, disa gjyqtarë paraqiten me numër dukshëm më të madh seancash sesa disa të tjerë, ndërkohë që këta të fundit në ditët e tjera të javës janë me numër më të madh sesa të parët. Ky konstatim shpjegohet dhe ka lidhje pikërisht me dakordësimin në parim për ndarjen e sallave të sipërcituar.

Referuar të dhënave të tabelës, për periudhën 9-mujore brenda periudhës së inspektimit (duke mos llogaritur gushtin si periudhë ku gjyqtarët kryesisht kryejnë lejen vjetore, si dhe seancat e zhvilluar ditëve të pushimit)<sup>[40]</sup> rezultojnë një mesatare seancash ditore për gjyqtar më masën 3.53. Ndërsa po t'i referohemi planifikimit në ditët nga e hëna deri në të enjte<sup>[41]</sup>, ku numri i seancave në nivel gjykate dukshëm është më i lartë se ai ditën e premte, rezultojnë të jetë në vlerën 4.45.

Në të dhënat e mësipërme, nuk janë përfshirë gjyqtarët Artan Çupi dhe Aurel Arapi, për shkak se i pari në periudhën objekt inspektimi ka qenë i ngarkuar me gjykimin e një çështje për shkak të transferimit të tij në një gjykatë tjetër dhe Aurel Arapi, i cili ka qenë i komanduar në përbërjen e trupit gjykues për gjykimin e një çështje civile për të cilën është vendosur pezullimi, rreth 3 vite përpara periudhës objekt i këtij inspektimi dhe që nuk e ka ndryshuar këtë status edhe në periudhën në fjalë (e inspektimit).

Nga përpunimi i të dhënave të marra Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, mbi planifikimin e seancave gjyqësore, janë konstatuar raste të planifikimit në të njëjtin orar të një dite të më shumë se një seancë gjyqësore jo vetëm për çështje të ndryshme, por edhe të njëjta që i përkasin të njëjtit gjyqtar.

Për rastet e kategorisë së çështjeve të ndryshme, ndër rreth 113 raste të konstatuara, evidentohet se ato i përkasin të gjithë gjyqtarëve në organikë për periudhën objekt inspektimi dhe për këtë kategori çështjesh nga verifikimi në sistemin ICMIS në zërin "procesverbal", rezultojnë se për secilën prej këtyre seancave sipas planifikimit është mbajtur procesverbali përkatës ku është pasqyruar çelja nga gjyqtari apo konstatimi nga sekretarja (në rastet për moszhvillim seance për shkak mungese të arsyeshme të gjyqtarit). Lidhur procesverbalin e konstatimit të mbajtur nga gjykata është informuar se hidhet në sistemin ICMIS.

Për rastet e kategorisë së çështjeve të njëjta, në 6 rastet e konstatuara të sipërcituara në nënçështjen 3.2., evidentohet se ato i përkasin vetëm një gjyqtari dhe për këtë kategori çështjesh nga verifikimi në sistemin ICMIS në zërin "procesverbal", rezultojnë se është gjetur i mbajtur një procesverbal për ditën e planifikimit.

<sup>40</sup> nga numri total prej 5027 seanca, heqim 56 seanca të zhvilluara në muajin gusht 2025, si dhe heqim 32 seanca të zhvilluara ditët e shtuna dhe 44 seanca ditët e diela, shifrën që del nga veprimi i mësipërm prej 4895 seanca e pjesëtojmë me 9 muaj (për të nxjerrë mesataren në muaj, ku del 543.888 seanca), e pjesëtojmë me 7 gjyqtar (ku del 77.69 seanca për gjyqtar në muaj) dhe në vazhdim këtë shifër e pjesëtojmë me 22 ditë punë në muaj del 3.53 seanca në ditë (ose 4 seanca në ditë për gjyqtar).

<sup>41</sup> nga numri total prej 5027 seanca, heqim 56 seanca të zhvilluara në muajin gusht 2025, si dhe heqim 32 seanca të zhvilluara ditët e shtuna dhe 44 seanca ditët e diela, shifrën që del nga veprimi i mësipërm prej 4770 seanca e pjesëtojmë me 9 muaj (për të nxjerrë mesataren në muaj, ku del 530 seanca), e pjesëtojmë me 7 gjyqtar (ku del 75.71 seanca për gjyqtar në muaj) dhe në vazhdim këtë shifër e pjesëtojmë me 17 ditë punë në muaj del 4.45 seanca në ditë.

### 3.3.3. Shpërndarja e seancave të zhvilluara sipas Raportit për përdorimin e Sistemit të Regjistrimit Audio, sipas gjyqtarëve, në periudhën 01.01.2025-31.10.2025

Për seancat e zhvilluara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, janë dërguar raportet për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio që gjenerohen për çdo muaj për secilin gjyqtar si në pozicionin e kryetarit të trupit gjykues ashtu edhe në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Në këtë raport, evidentohen të pasqyrohen të dhëna në shifra përsa i përket numrit të seancave audio dhe në zyrë, vijuar me totalin e këtyre seancave dhe % e seancave të regjistruara.

Për seancat e raportuara si të zhvilluar në zyrë, sipas raporteve të sipërcituara, gjykata mbi kërkesën tonë për sqarim mbi këto gjykime e lidhur me mungesën e konstatimeve të një planifikimi në zyrë, ka informuar se: *“Lidhur me çështjet civile dhe penale që parashikojnë kodet përkatëse për zhvillimin e gjykimeve në dhomë këshillimi ju informojmë se këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi por nga ana e sekretarisë gjyqësore në momentin që planifikon çështjen dhe zgjedh gjendja e gjykimit “Dhomë Këshillimi” duhet me patjetër të zgjidhet edhe salla e gjyqit pasi sistemi nuk e lejon që salla e gjyqit të jetë bosh. Po ashtu edhe në momentin kur hidhet procesverbali edhe pse seanca është zhvilluar në dhomë këshillimi duhet me patjetër ta zgjedhësh sallën e gjyqit pasi sistemi nuk të lejon të bësh “save” procesverbalin e përfunduar”.*

Në drejtim sa më sipër, janë marrë në trajtim edhe formatet e raportimit tremujor të kësaj gjykate, që përfshihen në periudhën objekt inspektimi<sup>42</sup>. Këto formate bazohen në vendimin e KLGJ nr. 25, datë 07.02.2019 dhe nga të dhënat që pasqyrohen në to, si persona përgjegjës për përgatitjen e raporteve rezultojnë kancelari, specialisti i statistikave dhe shefi i sektorit të IT statistikës dhe marrëdhëniet me publikun.

Të dhënat në dy dokumentet e sipërcituara “Raport për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio” (në vijim dokumenti 1) dhe “Format i raportimit tremujor” (në vijim dokumenti 2), janë krahasuar nga ku evidentohet se të dhënat që i përkisnin numrit të seancave në zërin “nr. i seancave në zyrë” në dokumentin 1 janë të dhëna me numrin e seancave në zërin “seanca të paregjistruara (SP)” në dokumentin 2 në pjesën “Niveli i përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar”. Ky zë i fundit, është i shoqëruar edhe me raportimin e arsyeve të mosregjistrimit, në një zë të veçantë nga ku për të gjitha këto raste të këtyre seancave, arsyeja e mosregjistrimit ka qenë e lidhur me faktin e zhvillimit të gjykimit *“pa praninë e palëve dhe në dhomë këshillimi, referuar K. Pr. Penal dhe K. Pr. Civile”.*

**Referuar objektit të inspektimit dhe faktit që në seksionin e veçantë të planifikimit të seancave gjyqësore pasqyrohen planifikimet për çështjet ku gjyqtari respektiv**

<sup>42</sup> Duke qenë se raportet në fjalë janë tremujore dhe periudha e inspektimit është 10-mujor, muaji i fundit nuk është përfshirë në këto raporte.

shfaqet si kryetar i trupit gjykues, më poshtë do të pasqyrojmë të dhënat mbi numrin e seancave audio dhe të seancave të paregjistruara

#### Numri i seancave audio

Muaji	Arxheina Shkopi	Flutura Çuko	Mevlute Çausi	Orald Hoxha	Megi Anxhela Muhaj	Enkeleda Halilaj	Romeo Merruko	Totali
Janar	41	32	57	37	43	69	43	322
Shkurt	52	73	72	73	40	97	78	485
Mars	62	42	31	55	48	75	48	361
Prill	88	101	90	71	118	75	54	597
Maj	99	73	56	65	88	68	47	496
Qershor	72	34	35	74	70	83	67	435
Korrik	69	109	87	77	82	86	54	564
Gusht	9	5	11	2	3	8	3	41
Shtator	76	84	50	59	42	74	49	434
Tetor	80	117	58	60	40	80	48	483
<b>Totali</b>	<b>648</b>	<b>670</b>	<b>547</b>	<b>573</b>	<b>574</b>	<b>715</b>	<b>491</b>	<b>4218</b>

#### Numri i seancave të paregjistruara

Periudha objekt inspektimi	Arxheina Shkopi	Flutura Çuko	Mevlute Çausi	Orald Hoxha	Megi Anxhela Muhaj	Enkeleda Halilaj	Romeo Merruko	Totali
<b>Totali</b>	<b>94</b>	<b>61</b>	<b>136</b>	<b>61</b>	<b>148</b>	<b>111</b>	<b>90</b>	<b>701</b>

Lidhur me të dhënat e Raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, është e rëndësishme të trajtojmë rastet e të proceduarit mbi gjykimet e planifikuara në ditët për të cilët gjyqtarit i është miratuar kërkesa e tij për leje vjetore. Periudha e lejes vjetore parashikohet si e drejtë e magjistratit, por që atij referuar kufijve të parashikuar në ligjin “Për statusin” i është dhënë mundësia ta planifikojë paraprakisht për ta shfrytëzuar atë në përputhje me ushtrimin e funksionit të tij, duke marrë masat e duhura në drejtim të dilijencës që ai tregon. Në nenin 23 të ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Magjistrati gëzon të drejtën për pushime vjetore të paguara me kohëzgjatje 25 ditë

pune. 5. Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në çdo rast, pushimet duhet të përfshijnë një periudhë trejavore pa ndërprerje, gjatë muajit gusht, përveç kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të gjykatës ose prokurorisë. 8. Magjistrati që nuk merr pushimet e plota vjetore deri në fund të vitit përkatës kalendarik, për arsye që nuk lidhen me kërkesa të funksionit, mund të shtyjë kohëzgjatjen e mbetur të pushimeve në vitin pasardhës, me kushtin që kohëzgjatja e mbetur të jetë deri në pesë ditë. Leja e prapambetur mund të merret deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës. Magjistrati që nuk ka marrë pushimet e plota vjetore në kohën e largimit nga funksioni, përfiton kompensim në pagesë, të barabartë me një të tridhjetën e pagës që merrte para largimit, për çdo ditë pushimi të mbetur. 9. Magjistrati që ndërpret pushimet vjetore për shkak të kërkesave të funksionit ose që i anulohen këto pushime, gëzon të drejtën për t'u kompensuar për të gjitha shpenzimet e kryera, veçanërisht shpenzimet e transportit, nëse ato vërtetohen me dokumentacionin e nevojshëm. 11. Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre.”. Për këto arsye, pjesë e këtij trajtimi do të jetë edhe analiza lidhur me planifikimin dhe moszhvillimin e gjykimit për shkak të shfrytëzimit të të drejtës së tij për të kryer lejen e zakonshme.

Nga të dhënat e marra nga gjykata, është evidentuar se 4 gjyqtarë nga 7 gjyqtarët në organikë kanë kërkuar dhe kanë kryer lejen vjetore për periudhën objekt inspektimi, ndërkohë që kishin planifikuar më parë seanca gjyqësore. Ndër gjyqtarët në fjalë rezultojnë të ketë qenë edhe vetë Zv/Kryetari i cili ka ushtruar edhe funksionet e kryetarit të gjykatës dhe si i tillë personi përgjegjës për miratimin e lejeve. Në të gjitha rastet e kërkesave të gjyqtarëve për leje të zakonshme është konstatuar miratimi i tyre nga Zv/Kryetari me shënimin përkatës në kërkesë, duke përfshirë edhe moszhvillimin e tyre. Rastet e evidentuara për periudhën objekt inspektimi rezultojnë si më poshtë:

- Gjyqtare Mevlude Çausi me datën 13.03.2025 kishte planifikuar 10 seanca; me datën 18.03.2025 kishte planifikuar 9 seanca; me datën 20.03.2025 kishte planifikuar 7 seanca; me datën 25.03.2025 kishte planifikuar 10 seanca; me datën 27.03.2025 kishte planifikuar 6 seanca; me datën 12.06.2025 kishte planifikuar 5 seanca.
- Gjyqtare Megi Anxhela Muhaj me datën 14.08.2025, kishte planifikuar 1 seancë.
- Gjyqtare Enkeleda Halilaj me datën 19.03.2025 kishte planifikuar 2 seanca; më datën 21.07.2025 kishte planifikuar 3 seanca; me datën 23.07.2025 kishte planifikuar 3 seanca; më datën 24.07.2025 kishte planifikuar 1 seancë; më datën 25.07.2025 kishte planifikuar 3 seanca; më datën 13.08.2025 kishte planifikuar 1 seancë; më datën 21.08.2025 kishte planifikuar 1 seancë; më datën 08.09.2025 kishte planifikuar 6 seanca.

- Gjyqtari Romeo Merruko, i cili në këtë periudhë ka qenë në cilësinë e zv/kryetarit më datën 10.03.2025 kishte planifikuar 1 seancë, më datën 12.03.2025 kishte planifikuar 6 seanca.

#### 4. Konkluzione

Për periudhën objekt inspektimi, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka funksionuar me organikë të plotë, me 7 gjyqtarë.

Për periudhën objekt inspektimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në drejtim të objektit të inspektimit, është proceduar mbi bazën e rregullores së miratuar nga ish kryetari i kësaj gjykate në vitin 2014, ndërsa nuk është proceduar ende me nxjerrjen dhe miratimin e rregullores së re mbështetur në Vendimin e KLGJ-së me nr. 150, datë 23.03.2023.

Gjithashtu, në kuadër të menaxhimit të caktimit të çështjeve, nga ana e zv/kryetarit (i caktuar për të ushtruar funksionet e kryetarit, pasi nuk kishte një të tillë), është proceduar me urdhër për caktimin e gjyqtarëve urdhrave të kryetarit të gjykatës për organizimin e shortit, miratimin e listës së gatishmërisë, për gjykimin e rasteve urgjente, gjatë pushimeve vjetore, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, të dërguar bashkëlidhur.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, për periudhën objekt inspektimi nuk ka pasur ndarje në seksione civile apo penale, por me vendim të Këshillit të Gjykatës, janë caktuar katër gjyqtarë për shqyrtimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër rezultojnë 5 salla gjykimi, nga të cilat vetëm 4 salla gjykimi janë funksionale. Nga këto salla, njëra është për gjykimin e çështjeve penale dhe tre të tjerat për gjykimet e çështjeve civile. Nga gjykata objekt inspektimi, është informuar për planifikime të gjykimeve nga ana e gjyqtarëve sipas një ndarje të sallave të dakordësuar në Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Kjo ndarje sipas të njëjtit informacion konstatohet të jetë dakordësuar në parim si rregull i përgjithshëm, pasi nuk është respektuar gjithmonë nga gjyqtarët. Këta të fundit për shkak të respektimit të afateve ligjore apo standardeve minimale kohore për shqyrtimin e çështjeve, kanë planifikuar seanca edhe gjatë ditëve të ndryshme nga ato të përcaktuara në tabelën e mësipërme. Nuk ka një urdhër të veçantë për ndarjen e këtyre sallave për gjyqtarë, e cila do të vlerësohej në drejtim të formalizimit të menaxhimit në këtë drejtim.

Nga ndarja e sallave, sipas rregullit të dakordësuar midis gjyqtarëve për të gjithë periudhën e inspektimit, dita e premte si rregull nuk ishte përfshirë në ditë planifikimi gjykimi, ndërsa u evidentuan planifikime në këtë ditë. Nga të dhënat e seancave të planifikuara sipas ditëve, evidentohet që në ditë të caktuara jave nga e hëna në-të enjte,

disa gjyqtarë paraqiten me numër dukshëm më të madh seancash sesa disa të tjerë, ndërkohë që këta të fundit në ditët e tjera të javës janë me numër më të madh se të parët. Ky konstatim shpjegohet dhe ka lidhje pikërisht me dakordësimin në parim për ndarjen e sallave të sipërcituar. Gjithashtu në seancat e planifikuara rezultojnë të përfshira edhe ditët e shtuna dhe të diela, të cilat lidhen me rastet e gjykimit të çështjeve urgjente. Në total numri i seancave të planifikuara për të gjithë ditët e javës rezultoi në shifrën 5027.

Referuar të dhënave të tabelës, për periudhën 9-mujore brenda periudhës së inspektimit (duke mos llogaritur gushtin si periudhë ku gjyqtarët kryesisht kryejnë lejen vjetore, si dhe seancat e zhvilluar ditëve të pushimit) rezulton një mesatare seancash ditore për gjyqtar me masën 3.53. Ndërsa po t'i referohemi planifikimit në ditët nga e hëna deri në të enjte, ku numri i seancave në nivel gjykate dukshëm është më i lartë se ai ditën e premte, rezulton të jetë në vlerën 4.45.

Në periudhën objekt inspektimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm rezultonin në total në gjykim 606 çështje të mbartura dhe 1276 çështje të reja (të regjistruar nga 1 janari), si dhe 1248 vendime të shpallura.

Nga të dhënat e Raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio dhe Formatit të raportimit tremujor, rezultonin gjykime të zhvilluara në audio në vlerën 4218 dhe në të pargjistruara në vlerën 701.

Për periudhën objekt inspektimi, u konstatuan moszhvillime të gjykimeve të planifikuara nga gjyqtarët për shkak të kryerjes së lejes vjetore. Periudha e lejes vjetore parashikohet si e drejtë e magjistratit, por që atij referuar kufijve të parashikuar në ligjin "Për statusin" i është dhënë mundësia ta planifikojë paraprakisht për ta shfrytëzuar atë në përputhje me ushtrimin e funksionit të tij, duke marrë masat e duhura në drejtim të dilijencës që ai tregon.

Për periudhën objekt inspektimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, u evidentuan se për gjykimet në dhomë këshillimi, bëhet planifikimi në sallë, ndërsa nuk realizohet aty gjykimi. Kjo pasjell zënie sallash me ndikim të drejtpërdrejt jo vetëm në planifikimin e gjykimeve të tjera që zhvillohen nëpër salla, por edhe në menaxhimin tërësor të zhvillimit të gjykimeve në një gjykatë.

Për periudhën objekt inspektimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, u konstatuan se në sistemin e menaxhimit të çështjeve në rastin e çështjeve të rishortuara, nuk pasqyroheshin të gjitha seancat gjyqësore të planifikuara respektivisht nga gjyqtari, por se raportimi në fakt lidhej me çështjen duke pasqyruar vetëm emrin e gjyqtarit të fundit për të gjitha seancat gjyqësore. Këto të dhëna u rregulluan nga ana e vetë gjykatës, duke informuar në drejtim të saktësimit të numrit faktik të seancave gjyqësore të planifikuara/zhvillim nga secili gjyqtar. Edhe pse kjo rezultoi në shumë pak raste dhe sistemimi u bë nga vetë gjykata si rezultat i konstatimit të kësaj çështje, kjo pasjell pasaktësi në statistikat lidhur me tregues të punës së gjyqtarit

dhe si i tillë duhet të adresohet në drejtim të ndërhyrjes në sistemin e menaxhimit të çështjeve për rregullim në një zë të veçantë.

Gjithashtu, nga të dhënat e planifikimit të seancave gjyqësore të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve, u konstatuan edhe pasaktësi në drejtim të numrit të seancave të planifikuara brenda një dite, në të njëjtin orar, të më shumë se një seancë gjyqësore jo vetëm për çështje të ndryshme, por edhe të njëjta që i përkasin të njëjtit gjyqtar. Kjo u evidentua për rastet e kategorisë së çështjeve të ndryshme, ndër rreth 113 raste të konstatuara dhe nga verifikimi rastësor i një grupimi çështjesh (gjithsej 6 raste) për të cilat rezultonte se ishin planifikuar më shumë se një seancë gjyqësore në të njëjtën orë. Në këto raste u evidentua se ishin të pasqyruar si planifikim nga i njëjti gjyqtar dy herë në të njëjtën orë të të njëjtës datë i të njëjtës çështje. Për këto raste nga verifikimi në sistemin ICMIS, për secilën nga këto çështje është gjetur i mbajtur një procesverbal për ditën e planifikimit. Këto pasaktësi, passjellin mospasqyrim të saktë në statistikat lidhur me tregues të punës së gjyqtarit, planifikim/zhvillim dhe si i tillë duhet të adresohet në drejtim të kujdesit të shtuar në drejtim të hedhjes në sistem të planifikimeve të seancave gjyqësore, për t'u shmangur planifikimet më shumë se një herë brenda një dite të një çështje gjyqësore.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër).*

## ✚ Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

### 1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

#### 1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

Në kuadër të inspektimit tematik me objekt “Mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Seancave në disa Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm” për të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka nxjerrë vendimin nr. 57, datë 20.10.2025, i ndryshuar<sup>[43]</sup> në përgjigje të kërkesës për të dhëna<sup>[44]</sup>, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës<sup>[45]</sup>, ka përcjellë informacion dhe kopje të dokumentacionit për sa më poshtë:

- Lidhur me pikën (a): Nga gjykata është përcjellë informacion statistikor, në formë tabelore për secilin gjyqtar lidhur me, numrin e çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024; numrin e çështjeve të reja të regjistruara për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025; numrin e vendimeve të shpallura gjatë kësaj periudhe, shoqëruar me numrin e seancave të zhvilluara përkatëse.
- Lidhur me pikën (b): Në lidhje me kalendarët e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025, për secilin gjyqtar janë paraqitur kalendarët përkatës të seancave, dokumentacion i cili është paraqitur dhe në CD, në kopje elektronike në format PDF.
- Lidhur me pikën (c): Sa i përket organikës së miratuar dhe asaj faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve në detyrë, është paraqitur dokumentacioni përkatës, duke përfshirë: (i) Vendimi nr. 4, datë 31.03.2023 “Për miratimin e organigramës dhe strukturës organizative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; (ii) Shkresë për shtesat në organike nr. 208/17, datë 23.01.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; (iii) Shkresë për shtesat në organike nr. 208/22 datë 23.01.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Lidhur me pikën (d): Në lidhje me kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025, gjykata ka përcjellë urdhrat përkatës të zëvendëskryetarit për miratimin e lejeve të gjyqtarëve.
- Lidhur me pikën (e): Sa i përket numrit të sallave të gjykimit në dispozicion për zhvillimin e seancave, gjykata ka informuar se në Gjykatën e Shkallës së Parë të

<sup>43</sup> Me vendimin nr. 87, datë 30.12.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

<sup>44</sup> Kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 2930 prot., datë 20.10.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

<sup>45</sup> Me shkresën nr. 1564/1 prot., datë 27.10.2025, protokolluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/1 prot., datë 27.10.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”.

Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë në dispozicion katër salla gjykimi, nga të cilat, një sallë përdoret për çështje penale dhe ndodhet në katin e dytë dhe tre salla të tjera janë të përmasave më të vogla nga madhësia.

Në vijim, për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 2930 prot., datë 20.10.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës<sup>[46]</sup>, ka përcjellë gjithashtu, kopje të urdhrat për caktimin e grafikut të përdorimit të sallave të gjykimit dhe Rregulloren e Brendshme të gjykatës. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sipërcituar, janë konstatuar mospërputhje në të dhënat e pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara. Për këtë arsye, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, iu drejtua gjykatës duke kërkuar<sup>[47]</sup> informacion dhe dokumentacion në lidhje me, arsyet e mospërputhjeve, saktësimin e tyre dhe ridërgimin e të dhënave në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, kryetarit, anëtarit) si dhe të seancave të zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, si dhe dërgimin në formë elektronike dhe me postë të dokumentacionit shtesë, përfshirë: (i) Analiza Vjetore për vitin 2024; (ii) Raportet tremujore drejtuar KLGJ-së për vitin 2025; (iii) RDA (raportet për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio) për çdo muaj për secilin gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025; (iv) Organikën mujore në lidhje me numrin e gjyqtarëve në detyrë për muajt Janar-Shtator; (v) Lista e çështjeve të rishortuara për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025; (vi) Urdhrat për gatishmërinë e gjyqtarëve për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës<sup>[48]</sup>, është administruar në formë shkresore, informacion dhe kopje e dokumentacionit shtesë, përfshirë: (i) Analizën Vjetore për vitin 2024; (ii) raportet tremujore drejtuar KLGJ-së për vitin 2025; (iii) raportet mbi përdorimin e sistemit të regjistrimit audio (RDA) për çdo muaj për secilin gjyqtar për periudhën objekt inspektimi; (iv) organikën mujore të gjyqtarëve në detyrë për muajt Janar-Shtator; (v) listën e çështjeve të rishortuara; (vi) urdhrat për gatishmërinë e gjyqtarëve për periudhën nga data 01 Janar-31 Gusht; (vii) kalendarët e seancave të planifikuara dhe të zhvilluara për secilin gjyqtar. Së bashku me dokumentacionin e sipërcituar, nga gjykata është përcjellë dhe informacioni në të cilin, kjo e fundit ka sqaruar si vijon: "...[...]. Lidhur me sa referoni se në informacionin e dërguar "Lista e seancave të planifikuara për gjykim" rezulton se për çështjen me nr. 21300-00045-55-2025 seanca e datës 11.03.2025, është planifikuar nga gjyqtarja S. K., ndërkohë që, referuar RIV-it të çështjes nr. 21300-00045-55-2025 dhe procesverbalit të seancës së datës 11.03.2025 të kësaj çështjeje, rezulton se kjo seancë është planifikuar dhe është zhvilluar nga gjyqtari A. P., përse më lart ju informojmë se çështja fillestare është shortuar dhe kaluar me short gjyqtarit z. A.P. Në zbatim të urdhrat

<sup>46</sup> Me shkresën nr. 1564/2 prot., datë 10.11.2025, protokolluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/2 prot., datë 12.11.2025 me lëndë "Dërgim dokumentacioni".

<sup>47</sup> Me shkresën nr. 2938/3 prot., datë 20.11.2025.

<sup>48</sup> Informacion i përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 1764 prot., datë 27.11.2025, protokolluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/4 prot., datë 02.12.2025 me lëndë "Dërgim dokumentacioni".

nr. 113, datë 14.04.2025, çështjet në ngarkim të gjyqtarit A. P., janë rishortuar, pasi gjyqtari A. P., me vendimin nr. 186, datë 26.03.2025 të KLGJ-së është transferuar në gjykatë tjetër. Ndërsa lidhur me seancat të planifikuara për datën 13.01.2025, pasqyrohet e dhëna se në të njëjtën sallë, në sallën 1 në të njëjtën orë, në orën 14:30, nga gjyqtari F. D., është planifikuar gjykimi i 2 (dy) çështjeve të ndryshme konkretisht çështja nr. 21246-00302-55-2024 dhe çështja nr. 82400-00543-55-2024, **përsa më lart sqarojmë se është një lapsus nga ana e sekretarisë gjyqësore** pasi çështja me nr. 21246-00302-55-2024 është zhvilluar në orën 15:15 e ka përfunduar në orën 15:20 minuta dhe çështja nr. 82400-00543-55-2024 në orën 15:30 dhe ka mbarua në orën 15:37”.

Në vijim, gjykata nëpërmjet shkresës nr. 2830/3 prot., datë 20.11.2023, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, konkretisht listën e seancave të zhvilluara nga gjyqtare M. Ç.<sup>[49]</sup> Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të sipërcituar, konkretisht raportimet mbi seancat e zhvilluara nga secili gjyqtar, rezulton se formati i raportimit përmban të dhëna të detajuara mbi numrat identifikues të çështjeve sipas sistemit ICMIS, si dhe të dhëna mbi procesverbalet administrative të mbajtura nga sekretarët gjyqësor përkatës. Ndërkohë, informacioni i pasqyruar në dokumentacionin e përcjellë nga magjistrate A. XH.<sup>[50]</sup>, nuk përmbante të dhëna të individualizuara për çdo çështje sipas sistemit ICMIS, por vetëm të dhëna përmbledhëse, i paraqitur mbi numrin total të seancave të zhvilluara në nivel mujor dhe ditor ku në disa raste është pasqyruar vetëm emri i palëve.

Nisur nga nevoja e ngutshme e përpunimit të materialit, gjykatës iu kërkuar<sup>[51]</sup>, dërgimi i informacionit të saktësuar në formatin tabelor Excel, në adresën elektronike dhe shkresor brenda një kohe sa më të shkurtër, por jo më vonë se data 17.12.2025. Në vijim gjykata, ka përcjellë dokumentacionin plotësues në adresën elektronike me formatin Excel<sup>[52]</sup> njëkohësisht dhe shkresor, përmes shkresave me nr. 1764/1 prot., datë 16.12.2025<sup>[53]</sup>, si dhe shkresës me nr. 1764/2 prot., datë 19.12.2025<sup>[54]</sup> kjo e fundit e shoqëruar me CD.

<sup>49</sup> Me shkresën nr. 1564/1 prot., datë 02.12.2025, protokolluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/5 prot., datë 05.12.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”. Konstatohet se kjo shkresë është e regjistruar nga Gjykata me të njëjtin numër protokollit me shkresën e ardhur nga gjykata më datë 27.10.2025 dhe e regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/1 prot., datë 27.10.2025.

<sup>50</sup> Shih shkresën nr. 1761 prot., datë 27.11.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

<sup>51</sup> Informacioni i kërkuar nga adresa elektronike [info@ild.al](mailto:info@ild.al) më datë 15.12.2025.

<sup>52</sup> Në adresën elektronike [info@ild.al](mailto:info@ild.al) më datë 16.12.2025 nga adresa elektronike e kancelarit të gjykatës [shkelzen.mulosmani@gjykata.gov.al](mailto:shkelzen.mulosmani@gjykata.gov.al) është bashkëlidhur: *Seanca 2025 A. P., e sakte.xlsx; seanca E. F., 2025 e sakte.xlsx; seanca 2025 F. D., e saktë.xlsx, Përmbledhëse seancave Janar-Tetor gjyqtare M. Ç..xlsx, Tabela përmbledhëse seancat Janar Tetor 2025 gjyqtare S. K., .xlsx, Përmbledhëse seancat Janar-Tetor gjyqtare B. A., .xlsx, struktura 2025 Gjykata Kukës Prill.xlsx; Tabela përmbledhëse seancat Janar-Tetor 2025 gjyqtare A. Xh., e ripunuar datë 17.12.2025.xlsx, struktura 2025 Gjykata Kukës prill.xlsx;*

<sup>53</sup> Regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.2930/6 prot., datë 16.12.2025.

<sup>54</sup> Regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.2930/7 prot., datë 22.12.2025.

## 2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

### 2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi

#### ➤ Rregullorja e Brendshme

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka vendosur në dispozicion Rregulloren e Brendshme në fuqi, miratuar me vendimin nr. 29, datë 12.03.2025 të Këshillit të Gjykatës. Në nenin 1 të rregullores është përcaktuar qëllimi i saj, i cili lidhet me vendosjen e rregullave themelore për organizimin dhe funksionimin e institucionit nëpërmjet strukturave administrative dhe nëpunësve/punonjësve që ushtrojnë detyrat përkatëse funksionale. Rregullorja synon gjithashtu të saktësojë dhe të harmonizojë përgjegjësitë e çdo strukture të administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, duke garantuar një funksionim të rregullt dhe efikas të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative.

Në nenin 9, të Rregullores janë përcaktuar organet vendimmarrëse të gjykatës i cili është i përbërë nga, Kryetari, Këshilli i Gjykatës, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve dhe Kancelari.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij neni parashikohet se Kryetari është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përgjithshëm gjyqësor të gjykatës, sipas ligjit<sup>[55]</sup> dhe kësaj rregulloreje.

Ndërsa në nenin 38 të Rregullores janë përcaktuar detyrimet e gjyqtarëve lidhur me respektimin e afateve të arsyeshme të gjykimit, të cilët duhet të marrin të gjitha masat dhe të planifikojnë në mënyrë efikase të gjitha veprimet procedurale, me qëllim që të mos shkaktojnë zvarritje të padobishme të gjykimeve, duke i përfunduar brenda standardeve të një gjykimi, në një afat të arsyeshëm. Pas përfundimit të gjykimeve gjyqtarët kanë detyrimin që të arsyetojnë vendimet dhe t'i depozitojnë në sekretari, duke respektuar afatin ligjor nga shpallja si për gjykimet penale dhe për gjykimet civile. Përmushja e

<sup>55</sup> Neni 37 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra: "[...] **b**) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; [...] **ç**) mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve; **d**) mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre; [...] **h**) garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë[...]"

këtij detyrimi i krijon mundësinë palëve për të bërë ankimin brenda afateve ligjore. Ndërkohë që në nenin 39 rregullohet mënyra e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, sipas së cilit, çështjet e depozituara për gjykim shpërndahen ndërmjet gjyqtarëve nëpërmjet shortit elektronik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sistemi elektronik i instaluar në këtë gjykatë është CCMIS dhe ICMIS.

Pjesë e Rregullores së brendshme vlen të përmendet dhe pozicioni i Sekretari Gjyqësor, i cili kryen detyra të aspektit procedural gjyqësor, sipas ligjit dhe përshkrimit të punës, si dhe mbikëqyret nga Kryesekretari dhe Kancelari<sup>56</sup>. Sekretarit gjyqësor<sup>57</sup> ka detyrimin të asistojë gjyqtarin, ose trupën gjyqësore gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore dhe deri në përfundimin e çështjes, të kryejë, sipas rastit, zbardhjen e vendimit, të përgatisë njoftimet për palët dhe të pasqyrojë të dhënat në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të gjykatës, disponimin e listave të gjykimeve për javën pasardhëse të cilat depozitohen tek kancelari çdo ditë të enjte, depozitim të cilat kancelari në fund të çdo dite, përmbledhje të gjykimeve të zhvilluara nga gjyqtari për atë ditë, duke përcaktuar dhe shkakun e shtyrjeve për çështjet që janë shtyrë, me qëllim pasjen e informacionit lidhur me ecurinë e gjykimeve dhe statusin e çështjeve, si dhe evitimin e zvarritjeve<sup>58</sup>.

- Në lidhje me organikën e miratuar dhe efektive të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, referuar informacionit të përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>59</sup>, struktura organizative e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, figuron e përbërë prej 7 gjyqtarësh ndërsa organika në fakt prej 8 gjyqtarësh, ku efektivisht në detyrë janë 7 gjyqtarësh.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga gjykata në kuadër të inspektimit, konkretisht pasqyra e numrit të punonjësve, sipas strukturës organizative dhe organikës në fakt gjendet i pasqyruar informacioni se, numri i magjistratëve që kanë ushtruar funksionin: (i) në muajt Janar<sup>60</sup>, Shkurt, Mars dhe Prill është 7 (shtatë) magjistratë, ndërsa për numrin e vakancave informacioni i pasqyruar është 0 (zero) vakancë; (ii) në muajin maj është 7 (shtatë) magjistratë, ndërkohë që sipas informacionit të përcjellë nga gjykata rezulton se, çështjet në ngarkim të gjyqtarit A. P., janë rishortuar në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 14.04.2025,

<sup>56</sup> Rregullorja e brendshme në nenin 18, të saj përcakton në mënyrë të detajuar detyrimet funksionale të Kancelarit i cili ndër të tjera ka kompetencën dhe përgjegjësinë për përgatitjen e të dhënave statistikore për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Ministrinë e Drejtësisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe çdo institucion tjetër për t'u mundësuar atyre përmbushjen e përgjegjësisë të tyre ligjore.

<sup>57</sup> Neni 20, pika 3, germa "c" e Rregullores së Brendshme, parashikon se, puna e Sekretarit Gjyqësor ndikon në procesin e punës së gjykatës, duke filluar nga të drejtat procedurale të palëve; në punën e gjyqtarit; zyrën e regjistratit; punën e punonjësve të gjykatës të caktuar për realizimin e njoftimeve; si dhe punën e kryesekretarit dhe kancelarit, të cilët janë mbikëqyrës të punës së tij.

<sup>58</sup> Neni 42 pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Brendshme.

<sup>59</sup> Njëpërmjet shkresës nr. 1240/1 prot., datë 06.03.2025 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 484/3 prot., datë 10.03.2025.

<sup>60</sup> Në muajin Janar është pasqyruar informacioni se, gjyqtare Merita Karaj, është komanduar në KLGJ, marrëdhëniet e punës kanë filluar efekte në datë 03.04.2024.

pasi me vendimin nr. 186, datë 26.03.2025 të KLGJ-së është transferuar në gjykatë tjetër. Në referimi të këtij informacioni, figuron se *organika në fakt* e numrit të magjistratëve në muajin Maj është 6 (gjashtë) ndërsa për numrin e vakancave informacioni i pasqyruar është sërish 0 (zero) vakancë; (iii) në muajt qershor<sup>[61]</sup>, korrik dhe gusht figuron 6 (gjashtë) magjistratë, për numrin e vakancave, informacioni i pasqyruar është 1 (një) vakancë; (iv) në muajin shtator dhe tetor është 7 (shtatë) magjistratë ku identifikohet plotësimi i gjykatës, nga dy magjistratë përkatësisht nga gjyqtarë S. C., dhe gjyqtar F. G., ndërsa për numrin e vakancave, informacioni i pasqyruar është 0 (zero) vakancë.

- Në lidhje me periudhën e gatishmërisë me të cilën ka funksionuar kjo gjykatë, referuar dokumentacionit të administruar nga gjykata, rezulton se nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë nxjerrë urdhrat për miratimin e listës së gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente/grafikut të gatishmërisë, për periudhën Janar - Gusht 2025, nga të cilat ka rezultuar i pa përcjellë, dokumentacioni që pasqyron informacionin lidhur me listën e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente /grafikut të gatishmërisë për periudhën Shtator - Tetor 2025.

#### ***Aneks nr. 2 Urdhrat e Gatishmërisë***

Nr.	Gjyqtari	Urdhër nr. 286 datë 26.12.2024	Urdhër nr. 10/1 datë 31.01.2025	Urdhër nr. 53 datë 28.02.2025	Urdhër nr. 98 datë 01.04.2025	Urdhër nr. 131 datë 29.04.2025	Urdhër nr. 180 datë 30.05.2025	Urdhër nr. 206 datë 30.06.2025
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
1	B. A	1-4	1-4	1-4	1-5	1-5	1-6	1-6
2	M. Ç	5-9	5-8	5-9	6-10	6-9	7-8	-
3	F. D	10-13	9-12	10-14	11-15	10-14	9-14	7-12
4	E. F	14-17	13-16	15-19	16-20	15-20	15-20	13-18
5	S. K	18-21	17-20	20-23	21-25	21-26	21-25	19-25
6	A. P	22-26	21-24	24-27	-	-	-	-
7	A. XH	27-31	25-28	28-31	26-30	27-31	26-30	26-31

Nga të dhënat të pasqyruara sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës kohore nga muaji Janar deri në muajin gusht 2025, çdo periudhë gatishmërie është caktuar nëpërmjet urdhrit përkatës, i identifikuar përmes numrit dhe datës, caktime të cilat, rezultojnë të kryera në mënyrë kronologjike dhe të vazhdueshme, duke mos evidentuar mbivendosje të periudhave të gatishmërisë ndërmjet gjyqtarëve.

#### **➤ Lejet vjetore të gjyqtarëve**

Sa i përket urdhrave për dhënien leje nga pushimet vjetore, nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ rezulton se dhënia e lejeve vjetore për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është realizuar nëpërmjet urdhrave individuale të Zëvendëskryetarit të Gjykatës, me objekt "Dhënie leje nga

<sup>61</sup> Nga muaji qershor dhe në vijim për gjyqtare M. Ç., është shënuar informacioni raport barrë lindje.

*pushimet vjetore të paguëshme*”, shoqëruar me kërkesën përkatëse të magjistratit siç pasqyrohet në tabelën si vijon:

Nr.	Nr. dhe data e urdhrit	Gjyqtari	Periudha e lejes nga pushimet vjetore	Nr. ditëve
1	Urdhri nr. 10, datë 29.01.2025	A. P	17.03.2025 - 20.03.2025	4 ditë
2	Urdhri nr. 19 datë 03.02.2025	E. F	04.02.2025 - 06.02.2025	3 ditë
3	Urdhri nr. 20, datë 03.02.2025	S. K	03.03.2025 - 12.03.2025	10 ditë
4	Urdhri nr. 46, datë 27.02.2025	A. XH	03.03.2025 - 07.03.2025	5 ditë
5	Urdhri nr. 72, datë 10.03.2025	M. Ç	18.03.2025 - 26.03.2025	6 ditë
6	Urdhri nr. 73, datë 10.03.2025	B. A	18.03.2025 - 26.03.2025	6 ditë
7	Urdhri nr. 167, datë 23.05.2025	A. XH	09.06.2025 - 12.06.2025	5 ditë pune
8	Urdhri nr. 253, datë 29.07.2025	F. D	01.08.2025 - 06.08.2025	17 ditë pune
		B. A	13.08.2025 - 31.08.2025	17 ditë pune
		E. F	07.08.2025 - 31.08.2025	17 ditë pune
		S. K	01.08.2025 - 12.08.2025	17 ditë pune
		A. XH	19.08.2025 - 31.08.2025	17 ditë pune
9	Urdhri nr. 279, datë 08.09.2025	B. A	01.08.2025 - 18.08.2025	17 ditë pune
		B. A	25.08.2025 - 31.08.2025	17 ditë pune
10	Urdhri nr. 307, datë 01.10.2025 <sup>[62]</sup>	B. A	01.08.2025 - 24.08.2025	17 ditë pune
		E. F	29.09.2025 - 30.09.2025	2 ditë pune
			29.09.2025 - 05.10.2025	3 ditë pune

- Lidhur me planifikimin e sallave në dokumentacionin e administruar figuron se, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkak të volumit të çështjeve dhe organikës së kësaj gjykate, çështjet gjyqësore civile, penale, me të mitur, tregtare dhe familjare shqyrtohen në një dhomë të pandarë në seksione<sup>[63]</sup>.

Në Analizën Vjetore të vitit 2024 gjendet i pasqyruar informacioni se, nga gjykata, ndarja e sallave në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, *është bërë me marrëveshje*, për shkak të organikës së trupës gjyqësore e përbërë nga 7 (shtatë) gjyqtar dhe numrit të lartë të çështjeve, si dhe duke mbajtur në vëmendje se, në sallën nr. 1, gjykohen çështjet penale me të arrestuar/ndaluar apo të dënuar. Me përjashtim të kërkesave penale të tilla si lejim përgjimi, kontroll banese, caktim masë sigurimi në mungese, të gjitha çështjet e tjera, qoftë dhe ato në dhomë këshillimi shqyrtohen në sallë gjykimi me audio nga ana e gjyqtarëve.<sup>[64]</sup>

<sup>62</sup> Në pjesën urdhëruese (dispozitivin) e urdhrit figuron se periudha e lejes se miratuar nga Zv/Kryetari është nga data 01.10.2025-03.10.2025, ndryshe nga periudha e kërkuar nga magjistrati data 29.09.2025-05.10.2025.

<sup>63</sup> Informacion i pasqyruar në Analizën Vjetore të vitit 2024, fq. 4.

<sup>64</sup> Informacion i pasqyruar në Analizën Vjetore të vitit 2024, fq. 8.

Në vijim, magjistrati z. F. D. me detyrë zëvendëskryetar i gjykatës, i cili në mungesë të kryetarit ushtron kompetencat e tij<sup>65</sup>, me Urdhrin nr. 281, datë 10.09.2025, "Për caktimin e grafikut të përdorimit të sallave të gjykimit", ka urdhëruar caktimin e grafikut të përdorimit të sallave të gjykimit me efekt nga data 10.09.2025, duke përcaktuar shpërndarjen e katër sallave të gjykimit ndërmjet gjyqtarëve, përkatësisht:

- Gjyqtarja B. A., do të gjykojë çdo ditë të hënë në sallën nr. 1 nga ora 08.00-16.00 dhe çdo ditë të enjte në sallën nr. 3 nga ora 08.00-16.00.
- Gjyqtari F. D., do të gjykojë çdo ditë të mërkurë dhe çdo ditë të enjte në sallën nr. 1 nga ora 08.00-16.00.
- Gjyqtarja E. F., do të gjykojë çdo ditë të hënë në sallën nr. 4 nga ora 08.00-16.00 dhe çdo ditë të enjte në sallën nr. 2 nga ora 08.00-16.00.
- Gjyqtarja S. K., do të gjykojë çdo ditë të hënë dhe çdo ditë të mërkurë në sallën nr. 3 nga ora 08.00-16.00.
- Gjyqtarja A. XH., do të gjykojë çdo ditë të hënë, të mërkurë dhe të premte në sallën nr. 2 nga ora 08.00-16.00.

## **2.2. Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë**

Në formatin e raportimeve 3-mujore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, gjendet i pasqyruar informacioni se, ky format është i bazuar në vendimin e KLGJ-së nr. 25, datë 07.02.2019, ku lidhur me etikën dhe solemnitetin nga ana e trupës gjyqësore, gjykata raporton se nuk është konstatuar asnjë problem në lidhje me disiplinën në punë, respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse, me kolegët dhe titullarin e gjykatës.

Sipas raportimeve 3-mujore, lidhur me nivelin e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi, nga sekretarët janë të ngarkuara procesverbalet administrative, në rastet kur gjyqtari nuk ka qenë prezent. Gjithashtu rezulton se, seancat gjyqësore janë të regjistruar në sistemin audio, përveç rasteve kur parashikohet nga ligji mosregjistrimi i seancës për efekt të ruajtjes së sekretit hetimor. Në raportimet 3-mujore gjendet i pasqyruar informacioni se: "Të dhënat janë gjeneruar nga sistemi PAKS në mënyrë të automatizuar, e bashkëlidhur raportit".

Lidhur me arsyet e seancave të filluara me vonesë, sipas të dhënave të raportimeve 3 mujore konstatohet gjithashtu se, arsyet e çeljes me vonesë të seancave gjyqësore për gjyqtarët janë zgjatja e seancave të mëparshme dhe numrit të vogël të sallave të gjykimit. Ndërsa nuk është konstatuar asnjë rast nga gjykata që, vonesat të jenë shkaktuar nga pakujdesia e gjyqtarëve. Referuar informacionit të pasqyruar në raportimet 3 mujore të

<sup>65</sup> Neni 9, pika 4, e Rregullores së Brendshme.

gjykatës lidhur me përdorimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve nga gjykata është raportuar se: “Sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS është në funksion të plotë, në të cilin regjistrohen dhe përpunohen të gjitha çështjet gjyqësore”.

### **2.3. Fakte të konstatuara në lidhje me përputhjen e të dhënave të vëna në dispozicion nga gjykata si dhe në sistemin elektronik (procesverbalet e seancave) përsa i përket numrit të seancave.**

Dokumentacioni i administruar nga gjykata lidhur me planifikimin e seancave, konkretisht lista e çështjeve për gjykim, pasqyrohen të dhënat :

Nr. Ora Salla Nr. i Çështjes Palët Gjyqtar/ë

Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara, në listën e çështjeve për gjykim, u konstatuan raste të:

- Mospërputhjeve të të dhënave lidhur me emrin e gjyqtarit të pasqyruar në listën e çështjeve për gjykim në raport me të dhënat e pasqyruara në RIV-in dhe procesverbalin e seancës së çështjes përkatëse. Konkretisht për çështjen me nr. 21300-00045-55-2025 seanca e datës 11.03.2025, është planifikuar nga gjyqtarja Suada Kurti, ndërkohë që, referuar RIV-it të çështjes nr. 21300-00045-55-2025 dhe procesverbalit të seancës së datës 11.03.2025 të kësaj çështjeje, rezulton se kjo seancë është planifikuar dhe është zhvilluar nga gjyqtari Aulon Pashaj.
- Planifikimit të dy çështjeve të ndryshme (82400-00543-55-2024, 21246-00302-55-2024) nga i njëjti gjyqtar (F. D.) në të njëjtën datë, orë dhe sallë (datë 13.01.2025, ora 14:30, salla 1).

Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, konkretisht RIV-it të çështjeve përkatëse rezulton se për çështjen nr. 82400-00543-55-2024, seanca është planifikuar më datë 20.12.2024 ora 11:15:56, ndërsa për çështjen nr. 21246-00302-55-2024 në RIV-in përkatës nuk figuron asnjë e dhënë lidhur me planifikimin e seancës së datës 13.01.2025. Ndërsa sipas procesverbaleve të seancave përkatëse rezultoi se ora faktike e fillimit të seancës është më e vonshme se ora e shënuar në tabelën e sistemit për numrin e gjykimeve të asaj çështjeje. Pasi referuar procesverbaleve të seancave të zhvilluara ka rezultuar se seanca për gjykimin e çështjes numër 21246-00302-55-2024 ka filluar në orën 15.14 dhe ka përfunduar në orën 15:20, ndërsa seanca për gjykimin e çështjes numër 82400-00543-55-2024 ka filluar në orën 15:20 dhe ka përfunduar në orën 15:37.

Planifikimit në të njëjtën datë, orë dhe sallë, (datë 15.01.2025, ora 11.00, salla 2) të tre çështjeve të ndryshme (çështje nr. 80101-01171-55-2024, nr. 230004-00470-55-2024 dhe nr. 23605-00494-55-2024) nga gjyqtar të ndryshëm (S. K., B. A., dhe A. XH.).

Në kuadër të verifikimit të saktësimit të të dhënave të hedhura në sistemin elektronik janë përzgjedhur nga dy çështje për secilin gjyqtar. Përzgjedhja e çështjeve është kryer mbi bazën e krahasimit të të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 1 (kalendari i seancave të planifikuara dhe të zhvilluara) e plotësuar nga dokumentacioni i dërguar nga gjykata, konkretisht kalendarët e seancave të planifikuara dhe të zhvilluara për secilin gjyqtar.

*Për gjyqtaren B. A., çështja e regjistruar me nr. 13000-00386-55-2024, referuar kalendarit të planifikimeve, dhe informacionit për zhvillimin e seancave, figuron se seanca e datës 04.02.2025, të jetë planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtari fillestar A. P.*

Ndërsa për çështjen e regjistruar me nr. 23605-00297-55-2025, figuron se seanca gjyqësore e datës 18.08.2025 është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtarja B. A., në një periudhë gjatë së cilës, sipas Urdhrit nr. 253, datë 29.07.2025, gjyqtarja B. A., nga data 07.08.2025 - 31.08.2025, figuron me lejen nga pushimet vjetore të miratuar.

*Për gjyqtarin F. D., çështja e regjistruar me nr. 61000-00013-55-2025, figuron që seanca e planifikuar më datë 13.01.2025, (në javën e gatishmërisë nga data 10-13 janar 2025) zhvillimi i të cilës nuk është raportuar nga gjykata, ndërkohë që sipas procesverbalit përkatës, është zhvilluar sipas datës së planifikimit.*

Ndërsa për çështjen e regjistruar me nr. 60605-00804-55-2025, seanca e datës 01.08.2025 është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtari F. D., në një periudhë gjatë së cilës, sipas Urdhrit nr. 253, datë 29.07.2025, gjyqtari F. D., nga data 01.08.2025 - 06.08.2025 figuron me lejen nga pushimet vjetore të miratuar.

*Për gjyqtaren S. K., çështja e regjistruar me nr. 88000-01107-55-2024, figuron se seanca e datës 05.03.2025, planifikimi i së cilës është vendosur në seancën e mbajtur më datë 22.01.2025, është shtyrë nga sekretarja gjyqësore M. T., me procesverbal administrativ për arsye se *trupi gjykues është me leje vjetore.**

Ndërsa, për çështjen e regjistruar me nr. 61000-00816-55-2025 seanca e datës 25.08.2025, janë planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtarja S. K., në një periudhë gjatë së cilës, nga data 25.08.2025 deri më datë 31.08.2025 figuron me lejen nga pushimet vjetore të miratuar sipas Urdhrit nr. 253, datë 29.07.2025, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës i urdhrave për dhënien leje nga pushimet vjetore.

*Për gjyqtaren E. F., çështja e regjistruar me nr. 11003-00187-55-2022, figuron që seanca e planifikuar më datë 15.01.2025, (në javën e gatishmërisë nga data 14.01.2025 - 17.01.2025) zhvillimi i të cilës nuk është raportuar nga gjykata, ndërkohë që sipas procesverbalit përkatës, është zhvilluar sipas datës së planifikimit.*

Ndërsa çështja e regjistruar me nr. 21013-00138-55-2024, referuar kalendarit të planifikimeve, dhe informacionit për zhvillimin e seancave, figuron se seanca e datës 15.01.2025, të jetë planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtari fillestar A. P.

Për gjyqtaren M. Ç., çështja e regjistruar me nr. 23605-00001-55-2025, figuron që seanca e planifikuar më datë 08.01.2025, (në javën e gatishtëmërisë nga data 05-09 janar 2025) zhvillimi i të cilës nuk është raportuar nga gjykata, ku sipas procesverbalit përkatës, është zhvilluar sipas datës së planifikimit përkatës.

Po kështu, në pasqyrat mbi numrin e punonjësve sipas strukturës organizative dhe organikës faktike, të administruara nga gjykata, figuron se, në muajin shtator gjykata është paraqitur si e plotësuar me dy magjistratë, përkatësisht nga gjyqtare S. C., dhe gjyqtar F. G. Për këta dy magjistratë nuk rezultojnë të dhëna të raportuara nga gjykata lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjatë periudhës objekt inspektimi. Nga ana tjetër, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka rezultuar se me vendimin nr. 761, datë 22.10.2025, "Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar znj. S. C." dhe me vendimin nr. 760, datë 22.10.2025, "Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. F. G.", plotësimi i gjykatës me këta magjistratë ka ndodhur më datë 22 tetor 2025.

### 3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

#### 3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nga të dhënat e paraqitura nga gjykata rezulton se nga viti 2024 janë mbartur gjithsej 562 çështje dhe janë regjistruar 1,336 çështje të reja, duke përbërë një ngarkesë totale të gjykatës prej 1898 çështje.

Nr.	Gjyqtari	Çështje të mbartura (31.12.2024)	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025
1	B. A	34	259	293
2	F. D	51	171	222
3	M. Ç	23	95	118
4	A. P	42	32	74
5	S. K	106	271	377
6	A.XH	184	250	434
7	E. F	122	258	380
	<b>Total</b>	<b>562</b>	<b>1336</b>	<b>1898</b>

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Lidhur me të dhënat e pasqyruara në informacionin e dërguar nga gjykata për numrin e çështjeve të gjykuara për periudhën 01.01.2025-20.10.2025<sup>[66]</sup>, në raport me dokumentacionin e dërguar nga gjykata, konkretisht dokumentacioni i emërtuar, “Të dhëna mbi numrin e seancave për çështjet e gjykuara gjatë vitit 2025...” për gjyqtarët B. A., F. D., M. Ç., A. P., S. K., A. XH., dhe E. F., figurojnë mospërputhje midis tyre, përsa i përket numrit total të çështjeve të gjykuara, të përfunduara me vendim nga gjykata si dhe numrit të vendimeve për secilin gjyqtar, përkatësisht për gjyqtarët B. A., M. Ç., S. K., dhe E. F., siç pasqyrohet në tabelën si vijon:

Nr.	Gjyqtari	Vendime të shpallura 01.01.2025-20.10.2025 (sipas informacionit të dërguar nga gjykata)	Nr. Vendimeve për çështjet e gjykuara gjatë vitit 2025 (sipas dokumentacionit të dërguar nga gjykata)
1	B. A	223	224
2	F. D	215	215
3	M. Ç	118	117
4	A. P	74	74
5	S. K	270	280
6	A. XH	221	221
7	E. F	270	276
	<b>Total</b>	<b>1391</b>	<b>1407</b>

### 3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar

Nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, rezulton se gjatë periudhës objekt inspektimi, numri i seancave të planifikuara nga gjykata figuron të jetë 5,662 seanca. Ndërsa lidhur me seancat e referuara në akte të zhvilluara, figurojnë të jenë 4,975 seanca, duke përbërë një diferencë prej 687 seanca në nivel gjykate, të paraqitura në mënyrë të detajuar përkatësisht në tabelën nr. 4 dhe tabelën nr. 4.1.

**Tabela nr. 4 Kalendar lidhur me seancat e planifikuara për secilin gjyqtar pas verifikimit të tabelave të ridërguara**

Gjyqtari Muaji	Gjyqtari							Totali i seancave për periudhën e inspektimit
	B. A	F. D	M. Ç	A. P	S. K	A. XH	E. F	
<b>Janar</b>	53	94	39	54	71	116	67	<b>494</b>
<b>Shkurt</b>	75	140	67	47	139	133	158	<b>759</b>
<b>Mars</b>	65	123	39	24	130	129	118	<b>628</b>

<sup>66</sup> Me shkresën nr. 1564/1 prot., datë 27.10.2025, protokolluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/1 prot., datë 27.10.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”.

Prill	70	135	48	4	186	207	151	801
Maj	70	91	45	0	122	166	144	638
Qershor	72	76	0	0	124	186	140	598
Korrik	99	47	0	0	133	230	157	666
Gusht	6	6	0	0	6	3	2	23
Shtator	88	23	0	0	99	134	111	455
Tetor	125	12	0	0	169	138	156	600
Nr. i seancave të planifikuara për periudhën e inspektimit	723	747	238	129	1179	1442	1204	5662

**Tabela nr. 4.1. Kalendar lidhur me seanca te zhvilluara sipas raportimit të gjykatës<sup>[67]</sup>**

Gjyqtari Muaji	B. A.	F. D.	M. Ç.	A. P.	S. K.	A.XH.	E. F.	Totali seancave realisht te zhvilluara për periudhën e inspektimit
Janar	53	59	37	51	58	112	53	423
Shkurt	62	116	67	40	118	127	100	630
Mars	50	117	39	24	47	123	89	489
Prill	56	101	48	4	162	207	125	703
Maj	67	82	45	0	112	178	122	606
Qershor	67	82	0	0	83	188	130	550
Korrik	93	84	0	0	129	231	137	674
Gusht	6	0	0	0	6	3	0	15
Shtator	81	19	0	0	64	135	62	361
Tetor	120	0	0	0	146	138	120	524
Nr. i seancave të zhvilluara për periudhën e inspektimit	655	660	236	119	925	1442	938	4975

### 3.3.1. Analiza e planifikimit të seancave brenda një dite

Nga analizimi i të dhënave të administruara evidentohet se, në disa raste, seancat planifikohen në intervale shumë të shkurtra kohore (5-15 minuta nga njëra-tjetra), situatë e cila paraqet mungesë të vëmendjes së duhur për një planifikim më të balancuar. Për rrjedhojë, duhet të sigurohet një kohë e mjaftueshme ndërmjet seancave, në funksion të një trajtimi më cilësor të çështjeve dhe zhvillimit të seancës nga gjyqtari, në përputhje me datën dhe orën e planifikuar.

<sup>67</sup> Sipas raportimit të pasqyruar në dokumentacionin e dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës nëpërmjet shkresës nr. 1764 prot., datë 27.11.2025, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/4 prot., datë 02.12.2025.

Lidhur me të dhënat që i përkasin emrit të gjyqtarit, i pasqyruar në listën e dokumentacionit të identifikuar nga gjykata “*lista e çështjeve për gjykim*”, figurojnë raste të mospërputhjeve të të dhënave në raport me të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore. Kjo mund të shihet në të dhënat për seancën e datës 11.03.2025 të çështjes me nr. 21300-00045-55-2025, e cila figuron e planifikuar nga gjyqtarja S. K., ndërkohë që, referuar RIV-it të çështjes dhe procesverbalit të seancës përkatëse, kjo seancë është planifikuar dhe është zhvilluar nga gjyqtari A. P. Nga gjykata jemi bërë me dije se çështja me nr. 21300-00045-55-2025 referuar RIV-it dhe procesverbalit të seancës së datës 11.03.2025 të kësaj çështjeje, rezulton se kjo seancë është planifikuar dhe është zhvilluar nga gjyqtari A. P., dhe se çështja fillestare është shortuar dhe kaluar me short gjyqtarit z. A. P., në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 14.04.2025, çështjet ne ngarkim të gjyqtarit A. P., janë rishortuar, pasi gjyqtari A. P., me vendimin nr. 186, datë 26.03.2025 të KLGJ-se është transferuar në një gjykatë tjetër.

Lidhur me planifikimin e seancave të gjyqimit të dy çështjeve të ndryshme, nga i njëjti gjyqtar, në të njëjtën sallë në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë<sup>[68]</sup>, nga gjykata është përcjellë informacioni se për datën 13.01.2025, ora 14:30, në sallën nr. 1 janë pasqyruar si të planifikuara dy çështje të ndryshme nga gjyqtari F. D., (çështjet nr. 21246-00302-55-2024 dhe nr. 82400-00543-55-2024) dhe është sqaruar se, kjo situatë është një lapsus nga ana e sekretarisë gjyqësore, pasi në fakt seancat janë zhvilluar në orare të ndryshme, konkretisht në orën 15:15-15:20 dhe në orën 15:30-15:37. Ndërkohë nga verifikimi i të dhënave të administruara në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) rezulton se informacioni i raportuar nuk përputhet me përmbajtjen e procesverbaleve.

Konkretisht, nga analiza e procesverbaleve rezulton se në seancën e datës 11.12.2024 për çështjen nr. 21246-00302-55-2024 është vendosur nga gjykata e përbërë nga gjyqtari F. D., seanca e ardhshme më datë 13.01.2025, ora 14:30 Gjithashtu në seancën e datës 19.12.2024 për çështjen nr. 82400-00543-55-2024, është vendosur nga gjykata e përbërë nga gjyqtari F. D., seanca e ardhshme më datë 13.01.2025 ora 14.30, si rrjedhojë vlerësimi i tij si lapsus nga ana e sekretarisë gjyqësore nuk përputhet me përmbajtjen e procesverbaleve të administruara. Ndërsa nga gjyqtari F. D., planifikimi i dy çështjeve të ndryshme, në të njëjtën sallë, në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë, ka bërë që planifikimi të mos jetë real, objektiv dhe i realizueshëm dhe zhvillimi jo në përputhje me planifikimin.

Krahas kësaj, në të dhënat e pasqyruara në listën e çështjeve për gjykim, janë pasqyruar raste, të planifikimit në të njëjtën datë, orë dhe sallë, (datë 15.01.2025, ora 11:00, sala 2) të çështjeve të ndryshme, çështjet nr. (80101-01171-55-2024, 230004-00470-55-2024

<sup>68</sup> Seancat e planifikuara më datë 13.01.2025, në të njëjtën sallë, sala 1, në të njëjtën orë, ora 14:30, nga i njëjti gjyqtar, gjyqtari F. D., është planifikuar gjyqimi i 2 çështjeve të ndryshme konkretisht çështja nr. 21246-00302-55-2024 dhe çështja nr. 82400-00543-55-2024.

dhe nr. 23605-00494-55-2024) nga gjyqtar të ndryshëm, përkatësisht (S. K., B. A., A. XH.). Në procesverbalet seancave të datës 15.01.2025 të çështjeve përkatëse, të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës figuron se çështjet nr. 80101-01171-55-2024 dhe nr. 230004-00470-55-2024, ndryshe nga sa pasqyrohet në listën e çështjeve për gjykim, janë zhvilluar në dy salla të ndryshme, pasi seanca për çështjen nr. 80101-01171-55-2024 është çelur nga gjyqtari A. P., gjyqtari fillestar i çështjes dhe jo nga gjyqtarja S. K., në orën 11:49 në sallën 4. Ndërsa çështja nr. 23004-00470-55-2024, figuron se seanca është çelur nga gjyqtarja B. A., në sallën nr. 2 në orën 11:35. Gjithashtu evidentohet se nga gjyqtari A. P., fillimi i seancës së datës datë 15.01.2025 për gjykimin e çështjes nr. 80101-01171-55-2024 nuk është zhvilluar në përputhje me orarin e planifikuar, por pas 49 minutash. E njëjta situatë paraqitet edhe nga gjyqtarja B. A., ku figuron se fillimi i seancës së datës 15.01.2025 për gjykimin e çështjes nr. 230004-00470-55-2024 nuk është zhvilluar në përputhje me orarin e planifikuar, por pas 35 minutash, nga orari i caktuar.

Ndërsa në procesverbalin e seancës së çështjes nr. 23605-00494-55-2024 figuron që nga sekretarja gjyqësore E. N., me procesverbal administrativ është shtyrë seanca e planifikuar më datë 15.01.2025, ora 09:00 për shkak se gjyqtarja e çështjes A. XH., ndodhet në trajnim pranë Shkollës së Magjistraturës. Referuar raportimit nga magjistratja A. XH., për seancat gjyqësore të zhvilluara, figuron se nga magjistratja, për muajin janar janë raportuar 112 seanca gjyqësore të zhvilluara ku për datën 15 janar 2025, ka informuar se: “19 seanca gjyqësore/çështja [...] është kaluar në shtator të 2025 nga rishortimit e gjyqtarit F. D., (është regjistruar nga sekretare gjyqësore”, pa individualizuar 19 çështjet përkatëse me numrat identifikues sipas sistemit ICMIS.

Sa më sipër, evidentohet se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lejon mundësinë e planifikimit të seancave për çështje të ndryshme në të njëjtën sallë, datë, dhe orë, nga gjyqtar të ndryshëm.

### 3.3.2. Analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor

➤ Planifikimi i seancave sipas ditëve të javës.

Në Analizën Vjetore 2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, është referuar se ndarja e sallave në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, është bërë me marrëveshje, për shkak të organikës së trupës gjyqësore e përbërë nga 7 (shtatë) gjyqtar dhe numrit të lartë të çështjeve si dhe duke mbajtur në vëmendje se, në sallën nr.1, gjykohen çështjet penale me të arrestuar/ndaluar apo të dënuar. Në vijim me Urdhrin nr. 281, datë 10.09.2025, “Për caktimin e grafikut të përdorimit të sallave të gjykimit”, të Zv/ Kryetarit të gjykatës, është urdhëruar caktimi i grafikut të përdorimit të sallave të gjykimit me efekt nga data 10.09.2025, grafik nga i cili i figuron se : (i) nuk ka mbivendosje të sallave të gjykimit në të njëjtën ditë, si dhe të gjithë gjyqtarët, në ditët e caktuara, do të gjykojnë nga ora 08:00-16:00, duke përdorur

sallat përkatëse të gjykimit; (ii) në ditën e hënë është caktuar, zhvillimi i gjykimit në katër sallat të ndryshme (1, 2, 3, 4) nga katër gjyqtar duke përbërë ditën me aktivitetin më të lartë gjyqësor ndërkohë që në ditën e martë rezultoi se, nuk është caktuar përdorimi i asnjërës prej katër sallave; (iii) përdorimi i sallës nr. 4 për gjykim vetëm ditën e hënë nga gjyqtarja E. F.

Ndërkohë që lidhur me planifikimin e seancave sipas ditëve të javës, nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga gjykata rezultoi se planifikimi i seancave është përqendruar kryesisht në fillim dhe në mes të javës (nga e hëna deri të enjten), me numrin më të lartë të seancave të regjistruar ditën e mërkurë ndërsa dita e premte paraqet dukshëm numër më të ulët të planifikimit të seancave, për sa pasqyrohet në tabelën në vijim:

Gjyqtarët	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel
B. A	152	66	181	284	36	1	3
F. D (deri më 17 shtator)	272	146	204	110	1	6	8
M. Ç (deri më 08 qershor)	32	26	56	115	4	4	1
A. P (deri më 14 prill)	0	63	5	59	0	0	2
S. K	456	32	532	85	62	9	3
A.XH	375	104	443	288	224	2	4
E. F	166	368	239	354	69	4	5
<b>Total Gjykata</b>	<b>1453</b>	<b>805</b>	<b>1660</b>	<b>1295</b>	<b>396</b>	<b>26</b>	<b>26</b>

Krahas kësaj janë evidentuar raste kur, për disa ditë të njëpasnjëshme, nga gjykata nuk janë planifikuar seanca, si rast ilustrues periudha nga data 1 deri më 3 shtator 2025, figuron në mungesë të planifikimit të seancave.

- Përdorimi audio nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës referuar RDA

Lidhur me nivelin e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar, nga gjykata është raportuar se seancat gjyqësore janë regjistruar në sistemin audio. Nga përpunimi i të dhënave të administruara nga gjykata, e numri i seancave audio sipas raportit të RDA figuron sipas të dhënave të shfaqura në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 3 Kalendari i konstatuar i totalit të seancave audio sipas raportimit të RDA**

Muaji	B. A.	F. D.	M. Ç.	A. P.	S. K.	A.XH.	E. F.	Totali	Nr. Mesatar i seancave nivel gjyqate
Janar	43	75	34	50	60	71	55	388	55
Shkurt	71	102	60	38	127	48	115	561	80
Mars	50	107	31	23	64	80	106	461	66
Prill	51	121	40	3	164	150	132	661	94

Maj	55	79	41	0	99	122	132	528	88
Qershor	63	70	1	0	92	109	135	470	94
Korrik	87	44	0	0	128	183	151	593	119
Gusht	5	5	0	0	6	2	2	20	4
Shtator	74	17	0	0	93	93	79	356	71
Tetor	98	0	0	0	122	99	114	433	87
<b>Totali</b>	<b>597</b>	<b>620</b>	<b>207</b>	<b>114</b>	<b>955</b>	<b>957</b>	<b>1021</b>	<b>4471</b>	

Nga krahasimi i këtyre të dhënave me të dhënat e pasqyruara në kalendarin e planifikimit të seancave dhe kalendarit të zhvillimit të tyre figurojnë mospërputhje lidhur me numrin e seancave audio, ku në disa raste rezultoi se numri i seancave të zhvilluara sipas raportimit të gjykatës është më i ulët ose më i lartë se ai i pasqyruar në RDA. Vlen të theksohet se, në raportimet tremujore drejtuar KLGJ-së, nga gjykata është raportuar se, rastet e seancave të paregjistruara lidhen kryesisht me procesverbale administrative të hedhura në sistemin ICMIS nga sekretaria gjyqësore, në situata kur gjyqtari nuk ka qenë i pranishëm ose kur, sipas parashikimeve ligjore, regjistrimi nuk kryhet për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor, duke ndikuar në vlerësimin e saktë të nivelit të përdorimit të sistemit të regjistrimit audio.

➤ Planifikimi i seancave në ditë të lejes së miratuar

Miratimi i lejeve vjetore të pashfrytëzuar të vitit 2024 dhe i lejes së pakryer të vitit 2025 për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është realizuar nëpërmjet urdhrave individual të zëvendëskryetarit të Gjykatës, me objekt “*Dhënie leje nga pushimet vjetore të pagueshme*”, në të cilët, është identifikuar emri i gjyqtarit, periudha konkrete e lejes, numri i ditëve të punës së miratuar, si dhe baza ligjore, neni 23 pika 11, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet ndër të tjera se: “...(...)...11.Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre...etj.”. Në referim të saj, figuron se kërkesat për leje nga gjyqtarët, M. Ç.,<sup>[69]</sup> B. A.,<sup>[70]</sup> A. XH.,<sup>[71]</sup> E. F.,<sup>[72]</sup> dhe për rrjedhojë edhe lejet e miratuara nga ana e Zv/Kryetarit të gjykatës, janë bërë duke mos zbatuar parashikimet ligjore pasi kërkesat nuk janë bërë të paktën 1 (një) muaj para nga marrja e lejes, duke ndikuar edhe në moszhvillimin e seancave të planifikuara më parë prej tyre.

Gjithashtu, nga verifikimi i periudhës së përcaktuar sipas urdhrave për dhënien e lejeve nga pushimet vjetore të pagueshme, në raport me periudhën e pasqyruar në kalendarët e

<sup>69</sup> Kërkesa e datës 06.03.2025 e miratuar me Urdhrin nr. 72, datë 10.03.2025 të Zv/Kryetarit F. D., për leje 6 ditë pune nga data 18.03.2025-26.03.2025.

<sup>70</sup> Kërkesa e datës 06.03.2025 e miratuar me Urdhrin nr. 73, datë 10.03.2025 të Zv/Kryetarit F. D., për leje 6 ditë pune nga data 18.03.2025-26.03.2025.

<sup>71</sup> Kërkesa e datës 22.05.2025 e miratuar me Urdhrin nr. 167, datë 23.05.2025 të Zv/Kryetarit F. D., për leje 5 ditë pune nga data 09.06.2025-12.06.2025.

<sup>72</sup> Kërkesa e datës 29.09.2025 e miratuar me Urdhrin nr. 307, datë 23.05.2025 të Zv/Kryetarit S. K., për leje 5 ditë pune nga data 29.09.2025-05.10.2025.

seancave të planifikuara dhe kalendarët seancave e zhvilluara sipas raportimeve të gjykatës, kanë figuruar edhe raste të planifikimit dhe të zhvillimit të seancave, në periudhën e lejes nga pushimet vjetore të miratuar, për verifikimin e të cilave nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, u nxorën procesverbalet nga të dhënat e të cilave kanë rezultuar rastet si vijon:

- Çështja e regjistruar me nr. 23605-00297-55-2025, seanca e datës 18.08.2025 është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtarja B. A., në një periudhë gjatë së cilës, sipas Urdhrit nr. 253, datë 29.07.2025, gjyqtarja B. A., nga data 07.08.2025 - 31.08.2025, figuron me lejen nga pushimet vjetore të miratuar.
- Çështja e regjistruar me nr. 60605-00804-55-2025, seanca e datës 01.08.2025 është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtari F. D., në një periudhë gjatë së cilës, sipas Urdhrit nr. 253, datë 29.07.2025, gjyqtari F. D., nga data 01.08.2025 - 06.08.2025 figuron me lejen nga pushimet vjetore të miratuar.
- Çështja e regjistruar me nr. 88000-01107-55-2024, ka rezultuar se seanca e datës 05.03.2025 për, planifikimin e së cilës është vendosur në seancën e mbajtur më datë 22.01.2025, është shtyrë nga sekretarja gjyqësore M. T., me procesverbal administrativ për arsye se *trupi gjykues është me leje vjetore*. Referuar Urdhrit nr. 20, datë 03.02.2025 magjistratja S. K., nga data 03.03.2025 deri më datë 12.03.2025 figuron me lejen nga pushimet vjetore, dhe seancat e planifikuara nga gjyqtarja, për tu mbajtur gjatë kësaj periudhe, janë shtyrë.

*Ndërsa për gjyqtar A. P., nga dokumentacioni i përcjellë nga gjykata u konstatua se periudha e planifikimit dhe zhvillimit të seancave, është në përputhje me urdhrat e nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për gjykimin e rasteve urgjente/grafikut të gatishmërisë dhe të urdhrave për dhënien leje nga pushimet vjetore.*

### **3.3.3. Korrelacioni strukturor midis ngarkesës, planifikimit, zhvillimit dhe vendimmarrjes**

#### **➤ Rishortimet**

Referuar të dhënave të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është evidentuar gjithashtu se, lista e çështjeve për gjykim që gjeneron sistemi lidhur me planifikimin e seancave, për çështjet e rishortuara, pasqyron të dhëna që nuk përputhen me të dhënat e Riv-it të përkatës të çështjes, pasi identifikon si gjyqtar që ka planifikuar, gjyqtarin të cilit i ka kaluar çështja pas rishortimit të saj, duke rritur fiktivisht numrin e seancave të planifikuara.

Nga analiza krahasuese e të dhënave të pasqyruara në kalendarët e seancave të planifikuara me të dhënat e përpunuara nga informacioni dhe dokumentacioni i

administruar nga gjykata<sup>[73]</sup> për çështjet e rishpërndara gjatë periudhës objekt inspektimi, ka rezultuar se këto të dhëna lidhur me emrin e gjyqtarit nuk përputhen me informacionin e pasqyruar në procesverbalet përkatëse, pasi në fakt, nuk janë planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtari përkatës. Referuar të dhënave të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, konkretisht procesverbalet e seancave rezultoi se, të dhënat e raportuara nga gjykata për çështjet e rishortuara, janë të dhëna të pasaktësuara, pasi për çështjet gjyqësore të gjykuara nga gjyqtarët magistratët z. A. P.,<sup>[74]</sup> znj. M. Ç., dhe z. F. D.,<sup>[75]</sup> dhe që më pas janë rishortuar, seancat e planifikuara prej tyre janë pasqyruar në mënyrë automatike në emër të gjyqtarit që i ka kaluar çështja pas rishortimit. Si pasojë, numri i seancave të planifikuara për gjyqtarët që kanë përfunduar gjykimin e çështjes rezulton i rritur artificialisht, ndërsa për gjyqtarët të cilët kanë planifikuar në fakt, mungon si e dhënë, duke pasqyruar pasaktësi në dhëna në kalendarët e seancave të planifikuara. Këto mospërputhje identifikohen dukshëm edhe në tabelën me të dhënat e përpunuara nga dokumentacioni dhe informacioni i raportuar nga gjykata, ku gjatë periudhës së gatishmërisë dhe të shfrytëzimit të lejes vjetore gjatë muajve Janar - Gusht 2025, të dhënat e pasqyruara rezultojnë jo në përputhje me urdhrat e nxjerrë nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për miratimin e listës së gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente/grafikut të gatishmërisë, për periudhën Janar - Gusht 2025 dhe të urdhrave për dhënien leje nga pushimet vjetore përse i përket planifikimit dhe zhvillimit të seancave.

***Aneks nr. 5 Numri i çështjeve të rishortuara në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës***

Për shortimet e datës 14.04.2025, në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 14.04.2025, çështjet në ngarkim të gjyqtarit A. P., rishortohen, me vendimin nr. 186, datë 26.03.2025 të KLGJ-së, numri i çështjeve të shpërndara është 105 dhe shpërndarja e çështjeve të magistratët është bërë sipas tabelës së mëposhtme:		
Nr.	Magjistrati	Shortuar
1	B. A	18
2	F. D	17
3	M. Ç	18
4	S. K	18
5	A.XH	17
6	E. F	17
<b>TOTAL</b>		<b>105</b>
Për shortimet e datës 23.06.2025, në zbatim të vendimit nr. 199, datë 23.06.2025, për rishortimin e çështjeve të gjyqtarës znj. M. Ç., për arsye të marrjes së raportit të barrëllindje numri i çështjeve të shpërndara është 45 dhe shpërndarja e çështjeve të magistratët është bërë sipas tabelës së mëposhtme:		
Nr.	Magjistrati	Shortuar
1	B. A	10
2	F. D	10
3	S. K	9
4	A. XH	8

<sup>73</sup> Njëpërmjet shkresës nr. 1764/1 prot., datë 16.12.2025 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2930/6 prot., datë 16.12.2025.

<sup>74</sup> Çështjet në ngarkim të gjyqtarit Aulon Pashaj janë rishortuar në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 14.04.2025, pasi me vendimin nr. 186, datë 26.03.2025 të KLGJ-së është transferuar në gjykatë tjetër.

<sup>75</sup> Me vendimin nr. 639, datë 17.09.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari F. D., është transferuar në Gjykatën Administrative Tiranë me transferim të përkohshëm nga data 17.09.2025 deri në datë 19.09.2026.

5	E. F	8
	<b>TOTAL</b>	<b>45</b>
Për shortimet e datës 06.10.2025, në zbatim të vendimit të KLGJ-së nr. 639, datë 17.09.2025 për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. F. D., bëhet rishortimi i çështjeve gjyqësore numri i çështjeve të shpërndara është 55 dhe shpërndarja e çështjeve te magistratët është bërë sipas tabelës së mëposhtme:		
<b>Nr.</b>	<b>Magjistrati</b>	<b>Shortuar</b>
1	B. A	14
2	S. K	13
3	A. XH	13
4	E. F	15
	<b>TOTAL</b>	<b>55</b>
	<b>Total çështje të rishortuara gjatë periudhës objekt inspektimi</b>	<b>205</b>

A. P., nga data 1 Janar -14 Prill 2025  
M. Ç., nga data 1 Janar- 8 Qershor 2025  
F. D., nga data 1 Janar - 17 Shtator 2025

➤ Raportet 3-mujore

Lidhur me të dhënat statistikore të përpunuara nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga gjykata për nivelin e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar, seanca audio, në raport me të dhënat e pasqyruara në raportet 3 mujore I dhe II ku figuron se të dhënat janë gjeneruar nga sistemi PAKS në mënyrë të automatizuar, identifikohen mospërputhje të vlerave të raportuara. Ndërsa përputhet me të dhënat e pasqyruara në raportin e 3 mujorit të III-të, si dhe me të dhënat e detajuara për gjyqtarin A. P., për sa pasqyrohet në tabelën si vijon:

Muaji	Besmira Arshiaj	Florin Demollari	Matilda Çela	Aulon Pashaj	Suada Kurti	Ajshe Xhafa	Ermelinda Fejzo
Janar	43	75	34	50	60	71	55
Shkurt	71	102	60	38	127	48	115
Mars	50	107	31	23	64	80	106
Tot. 3-mujori sipas informacionit të gjykatës	164	284	125	111	251	199	276
Tot. 3-mujori i raportuar KLGJ-së	147	315	144	111	238	196	258
Prill	51	121	40	3	164	150	132
Maj	55	79	41	0	99	122	132
Qershor	63	70	1	0	92	109	135
Tot. 3-mujori sipas informacionit të gjykatës	169	270	82	3	355	381	399
Tot. 3-mujori II i raportuar KLGJ-së	157	323	82	3	338	380	383
Korrik	87	44	0	0	128	183	151
Gusht	5	5	0	0	6	2	2
Shtator	74	17	0	0	93	93	79

Tot. 3-mujori sipas informacionit të gjykatës	166	66	0		227	278	232
Tot. 3-mujori III i raportuar KLGJ-së	166	66			227	277	232

Lidhur me të dhënat e administruara nga gjykata, për numrin e çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme, në raport me të dhënat e pasqyruara nga gjykata në Analizën Vjetore të Performancës 2024, ku është raportuar se numri i çështjeve të papërfunduara për vitin 2024, e detajuar sipas gjyqtarëve, është në vlerën 562, çështje nga të cilat 328 janë çështje civile<sup>[76]</sup> dhe 234 çështje penale<sup>[77]</sup>, si dhe në raport me të dhënat e pasqyruara në raportet 3 mujore I dhe II, figurojnë mospërputhje midis tyre, për sa i përket detajimit për secilin gjyqtar të numrit e çështjeve të mbartura. Ndërsa përputhet me të dhënat e pasqyruara në raportin e 3-mujorit të III-të, si dhe me vlerën totale të çështjeve të mbartura 562 në të gjithë dokumentacionin e cituar, për sa pasqyrohet në tabelën si vijon:

Çështje të papërfunduara 2024								
Gjyqtari / Dokumentacioni	Besmira Arshiaj	Florin Demollari	Matilda Çela	Aulon Pashaj	Suada Kurti	Ajshe Xhafa	Ermelinda Fejzo	Total çështjet e mbartura
Analiza Vjetore e Performancës 2024	20	53	21	95	96	170	107	562
Informacion i raportuar nga gjykata në 3-mujorin I drejtuar KLGJ-së	29	63	31	42	105	177	115	562
Informacion i raportuar nga gjykata në 3-mujorin II drejtuar KLGJ-së	30	64	23	42	103	181	119	562
Informacion i raportuar nga gjykata në 3-mujori III drejtuar KLGJ-së	34	51	23	42	106	184	122	562
Informacioni i Gjykatës datë 27.10.2025	34	51	23	42	106	184	122	562

Referuar të dhënave, evidentohet se deri më datë 20.10.2025, numri total i çështjeve të papërfunduara me vendim është 507 çështje, në vlerë të përafërt me numrin e çështjeve që janë mbartur nga viti 2024 për në vitin 2025. Ndërsa figuron se numri i çështjeve të cilat kanë përfunduar me vendim nga data 01.01.2025 - 20.10.2025, të jetë më i lartë në vlerë numerike në raport me 1336 çështjeve të reja të vitit 2025, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën si vijon:

Gjyqtari	Çështje të mbartura sipas informacionit të përcjellë nga gjykata (31.12.2024)	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025	Vendime të shpallura 01.01.2025-20.10.2025	Çështjet e papërfunduara me vendim dt.20.10.2025
B. A	34	259	293	223	70
F. D	51	171	222	215	7

<sup>76</sup> Sipas informacionit të pasqyruar në Analizën Vjetore të vitit 2024, fq. 39 lidhur me të dhënat krahasuese për çështjet penale.

<sup>77</sup> Sipas informacionit të pasqyruar në Analizën Vjetore të vitit 2024, fq. 40 lidhur me të dhënat krahasuese të tabelës nr. 20.

M. Ç	23	95	118	118	0
A. P	42	32	74	74	0
S. K	106	271	377	270	107
A. Xh	184	250	434	221	213
E. F	122	258	380	270	110
<b>Total</b>	<b>562</b>	<b>1336</b>	<b>1898</b>	<b>1391</b>	<b>507</b>

Gjithashtu, nga analiza statistikore e të dhënave të administruara për secilin gjyqtar, evidentohet një lidhje ndërmjet ngarkesës së punës, numrit të seancave të planifikuara dhe atyre të zhvilluara, që tregon se rritja e numrit të çështjeve në shqyrtim shoqërohet në mënyrë pothuajse proporcionale me rritjen e numrit të seancave të planifikuara dhe atyre të zhvilluara. Po ashtu, konstatohet një përputhje shumë e lartë ndërmjet numrit të seancave të planifikuara dhe atyre të zhvilluara, duke vënë në dukje se planifikimi i seancave nga gjykata është në përgjithësi realist dhe i zbatueshëm. Ndonëse ekziston një përputhje ndërmjet planifikimit dhe zhvillimit të seancave në nivel gjykate, kjo përputhje nuk reflekton një shpërndarje të drejtë dhe të balancuar të aktivitetit gjyqësor ndërmjet gjyqtarëve, pasi një numër i konsiderueshëm i seancave është i përqendruar tek një numër gjyqtarësh, me nivele dukshëm më të ulëta të krahasuar me gjyqtarët e tjerë.

### **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës**

**Periudha 01.01.2025-31.10.2025**

Aneks nr. 6 Ngarkesa, Vendimmarrja, Planifikimi dhe Zhvillimi						
Gjyqtari	Çështje të mbartura (31.12.2024)	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025	Vendime të shpallura 01.01.2026-20.10.2025 <sup>78</sup>	Seanca të planifikuara (Janar-Tetor)	Seanca të zhvilluara sipas raportimit të secilit gjyqtar (Janar-Tetor)
B. A	34	259	293	223	723	655
F. D	51	171	222	215	747	660
M. Ç	23	95	118	118	238	236
A. P	42	32	74	74	129	119
S. K	106	271	377	270	1179	925
A.XH	184	250	434	221	1442	1442
E. F	122	258	380	270	1204	938
<b>Total</b>	<b>562</b>	<b>1336</b>	<b>1898</b>	<b>1391</b>	<b>5662</b>	<b>4975</b>

F. D., nga data 1 Janar - 17 Shtator 2025

M. Ç., nga data 1 Janar- 8 Qershor 2025

A. P., nga data 1 Janar -14 Prill 2025

Ndërsa në raport me numrin e vendimeve të shpallura, evidentohen diferenca të ndjeshme ndërmjet gjyqtarëve, ku për disa gjyqtarë si M. Ç., A. P., dhe F. D., vihet re një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet ngarkesës, numrit të seancave dhe vendimeve të shpallura, për gjyqtarë të tjerë kjo lidhje paraqitet më e dobët. Në veçanti, për gjyqtaren A. Xh.,

<sup>78</sup> Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

evidentohet një numër shumë i lartë seancash të planifikuara dhe të zhvilluara, i cili nuk shoqërohet në mënyrë proporcionale me numrin e vendimeve të shpallura. Një tendencë e ngjashme, konstatohet edhe për gjyqtaret S. K., dhe E. F., ku numri i seancave të zhvilluara është i lartë në raport me vendimet e shpallura. Nga kjo evidentohet se ndonëse ekziston një lidhje e fortë ndërmjet ngarkesës së gjyqtarëve dhe seancave të planifikuara dhe të zhvilluara prej tyre, kjo lidhje dobësohet në fazën e përfundimit të çështjeve.

Gjyqta ri	Nr. Vendimeve për të gjitha çështjet në ngarkim të gjyqtarit për të cilat është disponuar me vendim në vitin 2025	Nr. i seancave të zhvilluara për të gjitha çështjet në ngarkim të gjyqtarit, për të cilat është disponuar me vendim në vitin 2025	Nr. mesatar i seancave për vendim	Nr. Vendimeve për çështjet e regjistruara në vitin 2025 për secilin gjyqtar	Nr. seancave të zhvilluara për çështjet e regjistruara në vitin 2025 për secilin gjyqtar	Nr. mesatar i seancave për vendim
B. A	224	456	2,04	193	294	1,5
F. D	215	832	3,87	168	403	2,4
M. Ç	117	235	2,01	94	124	1,3
A. P	74	293	3,96	30	32	1,1
S. K	280	1075	3,84	185	367	2,0
A. Xh	221	1120	5,07	107	216	2,0
E. F	276	1171	4,24	182	369	2,0
<b>Total</b>	<b>1407</b>	<b>5182</b>	<b>3,68</b>	<b>959</b>	<b>1805</b>	<b>1,9</b>

Në analizë të të dhënave lidhur me çështjet në ngarkim të gjyqtarit për të cilat është disponuar me vendim në vitin 2025 në raport me numrit të seancave të zhvilluara, evidentohet se në total, janë dhënë 1407 vendime për të cilat janë zhvilluar 5182 seanca, dukë përbërë një mesatare rreth 3.7 seanca për çdo vendim. Megjithatë, kjo mesatare nuk shpërmdahet njëtrajtësisht ndërmjet gjyqtarëve. Për shembull, nga gjyqtare E. F., janë dhënë 276 vendime për të cilat ka zhvilluar 1171 seanca (rreth 4.2 seanca për vendim), ndërsa A. Xh., ka disponuar 221 vendime për të cilat janë zhvilluar 1120 seanca (rreth 5.1 seanca për vendim), duke treguar një ngarkesë më të lartë procedurale dhe potencialisht çështje më komplekse. Në të kundërt, gjyqtare B. A., me 224 vendime dhe 456 seanca ka një raport dukshëm më të ulët (rreth 2.0 seanca për vendim), që tregon çështje më pak komplekse ose procese më të shpejta. Ndërkohë, gjyqtare S. K., (280 vendime, 1075 seanca) dhe gjyqtar F. D., (215 vendime, 832 seanca) paraqesin një raport më të balancuar, përkatësisht rreth 3.8-3.9 seanca për vendim. Këto diferenca tregojnë se, megjithëse ekziston një korrelacion pozitiv (më shumë vendime shoqërohen me më shumë seanca), natyra e çështjeve dhe trashëgimia e tyre ndikon ndjeshëm në intensitetin e procesit gjyqësor.

Nga ana tjetër, nëse analiza përfshin vetëm çështjet e reja të regjistruara në vitin 2025, paraqitet një pamje tjetër e performancës pasi totali prej 959 vendimesh dhe 1805 seancash jep një mesatare prej rreth 1.9 seanca për vendim, që tregon se zgjidhja e

çështjeve të reja ka kërkuar më pak seanca. Për shembull, nga gjyqtare B. A., është disponuar me 193 vendime dhe 294 seanca të zhvilluara (rreth 1.5 seanca për vendim), ndërsa nga gjyqtare M. Ç., është disponuar me 94 vendime në 124 seanca të zhvilluara (rreth 1.3 seanca për vendim), situatë e cila paraqet procese relativisht të shpejta. Ndërkohë, nga gjyqtari F. D., (168 vendime, 403 seanca) ka një raport më të lartë prej rreth 2.4 seanca për vendim. Ndërsa gjyqtare S. K., dhe E. F., dhe A. XH., paraqesin një balancë të qëndrueshme (rreth 2.0 seanca për vendim), shumë më e ulët krahasuar me analizën lidhur me çështjet në ngarkim të gjyqtarit për të cilat është disponuar me vendim në vitin 2025.

Të dhënat krahasimore tregojnë qartë ndikimin e çështjeve të mbartura, në rritjen e ndjeshme të numrit të seancave për vendim, duke krijuar ndryshime të theksuara ndërmjet gjyqtarëve. Ndërsa nëse analizohen vetëm çështjet e reja, raportet janë më të ulëta dhe më homogjene, duke reflektuar më mirë efikasitetin aktual. Në përfundim, të dhënat tregojnë një korrelacion pozitiv ndërmjet vendimeve dhe seancave në të dy rastet, por gjithashtu tregojnë se çështjet e mbartura janë faktor që ndikon në rritjen e numrit të seancave për vendim dhe në kohëzgjatjen e përfundimit të gjykimit të çështjes.

Në këtë kuadër, nga analiza rezulton se, ndonëse planifikimi dhe zhvillimi i seancave kryhen në mënyrë efektive, ekzistojnë dallime në efikasitetin e përfundimit të çështjeve nga një gjyqtar te tjetri, në analizën e së cilës duhet të merret në konsideratë edhe ndikimi i rishortimit të çështjeve, i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në pasqyrimin e të dhënave. Konkretisht, nga verifikimi krahasues i të dhënave të kalendarëve të seancave me procesverbalet përkatëse rezulton se, për çështjet e rishortuara, seancat e planifikuara fillimisht nga një gjyqtar janë pasqyruar automatikisht në emër të gjyqtarit përfitues pas rishortimit. Si pasojë, numri i seancave të planifikuara për disa gjyqtarë rezulton i rritur artificialisht, ndërsa për gjyqtarët që i kanë planifikuar realisht këto seanca, mungon pasqyrimi përkatës. Kjo situatë evidentohet veçanërisht në rastet e rishortimeve të çështjeve të gjyqtarit A. P., (105 çështje), të gjyqtares M. Ç., (45 çështje), dhe të gjyqtarit F. D., (55 çështje), duke përbërë në total 205 çështje të rishortuara gjatë periudhës objekt inspektimi, e cila ka ndikuar në shpërndarjen e ngarkesës dhe në pasqyrimin statistikor të numrit të seancave të planifikuara dhe atyre të zhvilluara, si dhe periudha jo e plotë e ushtrimit të funksionit të këtyre gjyqtarëve (A. P., deri në muajin prill, M. Ç., deri në qershor, F. D., deri në muajin shtator).

#### **3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara dhe zhvilluara nga secili gjyqtar sipas tabelës së mëposhtme:**

Numri mesatar i seancave të planifikuara dhe i seancave të zhvilluara në nivel gjykate për secilin muaj dhe për gjithë periudhën e inspektimit 01.01.2025-31.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është pasqyruar përkatësisht në Tabelën nr. 4 dhe Tabelën nr. 4.1., për sa më poshtë:

**Aneks nr. 4 Numri mesatar i seancave të planifikuara për secilin gjyqtar për periudhën 01 Janar 31 tetor 2025**

Muaji	B. A.	F. D.	M. Ç.	A. P.	S. K.	A. Xh.	E. F.	Totali i seancave për periudhën e inspektimit	Nr. Mesatar i seancave nivel gjykatë
Janar	53	94	39	54	71	116	67	494	71
Shkurt	75	140	67	47	139	133	158	759	108
Mars	65	123	39	24	130	129	118	628	90
Prill	70	135	48	4	186	207	151	801	114
Maj	70	91	45	0	122	166	144	638	106
Qershor	72	76	0	0	124	186	140	598	120
Korrik	99	47	0	0	133	230	157	666	133
Gusht	6	6	0	0	6	3	2	23	5
Shtator	88	23	0	0	99	134	111	455	91
Tetor	125	12	0	0	169	138	156	600	120
<b>Totali i seancave</b>	<b>723</b>	<b>747</b>	<b>238</b>	<b>129</b>	<b>1179</b>	<b>1442</b>	<b>1204</b>	<b>5662</b>	

**Aneks nr. 4.1 Numri mesatar i seancave të zhvilluara për secilin gjyqtar për periudhën 01 Janar-31 Tetor 2025**

Gjyqtari Muaji	B. A.	F. D.	M. Ç.	A. P.	S. K.	A.XH.	E. F.	Totali seancave të zhvilluara për periudhën e inspektimit	Nr. Mesatar i seancave nivel gjykatë
Janar	53	59	37	51	58	112	53	423	60
Shkurt	62	116	67	40	118	127	100	630	90
Mars	50	117	39	24	47	123	89	489	70
Prill	56	101	48	4	162	207	125	703	100
Maj	67	82	45	0	112	178	122	606	101
Qershor	67	82	0	0	83	188	130	550	110
Korrik	93	84	0	0	129	231	137	674	135
Gusht	6	0	0	0	6	3	0	15	3
Shtator	81	19	0	0	64	135	62	361	72
Tetor	120	0	0	0	146	138	120	524	131
<b>Totali seancave</b>	<b>655</b>	<b>660</b>	<b>236</b>	<b>119</b>	<b>925</b>	<b>1442</b>	<b>938</b>	<b>4975</b>	

Nga analiza krahasuese e të dhënave të pasqyruara në Tabelën nr. 4 dhe Tabelën nr. 4.1, në raport me mesataren mujore të seancave në nivel gjykatë, rezulton se veprimtaria gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës karakterizohet nga një shpërndarje jo e balancuar e ngarkesës dhe nga diferenca të dukshme ndërmjet gjyqtarëve, si në fazën e planifikimit ashtu edhe në atë të zhvillimit të seancave. Në mënyrë të veçantë, konstatohet se një pjesë e gjyqtarëve, konkretisht A. Xh., S. K., dhe E. F., mbajnë në mënyrë të vazhdueshme numër të seancave të planifikuara

dhe të zhvilluara dukshëm mbi mesataren e gjykatës. Për shembull, gjyqtarja A. Xh., ka planifikuar në muajin Prill 207 seanca kundrejt mesatares 114 dhe në muajin Korrik 230 seanca kundrejt mesatares 133. E njëjta tendencë, ndonëse në nivele disi më të moderuara, konstatohet edhe për gjyqtaret S. K., dhe E. F., të cilat në shumicën e muajve rezultojnë mbi mesataren, si në planifikim ashtu edhe në zhvillimin e tyre.

Në të kundërt, gjyqtarët M. Ç., dhe A. P., paraqiten në mënyrë të vazhdueshme nën mesataren e gjykatës, si në planifikim ashtu edhe në zhvillim të seancave. Megjithatë, kjo situatë lidhet drejtpërdrejt me periudhën e kufizuar të ushtrimit të funksionit, përkatësisht deri në muajin qershor për gjyqtaren M. Ç., dhe deri në muajin prill për gjyqtarin A. P., duke kufizuar analizën krahasuese me gjyqtarët e tjerë.

Sa i përket gjyqtares B. A., konstatohet se në planifikim dhe zhvillimin e seancave rezulton nën mesataren e gjykatës gjatë pjesës më të madhe të periudhës, ku p.sh. në muajin Janar ka planifikuar 53 seanca kundrejt mesatares 71 dhe në muajin prill 70 kundrejt 114, dhe vetëm në muajt e fundit evidentohet një afrim me mesataren.

Gjyqtari F. D., rezulton dukshëm me planifikim mbi mesataren (p. sh., 140 seanca në shkurt kundrejt mesatares 108) në muajt e parë të periudhës së inspektimit, ndërsa në muajt në vijim figuron një rënie, situatë, e cila lidhet me ndërprerjen e ushtrimit të funksionit duke ndikuar ndjeshëm në shpërndarjen e përgjithshme të ngarkesës në gjykatë.


#### **4. Konkluzione për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës**

4.1. Nga analiza e dokumentacionit dhe të dhënave të administruara gjatë periudhës së inspektimit rezulton se raportimi i gjykatës nuk paraqitet plotësisht i harmonizuar dhe i verifikueshëm në të gjitha rastet. Janë evidentuar mospërputhje ndërmjet kalendarëve të seancave, procesverbaleve gjyqësore, të dhënave në sistemin ICMIS dhe raporteve të dërguara, të cilat kanë kërkuar sqarime dhe verifikime të mëtejshme. Mungesa e një verifikimi të të dhënave përpara dërgimit të raporteve, ka ndikuar në pasaktësi në pasqyrimin e të dhënave të përpunuara për seancat e planifikuara dhe të zhvilluara, si dhe në përputhshmërinë e tyre me të dhënat e sistemit të regjistrimit audio (RDA).

4.2. Gjatë verifikimit të të dhënave të raportuara dhe informacionit të përcjellë nga gjykata, janë konstatuar raste të pasaktësive në raportimin e planifikimit dhe zhvillimit të seancave, duke përfshirë, për çështjet e rishortuara identifikimin e pasaktë të çështjeve pas rishortimit, si dhe mospërputhje në të dhenat lidhur me orën dhe sallën e gjykimit, rrethana të cilat tregojnë mungesë në kontrollin administrativ dhe në verifikimin paraprak të të dhënave të raportuara.

The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. On the right side, there is a circular official stamp with illegible text inside. The signatures appear to be from various officials involved in the report's preparation or approval.


- 4.3. Janë evidentuar pasaktësi në raportimin e organikës dhe të lëvizjeve të magjistratëve, si dhe mungesë dokumentacioni për raportimin e disa periudhave të gatisshmërisë, duke krijuar pamundësi në evidentimin e plotë të veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
- 4.4. Sistemi Elektronik (ICMIS) nuk pasqyron në mënyrë reale volumin individual të punës për çdo gjyqtar. Për shkak të rishortimeve (*rindarjeve*) të shpeshta (*si pasojë e largimeve apo transferimeve, si dhe lejes së barrëlindjeve të gjyqtarëve*), planifikimet e mëparshme kalojnë automatikisht në llogarinë e gjyqtarit të ri, duke krijuar raporte jo reale ku gjyqtarët figurojnë me seanca të zhvilluara në periudha kur nuk kanë qenë në detyrë.
- 4.5. Gjatë periudhës së inspektimit, gjykata ka funksionuar me një kapacitet të reduktuar (*5 deri në 7 gjyqtarë*). Ndryshimet e vazhdueshme të trupës (*largime apo transferime, dhe leje lindjeje*) kanë sjellë nevojën për rindarje masive të çështjeve gjyqësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në saktësinë e statistikave të sistemit.
- 4.6. Përdorimi i sallave të gjykimit rezulton i organizuar pa mbivendosje në grafikun e planifikimit, megjithatë evidentohet përqendrim i seancave në ditë të caktuara duke mos shfrytëzuar kapacitetet plotësisht në ditë të tjera.
- 4.7. Lidhur me planifikimin e seancave sipas ditëve të javës, rezulton se ka një fokus me të lartë në fillim dhe në mes të javës, me rënie të ndjeshme në fund të saj, si dhe raste të veçanta kur për disa ditë radhazi nuk janë planifikuar seanca gjyqësore.
- 4.8. Nga krahasimi i urdhrave për leje vjetore me kalendarët e seancave të planifikuara dhe raportimet mbi seancat e zhvilluara, rezultojnë raste planifikimi, ose zhvillimi seancash gjatë periudhës së lejes së miratuar.
- 4.9. Kërkesat për leje nga gjyqtarët, M. Ç., B. A., A. XH., dhe E. F., dhe për rrjedhojë edhe lejet e miratuara nga ana e Zv/Kryetarit të gjykatës, janë bërë duke mos zbatuar parashikimet ligjore pasi kërkesat nuk janë bërë të paktën 1 (një) muaji nga marrja e lejes, duke ndikuar edhe në moszhvillimin e seancave të planifikuara më parë prej tyre.
- 4.10. Planifikimi i seancave gjyqësore nga gjyqtarët bëhet në orare tepër të ngushta nga njëra seancë në tjetër, ku varion nga 5 minuta deri në 15 minuta, fakt i cili pasqyron se gjyqtarët nuk tregojnë vëmendjen e duhur zhvillimit të gjykimit dhe për rrjedhojë menaxhimin sa më të mirë të çështjeve gjyqësore dhe realizimin e këtij procesi, mbi bazën e parimit të transparencës, dhe barazisë së shpërndarjes së çështjeve të planifikuara për gjykim brenda ditës që ato gjykojnë.
- 4.11. Planifikimi i seancave nga gjyqtar të ndryshëm të çështjeve të ndryshme në të njëjtën datë, orë dhe sallë, duke evidentuar se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve



Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lejon mundësinë e planifikimit të seancave për çështje të ndryshme në të njëjtën sallë, datë, dhe orë, nga gjyqtar të ndryshëm.

- 4.12. Evidentohen mospërputhje midis të dhënave të administruara nga gjykata, për numrin e çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme, në raport me të dhënat e pasqyruara nga gjykata në Analizën Vjetore të Performancës 2024, si dhe në raport me të dhënat e pasqyruara në raportet 3-mujore I dhe II, të vitit 2025.
- 4.13. Identifikohen mospërputhje të vlerave të raportuara nga gjykata, për nivelin e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar, seanca audio, në raport me të dhënat e pasqyruara në raportet 3 mujore I dhe II, fakt i cili figuron se të dhënat janë gjeneruar nga sistemi PAKS në mënyrë të automatizuar.
- 4.14. Evidentohen mospërputhje midis të dhënave të pasqyruara në informacionin e dërguar nga gjykata për numrin e çështjeve të gjykuara për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025, në raport me dokumentacionin e dërguar nga gjykata, konkretisht dokumentacioni i emërtuar, "Të dhëna mbi numrin e seancave për çështjet e gjykuara gjatë vitit 2025..." përsa i përket numrit total të çështjeve të gjykuara, të përfunduara me vendim nga gjykata, si dhe numrit të vendimeve për secilin gjyqtar, përkatësisht për gjyqtarët B. A., M. Ç., S. K., dhe E. F.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës).*



## **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë**

### **1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrim të funksioneve ligjore dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, me vendimin nr. 57, datë 20.10.2025 ka vendosur “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, me objekt edhe veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për periudhën nga data 01.01.2025-31.10.2025.

Në kuadër të këtij inspektimi, është vendosur korrespondenca përkatëse me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me qëllim administrimin e të dhënave, informacionit dhe dokumentacionit shkresor për periudhën objekt inspektimi, nga data 01.01.2025 deri në datën 31.10.2025.

Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është dërguar pa vonesë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, por nga verifikimi paraprak ka rezultuar me mospërputhje. Konkretisht ka rezultuar mospërputhje e të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 të dërguara nga gjykata për secilin gjyqtar, me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi sa i përket emrit të gjyqtarit.

Pas kërkesës së ILD-së për saktësimin dhe ridërgimin e të dhënave në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë nga secili gjyqtar, si dhe seancat e zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk e pati të mundur saktësimin e të dhënave të kërkuara me argumentin se kjo mospërputhje ishte pasojë e një mangësie e sistemit elektronik dhe administrata e saj e kishte të pamundur nga ana teknike për të ndërhyrë manualisht, me qëllim korrigjimin apo saktësimin e të dhënave statistikore të gjeneruara. Referuar informacionit të përcjellë, kjo problematikë e konstatuar kërkonte një zgjidhje teknike në nivel programimi, në sistemin elektronik, me qëllim ndryshimin e logjikës së përpunimit dhe raportimit të të dhënave nga moduli statistikor, ndërhyrje për të cilën gjykata nuk dispononte kompetencë apo mundësi teknike për ta realizuar.

#### **1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrim të funksioneve ligjore dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, me vendimin nr. 57, datë 20.10.2025 vendosi “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, ku objekt i këtij inspektimi tematik ndër të tjera do të ishte edhe veprimtaria e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për periudhën nga data 01.01.2025-31.10.2025.

Në kuadër të inspektimit të Gjykatës së Shkallës ë Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. 2927 prot., datë 20.10.2025 të ILD-së, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, janë kërkuar të dhëna në përputhje me objektin e inspektimit:

k) Statistikat e secilit gjyqtar në lidhje me:

- v. numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025;
- vi. numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe;
- l) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar;
- m) Organikën e miratuar, si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve;
- n) Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025;
- o) Numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve.

Në përgjigje të kërkesës, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. 4981/1 prot., datë 11.11.2025, regjistruar në ILD me nr. 2927/1 prot., datë 14.11.2025 ka përcjellë dokumentacionin dhe informacionin si më poshtë:

1. Të dhënat statistike mbi numrin e çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja që i janë caktuar gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025.
2. Numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe, duke saktësuar se Sistemi ICMIS nuk reflekton një pasqyrë të saktë të të dhënave statistike mbi çështjet e përfunduara dhe seancat për secilën çështje, si dhe duke bashkëngjitur për periudhën Janar-Shtator kopjet e format raportimeve mujore dërguar pranë KLGJ-së.
3. Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar;
4. Organikën e miratuar dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve për secilin muaj sipas raportimeve;
5. Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025-31.10.2025;
6. Numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve;

Nga verifikimi dhe analiza paraprake e dokumentacionit të dërguar nga gjykata rezulton se ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, me të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë sa i takon emrit të gjyqtarit.

Lidhur me këtë konstatim dhe me qëllim evidentimin e të dhënave të sakta, me shkresën nr.2927/2 prot., datë 20.11.2025 të ILD-së, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është kërkuar informacion për arsyen e mospërputhjeve të konstatuara, saktësimin e të dhënave, si dhe ridërgimin e tyre në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë, nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm/kryetarit/anëtarit) si dhe seancat e zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025. Gjithashtu është kërkuar edhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) Rregullorja e brendshme e gjykatës;
- b) Analiza vjetore për vitin 2024;
- c) RDA (raportet për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat) për çdo muaj për secilin gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 (Seancat e zhvilluara nga secili gjyqtar në sallë dhe zyrë, të regjistruara ose jo);
- d) Listën e çështjeve të rishortuara për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025;
- e) Urdhrat e kryetarit të gjykatës në lidhje me ndarjen e sallave për periudhën 01.01.2025-31.10.2025;
- f) Listën e gatishmërisë për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025;

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. 5769 prot., datë 26.11.2025 regjistruar në ILD me nr. 2927/3 prot., datë 02.12.2025 ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar me sqarimin si më poshtë vijon:

- ✓ *“...mospërputhjet e konstatuara nëpërmjet të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara dhe procesverbaleve të seancave të gjeneruara nga sistemi, vijne si pasojë e lëvizjeve të trupës gjyqësore gjatë periudhës së inspektimit. Përgjatë kësaj periudhe, disa gjyqtarë janë transferuar dhe nuk e ushtrojnë më funksionin e tyre pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e më konkretisht janë transferuar në gjykata të tjera gjyqtarët: Ervin Kore, Valjona Haxhiraj, Dorinela Nikolli, Ervin Sulaj. Si rrjedhojë, çështjet në ngarkim të tyre janë rishortuar dhe shpërndarë tek gjyqtarë të tjerë, në përputhje me procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short elektronik.*
- ✓ *Procesverbalet e seancave të planifikuara pasqyrojnë gjyqtarin që realisht ka zhvilluar seancën në datën dhe kohën përkatëse. Ndërkohë, kalendarin aktual i seancave në Kalendarin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore PAKS + (përfshirë edhe gjenerimin e RDA-së) reflekton gjendjen e tanishme të dosjes, duke shfaqur emrin e gjyqtarit që ka marrë çështjen pas rishpërndarjes. Për këtë arsye, seancat e zhvilluara më herët figurojnë aktualisht nën emrin e gjyqtarit të ri relator, edhe pse ky i fundit nuk e ka zhvilluar realisht seancën në atë periudhë.*
- ✓ *Mospërputhja midis të dhënave të kalendarit dhe procesverbaleve nuk përbën gabim në përmbajtje, por është pasojë e një mangësie të sistemit elektronik, i cili në raportet*

*elektronike që gjeneron, nuk reflekton qartë dhe në mënyrë të ndarë historikun real të zhvillimit të seancave përkundrejt gjendjes së përditësuar të shpërndarjes së çështjeve për secilin gjyqtar”.*

Informacionit të mësipërm i është bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

1. Urdhri nr. 229, datë 31.12.2024 “Për miratimin e aktit të emëruar rregullorë “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”. Bashkëlidhur Rregullorja;
2. Raport analiza vjetore viti gjyqësor 2024;
3. Urdhrat e gatishmërive:
  - Urdhri nr. 223, datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”;
  - Urdhri nr. 44, datë 21.05.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”;
  - Urdhri nr. 52, datë 16.06.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, i ndryshuar;
  - Urdhri nr. 66, datë 07.07.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, për periudhën e lejeve vjetore, gjatë muajit gusht”;
  - Urdhri nr. 86, datë 08.09.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, i ndryshuar;
  - Urdhri nr. 90, datë 11.09.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, i ndryshuar;
  - Urdhri nr. 111, datë 27.10.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, i ndryshuar;
  - Urdhri nr. 224, datë 24.12.2024 “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudhën 01.01.2025-31.12.2025”;
  - Urdhri nr. 119, datë 10.11.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.05.2025 “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudhën 01.01.2025-31.12.2025”;
4. Raport për përdorimin e sistemit audio nga çdo gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025;
5. Raport për përdorimin e sistemit audio nga çdo gjyqtar për çdo muaj gjatë periudhën objekt inspektimi;
6. Informacion mbi shortin, rishortimet për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, duke përcaktuar numrin total të çështjeve të rishortuara në 772 çështje.

Gjithashtu, në vijim të informacionit të mësipërm dhe në përgjigje të emailit të dërguar nga ILD lidhur me mospërputhjet në të dhënat e dërguara, Gjykata e Shkallës së Parë e

Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me emailin datë 15.12.2025, ka sqaruar ndër të tjera se:

- ✓ *Sistemi elektronik pasqyron gjendjen aktuale administrative të dosjes, duke shfaqur emrin e gjyqtarit aktual relator, pa ruajtur në mënyrë të ndarë dhe të dukshme historikun kohor të mbajtjes së çështjes nga gjyqtarë të ndryshëm në faza të ndryshme të saj. (Përveç se kjo e dhënë shfaqet elektronikisht në sistem në RIV-in e secilës çështje).*
- ✓ *Procesverbalet e seancave, nga ana tjetër, pasqyrojnë gjendjen reale faktike të zhvillimit të seancave gjyqësore, duke evidentuar qartë gjyqtarin që ka zhvilluar realisht seancën, datën, orën dhe veprimet procedurale të kryera. Për këtë arsye, në rastet kur një çështje është rishpërndarë, seancat e zhvilluara përpara rishpërndarjes rezultojnë të pasqyruara në procesverbal nën emrin e gjyqtarit që ka ushtruar funksionin në atë periudhë, ndërkohë që në kalendarin elektronik të seancave dhe në raportet statistikore të gjeneruara nga sistemi, të njëjtat seanca shfaqen nën emrin e gjyqtarit aktual relator, pa u bërë dallimi ndërmjet periudhës faktike të zhvillimit të seancës dhe gjendjes aktuale të shpërndarjes së çështjes, duke krijuar kështu mospërputhjen e konstatuar ndërmjet kalendarit elektronik dhe procesverbaleve të seancave.*
- ✓ *Në aspektin teknik, raportet statistikore, përfshirë kalendarin e seancave, raportet RDA dhe çdo raport tjetër analitik, gjenerohen automatikisht nga moduli statistikor i sistemit elektronik, i cili funksionon mbi bazën e një arkitekture të centralizuar të të dhënave dhe një metodologjie të paracaktuar për përpunimin e tyre, sipas një source code. Ky modul nxjerr të dhëna në bazë të filtrave kohorë të përzgjedhur nga përdoruesi (datë fillimi – datë mbarimi), për secilin apo të gjithë gjyqtarët e gjykatës, duke u mbështetur në gjendjen aktuale të rekordeve në bazën e të dhënave, pa ofruar funksionalitet për ndarje historike të roleve të gjyqtarëve në kohë për të njëjtën çështje. Për sa kohë moduli statistikor i sistemit përdor të njëjtën logjikë programimi, të njëjtin model të të dhënave dhe të njëjtin format raportimi, administrata e gjykatës ndodhet në pamundësi teknike për të ndërhyrë manualisht, për të korrigjuar apo për të “saktësuar” të dhënat statistikore të gjeneruara. Pra, çdo provë për gjenerim të një raporti të ri, për të njëjtën periudhë kohore do të prodhojë të njëjtin rezultat, pasi burimi i të dhënave, algoritmi i përpunimit dhe metodologjia e raportimit mbeten të pandryshuara dhe të pavarura nga veprimet e përdoruesit. Për evidentimin dhe shmangien e këtyre mospërputhjeve në të dhënat mbi zhvillimin e seancave në raport me gjyqtarët përkatës në kohë, do të kërkohej domosdoshmërisht një zgjidhje teknike në nivel programimi, konkretisht ndërhyrje në kodin burimor (source code) të sistemit elektronik, me qëllim ndryshimin e logjikës së përpunimit dhe raportimit të të dhënave nga moduli statistikor, ndërhyrje për të cilën gjykata nuk disponon kompetencë apo mundësi teknike për ta realizuar”.*

Me emailin e datës 15.01.2026 drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është kërkuar informacion :

1. Nëse nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë nxjerrë urdhra për organizimin/ndarjen e seksioneve dhe sallave në të cilat zhvillohen gjyqet, duke kërkuar edhe kopje të vërtetuar të akteve përkatëse;
2. Nëse nga ana e Kryetarit të Gjykatës, janë dërguar raportime në KLGJ lidhur me zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore, sipas vendimit nr. 433, datë 22.07.2025 të KLGJ-së dhe nëse po të dërgohet kopje e vërtetuar e tyre.
3. Nëse nga ana e tyre janë adresuar problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve të konstatuara nga ana jonë dhe të pranuar edhe nga vetë gjykata me shkresën nr. 5769 prot., datë 15.12.2025 dhe emailin e datës 15.12.2025,

Në përgjigje të emailit të mësipërm, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me emailin e datës 15.01.2026, ka përcjellë ndër të tjera dhe informacionin si më poshtë:

- *Gjykata nuk është e organizuar në dhoma apo seksione, por funksionon vetëm me trupa gjykues. Pranë gjykatës vepron vetëm seksioni penal për të mitur, i përbërë nga tre gjyqtarë. Trupat gjyqësore shqyrtojnë të gjitha kategoritë e çështjeve gjyqësore.*
- *Ndarja e sallave të gjykimit nuk ka qenë e nevojshme, për shkak të numrit jo të plotë të gjyqtarëve në raport me numrin e sallave të gjykimit. Aktualisht, pranë gjykatës funksionojnë gjithsej 8 (tetë) salla gjykimi, prej të cilave 5 (pesë) salla civile dhe 3 (tre) salla penale.*
- *Nga ana e Kryetarit të Gjykatës është përcjellë raportimi i tre mujorit të III-të për periudhën Korrik - Shtator 2025 pranë KLGJ-së<sup>[79]</sup>, lidhur me zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore.*

Referuar akteve që i janë bashkëlidhur informacionit të përcjellë me emailin e sipërcituar rezulton se, me shkresën nr. 5078/1 prot., datë 11.11.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, “Dërgim raporti mbi zbatimin e afateve minimale kohore”, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë përcjellë të dhënat statistikore për periudhën korrik-shtator 2025, mbi zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykatën, si dhe sqarimet mbi arsyet e mosrealizimit të shqyrtimit të çështjeve në afat<sup>[80]</sup>.

<sup>79</sup> Shkresa nr. 5078/1, datë 11.11.2025 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

<sup>80</sup> Referuar vendimit nr. 433, datë 22.07.2025, të KLGJ-së “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve”.

Sipas informacionit të përcjellë në formë tabelare për secilin gjyqtar janë dhënë edhe arsyet e mosrealizimit sipas afateve të përcaktuara, si më poshtë:

### Për kërkesat penale

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			
Nr.	Gjyqtari	Kërkesa penale (në gjykim brenda 2 muajve)	Kërkesa penale (në gjykim më gjatë se 2 muaj)
1	Artan Jahollari	0	0
2	Dorinela Nikolli	7	4
3	Eda Nikolli	29	11
4	Estjon Venxha	39	26
5	Ervin Kore	0	0
6	Eglantina Milkani	22	15
7	Elena Tafa	47	13
8	Ervin Sulaj	21	5
9	Gentiana Shukullari	55	18
10	Klajdi Terova	39	17
11	Luljeta Kole	27	12
12	Luljeta Kolonja	22	21
13	Suzan Bushi	50	24

### Për kundërvajtjet penale

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			
Nr.	Gjyqtari	Kundërvajtjet penale (në gjykim brenda 2 muajve)	kundërvajtjet penale (në gjykim më gjatë se 2 muaj)
1	Artan Jahollari	0	0
2	Dorinela Nikolli	4	0
3	Eda Nikolli	3	1
4	Estjon Venxha	1	1
5	Ervin Kore	0	2
6	Eglantina Milkani	1	3
7	Elena Tafa	1	0
8	Ervin Sulaj	1	0
9	Gentiana Shukullari	6	0
10	Klajdi Terova	1	2
11	Luljeta Kole	2	1
12	Luljeta Kolonja	1	0
13	Suzan Bushi	7	1

Lidhur me afatet standarde minimale kohore mbi çështjet penale me dënim deri në 10 vjet dhe çështjet penale me dënim mbi 10 vjet është përcjellë informacioni statistikor si më poshtë:

### Çështjet penale me dënim deri/mbi 10 vjet

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			
Nr.	Gjyqtari	Çështjet penale me dënim mbi 10 vjet (në gjykim brenda 9 muajve)	Çështjet penale me dënim mbi 10 vjet (në gjykim më gjatë se 9 muaj)
1	Artan Jahollari	0	0
2	Dorinela Nikolli	7	0
3	Eda Nikolli	10	0
4	Estjon Venxha	3	0
5	Ervin Kore	1	1
6	Eglantina Milkani	8	1
7	Elena Tafa	4	0
8	Ervin Sulaj	2	0
9	Gentiana Shukullari	13	0
10	Klajdi Terova	9	0
11	Luljeta Kole	7	0
12	Luljeta Kolonja	8	4
13	Suzan Bushi	-	192

Lidhur me *shkaqet e kalimit të afateve* Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ka raportuar se arsyet e mosrealizimit të standardeve të caktuara nga KLGJ janë *të natyrës objektive sikurse janë kërkesa të përsëritura për shtyrje nga palët, marrja e dosjeve me short elektronik nga gjyqtarët e larguar nga gjykata, probleme me adresat dhe njoftimet e palëve, ngarkesa e lartë në punë, mungesa e burimeve njerëzore ndihmëse dhe leja vjetore e muajit gusht.*

Lidhur me pikën 3, mbi problematikën e sistemit elektronik, gjykata sqaron se nuk paraqitet si një situatë e krijuar së fundmi, por ka qenë e pranishme që në fazën e ndërtimit të arkitekturës së sistemit ICMIS. Me implementimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (Juronix), i cili ndodhet aktualisht në proces ndërtimi, synohet adresimi i të gjitha problematikave të evidentuara nga gjykatat në lidhje me sistemin aktual ICMIS.

### 2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

Nga administrimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezulton se kjo gjykatë funksionon sipas Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, të miratuar me urdhrin nr. 229 prot., datë 31.12.2024, të Zv/Kryetares së Gjykatës.

Referuar kësaj rregulloreje, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është organizuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.150 datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civile gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi " dhe përbëhet nga:

a) Kryetari; b) Trupa gjyqësore; c) Kancelari; ç) Kryesekretari; d) Sekretaria gjyqësore; dh) Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; e) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve; ë) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë; f) Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Referuar përmbajtjes së Rregullores rezulton se:

- Në nenin 5 parashikohet: "Kryetari është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përgjithshëm gjyqësor të gjykatës sipas ligjit dhe sipas kësaj rregulloreje. Kancelari është nëpunësi civil gjyqësor më i lartë dhe përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje".
- Në nenin 17 parashikohen detyrat e Kryetarit të Gjykatës, sipas të cilit bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë": Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor<sup>81</sup>.
- Në nenin 12, pika "a" të Rregullores parashikohen detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Median<sup>[82]</sup>.
- Lidhur me kancelarin e gjykatës si nëpunësi më i lartë për menaxhimin e administrimit gjyqësor, në nenin 18 të Rregullores parashikohen të listuara kompetencat e tij<sup>[83]</sup>.
- Në nenin 19 të Rregullores, parashikohen detyrat e Kryesekretarit sa i takon monitorimit dhe regjistrimit të të dhënave<sup>[84]</sup>.

<sup>81</sup> Në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet në ligj sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; Garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore; Garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore...

Siguron funksionimin normal të punës të Gjykatës për përmbushjen e objektivave konkrete të saj, në funksion të strategjisë së përgjithshme të shprehur me ligj.

<sup>82</sup> mirëmbajtjen dhe kontrollin e sistemit kompjuterik, elektronik, të teknologjisë së informacionit, si dhe për ruajtjen dhe përpunimin e statistikave të gjykatës;

<sup>83</sup> Mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të shortit elektronik për ndarjen e çështjeve gjyqësore; Pas ndarjes së çështjeve me short nënshkruan kalimin e praktikës së regjistrimit të çështjes, sipas formateve standarde të miratuar; Është përgjegjës për funksionimin e sistemit të gjykatës për menaxhimin e çështjeve /teknologjisë së informacionit ....., si dhe; Sigurohet që të krijohen mekanizmat e përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave që përcaktojnë gjendjen aktuale (reale) të gjykatës në menaxhimin e çështjeve gjyqësore.

<sup>84</sup> Monitoron regjistrimin e çështjeve gjyqësore në sistemin e gjykatës për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit duke siguruar saktësinë e hedhjes së të dhënave; Siguron hedhjen e të dhënave të shortit gjyqësor....

- Gjithashtu pjesë e Rregullores së brendshme janë edhe përkrahjet e punës ku vlen të përmendet pozicioni i sekretarit gjyqësor, i cili ndër të tjera ka si detyrë të hedhë të dhënat në regjistrat, si dhe sistemin elektronik të gjykatës.
- Në nenin 29 të titulluar “Zhvillimi i shortit elektronik në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë” parashikohet shprehimisht ndarja me short e çështjeve gjyqësore<sup>[85]</sup>.

Me vendimin nr. 87 prot., datë 31.03.2023 të Këshillit Gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përkrahjet e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, është miratuar struktura e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë sipas vendimit nr. 151, datë 29.03.2023<sup>[86]</sup> të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e Rregullave standarde për organigramën dhe përkrahjet e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi” sipas tabelës bashkëlidhur:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		
Nr.	Funksionet dhe struktura organizative	Nr. sipas strukturës organizative
1	Kryetar	1
2	Zv/Kryetar	1
3	Gjyqtar	13
4	Kancelar	1

Lidhur me organikën efektive të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për numrin e gjyqtarëve për secilin muaj sipas raportimeve është informuar se:

Për muajin janar 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je dhe 1 gjyqtar me leje lindje): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj;  
Ndërkohë:

<sup>85</sup> Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndarja me short e çështjeve gjyqësore realizohet duke u bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimit nr. 724, datë 07.12.2023 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të procesit të rregullt ligjor, transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes, eficiencës dhe objektivitetit. Shorti mbahet çdo ditë pas orës 12:00 në prezencë të Kryetarit të Gjykatës, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Çështjet administrative apo çdo lloj kërkesë tjetër që kërkon investimin e gjyqtarit i nënshtrohen shortit elektronik nëpërmjet sistemit elektronik”.

<sup>86</sup> Në aktin fizik, vendimi i KLGJ-së mban numër 150, datë 29.03.2023,

- gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024<sup>[87]</sup>;
- gjyqtare Elena Tafa ka filluar lejen e lindjes nga data 20.05.2024;
- gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së <sup>[88]</sup>.

Për muajin shkurt 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je dhe 1 gjyqtar me leje lindje): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj; *ndërkohë që gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024; gjyqtare Elena Tafa ka filluar lejen e lindjes nga data 20.05.2024, si dhe gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin mars 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je dhe 1 gjyqtar me leje lindje): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj; *ndërsa gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024; gjyqtare Elena Tafa ka filluar lejen e lindjes nga data 20.05.2024 si dhe gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin prill 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je dhe 1 gjyqtar me leje lindje): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj; *ndërsa gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024; gjyqtare Elena Tafa ka filluar lejen e lindjes nga data 20.05.2024 si dhe gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin maj 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (13 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj, Ervin Sulaj<sup>[89]</sup> dhe Elena Tafa (e rikthyer në punë pas lejes së lindjes); *ndërsa gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të*

<sup>87</sup> Me vendim të KPK-së nr. 788, datë 25.07.2024 është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Seladin Pysqyli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim i cili është lënë në fuqi nga KPA me vendimin nr. 15/26 JR, datë 11.02.2026.

<sup>88</sup> Me vendim të KPK-së nr. 641, datë 06.04.2023 është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të vlerësimit Besnik Shehu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim i cili është lënë në fuqi nga KPA me vendimin datë 29.10.2025.

<sup>89</sup> Me vendim të KLGJ-së nr. 474, datë 31.07.2024, gjyqtari Ervin Sulaj i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është transferuar përkohësisht për një periudhë deri në një vit në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ndërsa me vendim të KLGJ-së nr. 245, datë 12.05.2025 është vendosur deklarimi i përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Ervin Sulaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe kthimi i tij në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

KPK-së datë 26.07.2024; si dhe gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së.

Për muajin qershor 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (13 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je); Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Elena Tafa, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Kore, Valjona Haxhiraj, Ervin Sulaj; *ndërsa gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024, si dhe gjyqtari Besnik Shehu ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin korrik 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektivë në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je si dhe 2 vakanca): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Elena Tafa, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Sulaj, (vakancë pozicioni 2 gjyqtar); *ndërsa gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Besnik Shehu kanë qenë të pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin gusht 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je, si dhe 1 vakancë): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Elena Tafa, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Ervin Sulaj, (vakancë pozicioni 1 gjyqtar); *ndërsa gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Besnik Shehu kanë qenë të pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin shtator 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (10 gjyqtarë efektiv në punë + 2 gjyqtarë të pezulluar me vendim KPK-je, si dhe 2 vakanca): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Dorinela Nikolli, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Elena Tafa, Klajdi Terova, Estjon Venxha, (vakancë pozicioni 2 gjyqtarë); *ndërsa gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Besnik Shehu kanë qenë të pezulluar me vendim të KPK-së.*

Për muajin tetor 2025 kanë qenë në detyrë gjyqtarët: (11 gjyqtarë efektiv në punë + 1 gjyqtar të pezulluar me vendim KPK-je, si dhe 2 vakanca): Eglantina Mikani, Gentiana Shukullari, Luljeta Kole, Suzan Bushi, Eda Gjovari, Luljeta Kolonja, Elena Tafa, Klajdi Terova, Estjon Venxha, Eralinda Xhindi<sup>90</sup> dhe Gentjan Sallahu<sup>91</sup>, (vakancë pozicioni 2 gjyqtarë); *ndërsa gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë i pezulluar me vendim të KPK-së datë 26.07.2024.*

Referuar Raportimit tremujor të përcjellë me shkresën nr. 1759 prot., datë 18.07.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë “Dërgim format raportimi”, rezulton se me vendimin nr.297, datë 29.05.2025 të KLGJ-së, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele gjyqtari Ervin Kore është transferuar në Gjykatën e

<sup>90</sup> Emëruar me vendim të KLGJ-së nr. 762, datë 22.10.2025.

<sup>91</sup> Emëruar me vendim të KLGJ-së nr. 763, datë 22.10.2025.

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. Efektet juridike të këtij vendimi kanë filluar më datë 12.06.2025.

Referuar Raportimit tremujor të përcjellë me shkresën nr. 4898 prot., datë 20.10.2025 “Dërgim format raportimi”, rezulton se me vendimin nr.231, datë 23.04.2025 të KLGJ-së, është vendosur komandimi i znj. Valjona Haxhiraj si ndihmës magjistrate në Gjykatën e Lartë me afat komandimi 5 vjet duke filluar nga data 01.07.2025; Me vendimin nr. 419, datë 16.07.2025 të KLGJ-së është vendosur transferimi i gjyqtarit Ervin Sulaj në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës duke filluar nga data 01.09.2025. Me vendim nr.581 datë 09.09.2025 të KLGJ-së është komanduar gjyqtarja Dorinela Nikolli si ndihmës magjistrate në Gjykatën e Lartë me afat komandimi 5-vjeçar duke filluar nga data 01.10.2025.

➤ Në lidhje me rishortimet, nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, “Mbi shortin (rishortimet) nga data 01.01.2025-31.10.2025”, rezulton:

- Me urdhrin nr. 55, datë 25.06.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës janë rihedhur në short çështjet gjyqësore të gjyqtarit Ervin Kore, të cilat janë shpërndarë me short midis dy gjyqtarëve me më pak ngarkesë, konkretisht gjyqtarëve Ervin Sulaj dhe Elena Tafa;
- Me urdhrin nr.69, datë 10.07.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës janë rihedhur në short çështjet gjyqësore të gjyqtares Valjona Haxhiraj.
- Bazuar në urdhrin nr. 110 datë 27.10.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës janë rihedhur në short çështjet e gjyqtares Dorinela Nikolli;
- Bazuar në urdhrin nr. 112, datë 27.10.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës janë rihedhur në short çështjet e gjyqtarit Ervin Sulaj;
- Me urdhrin nr. 89, datë 11.09.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës është rihedhur në short çështja gjyqësore e gjyqtarit Ervin Sulaj (nr.21234-00361-41-2024), e cila i ka kaluar gjyqtarit Suzan Bushi;
- Me urdhrin nr. 99, datë 13.10.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës është rihedhur në short çështja gjyqësore me nr. 520005-01129-41-2025 e gjyqtares Dorinela Nikolli, e cila i ka kaluar gjyqtarit Estjon Venxha;
- Me urdhrin nr. 100, datë 13.10.2025 të zv/Kryetares së Gjykatës është rihedhur në short çështja gjyqësore me nr. 53817-02514-41-2023 e gjyqtares Dorinela Nikolli, e cila i ka kaluar gjyqtarit Estjon Venxha;
- Me urdhrin nr.101, datë 14.09.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës janë rihedhur në short çështja gjyqësore me karakter të ngutshëm të gjyqtarit Ervin Sulaj (p.sh: nr.520005-01929-41-2025), e cila i ka kaluar gjyqtarit Klajdi Tërova.
- Bazuar në urdhrin e brendshëm të Kryetarit të Gjykatës me nr. 37 prot., datë 23.04.2025, çështja nr. 71009-01125-41-2025, është rihedhur në short elektronik pasi gjyqtarja Valjona Haxhiraj me vendimin nr. 231, datë 23.04.2025 është komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrate”, në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, si dhe është përjashtuar nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore pranë kësaj gjykate.

Referuar informacionit dhe të dhënave në dokumentacionin e përcjellë nga gjykata, shpërndarja e çështjeve të rishortuara paraqitet si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		
Çështjet e rishortuara		
Nr.	Magjistrati	Shortuar
1	Eglantina Mikani	5
2	Dorinela Nikolli	23
3	Gentiana Shukullari	27
4	Elarinda Xhindi	162
5	Luljeta Kole	26
6	Suzan Bushi	33
7	Ervin Sulaj	106
8	Eda Diko	29
9	Luljeta Kolonja	15
10	Elena Tafa	109
11	Klajdi Terova	32
12	Estjon Venxha	30
13	Ervin Kore	7
14	Gentjan Sallahu	164
15	Valjona Haxhiraj	4
	<b>TOTALI</b>	<b>772</b>

**Konstatim:** Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore me të cilin operon kjo gjykatë, shfaq probleme për çështjet e rishortuara, pasi nuk arrihet të identifikohet historiku lidhur me gjyqtarin e mëparshëm duke i bashkëngjitur të gjitha të dhënat, gjyqtarit të cilit i kalon në rishortim çështja.

- Gjithashtu me shkresën nr. 2947 prot., datë 20.10.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, janë paraqitur *kërkesat për leje për vitin 2024-2025* dhe vendimet për miratimin e tyre për gjyqtarët e kësaj gjykate për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Nga të dhënat e dërguara rezulton se për periudhën objekt inspektimi janë paraqitur gjithsej 12 *kërkesa për leje vjetore* të cilat janë pranuar dhe janë si më poshtë:

- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 264 prot., datë 22.01.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtari Estjon Venxha ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, të cilat duhet të kryhen brenda muajit mars të vitit 2025, për periudhën 27.02.2025-03.03.2025 (3 ditë). Me vendimin nr. 5, datë 22.01.2025 “Për dhënie leje”, Zv/Kryetarja e prokurorisë Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtarit

Estjon Venxha për dhënien e 3 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datë 27.02.2025, datë 28.02.2025 dhe datë 03.03.2025.

- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 265 prot., datë 21.01.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtari Ervin Kore ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, (në raport me kohëzgjatjen në funksion”, për periudhën 24.02.2025-26.02.2025 (3 ditë). Me vendimin nr. 6, datë 22.01.2025 “Për dhënie leje”, Zv/Kryetarja e prokurorisë Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtarit Ervin Kore për dhënien e 3 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datat 24.02.2025, 25.02.2025 dhe 26.02.2025.
- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 360 prot., datë 28.01.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtari Klajdi Tërova ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, për periudhën 17-19.03.2025 (3 ditë) dhe periudhën 26-28.03.2025 (3 ditë). Me vendimin nr. 7, datë 22.01.2025 “Për dhënie leje”, Zv/Kryetarja e Gjykatës, ka miratuar kërkesën e gjyqtarit Klajdi Tërova për dhënien e 6 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datat 17-19.03.2025 dhe datat 26-28.03.2025.
- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 697 prot., datë 17.02.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtarja Eda Gjovani Diko ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, për periudhën 10.03.2025-13.03.2025 (4 ditë). Me vendimin nr. 9, datë 18.02.2025 “Për dhënie leje”, Zv/Kryetarja e Gjykatës Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtares Eda Gjovani Diko për dhënien e 4 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datat 10.03.2025-13.03.2025.
- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 827 prot., datë 24.02.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtarja Luljeta Kolonja ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, për periudhën 25.03.2025-26.03.2025 (4 ditë). Me vendimin nr. 11, datë 25.02.2025 “Për dhënie leje”, Zv/Kryetarja e Gjykatës Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtares Luljeta Kolonja për dhënien e 2 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datat 25.03.2025-26.03.2025.
- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 1300 prot., datë 25.03.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtari Estjon Venxha ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024, për periudhën 27.03.2025-28.03.2025 (2 ditë). Me vendimin nr. 19, datë 25.03.2025 “Për dhënie leje”, zv/Kryetarja e Gjykatës Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtarit Estjon Venxha për dhënien e 2 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, konkretisht në datat 27.03.2025 dhe 28.03.2025.

- Me kërkesën “Për marrje të pushimeve vjetore”, nr. 2563 prot., datë 09.06.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtari Klajdi Tërova ka kërkuar miratimin e datës 13.06.2025, (1 ditë) leje nga viti 2025. Me vendimin nr. 29, datë 10.06.2025 “Për dhënie leje”, zv. Kryetarja e prokurorisë Eglantina Mikani, ka miratuar kërkesën e gjyqtarit Klajdi Tërova për dhënien e 1 ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2025, konkretisht në datën 13.06.2025.2025.
- Me kërkesën datë 07.01.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtare znj. Gentiana Shukullari ka kërkuar marrjen e 3 (tre) ditëve pushim të mbetura pakryer për datat 13.01.2025, 14.01.2025 e 15.01.2025. Me vendimin nr. 1, datë 08.01.2025 “Për dhënie leje” të Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë znj. Eglantina Mikani ka vendosur pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. Gentiana Shukullari për dhënien e 3 (tre) ditëve leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, e konkretisht për data 13.01.2025, 14.01.2025 dhe 15.01.2025.
- Me kërkesën datë 09.05.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtare znj. Gentiana Shukullari ka kërkuar marrjen e 5 (pesë) ditëve pushim për periudhën 09-13.06.2025 për arsye familjare të paparashikuara nga leja vjetore e vitit 2025. Me vendimin nr. 21, datë 13.05.2025 “Për dhënie leje” të Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë znj. Eglantina Mikani është vendosur pranimi i kërkesës së gjyqtares znj. Gentiana Shukullari për dhënien e 5 (pesë) ditëve leje nga pushimet vjetore të pakryera për vitin 2025, e konkretisht për periudhën 09.06.2025 deri 13.06.2025.
- Me kërkesën datë 18.02.2025 “Për dhënie leje” drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtare znj. Dorinela Nikolli ka kërkuar miratimin e 4 ditëve leje nga pushimet vjetore të vitit 2024. Me vendimin nr. 10, datë 18.02.2025 “Për dhënie leje” të Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë znj. Eglantina Mikani është vendosur pranimi i kërkesës së gjyqtares znj. Dorinela Nikolli për dhënien e 4 (katër ditëve leje) nga pushimet vjetore për vitin 2024, e konkretisht për periudhën 17 mars - 20 mars katër ditë).
- Me kërkesën “Për dhënie leje” datë 20.03.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtar z. Suzan Bushi ka kërkuar miratimin e pushimeve vjetore për vitin 2024 për periudhën 25.03.2025 deri 29.03.2025 (gjithsej 4 ditë). Me Vendimin Nr. 18 datë 21.03.2025 “Për dhënie leje” të Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë znj. Eglantina Mikani është vendosur pranimi i kërkesës së gjyqtarit Suzan Bushi për dhënien e 4 (katër) ditëve leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, e konkretisht në datat 25.03.2025, 26.03.2025, 27.03.2025 dhe 28.03.2025.

- Me kërkesë “Për dhënie leje” datë 22.10.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, gjyqtare znj. Luljeta Kole ka kërkuar marrjen e 1 (një) dite leje e konkretisht në datë 24 tetor 2025. Me vendimin nr. 47, datë 23.10.2025 “Për dhënie leje” nr.4927 prot. datë 23.10.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është vendosur pranimi i kërkesës së gjyqtares znj. Luljeta Kole për dhënien e 1 (një) dite leje gjyqtare Luljeta Kole nga pushimet vjetore për vitin 2025 e konkretisht për datën 24.10.2025.
- Me shkresën nr. 2927/2 prot., datë 20.11.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është përcjellë informacioni mbi listat e gatishmërisë për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, të urdhëruara nga Zv/Kryetarja e gjykatës me Urdhrin nr. 223 prot., datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm për gjykimin e kërkesave penale dhe civile” dhe Urdhrin nr. 224 prot., datë 24.12.2024<sup>92</sup> “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve.

1- Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 223 prot., datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, është miratuar lista e gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake, si dhe lëshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025, urdhër i cili në vijim rezulton të jetë ndryshuar pesë herë me urdhër të Zv/Kryetares së gjykatës, për rrethana të ndryshme që pasqyrohen në urdhrat përkatës të tilla si regjistrimi/çregjistrimi në sistemin elektronik të shortit të gjyqtarëve të transferuar nga gjykata Korçë në gjykata të tjera apo të caktuar pranë kësaj gjykate.

**Në formë tabelare lista e gatishmërisë së gjyqtarëve të gatshëm, miratuar me Urdhrin nr. 223, dhe Urdhrin nr. 224, datë 24.12.2024 paraqitet si më poshtë:**

Periudha 01.01.2025-31.10.2025											
	Gjyqtari	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
1	Suzan Bushi	30/-05		17-23			02-08			15-21	
2	Eda Diko	06 -12		24-30			09-15			22-28	
3	Valjona Haxhiraj	13-19		31-06			16-22				

<sup>92</sup> Për muajin gusht do të disponohet me urdhër të posaçëm për shkak të marrjes së lejes vjetore nga trupa.

4	Luljeta Kole	20-26			07-13		23-29			06-12
5	Luljeta Kolonja	27-02			14-20		30-06/07			13-19
6	Ervin Kore		03-09		21-27			07-13		20-26
7	Eglantina Mikani		10-16		28-04			14-20		27-02/11
8	Dorinela Nikolli		17-23			05-11		21-27		
9	Gentiana Shukullari		24-02			12-18		28-03/08		
10	Klajdi Terova			03-09		19-25				01-07
11	Estjon Venxha			10-16		26-01/06				08-14

**1.1** Me urdhrin nr. 44, datë 21.05.2025, të protokolluar me nr. 2241 prot., datë 21.05.2025<sup>[93]</sup> “Për një ndryshim në urdhrin e datës 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile”, është urdhëruar ndryshimi i listës së gatishmërisë së gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake si dhe ndryshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025.

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri shkaku që ka sjellë ndryshimin e urdhrin të mëparshëm me datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm”, ka qenë: **1.** urdhri nr. 37, datë 23.04.2025 me të cilin është çregjistruar nga sistemi elektronik i shortit gjyqtarja Vajlona Haxhiraj; **2.** urdhri nr. 42, datë 20.05.2025, me të cilin është riaktivizuar në sistemin elektronik të shortit gjyqtari Ervin Sulaj dhe **3.** urdhri nr. 43, datë 20.05.2025 me të cilin është riaktivizuar në sistemin elektronik të shortit gjyqtarja Elena Tafa, duke sjellë edhe një ndryshim të trupës gjyqësore.

**1.2** Me urdhrin nr. 52, datë 16.06.2025, të protokolluar me nr. 2658 prot., datë 16.06.2025<sup>[94]</sup> “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, (i ndryshuar më datë 21.05.2025)”, rezulton se është urdhëruar ndryshimi i listës së gatishmërisë së gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake si dhe ndryshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025.

<sup>93</sup> Për muajin gusht do të disponohet me urdhër të posaçëm për shkak të marrjes së lejes vjetore nga trupa.

<sup>94</sup> Për muajin gusht do të disponohet me urdhër të posaçëm për shkak të marrjes së lejes vjetore nga trupa.

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri shkaku që ka sjellë ndryshimin e urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm”, i ndryshuar, ka qenë urdhri nr. 48, datë 30.05.2025 me të cilin është çregjistruar nga sistemi elektronik i shortit gjyqtari Ervin Kore duke sjellë edhe një ndryshim të trupës gjyqësore.

**1.3** Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 86, datë 08.09.2025, të protokolluar me nr.3987 prot., datë 08.09.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, (i ndryshuar)” është urdhëruar ndryshimi i listës së gatishmërisë së gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake, si dhe ndryshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025.

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri shkaku që ka sjellë ndryshimin e urdhrin me datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm”, i ndryshuar, ka qenë urdhri nr. 72, datë 17.07.2025 me anë të të cilit është çregjistruar nga sistemi elektronik i shortit gjyqtari Ervin Sulaj, duke sjellë një ndryshim në trupën gjyqësore.

**1.4** Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 90, datë 11.09. 2025, të protokolluar me nr.4045 prot., datë 11.09.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, (i ndryshuar)”, është urdhëruar ndryshimi i listës së gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake si dhe ndryshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025.

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri, shkaku që ka sjellë ndryshimin e urdhrin me datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm”, i ndryshuar, ka qenë urdhri nr. 88, datë 09.09.2025 me anë të të cilit është çregjistruar nga sistemi elektronik i shortit gjyqtari Dorinela Nikolli, duke sjellë një ndryshim në trupën gjyqësore.

**1.5** Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 111, datë 27.09. 2025, të protokolluar me nr. 4997 prot., datë 27.10.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm, për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, (i ndryshuar)”, është urdhëruar ndryshimi i listës së gatishmërisë së gjyqtarëve është urdhëruar ndryshimi i listës së gjyqtarëve të cilët do të gjykojnë kërkesat penale dhe civile urgjente (të fazës së hetimeve paraprake si dhe ndryshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes) për vitin 2025 me përcaktimin si vijon:

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri, shkaku që ka sjellë ndryshimin e urdhrin me datë 24.12.2024 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm” i ndryshuar, ka qenë: **1.** urdhri nr.107, datë 24.10.2025 me anë të të cilit është aktivizuar në sistemin elektronik të shortit gjyqtari Gentian Sallahu dhe **2.** urdhri nr. 108, datë 24.10.2025 me të cilin është aktivizuar në sistemin elektronik të shortit, gjyqtari Elarinda Xhindi, duke sjellë ndryshim në trupën gjyqësore.

2. Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës protokolluar me nr.224 prot. datë 24.12.2024<sup>95</sup> “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudhën 01.01.2025-31-12-2025”, janë caktuar gjyqtarët e seksionit penal për gjykimin e të miturve<sup>96</sup>, për shqyrtimin e kërkesave me objekt vleftësim arresti e ndalimi, si dhe çdo kërkesë tjetër urgjente që u përket personave të dyshuar që janë të mitur apo me viktimë shtetas të mitur.

2.1 Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 119, datë 10.11.2025, protokolluar me nr. 5342 prot., datë 10.11.2025 “Për një ndryshim në urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudhën 01.01.2025-31-12.2025)”, është urdhëruar ndryshimi i urdhrin datë 24.12.2024 “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për shqyrtimin e kërkesave me objekti vleftësim arresti dhe ndalimi, si dhe çdo kërkesë tjetër urgjente që u përket personave të dyshuar që janë të mitur apo me viktimë shtetas të mitur.

Sipas përmbajtjes së këtij urdhri, shkak që ka sjellë ndryshimin e urdhrin me datë 24.12.2024 “Mbi gatishmërinë e gjyqtarëve të seksionit penal për gjykimin e të miturve, për periudhën 01.01.2025-31-12.2025)”, ka qenë zëvendësimi i gjyqtares Luljeta Kolonja me gjyqtaren Elena Tafa.

Lista e gatishmërisë me ndryshimet sipas urdhrave përkatës të Zv/Kryetares së gjykatës paraqitet si më poshtë:

Nr	Gjyqtari	Urdhër . Nr. 224, datë 24.12.2024				Urdhër Nr. 44, datë 21.05.2025, për ndryshimin e urdhrave Nr. 37, datë 23.04.2025, Nr. 42 dhe Nr. 43 datë 20.05.2025	Urdhër Nr. 52, datë 16.06.2025, për ndryshimin e urdhrin Nr. 48, datë 30.05.2025	Urdhër Nr. 86 datë 08.09.2025, për ndryshimin e urdhrin Nr. 72, datë 17.07.2025	Urdhër Nr. 66 datë 07.07.2025, për planifikimin e lejeve vjetore gjatë muajit Gusht	Urdhër Nr. 90 datë 11.09.2025, për ndryshimin e urdhrin Nr. 88, datë 09.09.2025	Urdhër Nr. 107, 108, datë 24.10.2025 për ndryshimin e urdhrin Nr. 111, datë 27.09.2025
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
1	Klajdi Tërova		1-28			19-25,1-31			29-31	8-14, 1-7, 1-30	
2	Estjon Venxha			1-31		26-1.06	1-30		26-28	15-21, 8-14, 17-23	1-31
3	Suzan Bushi						2-08		15-22	22-28, 15- 21, 24-30	

<sup>95</sup> Për muajin gusht do të disponohet me urdhër të posaçëm për shkak të marrjes së lejes vjetore nga trupa.

<sup>96</sup> Me urdhrin nr. 23, datë 16.09.2024 të Këshillit të Gjykatës, gjyqtarë për çështjet me të mitur janë caktuar gjyqtarët Luljeta Kolonja, Klajdi Tërova dhe Estjon Venxha. (Nxjerrë nga Raporti i analizës vjetore për vitin 2024 të Gjykatës Korçë, fq. 10).

4	Eda Diko					9-15			29-05.10, 22-28	
5	Luljeta Kole					16-22,			29-05.10	06-12
6	Luljeta Kolonja	1-31			1-30	23-29	1-31	4-6		13-19, 06-12
7	Ervin Kore					30-06.07		23-25		20-26
8	Eglantina Mikani					30-06.07	7-13			27-2.11, 13-19
9	Dorinela Nikolli						14-20, 7-13			20-26
10	Ervin Sulaj						21-27, 14-20			27-02.11
11	Gentiana Shukullari						28-03.08, 21-27	07-14		27-02.11, 20-26
12	Elena Tafa						28-03.08		1-7	27-02.11
13	Elarinda Xhindi									

3. Me urdhrin e Zv/Kryetares së gjykatës nr. 66, datë 07.07.2025, protokolluar me nr.3098 prot., datë 07.07.2025 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm për gjykimin e kërkesave penale dhe civile, **për periudhën e lejeve vjetore gjatë muajit gusht (04.08.2025-31.08.2025)** janë si vijon:

- Luljeta Kolonja; nga data 04.08.2025-06.08.2025
- Gentiana Shukullari; nga data 07.08.2025-14.08.2025
- Suzan Bushi; nga data 15.08.2025-22.08.2025
- Ervin Sulaj; nga data 23.08.2025-25.08.2025
- Estjon Venxha; nga data 26.08.2025-28.08.2025
- Klajdi Tërova; nga data 29.08.2025-31.08.2025.

Referuar dokumentacionit dhe informacionit të dërguar nga gjykata, si dhe të dhënave të nxjerra nga sistemi i menaxhimit të çështjeve, konstatohet se në periudhën e gatishmërisë gjyqtarët përveç planifikimit dhe zhvillimit të seancave për gjykimin e kërkesave penale dhe civile të karakterit urgjent, të fazës së hetimeve paraprake, si dhe ato lidhur me lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, planifikojnë dhe zhvillojnë seanca edhe për çështjet e tjera të karakterit jo urgjent.

Më poshtë po përmendim disa raste

**Gjyqtari Klajdi Terova ka qenë i gatshëm për periudhën 03.03.2025-09.03.2025.**

Për këtë periudhë gatishmërie gjyqtar z. Klajdi Terova rezulton se:

**Në datë 03.03.2025 ka planifikuar 9 seanca gjyqësore konkretisht:**

- Çështja me nr. 71013-00244-41-2025, kërkesë e prokurorit për pushim e çështjes penale,
- Çështja civile nr. 21001-01506-41-2024, me palë paditës, Ndriçim Tollumi, e paditur, Juliana Tollumi, me objekt zgjidhje martesë,
- Çështja penale nr. 50506-02658-41-2025, me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur, Stefani Karafili, me objekt dhuna në familje.

- Çështja civile nr. 21001-01566-41-2024, me palë paditës, Blerina Filla, e paditur, Roland Filla, me objekt zgjidhje martesë,
- Çështja penale nr. 53503-02705-41-2024, me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur, Eri Syza, akuzuar për veprën penale, kontrabandë me mallra të licencuara.
- Çështja civile nr. 21327-01177-41-2024, me palë paditës, Bashkia Korçë, i paditur, Veli Xihani, me objekt: kërkim sendi civil,
- çështja penale nr. 53101-00369-41-2025, me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur, Ramazan Bufi, akuzuar për veprën penale, vjedhje.
- Çështja civile nr. 21001-01646-41-2024, me palë paditës, Rudhata Sadikllari, i paditur, Hysen Sadikllari, me objekt zgjidhje martesë,
- Çështja civile nr. 21001-01662-41-2024, me palë paditës, Valbona Kapllani, i paditur, Gabriele Kapllani, me objekt zgjidhje Martesë.

**Më datë 04.03.2025 ka planifikuar 8 seanca gjyqësore, konkretisht:**

- Çështja penale nr. 72037-00619-41-2025, me kërkues Prokuroria Korçë, me objekt kërkesë për zëvendësim ose bashkim të masave të sigurimit personal,
- Çështja civile nr. 90502-01521-41-2024 me kërkues Gjylbere Morava dhe me objekt: Vërtetim qenie dhe në marrëdhënie pune,
- Çështja penale nr. 61000-00694-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë, me objekt kërkesë për vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi
- Çështja penale nr. 60005-00658-41-2025 me kërkues Shpëtim Cuka, me objekt kërkesë për zëvendësim mase sigurimi,
- Çështja penale nr. 520005-02740-41-2024 me kërkues Prokuroria Korçë i pandehur Leonard Bezolli me objekt: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq
- Çështja civile nr. 21001-01402-41-2024, me palë paditës, Valbona Laki, i paditur, Arjan Lako, me objekt zgjidhje martesë,
- Çështja civile nr. 21001-01420-41-2024, me palë paditës, Aleksander Rexho, i paditur, Stela Rexho, me objekt zgjidhje Martesë,
- Çështja penale nr. 71003-00379-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë, me objekt: Kërkesë për bashkimin e dënimeve,

**Gjyqtari Estjon Venxha ka qenë i gatshëm për periudhën 26.05.2025-01.06.2025**

Për këtë periudhë gatishmërie gjyqtar z. Estjon Venxha rezulton se:

**Më datë 26.05.2025 ka planifikuar 6 seanca gjyqësore konkretisht:**

- Çështja penale nr.520005-02261-41-2024 me kërkues Prokuroria Korçë i pandehur Eles Drizaj me objekt: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.
- Çështja civile nr. 21246-01317-41-2024, me paditës: Vladimir Merruka, i paditur: Ministria e Mbrojtjes Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike, Bashkia Pogradec me objekt njohje pronar
- Çështja penale nr. 71013-00713-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë me objekt pushimin e çështjes penale
- Çështja penale nr. 50506-02500-41-2024 me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur Gerta Nici (Konomi) akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”

- Çështja civile nr. 90904-00744-41-2024 me kërkues Simon Hodo me objekt Vërtetim fakti juridik
- Çështja penale nr. 58344-00869-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur Enea Rrushan akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

**Më datë 27.05.2025 ka planifikuar zhvillimin e 4 seancave gjyqësore konkretisht:**

- Çështja civile nr. 10940-00578-41-2021 me palë paditës Trajanka Kota Brikena Kota etj., i paditur Këshilli i Ministrave, Bashkia Korçë padi pronësie,
- Çështja penale nr. 52610-00691-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur Nesti Xhobro akuzuar për veprën penale “Vepra të turpshme”,
- Çështja penale nr. 50506-00673-41-2025 me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur Artan Afesllari akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”,
- Çështja penale nr. 58319-02028-41-2024 me kërkues Prokuroria Korçë, i pandehur Xhimi Hoxha akuzuar për veprën penale “Trafikim i armëve dhe municionit”.

➤ **Raportimet tremujore** të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Nga Raportimet tremujore drejtuar KLGJ-së, lidhur me përdorimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është raportuar se: *“Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka në funksion sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore të njohur si ICMIS që prej vitit 2007, i cili përdoret për regjistrimin e çështjeve gjyqësore, hedhjen e çështjeve në çdo rast në short elektronik, mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, hedhjen e vendimeve dhe publikimin e vendimeve të anonimizuar në portal. Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ka funksionuar normalisht, dhe në rastet e reklamuar për probleme teknike të dala rishtazi është bërë raportimi në detyrat për suportin teknik online të raportimit Ticketing Service Desk, për të cilat është bërë zgjidhja teknike”.*

Po në këto raportime, lidhur me nivelin e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio nga secili gjyqtar, është raportuar se: *“Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë zhvillon gjykimet vetëm në sallat e gjykimit dhe me sistemin e regjistrimit audio, përjashtim bëjnë vetëm gjykimet që zhvillohen në dhomë këshillimi për shkak të parashikimeve ligjore. Nuk ka asnjë gjykim të zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve apo në mënyrë tjetër të regjistrimit të procesverbalit veç regjistrimit audio. Të gjitha seancat e shënuara në informacion si seanca të paregjistruara (SP) janë seanca të zhvilluara në dhomë këshillimi për shkak të parashikimeve ligjore. Në gjykatë të gjitha seancat mbahen me regjistrim audio, por për shkak se sistemi ICMIS nuk është përshtatur me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Civile dhe Penale, përqindja nuk shfaqet në 100%”.*

Referuar raportimeve 3-mujore bazuar në vendimin e KLGJ -së, nr. 25, datë 07.02.2019, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë raporton se nuk është konstatuar asnjë problem në lidhje me disiplinën në punë, si nga ana e gjyqtarëve ashtu dhe nga ana e administratës gjyqësore. Trupa gjyqësore ka respektuar normat e etikës në

gjykim, ato procedurale si dhe solemnitetin e gjykimit si përsa i përket veshjes ashtu dhe mënyrës së drejtimit të seancës. Kjo pasi, nuk rezulton asnjë ankesë apo pretendim i këtij karakteri.

Lidhur me disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, raportimi mbështetet edhe me listëprezencat ditore të formës elektronike.

Përsa i përket orarit të zhvillimit të seancave gjyqësore referuar raportimeve 3-mujore të gjykatës *rezulton se ato kanë filluar në orarin e caktuar* me përjashtim të rasteve të fillimit me vonesë mbi 15 minuta për shkaqe objektive si zgjatja e gjykimeve tej afatit të planifikimit nga gjyqtari, vonesat e avokatëve apo prokurorëve për shkak të qenies në procese të tjera gjyqësore. Vlen të theksohet se asnjë gjykim nuk është filluar me vonesë për shkak të vonesave të gjyqtarëve pa arsye.

- Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykatë (ICMIS)

1. *Lidhur me seancat e planifikuara dhe seancat e zhvilluara me regjistrim audio.*

Nga krahasimi i të dhënave në raportet për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio (RDA) nga secili gjyqtar për periudhën e inspektimit, me të dhënat statistikore të përpunuara nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, **konstatohet se numri i seancave të planifikuara, krahasuar me raportimin për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, në disa raste rezultojn më i vogël dhe në disa raste më i madh**, p. sh., gjyqtari Suzan Bushi rezultojn të ketë planifikuar në total për periudhën e inspektimit 01.01.2025-31.10.2025 gjithsej 1110 seanca, ndërkohë totali i seancave sipas raportit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio figurojnë në numër më i vogël, 1068 seanca.

2. *Lidhur me orarin e fillimit të seancës sipas kalendarit të planifikimit të seancave dhe orarin e fillimit të seancës referuar proces-verbalit të seancës së gjeneruar nga sistemi.*

Nga krahasimi i të dhënave të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në raportimet tremujore drejtuar KLGJ, me të dhënat e përpunuara nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë **konstatohen mospërputhje midis orarit të fillimit të seancës të përcaktuar në kalendarin e planifikimit të seancave, me orarin e fillimit të seancës referuar proces-verbalit të gjeneruar nga sistemi**. P. sh: Lidhur me kërkesën penale të shtetasit Ardian Papajanis, regjistruar me numër çështje 80001-00497-41-2025, datë regj.12.02.2025 me objekt "Përfitim ulje dënimi" në gjykim nga gjyqtari Suzan Bushi konstatohet se: referuar kalendarit të seancave të planifikuara në datë 05.06.2025, orari i planifikuar për fillimin e kësaj seance është ora 09.30, ndërsa referuar procesverbalit të seancës së kësaj date gjeneruar nga sistemi, ora e fillimit të kësaj seance është ora 09.15, pra 15 minuta më parë. Në përmbajtje të

procesverbalit të seancës, nga ana e gjyqtarit nuk relatohet ndonjë arsye për ndryshimin e orës së fillimit të seancës.

Lidhur me çështjen penale nr.71013-00442-41-2025 datë regj.06.02.2025 në gjykim po nga gjyqtari Suzan Bushi konstatohet se, referuar kalendarit të seancave të planifikuara nga ky gjyqtar në datë 05.06.2025, orari i planifikuar për fillimin e kësaj seance është ora 14.00, ndërsa referuar procesverbalit të seancës të po kësaj date të gjeneruar nga sistemi, orë fillimi seance figuron 15:07. Në përmbajtje të procesverbalit nuk relatohet ndonjë arsye për vonesën në fillimin e seancës nga ana e gjyqtarit.

Nga kalendarit i seancave të planifikuara konstatohet se nuk ka seanca të planifikuara për gjyqtarët Elarinda Xhindi dhe Gentian Sallahu, të cilët për periudhën objekt inspektimi figurojnë në organikën e gjykatës Korçë vetëm në muajin tetor<sup>[97]</sup> pasi janë gjyqtarë të rinj të emëruar në datën 22 tetor 2025, si dhe për gjyqtarët Thomaidha Roça dhe Sonjela Voskopi<sup>[98]</sup> të cilat janë transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

- **Fakte të konstatuara në lidhje me mos/përputhjen e të dhënave** të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara me të dhënat në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore:

**Rast me leje lindje**, gjyqtare Elena Tafa figuron me leje lindje nga 20.05.2024 - Maj i vitit 2025.

**Çështja me nr. 21001-01292-41-2024, datë Regj., 27.09.2024**

- Referuar kalendarit të planifikimit të seancave të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezulton se kjo çështje figuron e planifikuar nga gjyqtarja Elena Tafa, respektivisht për periudhën objekt inspektimi në datat 21.01.2025; 27.02.2025; 08.04.2025; 20.05.2025; 20.06.2025; 08.09.2025; 07.10.2025 (gjithsej 7 seanca),  
Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga printimi i procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi rezulton se, 5 seanca gjyqësore rezultojnë të zhvilluara nga magjistrati Ervin Kore dhe 2 seancat e fundit nga magjistratja Elena Tafa. Gjithashtu në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore kjo çështje është regjistruar në emër të gjyqtares Elena Tafa edhe pse ajo ka zhvilluar vetëm 2 seanca nga 7 të zhvilluara në total për periudhën objekt inspektimi.

- **Çështja civile themeli nr. 21001-01539-41-2024, datë regj., 26.11.2024,**

<sup>97</sup> Me vendimin nr. 762, datë 22.10.2025 KLGJ ka vendosur emërimin e znj. Elarinda Xhindi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

Me vendimin nr. 763, datë 22.10.2025 KLGJ ka vendosur emërimin e z. Gentian Sallahu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

<sup>98</sup> Me vendimin nr. 526, datë 11.10.2023 KLGJ ka vendosur transferimin e znj. Thomaidha Roca në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin të KLGJ-së nr. 478, datë 31.07.2024, është vendosur transferimi i përkohshëm i gjyqtares Sonjela Voskopi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Referuar kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, rezulton se kjo çështje figuron e planifikuar nga gjyqtarja Elena Tafa, për periudhën objekt inspektimi në datat : 04.02.2025; 11.03.2025; 15.04.2025; 28.05.2025; 22.07.2025; 08.09.2025; 22.09.2025; (gjithsej planifikuar 7 seanca).

Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga printimi i procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi rezulton se 4 seanca janë zhvilluar nga magjistrati Ervin Kore dhe 3 seancat e fundit nga magjistratja Elena Tafa. Gjithashtu në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore kjo çështje është regjistruar në emër të gjyqtares Elena Tafa edhe pse ajo ka zhvilluar vetëm 3 seancat e fundit nga 7 të zhvilluara në total për periudhën objekt inspektimi.

- **Çështja nr. 520005-02567-41-2024, datë Regj., 10.12.2024,**

Referuar kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, rezulton se kjo çështje është e planifikuar nga gjyqtarja Elena Tafa, respektivisht për periudhën objekt inspektimi në datat 23.01.2025; 06.03.2025; 07.05.2025; 10.06.2025; 08.09.2025; 01.10.2025; 21.10.2025 (gjithsej planifikuar 7 seanca), ndërkohë nga procesverbalet e printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se 4 seancat e para rezultojnë të zhvilluara nga magjistrati Ervin Kore dhe 3 seancat e fundit të zhvilluara nga magjistratja Elena Tafa. Gjithashtu në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore kjo çështje është regjistruar në emër të gjyqtares Elena Tafa edhe pse ajo ka zhvilluar vetëm 3 seancat e fundit nga 7 të zhvilluara për periudhën objekt inspektimi.

➤ **Rastet e transferimit të gjyqtarëve**

- **Kërkesa penale nr. 520005-00323-41-2024, datë regj., 13.02.2024 me kërkues:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë *me të pandehur:* Abdullah Haiduei dhe *me objekt:* Dërgimin e çështjes në gjyq. Rezulton se kjo çështje ka qenë në gjykim nga gjyqtare Valjona Haxhiraj. Bazuar në urdhrin nr. 69, datë 10.07.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Eglantina Mikani “Mbi hedhjen në short të çështjeve të gjyqtares Valjona Haxhiraj” kjo çështje është rishortuar dhe i është caktuar gjyqtarit Klajdi Terova në datë 10.07.2025. Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga printimi i procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi rezulton se, gjyqtarja Valjona Haxhiraj ka zhvilluar përgjatë periudhës objekt inspektimi 6 seanca gjyqësore (të cilat nuk figurojnë në kalendarin e planifikimit të seancave të përcjellë nga gjykata për këtë gjyqtare, respektivisht seancat e datave 14.01.2025; 13.02.2025; 13.03.2025; 03.04.2025; 23.04.2025; 23.05.2025). Ndërkohë që gjyqtari Klajdi Terova ka zhvilluar vetëm 1 seancë lidhur me këtë çështje, konkretisht seancën e datës 08.10.2025. Nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, kjo çështje i figuron gjyqtarit të fundit Klajdi Terova, në Total 7 seanca si të planifikuara prej tij.
- **Kërkesa penale nr. 70110-00747-41-2025 datë regj., 10.03.2025 me kërkues:** Ilir Mele *me objekt:* Zëvendësim mase mjekësore. Rezulton se kjo çështje ka qenë në gjykim nga gjyqtar Ervin Kore. Bazuar në urdhrin nr. 55, datë 25.06.2025 “Mbi

hedhjen në short të çështjeve të gjyqtarit Ervin Kore” kjo çështje është rishortuar dhe shpërndarë tek gjyqtari Ervin Sulaj në datë 25.06.2025. Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga procesverbalet e gjeneruara nga sistemi rezulton se, gjyqtari Ervin Kore ka zhvilluar 1 seancë, (seancën e datës 20.05.2025) ndërkohë që gjyqtari Ervin Sulaj në lidhje me këtë çështje ka zhvilluar 3 seanca (në datë 23.07.2025; 22.09.2025 dhe 13.10.2025). Referuar kalendarit të planifikimit të seancave të përcjellë nga vetë gjykata, totali i seancave gjyqësore të zhvilluara për këtë çështje, gjithsej 4 seanca figurojnë si të planifikuara nga gjyqtari i fundit, Ervin Sulaj.

- **Kërkesa penale nr. 70110-02092-41-2024 datë regj., 16.10.2024 me kërkues:** Bledi Demollari me objekt: Rivlerësim mase mjekësore. Rezulton se kjo çështje ka qenë në gjykim nga gjyqtari Ervin Kore. Bazuar në urdhrin nr. 55 datë 25.06.2025 “Mbi hedhjen në short të çështjeve të gjyqtarit Ervin Kore” kjo çështje është rishortuar dhe caktuar gjyqtare Elena Tafa në datë 25.06.2025. Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga printimi i procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi rezulton se, gjyqtari Ervin Kore ka zhvilluar 3 seanca përgjatë periudhës objekt inspektimi (të cilat nuk figurojnë në kalendarin e planifikimit të seancave përcjellë nga gjykata për këtë gjyqtar, respektivisht seancat e datave 18.02.2025, 18.03.2025, 20.05.2025) ndërkohë që gjyqtare Elena Tafa ka zhvilluar 4 seanca në lidhje me këtë çështje. Ndërkohë referuar kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, totali i seancave gjyqësore të zhvilluara për këtë çështje përgjatë periudhës së inspektimit, gjithsej 7 seanca figurojnë të planifikuara nga ana e gjyqtarit të fundit, konkretisht gjyqtare Elena Tafa.

➤ **Raste të seancave të planifikuara në ditët e lejes vjetore të miratuar**

Nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë rezulton se **gjyqtarit Suzan Bushi** i është miratuar leja vjetore e pakryer për periudhën 25- 28.03.2025, pra për 4 (katër) ditë. Kërkesa e gjyqtarit me datë 20.03.2025, drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Eglantina Milkani është protokolluar me nr. 1275 prot., datë 20.03.2025. Nga ana e gjyqtarit është kërkuar kryerja e pushimeve vjetore për periudhën 25.03.2025 deri në 29.03.2025.

Nga kalendarin e planifikimit të seancave gjyqësore të përcjellë nga gjykata rezulton se **gjyqtari Suzan Bushi** ka planifikuar në muajin mars përkatësisht në datën 26.03.2025, 9 (nëntë) seanca gjyqësore dhe në datën 28.03.2025, 8 (tetë) seanca gjyqësore.

Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës, për seanca të planifikuara në datën 26.03.2025 rezulton se:

- Për çështjen nr. 58344-00516-41-2025, datë Regj., 13.02.2025 (penale themeli) me palë prokuroria Korçë, i pandehur A. G., etj., të akuzuar për nenin 290.2 të K. Penal, e cila figuron në emër të gjyqtarit Suzan Bushi, referuar procesverbaleve të printuara

nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datën 26.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.

- Për çështjen nr. 80003-00511-41-2025, datë regj., 13.02.2025 kërkesë penale me kërkuar V. D. me objekt "Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë së burgut", e cila figuron në emër të gjyqtarit Suzan Bushi, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datë 26.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.

Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës, për seanca të planifikuara në datën 28.03.2025 rezulton:

- Për çështjen nr. 71009-02695-41-2024 datë regj.23.12.2024 e cila figuron në emër të gjyqtarit Suzan Bushi, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datë 28.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.

**Gjyqtarës Eva Diko** i janë miratuar 4 (katër) ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2024, për periudhën 10.03.2025-13.03.2025. Kërkesa e gjyqtarit me datë 17.02.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Eglantina Milkani, është protokolluar me nr. 697 prot., datë 17.02.2025. Nga ana e gjyqtarit kërkohet kryerja e pushimeve vjetore për periudhën 10.03.2025-13.03.2025.

Nga kalendari i planifikimit të seancave rezulton se kjo gjyqtare ka planifikuar 3 seanca më datë 10.03.2025, 3 seanca më datë 11.03.2025, 4 seanca më datë 12.03.2025 dhe 4 seanca më datë 13.03.2025.

Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës, për seanca të planifikuara në datën 10.03.2025 rezulton:

- Për çështjen nr. 87001-02120-41-2024, (kërkesë penale), me palë Orest Xarxallo, i dënuar, me objekt, përfitim nga amnistia, e cila figuron në emër të gjyqtarës Eva Dika, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datë 10.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.
- Për çështjen nr. 87001-02117-41-2024, (kërkesë penale), me palë Orest Xarxallo, i dënuar, me objekt, përfitim nga amnistia, e cila figuron në emër të gjyqtarës Eva Dika, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datë 10.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.
- Për çështjen nr. 21013-01555-41-2024, (kërkesë civile), me palë Gëzim Doko, kërkuar, me objekt, heqje e zotësisë juridike për të vepruar, neni 307-313 i K. Familjes, e cila figuron në emër të gjyqtarës Eva Dika, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që në datë 10.03.2025 të mos jetë zhvilluar *seancë gjyqësore*.

Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës, për seanca të planifikuara në datën 11.03.2025 rezulton se:

- Për çështjen me nr. 71013-02206-41-2024, (kërkesë penale), me palë Prokuroria Korçë, kërkuës, Liljana Pleqi, i akuzuar, me objekt, pushimi i çështjes penale nr.718, viti 2018, neni 329/A i K. Pr. Penale, e cila figuron në emër të gjyqtares Eva Dika, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton që *në datë 11.03.2025 të mos jetë zhvilluar seancë gjyqësore.*
- Për çështjen me nr. 21001-01589-41-2024, (civile themeli), me palë Mimoza Çela, paditës, Gëzim Çela, i paditur, me objekt, zgjidhje martese, neni 132 i K. Familjes, e cila figuron në emër të gjyqtares Eva Dika, referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që *në datën 11.03.2025 të mos jetë zhvilluar seancë gjyqësore.*

**Gjyqtarit Ervin Kore** i është miratuar leja vjetore e pakryer nga data 24-26 shkurt 2025. Kërkesa e gjyqtarit me datë 21.01.2025, i është drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Eglantina Milkani dhe është protokolluar me nr. 265, datë 22.01.2025. Në kërkesë, nga ana e gjyqtarit kërkohet miratimi i pushimeve vjetore të pjeshme për vitin 2024 (në raport me kohëzgjatjen në funksion) për periudhën 24, 25 dhe 26 shkurt 2025, duke qenë se këto pushime duhet të kryhen brenda muajit shkurt të vitit 2025.

Nga kalendari i planifikimit të seancave gjyqësore të përcjellë nga Gjykata rezulton se gjyqtari Ervin Kore ka planifikuar në datën 25.02.2025, seancë gjyqësore për çështjen me nr. 71013-02630-41-2024, regj. më datë 20.12.2024, me kërkuës prokuroria Korçë, me objekt pushimin e çështjes penale nr. 803 viti 2024.

Referuar procesverbalit me datë 25.02.2025 të printuar nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton që kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari është me leje vjetore.

**Gjyqtares Gentiana Shukullari** i janë miratuar 3 (tre) ditë leje nga pushimet vjetore për vitin 2025, konkretisht në datat 13.01.2025, 14.01.2025 dhe datë 15.01.2025. Kërkesa e gjyqtarit me datë 07.01.2025 drejtuar Zv/Kryetares së Gjykatës znj. Eglantina Milkani është protokolluar me nr. 47 prot., datë 07.01.2025. Në kërkesë, nga ana e gjyqtarit parashtrohet se për arsye familjare të paparashikuara nga ditët e periudhës së gatishmërisë të realizuara në muajin gusht 2024, kërkon marrjen e tre ditëve pushim të mbetura pa kryer për datat 13.01.2025, 14.01.2025, 15.01.2025.

Referuar kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore të përcjellë nga Gjykata për këtë gjyqtare rezulton se, gjatë kësaj periudhe për çështjen nr. 80003-00213-41-2024, Regj., më datë 30.01.2024, me kërkuës L. A., dhe objekt ndryshimi i llojit të sigurisë së burgut ka planifikuar seancë gjyqësore në datën 13.01.2025, ndërkohë që referuar procesverbalit me datë 13.01.2025 të printuar nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton se kjo seancë nuk është zhvilluar.

### **3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi**

**3.1 Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar.**

Nga përpunimi i dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me shkresën nr. 4918/1 prot., datë 11.11.2025 për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025 konstatohet se, nga viti 2024 janë mbartur 2013 çështje dhe janë regjistruar 3826 çështje të shpërndara sipas tabelës si më poshtë për secilin gjyqtar:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			
Nr.	Gjyqtari	Nr. i çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme <sup>[99]</sup>	Nr. i çështjeve të regjistruara të reja 01.01.2025-20.10.2025 <sup>[100]</sup>
1	Artan Jahollari <sup>[101]</sup>	4	0
2	Elena Tafa	30	244
3	Ervis Sulaj <sup>[102]</sup>	55	145
4	Ervin Kore <sup>[103]</sup>	80	89
5	Eglantina Mikani	257	281
6	Estjon Venxha	124	392
7	Eda Diko	171	421
8	Dorinela Nikolli <sup>[104]</sup>	124	289
9	Klajdi Terova	104	378
10	Luljeta Kole	215	388
11	Luljeta Kolonja	321	367
12	Gentiana Shukullari	203	418

<sup>99</sup> Kjo e dhënë i referohet çështjeve të mbartura nga viti 2024.

<sup>100</sup> Numri aktual i çështjeve të reja të regjistruara që nga fillimi i vitit deri në datën 20.10.2025.

<sup>101</sup> Me vendimin nr. 480, datë 31.07.2024 të KLGJ-së, gjyqtari Artan Jahollari është transferuar për kohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke filluar efektet juridike nga data 11.09.2024.

<sup>102</sup> Me vendimin nr. 419, datë 16.07.2025 të KLGJ-së, gjyqtari Ervin Sulaj është transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

<sup>103</sup> Me vendimin nr. 297, datë 29.05.2025 të KLGJ-së, gjyqtari Ervin Kore është transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

<sup>104</sup> Me vendimin nr. 581, datë 09.09.2025 të KLGJ-së, gjyqtare Dorinela Nikolli është transferuar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

13	Thomaidha Roca	1	0
14	Sonjela Voskopi	2	0
15	Suzan Bushi	166	414
16	Valjona Haxhiraj <sup>[105]</sup>	156	0
	<b>TOTALI</b>	<b>2013</b>	<b>3826</b>

### 3.2. Numri i çështjeve të gjykuara gjatë periudhës objekt inspektimi për secilin gjyqtar.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me shkresën nr. 4918/1 prot., datë 11.11.2025, ndër të tjera informon mbi çështjet e gjykuara për periudhën 01.01.2025-20.10.2025, sipas secilit magjistrat e konkretisht: numri i çështjeve të gjykuara nga secili gjyqtar referuar konkretisht tabelës si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		
Nr.	Gjyqtari	Nr. i çështjeve të gjykuara 01.01.2025-20.10.2025
1	Artan Jahollari	4
2	Elena Tafa	80
3	Ervis Sulaj <sup>106</sup>	63
4	Ervin Kore <sup>107</sup>	184
5	Eglantina Mikani	295
6	Estjon Venxha	337
7	Eda Diko	298
8	Dorinela Nikolli <sup>108</sup>	213
9	Klajdi Terova	337
10	Luljeta Kole	330
11	Luljeta Kolonja	323
12	Gentiana Shukullari	392
13	Thomaidha Roca	1
14	Sonjela Voskopi	2
15	Suzan Bushi	342

<sup>105</sup> Me vendimin nr. 231, datë 23.04.2025 të KLGJ-së, gjyqtare Valjona Haxhiraj është transferuar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

<sup>106</sup> Me vendimin nr. 419, datë 16.07.2025 të KLGJ-së, gjyqtari Ervin Sulaj është transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (nga data 01.09.2025).

<sup>107</sup> Me vendimin nr. 297, datë 29.05.2025 të KLGJ-së, gjyqtari Ervin Kore është transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. (nga data 12.06.2025).

<sup>108</sup> Me vendimin nr. 581, datë 09.09.2025 të KLGJ-së, gjyqtare Dorinela Nikolli është transferuar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. (nga data 01.10.2025).

16	Valjona Haxhiraj	156
	<b>TOTALI</b>	<b>3357</b>

Referuar informacionit të pasqyruar në listën e çështjeve të gjykuara, rezulton se, në periudhën 01.01.2025 -31.10.2025, gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, kanë gjykuar gjithsej 3357 çështje.

### 3.3 Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025

Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e planifikimeve të seancave, si dhe nga raportet për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio nga çdo gjyqtar në periudhën 01.01.2025 -31.10.2025, konstatohet se ka mospërputhje ndërmjet seancave të planifikuara dhe totalit të seancave të mbajtura (numri i seancave Audio + numri i seancave në zyrë) sipas sistemit të regjistrimit audio. Gjithashtu të dhënat lidhur me totalin e seancave të mbajtura nuk përputhen me shumën e numrit të seancave në zyrë dhe seancave audio.

#### Planifikimi i seancave sipas ditëve të javës në nivel gjykate paraqitet si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë									
	Gjyqtarët	Numri i seancave të planifikuara për çdo ditë të javës, për secilin gjyqtar të Gjykatës Korçë, për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025							Totali i seancave të planifikuara
		Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diel	
1	Eglantina Milkani	257	268	259	254	78	4	17	1137
2	Dorinela Nikolli	112	111	112	106	36	7	3	487
3	Gentiana Shukullari	292	328	350	31	18	20	5	1044
4	Luljeta Kole	217	257	248	132	146	13	12	1025
5	Suzan Bushi	262	69	210	220	315	6	28	1110
6	Ervin Sulaj	69	30	14	2	5	1	4	125
7	Artan Jahollari	19	0	1	0	0	0	0	20
8	Eda (Diko) Gjovani	192	229	205	203	84	12	13	938
9	Luljeta Kolonja	305	363	385	348	109	6	14	1530
10	Elena Tafa	106	118	112	90	22	7	0	455
12	Klajdi Terova	187	236	243	236	77	8	9	996
13	Estjon Venxha	206	209	203	188	177	10	11	1004
14	Ervin Kore	53	67	93	75	46	3	3	340
15	Valjona Haxhiraj	25	30	70	66	37	5	7	240
	<b>TOTALI:</b>	2302	2315	2505	1951	1150	102	126	10451

#### 3.3.1. Analiza e planifikimit të seancave brenda një dite:

*Planifikimi i të njëjtës çështje dy herë/ i dy çështjeve të ndryshme në të njëjtën orë me një diferencë të vogël kohore.*

**Raste të planifikimit të seancave në të njëjtën datë dhe orë:**

- Referuar Kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, rezulton se gjyqtari Estjon Venxha ka planifikuar në të njëjtën datë dhe orë (**14.02.2025; ora 12.00**), seanca për dy çështje të ndryshme çështjen nr. 50503-00137-41-2025 datë regj., 15.01.2025 dhe çështjen nr. 21282-01091-41-2023 datë Regj., 13.07.2023. Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, referuar procesverbaleve të printuara *këto dy seanca gjyqësore nuk janë zhvilluar pasi gjyqtari i çështjes ka qenë me raport mjekësor.*
- Referuar Kalendarit të planifikimit të seancave, gjyqtare Dorinela Nikolli ka planifikuar në datë **13.01.2025, ora 12:00**, seanca për dy çështje të ndryshme konkretisht me nr. 50506-02629-41-2024 datë regj., 17.12.2024 dhe nr.21001-01477-41-2024 datë regj., 11.11.2024. Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas procesverbalit të mbajtur, çështja nr.50506-02629-41-2024 *ka filluar në orën 12:02*, ndërsa çështja nr.21001-01477-41-2024 *ka filluar në orën 12:32*. Lidhur me çështjen nr.21001-01477-41-2024, gjyqtare znj. Dorinela Nikolli ka relatuar se, *“kjo seancë filloi me vonesë për shkak të zgjatjes tej afatit të planifikuar të një gjykimi të mëparshëm penal”*.

**Konstatim:** Planifikim i seancave për çështje të ndryshme në të njëjtën datë dhe orë; mospërputhje e orareve të seancave ; kohëzgjatje tepër e shkurtër e zhvillimit të seancës (e pamjaftueshme).

**Rast i planifikimit sasior ditor të seancave për çështje të ndryshme.**

Gjyqtarja **Gentiana Shukullari** ka planifikuar në të njëjtën ditë, (19 mars), 15 seanca gjyqësore për çështje të ndryshme. Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, 14 seanca rezultuan të zhvilluara, ndërsa lidhur me një seancë nuk është mundësuar verifikimi për shkak se procesverbali i seancës nuk shfaqej në sistem.

Nga kalendari i planifikimit të seancave gjyqësore të datës 19.03.2025 u konstatua se për çështjen nr. 520005-00382-41-2025 janë planifikuar 2 seanca në orare të ndryshme, konkretisht në orën 8:30 dhe 9:15, ndërkohë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, referuar procesverbaleve të printuara, u konstatua se për këtë çështje është zhvilluar seanca në orën 8:40, e cila është ndërprerë për disa minuta me qëllimi komunikimin me prokurorin e çështjes dhe drejtuesin e prokurorisë për të gjetur zgjidhje lidhur me përfaqësimin e organit të akuzës, duke e shtyrë zhvillimin e seancës po atë ditë në orën 9:15. Nga verifikimi në sistem rezultoi se seanca e planifikuar për tu zhvilluar në orën 9:15 është zhvilluar në orën 12:16.

Nga planifikimi i seancave sipas ditëve të javës përgjatë gjithë periudhës së inspektimit në përgjithësi konstatohet një shpërndarje thuajse e njëtrajtshme e seancave, duke veçuar ditën e premte.

**Nga verifikimi i kalendarit të planifikimit të seancave rezulton se disa gjyqtarë nuk planifikojnë seanca ditën e premte ose planifikojnë në këtë ditë një numër të vogël seancash, por evidentohet edhe ndonjë rast kur ditën e premte planifikohen seanca në numër edhe më të madh se çdo ditë tjetër e javës. (Gjyqtari Suzan Bushi 315 seanca në Total për ditët e premte)**

Përgjatë gjithë periudhës Janar-Tetor, janë gjithsej 41 ditë të premte (hiqen 5 të premte të muajit gusht) gjithsej 35 ditë të premte.

Nga analiza e kalendarit të planifikimit të seancave për periudhën Janar-Tetor 2025 lidhur me planifikimin për ditën e premte rezultoi se:

<b>Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë</b>		
<b>Të premte që nuk janë planifikuar seanca</b>		
<b>(01.01.2025-3.12.2025)</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Gjyqtari</b>	<b>Nr. i ditëve</b>
1	Artan Jahollari	35
2	Elena Tafa	14
3	Ervis Sulaj	31
4	Ervin Kore	22
5	Eglantina Mikani	11
6	Estjon Venxha	3
7	Eda Diko	10
8	Dorinela Nikolli	22
9	Klajdi Terova	8
10	Luljeta Kole	8
11	Luljeta Kolonja	15
12	Gentiana Shukullari	29
13	Suzan Bushi	3
14	Valjona Haxhiraj	20

Për gjithë periudhën objekt inspektimi rezultuan grupimet si më poshtë:

**Grupi I**, gjyqtarë të cilët kanë planifikuar rregullisht ditët e premte: Suzan Bushi (nuk ka planifikuar vetëm 3 të premte); Estjon Venxha (nuk ka planifikuar vetëm 3 të premte);

**Grupi II**, gjyqtarë të cilët kanë planifikuar në mënyrë të moderuar ditët e premte: Luljeta Kolonja (nuk ka planifikuar 15 të premte); Eglantina Mikani (nuk ka planifikuar 11 të premte); Elena Tafa (nuk ka planifikuar 10 të premte); Eda Diko (nuk ka planifikuar 10 të premte); Klajdi Terova (nuk ka planifikuar 10 të premte); Luljeta Kole (nuk ka planifikuar 8 të premte);

### 3.3.2 Planifikimi i seancave në nivel mujor

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë														
Planifikime të seancave në nivel mujor														
Muaji	Eglantina Mikani	Dorinela Nikolli	Gentiana Shukullari	Luljeta Kole	Suzan Bushi	Ervin Sulaj	Artan Jahollari	Eda (Diko) Gjovani	Luljeta Kolonja	Elena Tafa	Klajdi Tërova	Estjon Venxha	Ervin Kore	Vajona Haxhiraj
<b>Janar</b>	130	71	85	94	90	8	4	91	131	12	95	82	53	43
<b>Shkurt</b>	123	82	116	118	114	5	4	96	164	15	82	78	72	43
<b>Mars</b>	128	69	135	97	98	8	4	75	155	27	90	113	77	32
<b>Prill</b>	137	79	126	121	109	8	3	114	159	23	130	145	57	42
<b>Maj</b>	147	79	128	150	126	6	1	109	210	42	141	135	44	54
<b>Qershor</b>	141	52	89	131	163	9	2	120	184	46	108	127	21	26
<b>Korrik</b>	117	43	144	120	140	49	1	92	158	72	102	94	12	0
<b>Gusht</b>	0	0	16	0	38	3	0	0	7	15	6	7	0	0
<b>Shtator</b>	79	12	74	70	104	23	1	83	164	82	110	107	3	0
<b>Tetor</b>	135	0	131	124	128	6	0	158	198	121	132	116	1	0
<b>Totali</b>	<b>1137</b>	<b>487</b>	<b>1044</b>	<b>1025</b>	<b>1110</b>	<b>125</b>	<b>20</b>	<b>938</b>	<b>1530</b>	<b>455</b>	<b>996</b>	<b>1004</b>	<b>340</b>	<b>240</b>

### Raporti i seancave të mbajtura në audio

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë						
Nr.	Gjyqtar	Nr. Seancave audio	Nr. Seancave në sallë	Seanca në zyrë	Totali i seancave të mbajtura	% e seancave të mbajtura
1	Artan Jahollari	15	17	0	17	88.2%
2	Dorinela Nikolli	457	457	44	501	91.2 %
3	Eda Diko	820	829	145	974	84.2 %
4	Eglantina Mikani	1012	1029	125	1154	87.7 %
5	Elena Tafa	443	450	19	469	94.5 %
6	Ervin Kore	337	339	19	358	94.1 %
7	Ervin Sulaj	123	123	15	138	89.1 %
8	Estjon Venxha	996	993	59	1052	94.7 %
9	Gentiana Shukullari	910	983	78	1061	85.8 %
10	Klajdi Terova	946	959	65	1024	92.04 %
11	Luljeta Kole	1020	1022	44	1066	95.7 %
12	Luljeta Kolonja	1340	1334	230	1564	84.7 %

13	Suzan Bushi	<b>925</b>	1034	34	1068	<b>86.6 %</b>
14	Thomaidha Roca	<b>1</b>	1	0	1	<b>100 %</b>
15	Valjona Haxhiraj	<b>218</b>	221	31	252	<b>86.5 %</b>
16	Elarinda Xhindi	<b>218</b>	224	46	270	<b>80.7 %</b>
17	Gentjan Sallahu	<b>213</b>	217	48	265	<b>80.4 %</b>
	<b>Totali</b>	<b>9994/audio</b>	<b>10232/sallë</b>	<b>1002/zyrë</b>	<b>11234/total</b>	<b>88.9 %</b>

Nga **analiza në nivel gjyqtari**, treguesit më të ulët të përdorimit të sistemit audio paraqiten si më poshtë:

1. Gjyqtarja Eglantina Mikani gjatë muajit tetor vetëm 68.5 % të seancave i ka zhvilluar në audio.
2. Gjyqtarja Dorinela Nikolli gjatë muajit mars vetëm 74.6 % të seancave i ka zhvilluar në audio.
3. Gjyqtari Suzan Bushi ka zhvilluar në audio gjatë muajit qershor vetëm 75.2% e totalit të seancave, në shtator 64.1% dhe në tetor 77.4%.
4. Gjyqtarja Eda Diko (Gjovari) gjatë muajit tetor vetëm 66.2 % të seancave i ka zhvilluar në audio.
5. Gjyqtarja Valjona Haxhiraj gjatë muajit mars vetëm 75 % të seancave i ka zhvilluar në audio.

**Në nivel gjykate përdorimi i sistemit audio paraqitet si më poshtë:**

1. **Grupi I:** Mbi 94% rezultojnë gjyqtarët: Thomaidha Roca, Luljeta Kole, Estjon Venxha, Ervin Kore, Elena Tafa.
2. **Grupi II:** 90-92% rezultojnë gjyqtarët: Dorinela Nikolli, Klajdi Terrova,
3. **Grupi III:** 80-90% rezultojnë gjyqtarët: Artan Jahollari, Eda Diko, Eglantina Milkani, Elarinda Xhindi, Ervin Sulaj, Gentiana Shukullari, Gentjan Sallahu, Luljeta Kolonja, Suzan Bushi, Vjola Haxhiraj.

Në nivel gjykate, për periudhën objekt inspektimi 01.01.2025-31.10.2025 nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se raporti midis numrit të seancave të mbajtura në audio me numrin total të seancave të mbajtura është 88.9%. Pra konstatohet se pjesa e konsiderueshme e seancave të mbajtura regjistrohen në sistemin audio.

Referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me email e datës 15.01.2026 rezulton se *ndarja e sallave të gjykimit nuk ka qenë e nevojshme për shkak të numrit jo të plotë të gjyqtarëve në raport me numrin e sallave të gjykimit*, nga e cila rezulton se numri i sallave të gjykimit është më se i mjaftueshëm, në raport me numrin e gjyqtarëve gjë që çon në sugjerimin për regjistrimin në sistemin audio të të gjitha seancave për të cilat është detyrimi ligjor.

**3.3.3. Analiza në tërësi lidhur me planifikimin e seancave për periudhën 10 mujore të inspektimit, si dhe korrelacioni midis ngarkesës/planifikimit/vendimeve të shpallura.**

**Produktiviteti mbi çështjet**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë						
Ngarkesa/Planifikimi/shpalljet e vendimeve (tabelë përmbledhëse)						
Nr	Gjyqtari	Çështje të mbartura 31.12.2024	Çështje të reja 2025	Ngarkesa totale 2025	Seanca të planifikuara (Janar-Tetor)	Vendime të shpallura 01.01.2026-20.10.2025
1	A. Jahollari	4	0	4	20	4
2	E. Tafa	30	244	272	455	80
3	E. Sulaj	55	145	200	125	63
4	E. Kore	80	89	169	340	184
5	E. Mikani	257	281	538	1137	295
6	E. Venxha	124	392	516	1004	337
7	E. Diko	171	421	592	938	298
8	D. Nikolli	124	289	413	487	213
9	K. Terova	104	378	482	996	337
10	L. Kole	215	388	603	1025	330
11	L. Kolonja	321	367	688	1530	323
12	G. Shukullari	203	418	621	1044	392
13	S. Bushi	166	414	580	1110	342
14	V. Haxhiraj	156	0	156	240	156
	<b>TOTALI</b>	<b>2010<sup>109)</sup></b>	<b>3826</b>	<b>5834</b>	<b>10451</b>	<b>3354</b>

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga gjykata, më poshtë paraqesim në mënyrë të përmbledhur, të dhëna sasiore të planifikimit të seancave nga secili gjyqtar gjatë periudhës objekt inspektimi, në raport me kohën e ushtrimit prej tyre të veprimtarisë gjyqësore në periudhën objekt inspektimi:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë					
Nr.	Gjyqtarët	Seanca të planifikuara	Seanca të mbajtura	Lejet vjetore	Periudha në detyrë nga 01.01.2025 - 31.10.2025
1	Eglantina Mikani	1137	1154	muaji gusht (leja vjetore 2025)	<b>e plotë</b>
2	Dorinela Nikolli	487	448	4 ditë leje të 2024 (17-20.03.2025) + muaji gusht (leja vjetore 2025)	(9 muaj) Transferuar nga data 01.10.2025
3	Gentiana Shukullari	1044	1061	3 ditë leje të 2024 (13-15.01.2025) + 5 ditë leje nga 2025 (9-13.06.2025)	<b>e plotë</b>

<sup>109</sup> Nuk përfshihen 3 çështjet e mbartura nga gjyqtaret Thomaidha Roca dhe Sonjela Voskopi, të cilat në vitin 2025 nuk kanë qenë efektiv të Gjykatës Korçë, duke qenë se ishin transferuar nga kjo gjykatë në gjykatë tjetër, me vendim të KLGJ-së të vitit 2023 dhe 2024.

				+ muaji gusht (leja vjetore 2025)	
4	Luljeta Kole	1025	1066	1 ditë leje nga 2025 (24.10.2025) + muaji gusht (leja vjetore 2025)	<b>e plotë</b>
5	Suzan Bushi	1110	1068	4 ditë leje të 2024 (25-29.03.2025) + muaji gusht (leja vjetore 2025)	<b>e plotë</b>
6	Ervin Sulaj	125	137	+ muaji gusht (leja vjetore 2025)	(rreth 4 muaj) maj-shtator
7	Artan Jahollari	20	17		çështje të veçanta
8	Eda (Diko) Gjova	938	974	4 ditë leje të 2024 (10-13.03.2025) + muaji gusht (leja vjetore 2025)	<b>e plotë</b>
9	Luljeta Kolonja	1530	1564	2 ditë leje 2024 (25-26.03.2025) + muaji gusht (leja vjetore 2025)	<b>e plotë</b>
10	Klajdi Terova	996	1024	6 ditë leje të 2024 (17.03-19.03.2025) (26.03-28.03.2025)	<b>e plotë</b>
11	Elena Tafa	455	469	01.01.2025-01.05.2025 (leje lindje)	6 muaj (maj-tetor)
12	Valjona Haxhiraj	240	252		6 muaj
13	Ervin Kore	340	358	3 ditë leje të 2024 (24.02-26.02.2025)	5 muaj
14	Estjon Venxha	1004	1052	5 ditë leje të 2024 (27-28.02.2025 dhe 03.03.2025) (27.03-28.03.2025)	<b>e plotë</b>
15	Thomaidha Roca	-	1		çështje të veçanta

Nga analiza e të dhënave më sipër për gjyqtarët që kanë qenë me kohë të plotë për periudhën e inspektimit, duke marrë për referencë numrin e seancave të planifikuara, rezultojn performanca si më poshtë:

1. Luljeta Kolonja, numër i seancave të planifikuara **(1530)**, numri i çështjeve të përfunduara 323, në raport me 688 çështje në total.
2. Suzan Bushi, numër i seancave të planifikuara **(1110)**, numri i çështjeve të përfunduara 342, në raport me 580 çështje në total.
3. Gentiana Shukullari, numër i seancave të planifikuara **(1044)**, numri i çështjeve të përfunduara 392, në raport me 621 çështje në total.
4. Luljeta Kole, numër i seancave të planifikuara **(1025)**, numri i çështjeve të përfunduara 330, në raport me 603 çështje në total.
5. Estjon Venxha, numër i seancave të planifikuara **(1004)** numri i çështjeve të përfunduara 337, në raport me 516 çështje në total.
6. Klajdi Terova, numër i seancave të planifikuara **(996)**, numri i çështjeve të përfunduara 337, në raport me 482 çështje në total.
7. Eva Diko, numër i seancave të planifikuara **(938)**, numri i çështjeve të përfunduara 298, në raport me 592 çështje në total.

Në gjyqtarët me kohë të plotë përgjatë periudhës së inspektimit, konstatohet një diferencë prej 592 seancash nga gjyqtari me numrin më të lartë të planifikimeve me gjyqtarin me numrin më të ulët të seancave të planifikuara.

Disa gjyqtarë duke qenë se kanë ushtruar detyrën vetëm për një pjesë të periudhës së inspektimit për shkak shkaqe të ndryshme (transferime/leje etj.) ngarkesa dhe produktiviteti në trajtimin prej tyre të çështjeve, nuk mund të merren në analizë krahasuese me gjyqtarët e tjerë që kanë qenë në detyrë përgjatë gjithë periudhës së inspektimit.

**Gjyqtarë që kanë ushtruar funksionin pjesërisht në kohë përgjatë periudhës së inspektimit janë:**

1. Elena Tafa, numër i seancave të planifikuara **(455)**, numri i çështjeve të përfunduara 80, në raport me 275 çështje në total. *(leje barrë lindje 20 maj 2024-maj 2025).*
2. Ervin Kore, numër i seancave të planifikuara **(340)**, numri i çështjeve të përfunduara 184, në raport me 169 çështje në total. *(transferuar më datë 01.06.2025)*
3. Valjona Haxhiraj, numër i seancave të planifikuara **(240)**, numri i çështjeve të përfunduara 156, në raport me 156 çështje në total. *(transferuar më datë 01.07.2025)*
4. Ervin Sulaj, numër i seancave të planifikuara **(125)**, numri i çështjeve të përfunduara 63 në raport me 200 çështje në total. *(transferuar më datë 01.09.2025)*
5. Artan Jahollari, numër i seancave të planifikuara **(20)**, numri i çështjeve të përfunduara 4, në raport me 4 çështje në total. *(transferuar për një periudhë deri 1 vit duke filluar nga data 11.09.2024)*

Lidhur me gjyqtarin Ervin Kore në të dhënat e përcjella nga vetë gjykata konstatohet se ka mospërputhje midis numrit të çështjeve të gjykuara (184) dhe numrit të çështjeve në total (169), çka tregon pasaktësi në statistikat në lidhje me këtë magjistrat.

**Konstatim:** Ndër gjyqtarët që kanë qenë me kohë të plotë 8 (tetë) përgjatë periudhës së inspektimit, evidentohen këto modele gjyqtarësh:

- Gjyqtarë me ngarkesë të lartë të çështjeve, me numër të madh të seancave të planifikuara, dhe me numër të lartë të vendimeve të shpallura. Gjyqtarja G. Sh., renditet e dyta për ngarkesë dhe treta për numrin e seancave të planifikuara, por renditet e para për numrin e vendimeve të shpallura, duke pasur korrelacion pozitiv në raportin ngarkesë/planifikim dhe raportin planifikim/vendime të shpallura.
- Gjyqtarë me ngarkesën më të lartë të çështjeve, me numrin më të madh të seancave të planifikuara, por jo me numrin më të lartë të vendimeve të shpallura. Gjyqtarja L. K., renditet e para për ngarkesën dhe numrin e seancave të planifikuara, por e gjashta për numrin e vendimeve të shpallura, duke pasur korrelacion pozitiv në

raportin ngarkesë/planifikim dhe korrelacion negativ në raportin planifikim/vendime të shpallura.

- Gjyqtarë jo me ngarkesën më të lartë të çështjeve, të renditur të fundit për numrin e seancave të planifikuara, por të renditur të fundit edhe për numrin e vendimeve të shpallura, duke pasur korrelacion negativ si në raportin ngarkesë/planifikim, ashtu dhe në raportin planifikim/vendime të shpallura, si p. sh., gjyqtare E. D.

*Raporti ndërmjet numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin total të çështjeve, është paraqitur vetëm si një raport sasior, jo cilësor, në pamundësi të analizës së kompleksitetit dhe natyrës së çështjeve.*

*Lidhur me numrin e seancave të zhvilluara, për çështjet në proces për periudhën e inspektimit, nuk mund të bëhet një analizë, për shkak të problematikave të sistemit ICMIS në drejtim të saktësisë së të dhënave.*

Nga analiza e kalendarit të planifikimit të çështjeve dhe dokumentacionit të përcjellë nga gjykata, nuk evidentohet një ndarje e gjyqtarëve të cilët trajtojnë çështje civile/penale, duke trajtuar të gjitha çështjet, pa dallim.

**Referuar Raportit të analizës vjetore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024, rezulton se për vitin 2025 janë mbartur 2013 çështje nga viti paraardhës, e dhënë kjo që përputhet me atë të përcjellë nga gjykata Korçë në kuadër të këtij inspektimi.**

### 3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar.

Nga të dhënat e administruara rezulton se numri mesatar i seancave të planifikuara në muaj nga secili gjyqtar, është i ndryshëm, kjo për shkak të ngarkesës së ndryshme, si dhe qenies së gjyqtarit efektiv në gjykatë përgjatë gjithë periudhës së inspektimit 01.01.2025-31.10.2025.

Gjyqtari Muaji	A. Jahollari	E. Tafaj	E. Sulaj	E. Kore	E. Mikani	E. Venxha	E. Diko	D. Nikolli	K. Terova	L. Kole	L. Kolonja	G. Shukullari	S. Bushi	V. Haxhiraj	Totali seanca ve për periudhën	Numri mesatar në nivel gjykate
Janar	4	12	8	53	130	82	91	71	95	94	131	85	90	43	989	71
Shkurt	4	15	5	72	123	78	96	82	82	118	164	116	114	43	1112	79
Mars	4	27	8	77	128	113	75	69	90	97	155	135	98	32	1108	79.1
Prill	3	23	8	57	137	145	114	79	130	121	159	126	109	42	1253	89.5
Maj	1	42	6	44	147	135	109	79	141	150	210	128	126	54	1372	98
Qershor	2	46	9	21	141	127	120	52	108	131	184	89	163	26	1219	87
Korrik	1	72	49	12	117	94	92	43	102	120	158	144	140	-	1144	88
Gusht	0	15	3	0	0	7	0	0	6	0	7	16	38	-	92	13
Shtator	1	82	23	3	79	107	83	12	110	70	164	74	104	-	912	70
Tetor	0	121	6	1	135	116	158	0	132	124	198	131	128	-	1250	113
<b>Totali</b>	<b>20</b>	<b>455</b>	<b>125</b>	<b>340</b>	<b>1137</b>	<b>1004</b>	<b>938</b>	<b>487</b>	<b>996</b>	<b>1025</b>	<b>1530</b>	<b>1044</b>	<b>1110</b>	<b>240</b>	<b>10451</b>	

Nga të dhënat në tabelën përmbledhëse të sipërcituar, rezulton se ngarkesën më të lartë e kanë gjyqtarët Luljeta Kolonja me 688 çështje përfshirë (321 të mbartura nga viti 2024), nga të cilat përfunduar së gjykuari 323 dhe Gentiana Shukollari me 621 çështje (203 të mbartura nga viti 2024), përfunduar së gjykuari 392 çështje.

<b>Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë</b>		
<b>Gjyqtarët</b>	<b>Seanca të planifikuara</b>	<b>Nr. mesatar i seancave të planifikuara/në muaj</b>
Eglantina Mikani	1137	126.3
Dorinela Nikolli	487	60.9
Gentiana Shukollari	1044	104.4
Luljeta Kole	1025	113.9
Suzan Bushi	1110	111
Ervin Sulaj	125	12.5
Artan Jahollari	20	2.5
Eda (Diko)Gjovari	938	104.2
Luljeta Kolonja	1530	153
Elena Tafa	455	45.5
Klajdi Tërova	996	99.6
Estjon Venxha	1004	100.4
Ervin Kore	340	37.8
Valjona Haxhiraj	240	40
<b>TOTALI</b>	<b>10451</b>	<b>1112</b>

#### 4. Konkluzione

- Të dhënat e pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, kanë mospërputhje me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë sa i përket emrit të gjyqtarit, në rastet kur ky i fundit është transferuar, zëvendësuar apo është me leje (vjetore/lindje);
- Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, me të cilin operon Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, shfaq probleme në drejtim të çështjeve të rishortuara, duke i bashkëngjitur të gjitha të dhënat gjyqtarit të ri të cilit i kalon çështja pas rishortimit dhe duke reduktuar artificialisht ngarkesën e gjyqtarit të mëparshëm.
- Të dhënat statistikore periodike të dërguara nga gjykata në KLGJ, referuar Raporteve 3-mujore, nuk përputhen me ato të përcjella nga gjykata pranë ILD-së në kuadër të inspektimit. Konkretisht për periudhën Janar-Tetor 2025 numri i seancave

audio sipas raportimit në KLGJ është 9149 seanca, ndërsa sipas raportimit në zyrën e ILD-së është 8523.

- I njëjti gjyqtar planifikon 2 seanca gjyqësore për 2 çështje të ndryshme, në të njëjtën datë dhe orë, duke pamundësuar me vetëdije respektimin e orarit të gjykimit.
- Nga ana e gjyqtarëve kërkohet leje vjetore për më shumë se 3 ditë në periudhë më të shkurtër se një muaj, në shkelje të parashikimeve në nenin 23, pika 11 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin...”, i ndryshuar.<sup>[110]</sup> Në të gjitha këto raste kërkesat e gjyqtarëve janë miratuar nga Zv/Kryetari gjykatës.
- Nga ana e gjyqtarëve planifikohen seanca gjyqësore për periudha kur janë me leje (vjetore/lindje etj.), duke e ditur që ato nuk mund të zhvilloheshin;
- Ka një përqindje relativisht të lartë të seancave gjyqësore të zhvilluara në audio në raport me ato të zhvilluara në zyrë, por referuar organikës dhe numrit të sallave në dispozicion, ka mundësi për një përqindje edhe më të lartë.
- Numri i seancave të planifikuara ditën e premte është shumë më i ulët se ditët e tjera të javës ndërkohë që disa gjyqtarë nuk planifikojnë fare seanca gjyqësore në këtë ditë.
- Statistikat e dërguara nga gjykata për efekt të këtij inspektimi, të konstatuara me pasaktësi në disa elementë sikundër është evidentuar përgjatë raportit, kanë penguar nxjerrjen e konkluzioneve të sakta lidhur me këtë inspektim.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet “aneksi” i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.)*

---

<sup>110</sup> Neni 23, pika 11 “Pushimet vjetore”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon “Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se 3 ditë i drejtohet kryetarit të gjykatës të paktën 1 (një) muaj para marrjes së tyre”.

## ✚ Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

### 1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

#### 1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

Në kuadër të inspektimit të miratuar sipas vendimit nr. 57, datë 20.10.2025, "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm" të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me shkresën e ILD-së nr. 2923 prot., datë 20.10.2025, janë kërkuar të dhëna dhe dokumentacion.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me shkresën "Kthim përgjigje" nr. 9952/1 prot., datë 06.11.2025, regjistruar në ILD me nr. 2923/1 prot., datë 10.11.2025, ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në funksion të inspektimit tematik në lidhje me:

a) statistikatat e secilit gjyqtar në lidhje me numrin e çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024, numrin e çështjeve të reja të caktuar gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025, si dhe vendimet e shpallura për këtë periudhë (Këto të dhëna janë nxjerrë nga regjistrat dhe numërorët manualë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier).

b) numrin e seancave përse i përket secilës çështje të përfunduar për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 (Këto të dhëna janë nxjerrë nga sistemi elektronik ICMIS).

c) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (Këto të dhëna janë nxjerrë nga sistemi elektronik ICMIS).

d) Organikën e miratuar si dhe organikën faktike të Gjykatës me numrin e gjyqtarëve për çdo muaj Janar-Tetor 2025, ku bëhet me dije se gjatë vitit 2025 janë larguar me raport leje lindjeje disa gjyqtare, duke u rishortuar çështjet e tyre përsëri.

e) Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

Në vijim të kërkesës së ILD me nr. 2923/1 prot., datë 20.10.2025, me shkresën nr. 9952/2 prot., datë 20.11.2025 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe materialin e përcjellë bashkëlidhur, regjistruar në ILD me nr. 2923/3 prot., datë 25.11.2025 ka përcjellë të dhënat të saktësuara lidhur me numrin e çështjeve të caktuara si me short elektronik, manualisht dhe numrin e çështjeve të përfunduara, të reja të caktuara për secilin gjyqtar dhe të rishortuara, si dhe ka kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për 8 (tetë) çështjet e gjykuara nga

gjqtarja Ersida Bajgora dhe për 1 (një) çështje të gjykuar nga gjyqtare Dorina Alushi, numrin e seancave për çështjet civile (pa palë kundërshtare) të gjykuara deri më datë 20 tetor 2025 nga gjyqtari Vladimir Cjapi, numrin e seancave për çështjet e gjykuara (sipas kategorive të çështjes civile/penale; me palë kundërshtare/pa palë kundërshtare) deri më datë 20 tetor 2025, nga gjyqtarët Ersida Bajgora (8 çështje të gjykuara) dhe Dorina Alushi.

Gjithashtu, janë dërguar vendimet nr. 476, datë 31.10.2023, nr. 46/1, datë 31.01.2024, vendimit datë 21.10.2024, nr. 463, datë 22.1.2025, nr. 410, datë 06.10.2025 dhe nr. 10253, datë 30.10.2025 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, udhëzim "Për përdorimin e sallave gjyqësore nga gjyqtarët e sekretaret gjyqësore" nr. 340, datë 24.10.2024, udhëzim "Për përdorimin e sallave gjyqësore nga gjyqtarët e sekretaret gjyqësore" nr. 458, datë 3.11.2025 dhe kopje e rregullores së gjykatës me nr. 2530, datë 12.12.2024.

Më tej, nga ILD në shkresën nr. 2923/2 prot., datë 20.11.2025, është kërkuar të sqarohet dhe përcillet informacion dhe dokumentacion shtesë, konkretisht është kërkuar të saktësohen mospërputhjet e të dhënave të përcjella nga gjykata, me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit, i cili rezultonte i ndryshëm në planifikim me atë që kishte zhvilluar seancën sipas procesverbalit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me shkresën "Kthim përgjigje" me nr. 11029/1 prot., datë 12.12.2025" ka dërguar informacionin dhe të dhënat shtesë për kryerjen e inspektimit tematik, me sqarimin se "kemi konstatuar se pas rishortimit të një çështje, të gjitha planifikimet e mëparshme shfaqen tek gjyqtari të cilit çështja i kalon pas rishortimit, megjithëse seancat dhe procesverbalet përkatëse janë mbajtur nga gjyqtari që e ka pasur realisht çështjen në atë periudhë".

Me shkresën e mësipërm janë dërguar analiza e gjykatës për vitin 2024, RDA (raportet për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat) për çdo muaj për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, lista e çështjeve të rishortuara për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025 (në format CD), urdhrat për gatishmërinë e gjyqtarëve për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, raport mbi kohëzgjatjen e çështjeve të gjykuara për këtë periudhë.

## **2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative**

### **2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi**

## Rregullorja

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier organizohet dhe funksionon mbi bazën e Rregullores së Gjykatës, së miratuar me urdhrin e Zv/Kryetarit të Gjykatës nr. 2530 prot., datë 12.12.2024 “Për miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” dhe Rregullore për organizimin dhe funksionimin e gjykatës.

Referuar përmbajtjes së Rregullores, ndër të tjera, rezulton se në nenin 1 është përcaktuar qëllimi i kësaj Rregulloreje: *“bashkërendimi në një akt të vetëm, si dhe përditësimi i të gjitha rregullimeve të urdhëruara nga titullari i gjykatës, në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e sistemit gjyqësor, për të standardizuar, harmonizuar dhe unifikuar veprimtarinë administrative të gjykatës”*.

Në nenin 4 të kësaj rregulloreje është përcaktuar se: *“1. Kryetari i gjykatës një herë në dy vjet jo domosdoshmërisht në fillim të vitit kalendarik, vendos me urdhër shpërndarjen e përgjithshme të gjyqtarëve në dhoma e seksione, si dhe në trupa gjykues. Përjashtimisht, në raste të veçanta dhe vetëm në funksion të shpërndarjes së drejtë të ngarkesës në punë, kryetari mund të urdhërojë ndryshimin e pjesshëm dhe proporcional të kësaj shpërndarjeje të përgjithshme dhe përgjatë këtij afati. 2. Gjithashtu gjatë vitit kalendarik për nevojë pune, kryetari vetë, ose mund të komandojë një, ose disa gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër, ose çështje të së njëjtës natyrë, pavarësisht seksionit, apo dhomës.*

Në nenin 5, të titulluar shpërndarja e çështjeve, përcaktohet se: *“1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në K. Pr. Penale, K. Pr. Civile dhe Kodin e Familjes ka në kompetencë lëndore të shqyrtojë mosmarrëveshjet civile, tregtare, familjare dhe çështje penale.*

*2. Në kuptim të nenit 3 të Vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 të KLD, çështjet gjyqësore civile do të ndahen për gjykim me short, në mënyrë të barabartë, ndërmjet gjyqtarëve të dhomës civile, sipas seksioneve respektive.*

*3. Kërkesat për lëshimin e urdhrave të menjëhershme të mbrojtjes do të gjykohen çdo javë nga gjyqtari i caktuar mbi bazë planifikimi gatishmërie të këtyre kërkesave, midis gjyqtarëve të seksionit familjar.*

*4. Kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake do të shqyrtohen nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sipas grafikut të gatishmërisë së përcaktuar nga Kryetari i Gjykatës.....*

Neni 6 “Procedura e shortimit elektronik” ka përcaktuar ndër të tjera se: *“Duke qenë se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, është në funksion sistemi i integruar i menaxhimit të çështjeve civile e penale, nëpërmjet të cilit shorti pra ndarja rastësore e çështjeve nuk është e menjëhershme, por realizohet pas regjistrimit tërësor të çështjeve të ardhura për gjykim, nëpërmjet dhënies së komandës, përkatëse “shortimi”, nga Kryetari i gjykatës. Shortimi do zhvillohet në këtë mënyrë:*

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier do të zhvillohet shorti elektronik, për çështjet civile, familjare e tregtare dhe penale dy herë në javë, ditën e martë dhe të enjte, në fraksionet kohore 14.30-15.30.....

I. Për çështjet civile dhe penale, që sipas K. Pr. Penale dhe Civile përcaktohet një afat i shkurtër kohor gjykimi, nuk do të pritët data e shorteve, por do të hidhen në short menjëherë....

II. Përrjashtohen nga shorti çështjet civile dhe penale si më poshtë:

III. "Çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë me vendim jopërfundimtar nga gjykata, siç janë vendimi i pushimit të gjykimit dhe vendimi i kthimit të akteve të kërkesëpadisë, përjashtohen nga shorti dhe i kalojnë për gjykim të njëjtit gjyqtar, që ka vendosur pushimin, apo kthimin e akteve.....

**Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier funksionon e ndarë në dy seksione penale dhe civile, si dhe në tre trupa civile dhe tre trupa penale. Seancat gjyqësore zhvillohen në 6 salla, aktet nënligjore mbi bazën e këtij organizimi janë si më poshtë:**

- Udhëzim nr. 340 prot., datë 24.10.2024 "Për përdorimin e sallave gjyqësore nga gjyqtarët dhe sekretaret", sipas të cilit, duke pasur parasysh se sallat nr. 3 dhe 5 kanë ambient të posaçëm për qëndrimin e të arrestuarve, burgosurve/paraburgosurve, ndarja e sallave të gjykimi për trupat gjyqësore do të bëhet në këtë mënyrë: i) Gjyqtarët Olkeda Liçe, Alfred Konomi, Erola Tarelli dhe Elira Hroni do të gjykojnë në sallën nr. 3; ii) gjyqtarët Vladimir Cjapi, Noel Veizi, Genci Busho dhe Klodiana Kryeziu do të gjykojnë në sallën nr. 5, iii) gjyqtarët Miranda Nakaj, Nertil Dushku dhe Amantia Levanaj do të gjykojnë në sallën nr. 6, iv) gjyqtarët Gladiola Bregu, Dajana Ndreja dhe Aurora Tushe do të gjykojnë në sallën nr. 2; v) gjyqtarët Klodiana Kryeziu, Dorina Alushi, Juliana Pjetri dhe Iva Bregasi do të gjykojnë në sallën nr. 1.

Gjithashtu në këtë udhëzim është përcaktuar ndër të tjera se, salla 5 dhe 3 do të përdoren sipas mundësive edhe nga gjyqtarët për gjykimin e masave të sigurimit, me dakordësim paraprak dhe se gjyqtarët e dhomave penale dhe civile mund të zhvillojnë gjykim në një sallë gjyqi të caktuar gjyqtarëve të së njëjtës dhomë ose jo në darkodësim me njëri-tjetrin, duke shmangur gjykimet në të njëjtin orar.

- Vendim nr. 476 prot., datë 31.10.2023 i Këshillit të Gjykatës "Për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, si dhe caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e drejtësisë për të mitur", ku referuar përmbajtjes së këtij urdhri në Seksionin Penal do të gjykojnë gjyqtarët Olkeda Liçe, Alfred Konomi, Miranda Nakaj, Klodiana Kryeziu, Vladimir Cjapi, Genci Busho dhe Noel Veizi; në Seksionin Civil do të gjykojnë gjyqtarët Ersida Bajgora, Rudi Laze, Nertil Dushku, Gladiola Bregu, Dajana Ndreja, Juliana Pjetri dhe Dorina Alushi; Caktimin e gjyqtarëve të Seksionit që do të gjykojnë Çështjet e Drejtësisë për të Mitur si më poshtë: Olkeda Liçe, Alfred Konomi, Miranda Nakaj, Klodiana Kryeziu, Vladimir Cjapi, Genci Busho dhe Noel Veizi.

- Vendimi nr. 476/1 prot., datë 31.01.2024 i Këshillit të Gjykatës “Sqarim lidhur me vendimin nr. 476 prot., datë 31.10.2023 ‘Për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, si dhe caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e drejtësisë për të mitur”, vendim me anë të të cilit është vendosur: Në seksionin penal do të gjykojnë: Trupi i dytë gjykues: Miranda Nakaj, Noel Veizi dhe Olkeda Liçe, trupi i tretë gjykues: Alfred Konomi, Vladimir Cjai dhe Genci Busho; Në seksionin civil do të gjykojnë trupi i tretë gjykues: gjyqtarët Ersida Bajgora, Juliana Pjetri dhe Dorina Alushi.
- Vendim datë 21.10.2024 i Këshillit të Gjykatës, me anë të së cilit është vendosur që gjyqtare Elira Hroni të gjykojë në seksionin penal, ndërsa gjyqtarët Erola Tarelli, Aurora Tusha, Iva Bregasi dhe Amantja Levanaj do gjykojnë në seksionin civil.
- Vendim nr. 463 prot., datë 22.01.2025 i Këshillit të Gjykatës “Për riorganizimin e gjyqtarëve në trupa gjykues”, në përmbajtje të të cilit ndër të tjera është vendosur: Në Seksionin Penal do gjykojnë: Trupi i parë gjykues gjyqtarët: Alfred Konomi, Noel Veizi dhe Klodiana Kryeziu; trupi i dytë gjykues: Miranda Nakaj, Noel Veizi dhe Klodiana Kryeziu; trupi i tretë gjykues: Elira Hroni, Vladimir Cjapi dhe Genci Busho; Në Seksionin Civil do të gjykojnë: Trupi i parë gjykues: Juliana Pjetri, Dajana Ndreja dhe Dorina Alushi; trupi i dytë gjykues: Gladiola Bregu, Iva Bregasi dhe Erola Tarelli; trupi i tretë gjykues: Aurora Tusha, Amantja Levanaj dhe Nertil Dushku.
- Vendim nr. 410 prot., datë 06.10.2025 i Këshillit të Gjykatës “Për shkrirjen e seksioneve dhe trupave gjykues”, me anë të së cilit është vendosur shkrirja e Seksionin Penal dhe Civil të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe të trupave të tyre gjykues, gjyqtarët do të gjykojnë çështje civile dhe penale pa ndarje të veçantë.
- Vendim nr. 10253 prot., datë 30.10.2025 i Këshillit të Gjykatës “Për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, si dhe caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e drejtësisë për të mitur”, me anë të së cilit ndër të tjera thuhet se: “Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me emërimin e 7 gjyqtarëve të rinj, ushtrojnë aktualisht detyrën në gjykatë 15 gjyqtarë dhe duke mbajtur në konsideratë numrin e gjyqtarëve, llojin e çështjeve, numrin e çështjeve të regjistruara del e nevojshme që Gjykata Fier të organizohet dhe funksionojë në seksione, ndarja e seksioneve do të jetë në atë civil dhe penal”. Në përmbajtje të urdhrin citohen dhe trupat gjykuese penale dhe civile (nuk po citohet e plotë përmbajtja e këtij urdhri për shkak se është jashtë periudhës së inspektimit).

**Përsa i përket organigramës dhe numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën në periudhën objekt inspektimi, konstatohet se, gjykata nuk ka funksionuar me organigramë të plotë dhe njëkohësisht, përgjatë kësaj periudhe 4 gjyqtare kanë qenë me leje lindjeje.**

Në lidhje me organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve për çdo muaj Janar - Tetor 2025, në shkresën “Kthim përgjigje sqarohet se, numri i gjyqtarëve sipas organikës së miratuar dhe gjyqtarët që ushtrojnë efektivisht detyrën për muajt nga janari deri në tetor 2025 është si më poshtë:

Muajt	Nr. gjyqtarëve sipas organikës së miratuar (përfshirë kryetar e Zv/Kryetar)	Nr. gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën
Janar 2025	24	18
Shkurt 2025	24	18
Mars 2025	24	18
Prill 2025	24	18
Maj 2025	24	18
Qershor 2025	21	17
Korrik 2025	21	17
Gusht 2025	21	17
Shtator 2025	21	17
Tetor 2025	26	19

Gjithashtu rezulton se, gjatë vitit 2025 janë larguar me raport leje lindje këto gjyqtare:

- Gjyqtare Juliana Pjetri më datë 17.02.2025;
- Gjyqtare Dorina Alushi më datë 10.02.2025;
- Gjyqtare Dajana Ndreja më datë 26.05.2025;
- Gjyqtare Gladiola Bregu më datë 08.09.2025.

Ndërkohë që gjyqtarët Ersida Bajgora, Miranda Nakaj, Nertil Dushku, Gladiola Bregu, Iva Bregasi dhe Erola Tarolli përgjatë vitit 2025 janë larguar në gjykata të tjera dhe çështjet gjyqësore të këtyre gjyqtarëve janë rishortuar përsëri, konkretisht:

- **Gjyqtare Ersida Bajgora** transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në Vendimin nr. 479, datë 31.07.2024 “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit Ersida Bajgora në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”; Transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në Vendimin nr. 184, datë 26.03.2025 “Për transferimin e gjyqtares znj. Ersida Bajgora në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 28.03.2025.
- **Gjyqtare Miranda Nakaj** rezulton të jetë transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në Vendimin nr. 637, datë 17.09.2025 “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. Miranda Nakaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 19.09.2025 deri në datë 19.09.2026. Sipas pikës 3 dhe 4 të këtij vendimi, gjyqtarja Miranda Nakaj

përrjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përrhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përrgjithshëm Fier. Gjyqtarja Miranda Nakaj ngarkohet të përrfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përrgjithshëm Fier, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përrfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore në gjendje gjykimi ose të pezulluara dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" përr të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

- **Gjyqtare Gladiola Bregu** rezulton të jetë transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përrgjithshëm Durrës, bazuar në vendimin nr. 601, datë 16.09.2025 "Përr transferimin e gjyqtarës znj. Gladiola Bregu në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përrgjithshëm Durrës". Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 17.09.2025.
- **Gjyqtar Nertil Dushku** rezulton të jetë komanduar Këshilltar ligjor në KLGJ, me vendimin nr. 673, datë 01.10.2025 "Përr komandimin e gjyqtarit z. Nertil Dushku në pozicionin "Nëpunës përrgjegjës përr vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor". Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datë 15.10.2025. Në pikën 3 të këtij vendimi, disponohet përr përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit Nertil Dushku, nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.
- **Gjyqtare Iva Bregasi** rezulton të jetë komanduar Nd/magjistrat në GJL vendim nr. 583, datë 09.09.2025 "Përr komandimin e gjyqtarit znj. Iva Bregasi në pozicionin e "ndihmësmagjistratit", në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë". Afati i komandimit është 5 (pesë) vjet dhe fillon më datë 01.10.2025.
- **Gjyqtare Erola Tarolli** rezulton të jetë komanduar Nd/magjistrat në GJL bazuar në Vendimin nr. 582, datë 09.09.2025 "Përr komandimin e gjyqtarit znj. Erola Tarolli në pozicionin e "ndihmësmagjistratit", në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë". Afati i komandimit është 5 (pesë) vjet dhe fillon më datë 01.10.2025.

## 2.2. Konstatimet mbi seancat përrsa i përrket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë (ICMIS apo ARKIT).

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përrgjithshëm Fier punon me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore - ICMIS.

### Konstatim 1:

- Nga verifikimi paraprak i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, u konstatua se kishte mospërrputhje të këtyre të dhënave me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi dhe planifikimeve nga gjyqtarët, në mënyrë të veçantë përrsa i përrket emrit të gjyqtarit.

Raste të ngjashme u konstatuan tek pasqyrat e planifikimeve për të gjithë gjyqtarët.

- Për sa më sipër, i është kërkuar informacion në lidhje me arsyen e këtyre mospërputhjeve, saktësimin e tyre si dhe ridërgimin e të dhënave në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, kryetarit, anëtarit) si dhe seancat e zhvilluara në nivel mujor për secilin gjyqtar, për periudhën 01.01.2025-31.10.2025. Nga komunikimi dhe nga aktet e përcjella në vijim rezultoi të ketë qenë një problematikë e sistemit ICMIS, e cila ka sjellë konstatimin e mësipërm.
- Pas rregullimit të kësaj problematike, gjykata ka përcjellë listat e kalendarëve të korrigjuar për secilin gjyqtar. Të dhënat e përcjella pas korrigjimit kanë shërbyer si bazë për identifikimin e gjetjeve, analizave dhe nxjerrjen e konkluzioneve.
- Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e korrigjuar të seancave të planifikuara, sërish është konstatuar 1 (një) rast mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit. Konkretisht, në kalendarin e seancave për gjyqtaren Aurora Tusha, lidhur me çështjen me nr. 11002-01902-62-2023, rezultoi si pjesë e trupës gjyqtarja Bora Shaholli përgjatë seancave të zhvilluara deri në shtator 2025, kur kjo e fundit është e emëruar në detyrë më datë 22.10.2025. Ndërkohë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, rezultoi se pjesë e trupës është gjyqtari Nertil Dushku, ndërkohë që kjo çështje nuk rezultoi që të jetë pasqyruar në kalendarin e seancave të këtij të fundit.

Gjykata ka përcjellë edhe të dhënat në lidhje me seancat e raportuara si të zhvilluara sipas raportit mbi përdorimin e sistemit audio (RDA) nga secili gjyqtar. Nga këto të dhëna rezultoi se në total për periudhën 10 mujore janë zhvilluar 16953 seanca, të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Totali
Gjyqtari	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor
Olkeda Liçe	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Ersida Bajgora	7	6	5	0	0	0	0	0	0	0	18
Noel Veizi	79	161	145	211	119	147	140	34	121	198	1355
Alfred Konomi	135	204	193	268	239	228	228	1	162	264	1922
Nertil Dushku	98	176	127	213	176	167	159	2	91	124	1333
Gladiola Bregu	87	166	121	203	181	147	141	0	4	0	1050
Dajana Ndreja	31	191	155	100	196	0	0	0	0	0	673

Miranda Nakaj	84	221	118	208	194	220	275	23	10	37	1390
Vladimir Cjapi	95	120	145	143	169	134	171	2	99	169	1247
Genci Busho	95	159	110	189	168	169	139	0	136	216	1381
Klodiana Kryeziu	141	209	129	275	233	231	222	8	153	249	1850
Dorina Alushi	45	50	0	0	0	0	0	0	0	0	95
Juliana Pjetri	79	0	0	0	0	0	0	0	0	0	79
Aurora Tusha	33	71	49	99	129	157	79	33	147	138	935
Amantja Levanej	51	57	98	113	154	139	143	17	167	215	1154
Elira Hroni	77	153	128	218	158	179	154	0	161	206	1434
Iva Bregasi	29	58	59	54	72	84	39	1	58	0	454
Erolda Tarelli	23	51	63	98	91	82	81	27	60	0	576
<b>Total</b>	<b>1196</b>	<b>2053</b>	<b>1645</b>	<b>2392</b>	<b>2279</b>	<b>2084</b>	<b>1971</b>	<b>148</b>	<b>1369</b>	<b>1816</b>	<b>16953</b>

## Konstatim 2:

- Gjithashtu një tjetër problematike e konstatuar është se në disa raste konstatohet mospërputhje ndërmjet numrit të seancave të raportuara si të zhvilluara sipas raportit mbi përdorimin e sistemit audio (RDA) dhe numrit të seancave të planifikuara sipas kalendarit gjyqësor. Konkretisht, në disa raste, numri i seancave të rezultuara si të zhvilluara sipas të dhënave të RDA-së paraqitet më i lartë se numri i seancave të planifikuara në kalendar për të njëjtën periudhë referimi.

## 3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

### 3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme (31.12.2024)	Numri i çështjeve të reja		
			Nr. i çështjeve të caktuara me short (Çështje të reja të regjistruara nga 1 janari deri më 20.10.2025)	Nr. i çështjeve të caktuara me rishortim (Kjo përfshin edhe numrin e çështjeve të mbartura që mund të jenë rishortuar elektronikisht përgjatë periudhës 01.01.2025-20.10.2025, për shkak të largimit të gjyqtarëve, si dhe për shkak të pranimit të kërkesave të reja p. sh., për dorëheqje ose përjashtim gjyqtari. Kjo kolonë përfshin çështjet e reja të regjistruara në 2025 dhe të rishortuara, si edhe	Nr. i çështjeve me short manual (Çështje të regjistruara pas 1 janar 2025, të cilat janë kaluar manualisht në sistemin ICMIS, p. sh., kërkesat për korigjim, saktësim vendimi etj.)

				çështjet e mbartura nga vitet e kaluara që janë rishortuar në vitin 2025.	
1	<b>Alfred Konomi</b>	138	537	47	39
2	<b>Ersida Bajgora</b>	10	-	-	-
3	<b>Dajana Ndreja</b>	315	121	5	5
4	<b>Gladiola Bregu</b>	285	223	-	2
5	<b>Nertil Dushku</b>	232	235	113	19
6	<b>Miranda Nakaj</b>	221	423	16	20
7	<b>Olkeda Lice</b>	90	-	-	-
8	<b>Rudi Laze</b>	3	-	-	-
9	<b>Dorina Alushi</b>	151	67	3	-
10	<b>Juliana Pjetri</b>	132	-	-	-
11	<b>Genci Busho</b>	75	531	41	29
12	<b>Klodiana Kryeziu</b>	111	535	46	33
13	<b>Noel Veizi</b>	156	305	42	25
14	<b>Vladimir Cjapi</b>	76	532	46	41
15	<b>Amantja Levanaj</b>	58	384	162	34
16	<b>Aurora Tusha</b>	41	421	163	26
17	<b>Elira Hroni</b>	51	544	50	24
18	<b>Erolda Tarelli</b>	56	255	132	12
19	<b>Iva Bregasi</b>	62	249	132	10
20	<b>Të tjerë</b>	8			
			<b>5562</b>	<b>998</b>	<b>319</b>

TOTALI	2271	6879
--------	------	------

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Përsa i përket numrit të çështjeve të gjykuara deri më datë 20 tetor 2025 janë përcjellë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara deri më 20 tetor 2025
1.	Alfred Konomi	685
2.	Ersida Bajgora	8
3.	Dajana Ndreja	100
4.	Gladiola Bregu	231
5.	Nertil Dushku	383
6.	Miranda Nakaj	469
7.	Dorina Alushi	1
8.	Juliana Pjetri	6
9.	Genci Busho	655
10.	Klodiana Kryeziu	656
11.	Noel Veizi	420
12.	Vladimir Cjapi	604
13.	Amantja Levanaj	342
14.	Aurora Tusha	375

15.	Elira Hroni	622
16.	Erolda Tarelli	229
17.	Iva Bregasi	204
<b>TOTALI</b>		<b>6046</b>

**3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar**

**A. GJETJE NGA VERIFIKIMI I KALENDARIT TË PLANIFIKIMEVE TË SEANCAVE GJYQËSORE**

**3.3.1. Analiza e planifikimit të seancave brenda një ditë**

Nr.	Gjyqtari	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel
1	Klodiana Kryeziu	882	104	878	211	104	10	6
2	Alfred Konomi	260	490	340	459	450	13	3
7	Elira Hroni	429	19	449	70	229	5	6
4	Genci Busho	402	30	564	307	154	19	-
3	Noel Veizi	360	406	193	388	69	7	13
5	Miranda Nakaj	232	615	74	451	9	21	1
6	Vladimir Cjapi	147	435	100	370	313	30	10
8	Amantja Levanaj	233	126	287	40	459	9	1
9	Aurora Tusha	474	2	52	403	40	8	14
10	Nertil Dushku	370	2	448	2	73	19	10
11	Gladiola Bregu*	41	184	275	4	255	5	12
12	Erolda Tarelli	82	123	38	162	51	12	1
13	Iva Bregasi	146	71	74	81	41	9	2
14	Dajana Ndreja*	8	162	171	18	52	1	1
16	Juliana Pjetri*	15	21	18	-	-	-	-
15	Dorina Alushi*	-	30	-	13	10	-	-
17	Olkeda Liçe*	11	18	1	10	-	-	-
18	Ersida Bajgora*	-	22	-	-	-	-	-
	<b>Totali</b>	<b>4092</b>	<b>2860</b>	<b>3962</b>	<b>2989</b>	<b>2309</b>	<b>168</b>	<b>80</b>

\* gjyqtarët kanë ushtruar funksionin për periudha kohore të caktuara

- i. **Mbivendosje oraresh (planifikim i seancave për çështje të ndryshme në të njëjtën orë) dhe/ose interval i shkurtër kohor ndërmjet seancave**

**Gjetje faktike:** Nga analiza e kalendarëve të seancave gjyqësore janë konstatuar raste të shumta ku dy ose më shumë seanca për çështje të ndryshme rezultojnë të planifikuara në të njëjtën orë, qoftë në të njëjtën sallë gjyqi, qoftë në salla të ndryshme. Nga verifikimi i procesverbaleve përkatëse rezulton se, seancat janë zhvilluar në mënyrë të njëpasnjëshme, ku seanca pasuese ka nisur me vonesë në raport me orarin e planifikuar.

Gjithashtu, në një numër të konsiderueshëm rastesh, për secilin gjyqtar, konstatohet se intervali kohor ndërmjet seancave të planifikuara është minimal (5, 10, 15 apo 20 minuta), çka në praktikë rezulton i pamjaftueshëm për administrimin normal të një seance gjyqësore, përfshirë çështje procedurale, verifikimin e prezencës së palëve dhe përgatitjen për seancën pasuese.

## ii. Konstatime të tjera të natyrës formale:

**Gjetje faktike:** Gjatë verifikimit të kalendarëve të seancave gjyqësore u konstatuan raste të përsëritura të pasqyrimin të dyfishtë të së njëjtës seancë, në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë. Shembuj konkretë evidentohen për secilin prej gjyqtarëve të verifikuar, ku e njëjta seancë gjyqësore figuron e regjistruar dy herë radhazi në kalendar, pa ekzistuar elementë që të justifikojnë një planifikim të veçantë apo të ndryshëm procedural. Gjithashtu, planifikimet ditore të seancave tregojnë variacione të ndryshme sipas gjyqtarit, ku numri më i lartë i seancave është i përqendruar në ditë të caktuara të javës së punës, duke nxjerrë ditët e tjera me më pak planifikime. Ndërkohë për gjyqtarë të caktuar vihet re shpërndarje e njëtrajtshme e seancave në të gjitha ditët e javës.

### 3.3.2. Analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor

#### i. Miratimi i lejes së zakonshme në ditë me seanca të planifikuara

**Gjetje faktike:** Nga verifikimi i kalendarit të planifikimit të seancave gjyqësore, si dhe i dokumentacionit shoqërues administrativ (vendime për miratimin e lejes së zakonshme vjetore dhe procesverbale seancash), rezulton se, për pjesën më të madhe të gjyqtarëve, gjatë muajve objekt inspektimi (me përjashtim të muajit gusht), leja e zakonshme vjetore është miratuar në data në të cilat në kalendar figuronin të planifikuara seanca gjyqësore.

Në rastet e konstatuara, seancat e planifikuara në datat për të cilat ishte miratuar leja nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit, duke u shtyrë për një datë të mëvonshme, sipas pasqyrimin në procesverbalet përkatëse.

#### ii. Përqendrim i lartë ditor i seancave të planifikuara

**Gjetje faktike:** Nga analiza e kalendarëve të planifikimit të seancave gjyqësore rezulton se në data të caktuara evidentohet një numër i lartë seancash të planifikuara nga i njëjti gjyqtar, që në disa raste arrijnë në 25–30 ose më shumë seanca brenda një dite pune. Ky fenomen nuk paraqitet në mënyrë uniforme për të gjithë gjyqtarët, por konstatohet kryesisht tek gjyqtarë të veçantë me volum të lartë total planifikimi.

### iii. Mospërputhje dhe pasaktësi e të dhënave

#### Gjetje faktike:

- i. Në disa raste konstatohet mospërputhje ndërmjet numrit të seancave të raportuara si të zhvilluara sipas raportit mbi përdorimin e sistemit audio (RDA) dhe numrit të seancave të planifikuara sipas kalendarit gjyqësor. Konkretisht, në disa situata, numri i seancave të rezultuara si të zhvilluara sipas të dhënave të RDA-së paraqitet më i lartë se numri i seancave të planifikuara në kalendar për të njëjtën periudhë referimi.
- ii. Pavarësisht adresimit të kësaj problematike më herët pranë Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e korrigjuar të seancave të planifikuara, sërish është konstatuar 1 (një) rast mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përsa i përket emrit të gjyqtarit. Konkretisht, në kalendarin e seancave për gjyqtaren Aurora Tusha, lidhur me çështjen me nr. 11002-01902-62-2023, rezulton si pjesë e trupës gjyqtarja Bora Shaholli përgjatë seancave të zhvilluara deri në shtator 2025, kur kjo e fundit është e emëruar në detyrë më datë 22.10.2025. Ndërkohë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, rezulton se pjesë e trupës është gjyqtari Nertil Dushku, ndërkohë që kjo çështje nuk rezulton që të jetë pasqyruar në kalendarin e seancave të këtij të fundit.

### 3.3.3. Korrelacioni midis ngarkesës, planifikimit dhe vendimeve të shpallura

#### I. Kuadri metodologjik dhe kufizimet e analizës

Në funksion të kësaj analize, për çdo gjyqtar janë llogaritur indikatorët vijues:

- Ngarkesa fillestare (çështjet e mbartura më 31.12.2024);
- Çështjet e reja të caktuara gjatë vitit 2025 (short, rishortim dhe manuale);
- Numri i seancave të planifikuara për periudhën 01.01–31.10.2025;
- Numri i çështjeve të përfunduara deri më 20.10.2025.

Analiza mbështetet në të dhëna agregate numerike dhe nuk përfshin informacion të detajuar mbi:

- Natyrën juridike të çështjeve (penale, civile, familjare etj.);
- Kompleksitetin material të tyre;
- Kohëzgjatjen mesatare të seancave;
- Numrin e shtyrjeve për çështje.

Për rrjedhojë, analiza mat dimensionin sasior të aktivitetit, por jo cilësinë apo kompleksitetin real të punës gjyqësore. Në veçanti:

- i. Shkalla e absorbimit të ngarkesës nuk mund të interpretohet si tregues absolut i efikasitetit pa analizuar kompleksitetin material të çështjeve;
- ii. Nuk mund të vlerësohet nëse planifikimi intensiv përkthehet në zgjidhje më të shpejtë të çështjeve apo në rritje të shtyrjeve;
- iii. Produktiviteti numerik nuk duhet barazuar automatikisht me cilësi gjyqësore.

Gjithashtu, disa gjyqtar kanë ushtruar funksionin vetëm për një pjesë të periudhës 10-mujore (për shkak të lejes së lindjes ose transferimeve). Në këto raste, krahasimi linear me gjyqtarët aktivë gjatë gjithë periudhës objekt inspektimi nuk është metodologjikisht i mundur. Analiza është kufizuar në periudhën efektive të ushtrimit të detyrës dhe treguesit agregatë 10-mujorë sipas tabelës përmbledhëse nuk janë plotësisht përfaqësues për këta subjekte.

#### **Klodiana Kryeziu**

- Intensiteti më i lartë i planifikimit (2195 seanca në total për periudhën objekt inspektimi);
- Absorbim shumë i lartë i ngarkesës (656 përfundime nga 725 në total.)  
→ Model i qëndrueshëm i lidhjes lineare ndërmjet planifikimit dhe rezultatit.

#### **Alfred Konomi**

- Ngarkesa më e lartë totale (761)
- 685 çështje të përfunduara
- Intensiteti i lartë i planifikimit (2016 seanca në total për periudhën objekt inspektimi);  
→ Reagim proporcional procedural ndaj volumit.

#### **Genci Busho**

- 655 çështje të përfunduara nga 676
- Intensiteti i lartë i planifikimit (1486 seanca në total për periudhën objekt inspektimi);  
→ Shkallë absorbimi shumë e lartë dhe efikasitet i lartë operacional.

#### **Elira Hroni**

- 622 përfundime nga 669
- Intensiteti i lartë i planifikimit (1486 seanca në total për periudhën objekt inspektimi);  
→ Koherencë e fortë ndërmjet hyrjeve dhe daljeve.

#### **Noel Veizi**

- 420 çështje të përfunduara nga 528  
→ Intensiteti i lartë planifikimi me produktivitet proporcional.

### **Vladimir Cjapi**

- 604 çështje të përfunduara nga 695
- → Intensitet i lartë planifikimi me produktivitet proporcional.

### **Miranda Nakaj**

- 469 çështje të përfunduara nga 680
- → Ngarkesë e lartë, absorbim mesatar; kërkon analizë të natyrës së çështjeve.

### **Nertil Dushku**

- 383 çështje të përfunduara nga 599
- → Nivel i qëndrueshëm.

**Aurora Tusha** - 375 çështje të përfunduara nga 651 çështje në total

**Amantja Levanaj** - 342 çështje të përfunduara nga 638 çështje në total

**Erolda Tarelli** - 229 çështje të përfunduara nga 455 çështje në total

**Iva Bregasi** - 204 çështje të përfunduara nga 453 çështje në total

Në këtë grup konstatohet një raport normal ndërmjet ngarkesës, planifikimit dhe çështjeve të përfunduara. Në rastin e gjyqtareve Aurora Tusha dhe Amantja Levanaj konstatohet ngarkesë e lartë, planifikim mesatar, absorbim mesatar i ngarkesës. Në rastin e gjyqtareve Erolda Tarolli dhe Iva Bregasi konstatohet ngarkesë mesatare, planifikim nën mesatare në raport me ngarkesën, absorbim mesatar i ngarkesës. Në këto raste, faktorë të tillë si kompleksiteti i çështjeve, tipologjia e çështjeve shortuar gjyqtarit dhe modeli organizativ individual mund të kenë ndikim në rezultat.

- **Rastet me periudhë jo të plotë ushtrimi funksioni për shkaqe objektive**

**Gjyqtarët Dajana Ndreja, Juliana Pjetri, Dorina Alushi, Olkeda Liçe, Ersida Bajgora, Gladiola Bregu** (në periudha të caktuara). Për këto raste, analiza duhet të kufizohet në periudhën efektive të ushtrimit të detyrës dhe nuk mund të krahasohet në mënyrë lineare me gjyqtarët që kanë ushtruar funksionin gjatë gjithë periudhës 10-mujore objekt inspektimi.

## **II. Analiza e trendeve javore të planifikimit**

**Gjetje: Analiza javore evidenton tre modele të dallueshme organizative:**

- **Modeli A - Planifikim pothuajse çdo ditë pune (4-5 ditë/javë).** Zakonisht i pranishëm tek gjyqtarët me volum shumë të lartë seancash. Karakterizohet nga stabilitet dhe shpërndarje e ngarkesës.
- **Modeli B - Planifikim 3-4 ditë në javë,** i cili paraqet një ritëm i qëndrueshëm.
- **Modeli C - Planifikim 2-3 ditë në javë.** Duket si modeli tipik organizativ, me shpërndarje ndërmjet seancave dhe kohës për arsyetim.
- **Modeli D - Planifikim 1-2 ditë në javë.** Zakonisht i pranishëm tek gjyqtarët me volum të ulët seancash.

**3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar sipas tabelës së mëposhtme:**

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Totali
Gjyqtari	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali mujor	Totali
Olkeda Liçe	40	0	0	0	0	0	0	0	0	0	40
Ersida Bajgora	9	7	6	0	0	0	0	0	0	0	22
Noel Veizi	88	174	154	222	130	163	160	35	129	208	1463
Alfred Konomi	144	215	202	275	246	235	239	2	169	289	2016
Nertil Dushku	95	147	94	173	111	97	80	1	36	60	894
Gladiola Bregu	77	112	103	135	118	75	88	0	80	0	788
Dajana Ndreja	18	128	91	70	106	0	0	0	0	0	413
Miranda Nakaj	89	194	115	186	165	190	226	24	73	168	1430
Vladimir Cjapi	107	144	158	168	186	165	195	3	107	175	1408
Genci Busho	114	167	123	201	187	194	149	0	152	199	1486
Klodiana Kryeziu	170	245	149	313	271	265	280	11	195	296	2195
Dorina Alushi	30	23	0	0	0	0	0	0	0	0	53
Juliana Pjetri	54	0	0	0	0	0	0	0	0	0	54
Aurora Tushe	36	84	58	107	141	160	79	33	148	146	992
Amantja Levanaj	53	60	99	115	154	141	141	17	158	216	1154
Elira Hroni	86	171	136	231	172	205	176	0	173	223	1573
Iva Bregasi	30	58	62	53	66	78	30	1	45	0	423
Erolda Tarelli	24	62	58	83	77	51	40	26	17	3	441
<b>Total</b>	<b>1264</b>	<b>1991</b>	<b>1608</b>	<b>2332</b>	<b>2130</b>	<b>2019</b>	<b>1883</b>	<b>153</b>	<b>1482</b>	<b>1983</b>	<b>16845</b>
<b>Nr. mesatar mujor në nivel gjykatë</b>	<b>70</b>	<b>111</b>	<b>89</b>	<b>130</b>	<b>118</b>	<b>112</b>	<b>105</b>	<b>9</b>	<b>82</b>	<b>110</b>	<b>936</b>

**4. Konkluzione**

1. Konstatohet mungesë koordinimi efektiv ndërmjet planifikimit të seancave gjyqësore dhe procedurës së miratimit të lejes së zakonshme vjetore. Kjo praktikë ka sjellë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, shtyrjen e seancave të planifikuara dhe, si pasojë, ka ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve.

2. Nga të dhënat e analizuara nuk rezulton një praktikë me karakter sistemik në nivel gjyqate, por një model i lokalizuar organizimi, i lidhur me strategjinë individuale të menaxhimit të kalendarit gjyqësor. Megjithatë ky model organizimi me shumë seanca në një ditë të vetme pune paraqet disa elementë risku që kanë nevojë për vlerësim dhe monitorim. Kjo ngarkesë e përqendruar mund të ngrejë çështje lidhur me cilësinë e shqyrtimit efektiv të çështjeve dhe rrezikun e shtyrjeve për shkak të mbingarkesës orare.
3. Mbivendosja e orareve dhe planifikimi me intervale shumë të shkurtra kohore krijon një perceptim jo të saktë mbi organizimin e punës gjyqësore. Kjo praktikë bëhet shkak për fillimin me vonesë të një ose më shumë seancave gjatë ditës gjyqësore, duke prodhuar efekt zinxhir në oraret vijuese dhe duke ndikuar negativisht në menaxhimin efektiv të kohës dhe në standardin e zhvillimit të rregullt të procesit gjyqësor.
4. Pasaktësitë (mospërputhje) e konstatuara tregojnë problematika në saktësinë e regjistrimeve në kalendar dhe raportimeve statistikore. Evidentohet mungesë e një mekanizmi efektiv verifikimi dhe rakordimi përfundimtar të të dhënave ndërmjet sistemeve përkatëse përpara konfirmimit ose publikimit të tyre.
5. Pasaktësitë e tjera paraqesin mangësi formale në administrimin dhe përditësimin e kalendarit gjyqësor, duke ndikuar në qartësinë dhe saktësinë e të dhënave të publikuara.
6. Katër modelet e identifikuar organizative të planifikimit të seancave nga ana e gjyqtarëve të cilët kanë ushtruar detyrën në periudhën objekt inspektimi (4-5 ditë/javë; 3-4 ditë/javë; 2-3 ditë/javë; 1-2 ditë/javë) dëshmojnë mungesë të një standardi të unifikuar institucional mbi strukturimin minimal të javës gjyqësore. Ndërkohë që fleksibiliteti organizativ është i pranueshëm në parim, variacionet e theksuara ndërmjet gjyqtarëve tregojnë se planifikimi është i orientuar kryesisht nga praktika individuale dhe jo nga një kornizë e harmonizuar menaxheriale. Nga këndvështrimi i inspektimit, kjo situatë paraqet disa elementë problematikë lidhur me mungesën e indikatorëve orientues për shpërndarjen optimale të ditëve të seancave, rrezik potencial për krijimin e diferencave të theksuara në ritmin procedural midis gjyqtarëve, si dhe potencial për pabarazi funksionale në absorbimin institucional të ngarkesës.
7. Nga të dhënat e administruara në kuadër të këtij inspektimi tematik rezulton një korrelacion i fortë pozitiv ndërmjet numrit të seancave të planifikuara dhe numrit të çështjeve të përfunduara. Në shumicën dërrmuese të rasteve, intensiteti i planifikimit procedural përkthehet drejtpërdrejt në produktivitet vendimmarrës, duke treguar se planifikimi ka efekt real në ecurinë e çështjeve. Në planin institucional, konstatohet një përqendrim i konsiderueshëm i performancës në një grup prej disa gjyqtarësh me intensitet të lartë planifikimi dhe nivel të lartë absorbimi të ngarkesës. Ky element nuk përbën problematikë në vetvete, por kërkon monitorim të qëndrueshmërisë dhe balancës së shpërndarjes së ngarkesës në perspektivë afatmesme. Konstatohet gjithashtu një lidhje pozitive ndërmjet ngarkesës totale dhe intensitetit të planifikimit, çka tregon reagim proporcional procedural ndaj volumit të çështjeve. Megjithatë, intensiteti i planifikimit nuk

paraqitet plotësisht uniform në raport me ngarkesën, duke reflektuar variacione që lidhen me stilin individual të menaxhimit të kalendarit.

8. Në referim të Vendimit nr. 476 prot., datë 31.10.2023 i Këshillit të Gjykatës “Për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, si dhe caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e drejtësisë për të mitur”, dhe Vendimit nr. 476/1 prot., datë 31.01.2024 të Këshillit të Gjykatës “Sqarim lidhur me vendimin nr. 476 prot., datë 31.10.2023 ‘Për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, si dhe caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e drejtësisë për të mitur”, konstatohet se, pranë kësaj gjykate në periudhën objekt inspektimi funksionojnë tre trupa gjykues penale dhe tre civile. Ndërkohë nisur nga të dhënat statistikore të përcjella në lidhje me ngarkesën efektive (çështjet të përfunduara, të planifikuara) për secilin gjyqtar, në raport me kolegjin penal/civil pranë të cilit ushtrojnë detyrën, vërehet një ngarkesë tejet e lartë e gjyqtarëve që gjykojnë çështje penale në krahasim me ato që gjykojnë çështje civile, pra vërehet një disbalancë joproporcionale, e cila sjell pasoja në planifikimin e çështjeve nga secili gjyqtar dhe në rendimentin e punës së secilit.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet “aneksi” i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier).*

# Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

## 1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

### 1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

Në funksion të realizimit të inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresë nr. 2924 prot., datë 20.10.2025<sup>[111]</sup>, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ku i është kërkuar informacion dhe dokumentacion.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. 4052/1 prot., datë 30.10.2025<sup>[112]</sup> ka përcjellë informacioni dhe dokumentacionin përkatës, këtë informacion e ka përcjellë me shkresë duke sqaruar ndër të tjera se:

I. Në përgjigje të kërkesës tuaj, nr. 2924 prot., datë 20.10.2025, bazuar në ushtrimin e funksioneve si dhe vendimit tuaj nr. 57, datë 20.10.2025 për kryerjen e inspektimit tematik me objekt "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm" për periudhën 01.01.2025 deri më 31.10.2025, ju bëj me dije se:

a) Statistikat për secilin gjyqtar

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1.	Arbana Selmanaj	219	265	299	185
2.	Dorina Stroka	168	308	295	181
3.	Enkel Peza	249	195	214	230
4	Mirela Mishgjoni	0 (160) <sup>1</sup>	59 (92)	59	-
5	Vjola Canaj	282	285	305	262
6	Artan Cirraga	134	286	332	88
7	Alba Ngresi	180	284	298	166
8	Eranda Cufo	175	287	300	162
9	Fjorald Behari	187	279	312	154
10	Alfred Konomi	1	0	0	1
11	Uran Korra	146	269	300	115
12	Bevil Beqiraj	148	325	322	151
13	Ertit Mecaj	161	307	300	168
14	Te tjere	10	0	0	10
15	Lireza Sinollari	14	224	139	99
<b>TOTALI</b>		<b>2074</b>	<b>3373</b>	<b>3475</b>	<b>1972</b>

i. Bazuar te tabela e sipërcituar e cila është e specifikuar për çdo gjyqtar: - shuma e çështjeve të mbartura nga viti 2024 është 2074.

<sup>111</sup> A). Statistikat e secilit gjyqtar në lidhje me: I. numrin e çështjeve gjyqësore që janë mbartur nga viti 2024 dhe numrin e çështjeve të reja të caktuara gjyqtarit për periudhën 01.01.2025-20.10.2025; II. numrin e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe numrin e seancave për sa i përket secilës çështje të përfunduar gjatë kësaj periudhe. B). Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtar. C). Organikën e miratuar si dhe organikën faktike të gjykatës për numrin e gjyqtarëve. D). Kërkesat për leje dhe vendimet për miratimin e tyre për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025. E). Numrin e sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve.

<sup>112</sup> Protokolluar në ILD me nr. 2924/1 prot., Datë 10.11.2025.

ii. Shuma e çështjeve të reja për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025 është 3373. Shuma e vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 është 3475.

Është e pamundur të gjenerohen nga sistemi numri i seancave të mbyllura për secilën çështje.

b. Kalendari i seancave nxjerrë nga sistemi ICMIS për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 për secilin gjyqtarë i ndarë në muaj.

c. Organika e miratuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është 16 gjyqtarë. Në fakt janë 13 gjyqtarë (3 gjyqtarë janë në proces vettingu me 75%)

d. Kërkesat për leje të gjyqtarëve për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 janë miratuar nga Zëvendeskryetari i Gjykatës të cilat janë si më poshtë vijon:

Enkel Peza -2 (dy) kërkesa

Arbana Selmanaj - 1 (një) kërkesë

Vjola Canaj -1 (një) kërkesë

Mirela Mishgjoni - 4 (katër) kërkesa

Lirëza Sinollari - 2 (dy) kërkesa

Dorina Stroka -4 (katër) kërkesa

Eranda Cufo -5 (pesë) kërkesa

Alba Ngresi - 5 (pesë) kërkesa

Artan Çirraga - 1 (një) kërkesë

Fjorald Behari - 2 (dy) kërkesa

Uran Korra - 1 (një) kërkesë

Bevil Beqiraj - 1 (një) kërkesë

Ertit Meçaj - 3 (tre) kërkesa

e. Numri i sallave për zhvillimin e gjykimeve është 13 (trembëdhjetë).

i. Bashkëlidhur shkresës së gjykatës është përcjellë dokumentacioni lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore në variantin shkresor (gjithsej 1995 faqe), ku nga shqyrtimi dhe vlerësimi paraprak i tyre rezulton se ekzistojnë disa të dhëna kontradiktore lidhur me orën e planifikimit të seancës gjyqësore dhe emrin e gjyqtarit përkatës.

**1.1.1** Për sa më sipër, nga përpunimi i informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, ka lindur nevoja për akte dhe dokumentacion shtesë, të cilat i janë komunikuar Gjykatës,<sup>[113]</sup>

<sup>113</sup> Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, konstatohet se ka mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë për sa i përket emrit të gjyqtarit, konkretisht:

- Në kalendarin e seancave për datën 27.01.2025, pasqyrohet se gjyqtare Eranda Cufo ka planifikuar dy seanca në ora 09:30, për çështje të ndryshme konkretisht, (i) në sallën 12 për çështjen nr. 23004-01732-61-2024 dhe (ii) në sallën 08 për çështjen me nr. 21234-00722-61-2024. Nga verifikimi paraprak,

duke kërkuar informacion shtesë, me shkresën nr. 2924/2 prot., datë 20.11.2025<sup>[114]</sup>. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. 4234/1 prot., datë 27.11.2025<sup>[115]</sup> ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës, duke sqaruar ndër të tjera se:

*Në lidhje me kalendarin e seancave të planifikuara, nuk rezulton të ketë mospërputhje përse i përket emrit të gjyqtarit si dhe planifikimit të seancave. Konkretisht çështja nr. 23004-01732-61-2024 është shortuar dhe relatore ka qenë gjyqtare Mirela Mishgjoni, e cila gjykonte në sallën nr. 12 dhe e kishte planifikuar këtë çështje për gjykim në datë 27.01.2025 ora 09.30. Pas largimit nga detyra të gjyqtares Mirela Mishgjoni me vendimin e KPA, dosjet u rishortuan dhe çështja e sipërcituar i kaloi si relatore gjyqtares Eranda Cufo.*

*Çështja nr. 21234-00722-61-2024 është shortuar dhe i kaloi si relatore gjyqtares Eranda Cufo e cila gjykon në sallën nr.8 dhe e kishte planifikuar gjykimin në datë 27.01.2025 ora 09.30.*

*Regjistri i veprimeve (RIV) i ka të pasqyruara të gjitha shortimet/rishortimet dhe arsyet.*

**Sa më sipër rezulton se gjykimet janë planifikuar nga gjyqtare të ndryshëm, por sistemi ICMIS pas rishortimit të çështjeve nuk i fshin të dhënat e mëparshme, gjë që nuk mund të bëhet nga IT e Gjykatës. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me çështjet nr. 23004-01196-61-2023 dhe 53101-03242-61-2021 si dhe çështje të tjera të rishortuara pas largimit të gjyqtarëve nga procesi i vetting-ut.**

Bashkëlidhur shkresës edhe aktet:

- 1- Rregullore e brendshme e gjykatës.
- 2- Analiza vjetore për vitin 2024
- 3- Raportet 3-mujore drejtuar KLGJ-së për vitin 2025

*procesverbalet e seancave përkatëse, rezulton se ka mospërputhje të këtyre të dhënave. Konstatohet se ka qenë gjyqtare Mirela Mishgjoni ajo që ka planifikuar dhe zhvilluar seancën për çështjen e parë, ndërsa çështja e dytë është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtare Eranda Cufo.*

*- E njëjta situatë është konstatuar edhe në lidhje me planifikimin e seancës datë 29.01.2025 nga gjyqtari Fjoral Behari, i cili ka planifikuar dy seanca në ora 09:30, për çështje të ndryshme konkretisht, (i) në sallën 12 për çështjen nr. 23004-01196-61-2023 dhe (ii) në sallën 13 për çështjen me nr. 53101-03242-61-2021. Nga verifikimi paraprak, procesverbalet e seancave përkatëse, rezulton se ka mospërputhje të këtyre të dhënave. Konstatohet se ka qenë gjyqtare Mirela Mishgjoni ajo që ka planifikuar dhe zhvilluar seancën për çështjen e parë, ndërsa çështja e dytë është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtar Fjoral Behari.*

<sup>114</sup> Rregullorja e brendshme e gjykatë, Analiza Vjetore për vitin 2024, Raportet 3-Mujore drejtuar KLGJ-së për vitin 2025, Të dhëna mbi seancat që janë zhvilluar në salla me sistemin audio dhe në zyre të gjyqtarit, për çdo muaj, brenda periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025. Këto të dhëna, të jenë për çdo gjyqtar duke specifikuar edhe pozicionin e tij në trupën gjyqësore kryetar/relator apo anëtar, Lista e çështjeve të rishortuara për secilin gjyqtar gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025, urdhrat e kryetarit të gjykatës në lidhje me ndarjen e sallave për periudhën 01.01.2025 31.10.2025; Urdhra për gatishmërinë e gjyqtareve për periudhën 01.01.2025-31.10.2025.

<sup>115</sup> Protokolluar në ILD me nr. 2931/3 prot., datë 02.12.2025.

- 4- RDA (raportet për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat) për çdo muaj për secilin gjyqtar
- 5- Organika mujore
- 6- Miratimet e lejeve dhe raportet mjekësore të gjyqtarëve
- 7- Listat e çështjeve të rishortuara
- 8- Urdhrat e Zv/Kryetarit në lidhje me ndarjen e sallave të gjykimit.
- 9- Urdhrat e gatishmërisë

ii. Informacioni i përcjellë është në formë shkresore (gjithsej 1997 faqe), i cili ka përfshirë Rregulloren e brendshme të gjykatës; Analiza vjetore për vitin 2024; Miratimet e lejeve dhe raportet mjekësore të gjyqtarëve; Urdhrat e Zv/Kryetarit në lidhje me ndarjen e sallave të gjykimit; Urdhrat e gatishmërisë dhe një pjesë e Raporteve të Planifikimit të seancave gjyqësore të ndarë në sipas gjyqtarëve të ndryshëm.

**1.1.2** Nisur nga disa mangësi në dokumentacionin dhe informacionin e përcjellë nga Gjykata, është kërkuar sërish informacion dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me emailin e datës 09.01.2026 dhe në formë shkresore më datë 12.01.2026,<sup>[116]</sup> ka dërguar sërish informacion duke bashkëlidhur informacionin e kërkuar.

## **2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative**

### **2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi**

Referuar akteve të përcjella nga gjykata si dhe komunikimi i vazhdueshëm me gjykatën, ndër të tjera informon se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka dy urdhra të brendshëm të nxjerra nga ushtruesi i detyrës së kryetarit “Zv/Kryetari” për ndarjen e sallave, gjatë vitit 2024 dhe 2025.

Urdhër viti 2024<sup>[117]</sup>:

Vjola Canaj	- Salla 1
Hektor Sinanaj	- Salla 3
Fjorald Behari	- Salla 3
Artan Cirraga	- Salla 4
Laurent Fucia	- Salla 5
Enkel Peza	- Salla 6
Lireza Sinollari	- Salla 7
Eranda Cufo	- Salla 8

Urdhër i vitit 2025<sup>[118]</sup>:

Ertit Mecaj	- Salla 2
Renata Kocaqi	- Salla 3
Etien Isak	- Salla 3
Bevil Beqiraj	- Salla 4
Uran Kurra	- Salla 6

<sup>116</sup> Protokolluar në ILD me nr. 2931/5 prot., datë 12.01.2026.

<sup>117</sup> Urdhër nr. 80 prot., datë 19.02.2024 “Për ndarjen e sallave të gjykimit”.

<sup>118</sup> Urdhër nr. 457 prot., 04.11.2025 “Për ndarjen e sallave të gjykimit”.

Alba Ngresi - Salla 9  
Dorina Stroka - Salla 10  
Arbana Selmanaj - Salla 11  
Mirela Mishgjoni - Salla 12  
Emirjana Dimo - Salla 13

Nga sa më sipër rezulton se gjyqtarët kanë pasur disponibilitet të plotë në salla gjyqësore të përcaktuara për secilin prej tyre dhe ngarkesa rezulton në sallën nr. 3, ku kanë gjykuar gjyqtarët Fjorald Behari, Hektor Sinanaj (i cili është pezulluar me vendimin datë 13.03.2024 të KPK) dhe gjyqtarët Renata Kocaqi dhe Etien Isak (të emëruar gjyqtarë pranë kësaj gjykate në datën 22 tetor 2025).

Gjithashtu në sallën nr. 4 rezulton të kenë zhvilluar seancat gjyqësore, gjyqtarët Artan Çirraga dhe Bevil Beqiraj, ndërsa në sallën 6 gjyqtarët Enkel Peza dhe Uran Kurra.

**2.1.1. Lidhur me organikën e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë rezulton se gjyqtarët të cilët kanë ushtruar detyrën pranë kësaj Gjykate janë si më poshtë:**

1. Herila Çela - Pezulluar me vendimin date 31.11.2023 të KPK
2. Hektor Sinanaj - Pezulluar me vendimin date 13.03.2024 të KPK
3. Laurent Fuça - Pezulluar me vendimin datë 25.07.2024 të KPA
4. Arqile Basho - Pezulluar me vendimin datë 15.12.2021 të KPK
5. Mirela Mishgjoni - Shkarkuar nga detyra me vendimin date 03.04.2025 të KPA
6. Vjola Canaj - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
7. Arbana Selmanaj - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
8. Enkel Peza - Transferuar në Gjykatën Tiranë më datë 17.09.2025 (vendim KLGJ)
9. Lireza Sinollari - Kthyer nga Leja e lindjes më datë 18.02.2025.
10. Dorina Stroka - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
11. Artan Çirraga - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
12. Alba Ngresi - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
13. Fjorald Behari - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
14. Ertil Meçaj - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
15. Bevil Beqiraj - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
16. Uran Korra - Në detyrë pranë kësaj Gjykate
17. Etien Isak - Emëruar pranë kësaj Gjykate më datë 22.10.2025 (vendim KLGJ)
18. Renata Kocaqi - Emëruar pranë kësaj Gjykate më datë 22.10.2025 (vendim KLGJ)

Organika e miratuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është 16 gjyqtarë. Në fakt janë 13 gjyqtarë (3 gjyqtarë janë në proces vettingu me 75%) dhe të tjerët (nga numri 6 në nr. 18 më lart) ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate.

Pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë rezultojnë në disa procese gjyqësore edhe magjistrati Alfred Konomi (në 8 seanca gjyqësore për periudhën e inspektimit), i cili është Gjyqtar pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

### **2.1.2. Lidhur me Rregulloren e brendshme, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vendosur në dispozicion një kopje të Rregullores, miratuar me Urdhrin nr. 41, datë 15.02.2018, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”**

Rregullorja në fuqi nuk ka të parashikuar në dispozitat e saj parashikime lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga trupa e magistratëve në funksion të shpërndarjes sa më të drejtë të seancave gjyqësore për të mënjanuar mbingarkesën në trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe respektimin dhe garantimin e të drejtave ligjore e procedurale të palëve në proceset gjyqësore. Dispozita të përgjithshme janë të identifikueshme por jo plotësisht të mjaftueshme në funksion të planifikimit të përshtatshëm të seancave gjyqësore, të tilla si neni 4<sup>[119]</sup> dhe 27<sup>[120]</sup> i kësaj rregulloreje.

Nga verifikimi i seancave të planifikuara për secilin gjyqtar nuk konstatohen probleme në drejtim të mbarëvajtjes së procesit të planifikimit dhe realizimit, nuk janë evidentuar përplasje oraresh në të njëjtën sallë nga gjyqtarë të ndryshëm pasi edhe numri i sallave në dispozicion të Gjykatës është i lartë (13 salla gjyqësore).

### **2.2. Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim

<sup>119</sup> Neni 4, “Misioni dhe Veprimtaria”: Administrata Gjyqësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka për mision ndjekjen dhe përmbushjen e veprimtarisë procedurale nëpërmjet shërbimeve që ofron në mbështetje të veprimtarisë gjyqësore, si dhe realizimin e përmbushjes së veprimtarisë administrative. Administrata gjyqësore është e ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të paanësisë, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi

<sup>120</sup> Neni 27, “Etika, solemniteti dhe disiplina e gjyqtarëve dhe sekretarit të seancës”, 1. Gjyqtarët marrin masa që të fillojnë zhvillimin e seancave gjyqësore në orarin e parashikuar. Në çdo rast kur kjo nuk realizohet, sekretarja e seancës, edhe kryesisht apo me njoftimin e gjyqtarit duhet të pasqyrojë në procesverbalin e seancës shkakun e vonësës...

procedurat e zhvillimit të gjykimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Çështje gjyqësore shpërndahen në mënyrë transparente, nëpërmjet shortit elektronik të zhvilluar nëpërmjet sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Gjithashtu si rezultat i azhurnimit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS dhe plotësimi i trupave gjyqësore bëhet me short elektronik në sistem.<sup>[121]</sup>

Në pikën II.a “Menaxhimi i Seancave Gjyqësore” të Raportit Vjetor, “Analiza e të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitin 2024”, Gjykata shprehet se: “Gjyqtarët trajtojnë me prioritet çështjet që janë urgjente dhe sensitive ndërsa dakordësojnë me palët rregullisht për aq sa është e mundur, për kalendarin e gjykimit të çështjes gjyqësore. Çështjet gjyqësore që u janë caktuar me anë të shortit elektronik, vihen në lëvizje sa më shpejt të jetë e mundur duke respektuar afatet që parashikon ligji...<sup>[122]</sup>

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka gjithsej 13 salla gjykimi me sistem audio dhe në 3 salla gjykimi audio mund të gjykohet personat e arrestuar/ndaluar pasi janë të pajisura me vendqëndrime për të arrestuarit/pandehurit.

### 2.2.1. Shqyrtimi dhe analizimi i “Raportit të Planifikimit të Çështjeve në Gjykim”

Materialet dhe informacioni i dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën e regjistruar me nr. 2924/1 prot., datë 10.11.2025, rezulton bashkëlidhur edhe lista e çështjeve për gjykim për periudhën 01 Janar 2025 deri më 31 Tetor 2025.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i materialeve bashkëlidhur rezultoi se lista është përcjellë pranë Zyrës së ILD-së në formatin *pdf*, të printuar. Në momentin e parë të konstatimit është kërkuar nga Gjykata ridërgimi i Raportit në një format më të aksesueshëm me qëllim nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave (*word* ose *excel*). Në përgjigje të kërkesës tonë është sqaruar pamundësia për ta paraqitur materialin në format të ndryshëm nga (*pdf*) pa dëmtuar përmbajtjen e materialit.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i materialit të përcjellë (ilustruar më poshtë për datën 29.01.2025) rezulton se Raporti është gjeneruar për të gjithë gjyqtarët së bashku në mënyrë kronologjike për muaj të ndryshëm.

<sup>121</sup> Analiza e të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitin 2024. Pika II, Procesi i punës në Gjykatë.

<sup>122</sup> Analiza e të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitin 2024. Pika II, a “Menaxhimi i Seancave Gjyqësore”.

## LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM

DATA: 29/01/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTARË
803	11:00:00	06	23004-01623-61-2024	Eali Ijazi [Paditës] Albjon Cili [i Paditur]	Enkel Peza
804	11:00:00	11	10901-01013-61-2023	Bir Vongli [Paditës] Meris Vongli [Paditës] Piro Vongli [Paditës] Mihal Vongli [Paditës] Sofia Hoxha [Paditës] Katina Merini [Paditës] Vasilqi Boci Vongli [i Paditur]	Arbana Selmanaj
805	11:00:00	13	56325-01542-61-2022	Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë [Kërkuar] Ledjon Hysaj (Hamili) [i Pandehur]	Fjorëfë Behari
806	11:00:00	10	71108-01842-61-2023	Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuar] Përsoni juridik Valona Konstruksion [i Pandehur]	Dorina Straka
807	11:00:00	02	58345-01689-61-2024	Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuar] Ana Hurdia [i Pandehur]	Enri Meçaj
808	11:00:00	06	21234-02063-61-2023	Arifete Biçe [Paditës] Shoqëria Original Marines sh.p.k [i Paditur]	Alba Agnesi
809	11:00:00	01	11232-02630-61-2025-R	Shoqëria Gjiri sh.p.k [Paditës] Besnik Muharemi [i Paditur]	Vjola Canaj
810	11:00:00	06	21264-01040-61-2024	Vladimir Gjeva [Paditës] Shoqëria Ajetrol sh.a [i Paditur]	Eranda Culo
811	11:00:00	06	71028-00280-61-2023	Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë [Kërkuar] Mihal Baniu [i Pandehur] Dhora Beja [Viktima] Thimo Beja [Viktima]	Enkel Peza

## Ilustrim A.

Për sa më sipër, për të realizuar verifikimin e çështjeve të planifikuara nga secili gjyqtar, nevojitet kryerja e numërimit dhe verifikimit manual të çështjeve për çdo datë të paraqitur në raportin përmbledhës. Për këtë arsye, në mënyrë që të lehtësohet përpunimi i të dhënave, është aksesuar edhe sistemi i Gjykatës duke nxjerrë nga seksioni i Menaxhimit të Gjykatës, raporte lidhur me secilin gjyqtar për periudhën objekt inspektimi.

Nga verifikimi i këtyre raporteve rezultoi se paraqitja e të dhënave, për secilin gjyqtar, bëhet në bazë të Sallave të ndryshme në të cilat është bërë planifikimi i seancave gjyqësore, duke paraqitur të dhënat në një mënyrë të papërshtatshme për të kuptuar kronologjinë (*ditë pas dite*) të planifikimit të seancave gjyqësore. Për këtë arsye është kërkuar sërish asistencë e Gjykatës për të realizuar nxjerrjen e të dhënave për secilin gjyqtar por në një rend kronologjik duke filluar nga data 1 Janar 2025 deri më datë 31 Tetor 2025. Edhe ky informacion i mbërritur nga Gjykata është në formë shkresore, material *pdf*, dhe përpunimi i të cilit duhej të realizohej manualisht. Mbi bazën e këtij materiali është bërë përpunimi i të dhënave për secilin gjyqtar për periudhën objekt i këtij inspektimi.

*\* Nga gjykata bëhemi me dije se Raportet e nxjerra nga gjykata për secilin gjyqtar në mënyrë kronologjike, (duke evituar paraqitjen me bazë sallat e gjykimit) janë realizuar nga sistemi ICMIS por nga llogaritë në sistem të secilit gjyqtar, pasi është e pamundur për ta realizuar këtë nga përdorues të tjerë të autorizuar.*

### 2.3. Dokumentacioni fizik (regjistrat) i ndodhur në gjykatë për sa i përket pasqyrimit të seancave.

Gjykata informon se, për sa i përket numrit të seancave për secilën çështje të përfunduar, kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, janë gjeneruar nga sistemi ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të

gjykimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Regjistri në lidhje me planifikimit të seancave përmban, Sallën, Datën<sup>[123]</sup>:

Nr.	Ora	Salla	Nr. Çështjes	Palët	Gjyqtari
-----	-----	-------	--------------	-------	----------

\*Regjistri i vendosur në dispozicion nga gjykata për secilin gjyqtarë është i njëjtë me atë që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS.

### 3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

#### 3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nga përpunimi i dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 konstatohet se nga viti 2024 janë mbartur 2074 çështje dhe janë regjistruar 3373 çështje për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 të shpërndara si më poshtë për secilin gjyqtar:

##### a) Statistikat për secilin gjyqtar

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1.	Arbana Selmanaj	219	265	299	185
2.	Dorina Stroka	168	308	295	181
3.	Enkel Peza	249	195	214	230
4	Mirela Mishgjoni	0 (160) <sup>1</sup>	59 (92)	59	-
5	Vjola Canaj	282	285	305	262
6	Artan Cirraga	134	286	332	88
7	Alba Ngresi	180	284	298	166
8	Eranda Cufo	175	287	300	162
9	Fjoral Behari	187	279	312	154
10	Alfred Konomi	1	0	0	1
11	Uran Korra	146	269	300	115
12	Bevil Beqiraj	148	325	322	151
13	Ertit Mecaj	161	307	300	168
14	Te tjere	10	0	0	10
15	Lireza Sinollari	14	224	139	99
<b>TOTALI</b>		<b>2074</b>	<b>3373</b>	<b>3475</b>	<b>1972</b>

\*Organika e miratuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është 16 gjyqtarë. Aktualisht pranë kësaj gjykate ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë

<sup>123</sup> Sipas tabelave të përcjella nga gjykata, si dhe nga verifikimi në ICMIS.

(pasi 3 gjyqtarë janë në proces vettingu me 75%), ndërkohë që efektivisht ushtrojnë detyrën vetëm 12 magjistratë pasi gjyqtari Enkel Peza është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 17.09.2025.

\*Nuk vërehen dhe nuk janë raportuar problematika lidhur me përdorimin e sallave të gjykimit. Numri i sallave të gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është 13 salla. Gjyqtarët kanë pasur disponibilitet të plotë në salla gjyqësore të përcaktuara për secilin prej tyre, nëpërmjet dy vendimeve të Zv/Kryetarit të gjykatës për ndarjen e sallave të gjykimit.

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. 4052/1 prot., datë 30.10.2025, ndër të tjera informon se mbi vendimet e shpallura nga secili gjyqtarë për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025 referuar konkretisht si më poshtë:

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara
1	Alba Ngresi	285
2	Arbana Selmanaj	289
3	Artan Çirraga	322
4	Bevil Beqiraj	299
5	Dorina Stroka	278
6	Enkel Peza	198
7	Eranda Cufo	285
8	Ertit Meçaj	295
9	Etien Isak	3
10	Fjorald Behari	300
11	Lirëza Sinollari	129
12	Mirela Mishgjoni	55
13	Uran Kurra	288
14	Vjola Canaj	304
	<b>TOTALI:</b>	<b>3330</b>

Për t'u mbajtur në konsideratë fakti se:

- Gjyqtare Mirela Mishgjoni është shkarkuar me vendimin e KPA-së datë 03.04.2025.
- Gjyqtare Lirëza Sinollari ka ushtruar efektivisht detyrën duke filluar nga data 17.02.2025 me mbarimin e lejes së lindjes.
- Gjyqtari Enkel Peza është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 17.09.2025.
- Gjyqtari Etien Isak është emëruar pranë kësaj Gjykate me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 22.10.2025.

**3.3. Nga përpunimi i të dhënave për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 rezulton se gjyqtarët kanë planifikuar seanca gjatë ditëve të javës, sipas tabelës së mëposhtme:**

Gjyqtarët	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel	Total
Arbana Selmanaj	211	217	285	214	7	12	6	952
Dorina Stroka	255	305	290	257	20	8	11	1146
Enkel Peza	134	210	193	17	16	8	1	579
Mirela Mishgjoni	22	6	11	10	9	5	2	65
Vjola Canaj	279	319	364	380	30	14	7	1393
Artan Cirraga	348	352	322	63	15	13	10	1123
Alba Ngresi	242	310	334	208	28	25	6	1153
Eranda Cufo	273	355	331	190	40	12	15	1216
Fjorald Behari	337	364	386	48	9	13	2	1159
Uran Korra	232	344	306	73	6	9	13	983
Bevil Beqiraj	319	362	382	41	18	6	13	1141
Ertit Mecaj	277	332	344	110	21	8	19	1111
Lirëza Sinollari	91	107	91	43	9	5	4	350
<b>Totali</b>	<b>3020</b>	<b>3583</b>	<b>3639</b>	<b>1654</b>	<b>228</b>	<b>138</b>	<b>109</b>	<b>12371</b>

*\* Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura në formë tabelare si më lart (ashtu dhe në format excel) vihet re një tendencë për planifikimin e seancave gjyqësore kryesisht në ditët e para të javës, (të hënë deri ditën e mërkurë) dhe duke ulur numrin e seancave të planifikuara për ditët në vijim (të enjten), nga një pjesë e gjyqtarëve dhe ditën e premte nga të gjithë gjyqtarët.*


Kjo tendencë mund të konstatohet lehtësisht edhe në paraqitjen statistikore të paraqitur në tabelë dhe tabelën në formatin excel bashkëlidhur këtij raporti, ku numri i seancave gjyqësore të planifikuara gjatë ditëve të javës (përfshirë këtu ditën e shtunë dhe të premte), fillon më 3020 çështje të planifikuara ditëve të Hëna, duke u rritur ky numër në

ditët e marta me 3583 çështje, më pas arrihet kulmi në ditën e mërkurë me 3639 çështje të planifikuara dhe duke zbritur më pas eksponencialisht ditën e enjte me 1654 çështje dhe një rënie drastike e këtij numri ditën e premte me vetëm 228 çështje të planifikuara për një periudhë 10-mujore.

\*Ndryshe e shprehur në përqindje, kjo e dhënë mund të reflektohet si vijon:<sup>[124]</sup>

- E hënë - 24.4 % të seancave gjyqësore.
- E Martë - 28.9% të seancave gjyqësore.
- E Mërkurë - 29.4% të seancave gjyqësore.
- E Enjte - 13.3% të seancave gjyqësore.
- E Premte - 1.8% të seancave gjyqësore.

Planifikimi i seancave gjyqësore për të gjithë gjyqtarët 1 Janar 2025 – 31 Tetor 2025.



### 3.3.1. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar

Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e planifikimeve të seancave rezulton se planifikimi i seancave përgjatë ditëve të javës është i ndryshëm për secilin gjyqtar, ndaj dhe për këtë arsye po i paraqesim si më poshtë:

Ditët e Javës / Gjyqtari	Numri i seancave të planifikuara për gjyqtar për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025, të përpunuara për çdo ditë të javës .												
	Arbana Selmanaj	Dorina Stroka	Enkel Peza	Mirela Mishgjoni	Vjola Canaj	Artan Cirraga	Alba Ngresi	Eranda Cufo	Fjorald Behari	Uran Korra	Bevil Beqiraj	Ertit Meca	Lireza Sinollari
Hënë	211	255	134	22	279	348	242	273	337	232	319	277	91
Martë	217	305	210	6	319	352	310	355	364	344	362	332	107
Mërkurë	285	290	193	11	364	322	334	331	386	306	382	344	91
Enjte	214	257	17	10	380	63	208	190	48	73	41	110	43

<sup>124</sup> Kjo statistikë shërben vetëm për të ilustruar trendin e përgjithshëm të planifikimit të seancave gjyqësore duke mbajtur parasysh rezervën se kjo e dhënë është e ndryshme për gjyqtarë të ndryshëm.

*(Handwritten signatures and marks)*

Premte	7	20	16	9	30	15	28	40	9	6	18	21	9
Shtunë	12	8	8	5	14	13	25	12	13	9	6	8	5
Diel	6	11	1	2	7	10	6	15	2	13	13	19	4
<b>Totali</b>	<b>952</b>	<b>1146</b>	<b>579</b>	<b>65</b>	<b>1393</b>	<b>1123</b>	<b>1153</b>	<b>1216</b>	<b>1159</b>	<b>983</b>	<b>1141</b>	<b>1111</b>	<b>350</b>

➤ Totali i çështjeve gjyqësore të planifikuara është: 12371

\*Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura si më lart vihet re një tendencë për planifikimin e seancave gjyqësore kryesisht në ditët e para të javës, (të hënë deri ditën e mërkurë) dhe duke ulur numrin e seancave të planifikuara për ditët në vijim (të enjten), nga një pjesë e gjyqtarëve dhe ditën e premte nga të gjithë gjyqtarët.

\*Ashtu siç është paraqitur edhe më lart, planifikimi i seancave gjyqësore është realizuar duke u përqendruar në tre ditët e parë të javës (24.4 %, 28.9% dhe 29.4%) dhe duke planifikuar më pak ditët e mbetura (13.3 % dhe 1.8%)<sup>[125]</sup> seanca gjyqësore, gjë e cila mund të pasjellë edhe mbingarkesë fiktive të seancave në ditët e para të javës dhe vonesa në fillimin dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore. Një fenomen i tillë mund të jetë objekt diskutimi në mbledhjen e gjyqtarëve pranë kësaj gjykate në funksion të mirëfunksionimit të gjykatës, shpejtësisë në realizimin e proceseve gjyqësore dhe planifikimit më objektiv dhe funksional të seancave gjyqësore nga të gjithë gjyqtarët.

### **3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me përputhjen e të dhënave të hedhura në regjistrin fizik si dhe në sistemin elektronik (procesverbalet e seancave) përsa i përket numrit të seancave**

*U përdor një kampionim i qëllimshëm, ku u përzgjedhën disa dosje nga tabela statistikore, duke marrë nga një ose dy dosje për secilin gjyqtar në mënyrë të shpërndarë (nga fillimi, mesi ose fundi i tabelës), me qëllim sigurimin e një kontrolli përfaqësues të përputhjes së të dhënave ndërmjet regjistrit fizik dhe sistemit elektronik.*

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk mban regjistra fizik për planifikimin e seancave, por vetëm regjistrin që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS, nga krahasimi i regjistrit të vendosur në dispozicion nga gjykata dhe atij të gjeneruar nga sistemi ICMIS, konstatohen se janë të njëjtët.

Nga verifikimi i Raportit mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore si dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore të marra me kampionim për disa çështje specifike konstatohen disa problematika kryesore, të cilat po i paraqesim si më poshtë:

<sup>125</sup> Shih pikën 3.3 të Raportit.

**i. Verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të marra me kampionim.**

1. Seanca gjyqësore e datës 05.02.2025, ora 11:30, salla 01, Gjyqtare znj. Vjola Canaj, numri i Çështjes: 21001-01498-61-2024. Zhvillohet seanca audio (11:37:40 – 11:42:59), gjyqtarja prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore (05.02; 04.03; 08.05), gjyqtarja ka qenë prezent. Vendimmarrja më datë 08.05.2025.
2. Seanca gjyqësore e datës 27.02.2025, ora 11:30, salla 12, Gjyqtar z. Uran Kurra, numri i Çështjes: 21001-01541-61-2024.

Shënim nga sistemi i Gjykatës: *Seanca e datës 27.02.2025, ora 11.30 nuk u çel për shkak se gjyqtaria e çështjes Mirela Mishgjoni sipas shkresës date 14.02.2025, te Kryetarit të Gjykatës z. Enkel Peza, Gjyqtaria është duke kryer një pjese te lejes vjetore sipas ligjit nr. 96/2016 nga data 25.02.2025-27.02.2025 dhe 03.03.2025-06.03.2025 qe konsiston ne 7 (shtate) dite pune.*

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore (21.01; 27.02 – me Gjyqtare të çështjes znj. Mirela Mishgjoni), dhe (12.05; 04.06; 01.07; 15.09 me gjyqtar të çështjes z. Uran Kurra) gjyqtari ka qenë prezent. Vendimmarrja më datë 15.09.2025.

\*Në sistemin e Gjykatës, Lista e çështjeve për gjykim, rezulton emri i gjyqtarit Uran Kurra edhe ne seancat e datës 21.01 dhe 27.02, ku gjyqtare ka qenë znj. Mirela Mishgjoni.

Data e Seancës	Orari i Seancës	Gjyqtari	Tipi i Dispozitivit	Pëtesuar nga Arkiva
21/01/2025	10:34-11:00	Mirela Mishgjoni		<input type="checkbox"/>
27/02/2025	10:56-12:00	Mirela Mishgjoni		<input type="checkbox"/>
12/05/2025	14:30-14:45	Uran Kurra		<input type="checkbox"/>
04/06/2025	11:00-11:15	Uran Kurra		<input type="checkbox"/>
01/07/2025	12:30-12:45	Uran Kurra		<input type="checkbox"/>
15/09/2025	12:30-12:45	Uran Kurra	Pranimi Pade	<input type="checkbox"/>

Ilustrim N

3. Seanca gjyqësore e datës 12.03.2025, ora 11:30, salla 11, gjyqtare znj. Arbana Selmanaj, numri i çështjes: 11115-01320-61-2014. Zhvillohet seanca audio (11:12:46 – 12:14:12), gjyqtarja prezent. Gjatë vitit 2025 është zhvilluar vetëm 1 seancë gjyqësore (12.03.2025). Është vendosur vijimi i pezullimit pasi nuk ka rënë shkak.

Rezultoni se koha e pasqyruar e zhvillimit të seancës nuk përputhet me kohën faktike të zhvillimit të seancës, pasi gjyqtare Arbana Selmanaj rezulton në të njëjtën orë edhe në një seancë tjetër gjyqësore me trupë gjyqësore, me nr. çështje

21013-01776-61-2024, nga procesverbali i të cilës rezulton se seanca është çelur në orën (11:46:22) dhe ka përfunduar në orën (11:50:48).

\*Për sa më sipër, paraqitja e kohëzgjatjes së seancave gjyqësore mund të shfaqet e tillë për shkak të mbivendosjes së seancave dhe veprime të sekretarisë gjyqësore në sistemin e gjykatës.

4. Seanca gjyqësore e datës 27.03.2025, ora 11:00, salla 10, Gjyqtare znj. Dorina Stroka, numri i Çështjes: 21250-00769-61-2024. Zhvillohet seanca audio (11:22:33 – 11:55:48), gjyqtarja prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore (23.01; 19.02; 27.03) dhe gjyqtarja ka qenë prezent. Është vendosur pranimi i padisë.

\*Rezulton se nisja me vonesë e seancës gjyqësore vjen për shkak të planifikimit dhe zhvillimit të seancës gjyqësore të çështjes nr. 520005-01555-61-2024, në të njëjtën orë, e cila ka nisur 10:59:13 dhe ka përfunduar 11:19:41.

5. Seanca gjyqësore e datës 14.05.2025, ora 09:30, salla 2, Gjyqtar z. Ertit Meçaj, numri i Çështjes: 21282-02215-61-2023. Zhvillohet seanca audio (09:38:12 – 09:47:27), gjyqtari prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 11 seanca gjyqësore (14.05; 14.06; 23.06; 14.07; 17.09; 01.10; 14.10; 17.10; 05.11; 18.11 dhe 17.12) dhe gjyqtari ka qenë prezent. Përjashtim bën vetëm seanca gjyqësore e datës 23.06.2025 ku seanca është shtyrë për shkak se gjyqtari ka qenë më raport mjekësor.

Përrunuar: [ ]  
Ijykim i Shkurtuar: 30  
Statusi i Gjykimit: Shtyrje  
Arsyeja: Seancat gjyqësore të planifikuara në datën 23.06.2025 nuk do të zhvillohen  
Koha e Fillimit: 11:00  
Gjyqtari: Ertit Meçaj  
Padites: [ ]  
I Paditur: [ ]  
Palëti: Aurora Zenelaj, Zyra Përbërëse Vjetro, Lulash Zenelaj  
Provati: [ ]  
Regjistrim Audio: Po  
Data e Seancës: 27/03/2025  
Koha e Mbarimit: 11:55  
Salla e Gjyqit: 10  
Procesverbali:  
Sancat gjyqësore të planifikuara në datën 23.06.2025 nuk do të zhvillohen për shkak se Gjyqtar Ertit Meçaj është më raport mjekësor

Ilustrim O.

6. Seanca gjyqësore e datës 28.05.2025, ora 12:30, salla 7, gjyqtar z. Bevil Beqiraj, numri i çështjes: 21239-01959-61-2023. Zhvillohet seanca audio (1:00 – 1:27:29), gjyqtari prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 9 seanca gjyqësore (08.04; 06.05; 28.05; 30.06; 22.09; 28.10; 18.11; 10.12 dhe 18.12) dhe gjyqtari ka qenë prezent. Përjashtim bën vetëm seanca gjyqësore e datës 22.09.2025 ku seanca është shtyrë për shkak se gjyqtari është në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës. (shënim në procesverbalin e seancës).

Rezulton se seanca e datës 28.05.2025, ka nisur me vonesë pasi seanca gjyqësore e planifikuar më herët (ora 12:00), lidhur me çështjen me nr. 11232-00388-61-

2025, ka zgjatur tej pritshmërive duke nisur në 12:13:21 dhe ka përfunduar në 12:54:47.

7. Seanca gjyqësore e datës 16.09.2025, ora 13:15, salla 1, gjyqtare znj. Vjola Canaj, numri i çështjes: 71016-01195-61-2025. Zhvillohet seanca audio (1:26:56 – 1:30:30), gjyqtari prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore (16.09; 14.10 dhe 30.10) dhe gjyqtari ka qenë prezent. Në seancën e datës 30.10.2025 ka disponuar me vendim pranimin e kërkesës.
8. Seanca gjyqësore e datës 30.09.2025, ora 09:30, salla 12, gjyqtari z. Artan Çirraga, numri i çështjes: 23004-01069-61-2025. Zhvillohet seanca audio (09:54:19 – 10:23:13), gjyqtari prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore (23.07; 08.09; 17.09 dhe 30.09) dhe gjyqtari ka qenë prezent. Në seancën e datës 30.09.2025 ka disponuar me vendim pranimin e pjesëshëm të padisë.  
Nuk janë të shënuar arsyet pse seanca ka nisur me vonesë, ndërkohë që edhe seanca e planifikuar më parë në kohë (ora 9:00) ka nisur dhe ka përfunduar në kohë.
9. Seanca gjyqësore e datës 01.10.2025, ora 11:30, salla 13, gjyqtare znj. Dorina Stroka, numri i çështjes: 21234-00893-61-2023. Zhvillohet seanca audio (11:30:28 – 12:13:43), gjyqtarja prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 8 seanca gjyqësore (27.01; 27.02; 15.04; 27.05; 10.07; 01.10; 05.11 dhe 13.11), në të cilat gjyqtarja ka qenë prezent, dhe është vendosur pranimi i padisë.  
Rezulton se në datën 01.10.2025 nga e njëjta gjyqtare është planifikuar edhe një tjetër seancë gjyqësore në orën 11:30, e cila i përket çështjes me nr. 520003-01101-61-2025, e cila rezulton se ka nisur me vonesë (12:17:38), reflektuar shënimi edhe në procesverbalin e seancës.
10. Seanca gjyqësore e datës 08.10.2025, ora 11:00, salla 08, gjyqtare znj. Eranda Cufo, numri i çështjes: 21234-01422-61-2024, nga verifikimi i rastit, në Procesverbalin e seancës arsyetohet se seanca e planifikuar nuk do të zhvillohet, bazuar në procesverbalin e datës 07.10.2025 të mbledhjes të trupës gjyqësore të kësaj gjykate kanë vendosur “Për pezullimin e seancave gjyqësore për datat 07.10.2025 - 10.10.2025” në shenjë reagimi institucional dhe solidariteti ndaj ngjarjes se ndodhur ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm z. Astrit Kalaja.

#### Procesverbali:

##### PROCES-VERBAL – ADMINISTRATIV

Seanca e planifikuar për ditën e sotme nuk do të zhvillohet, bazuar në procesverbalin e datës 07.10.2025 të mbledhjes të trupës gjyqësore të kësaj gjykate kanë vendosur “Për pezullimin e seancave gjyqësore për datat 07.10.2025-10.10.2025” në shenjë reagimi institucional dhe solidariteti ndaj ngjarjes se ndodhur ndaj Gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, z. Astrit Kalaja.

Seanca e sotme me urdher dhe porosi të gjyqtarës do të shtyhet për në datën 10.11.2025 Ora 11:00


*Ilustrim R.*

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore (08.10; 10.11 dhe 09.12), ku në dy seancat muajit nëntor dhe dhjetor, gjyqtarja ka qenë prezent.

11. Seanca gjyqësore e datës 21.10.2025, ora 14:15, salla 08, gjyqtari z. Fjoral Behari, numri i çështjes: 11232-01378-61-2025, nga verifikimi i rastit, në Procesverbalin e seancës sqarohet se gjykata ka disponuar me vendim duke rrezuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit. Në procesverbalin e seancës është shënuar orari i fillimit të seancës në orën 14:15, ndërkohë në sistemin e Gjykatës paraqitet orari i seancës 15:15 – 15:16. Nuk kuptohen arsyet e paraqitjes së ndryshme të të dhënave në lidhje me fillimin e seancës gjyqësore.

Në seancën gjyqësore të mëparshme, që i takon çështjes me nr. 21001-01330-61-2025, planifikuar në orën 14:00, në vendimmarrjen e gjykatës arsyetohet se arsyet e vonesës janë për shkak të zgjatjes tej afateve të seancave të mëparshme, ilustruar më poshtë.

Procesverball:



*Ilustrim S.*

12. Seanca gjyqësore e datës 29.10.2025, ora 12:00, salla 13, gjyqtare z. Lirëza Sinollari, numri i çështjes: 21264-01886-61-2024. Zhvillohet seanca audio (12:05:23 – 12:31:44), gjyqtari prezent. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore (29.10; 03.11; dhe 03.12) dhe gjyqtari ka qenë prezent.

## **ii. Planifikimi dhe zhvillimi i seancave gjyqësore në të njëjtën orë:**

Rasti 1.

Në kalendarin e seancave për datën 27.01.2025, pasqyrohet se gjyqtare Eranda Cufo ka planifikuar dy seanca në ora 09:30, për çështje të ndryshme konkretisht, (i) në sallën 12 për çështjen nr. 23004-01732-61-2024 dhe (ii) në sallën 08 për çështjen me nr. 21234-00722-61-2024. Nga verifikimi paraprak, procesverbalet e seancave përkatëse, rezulton se ka mospërputhje të këtyre të dhënave.

Gjykata, lidhur me këtë rast ka sqaruar se në lidhje me kalendarin e seancave të planifikuara, nuk rezulton të ketë mospërputhje përsa i përket emrit të gjyqtarit si dhe planifikimit të seancave. Konkretisht çështja e parë me nr. 23004-01732-61-2024 është shortuar dhe relatore ka qenë gjyqtare Mirela Mishgjoni, e cila gjykonte në sallën nr. 12 dhe e kishte planifikuar këtë çështje për gjykim në datë 27.01.2025 ora 09.30. Pas largimit

nga detyra të gjyqtares Mirela Mishgjoni me vendimin e K.P.A, dosjet u rishortuan dhe çështja e sipërcituar i kaloi si relatore gjyqtares Eranda Cufo.

Çështja nr. 23004-01732-61-2024 është regjistruar më datë 22.10.2024 dhe më pas është shortuar tek gjyqtare Mirela Mishgjoni e cila ka planifikuar seancën gjyqësore në datë 27.01.2025. Seanca e radhës gjyqësore është caktuar më datë 05.03.2025.

Nisur nga Vendimi i KPA-së për shkarkimin e magjistrates Mirela Mishgjoni, çështja është rishortuar pranë gjyqtares Eranda Çufo. Ndërkohë rezulton se në Raportin e Planifikimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton vetëm emri i gjyqtares përfundimtare të çështjes, znj. Eranda Çufo, duke ndryshuar kështu edhe të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga gjyqtarët respektiv.

LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM  
DATA: 27/01/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTARË
576	09:00:00	02	21250-01409-61-2024	Pushime Kasaj [Kërkues] DRSSH Vlore [Person i Tretë]	Ertit Meçaj
577	09:30:00	12	23004-01732-61-2024	Ledja Zoto [Pacitës] Leonard Zoto [i Paditur]	Eranda Cufo
578	09:30:00	13	53805-01390-61-2024	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdikcionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkues] Merigen Luto [i Pandehur] Endri Nenaj [Persona Nën Hetim]	Fjorald Behari
579	09:30:00	08	520003-01590-61-2024	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdikcionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkues] Liljana Mano (Shytë) [Palë e Interesuar]	Alba Ngresi
580	09:30:00	02	21250-01477-61-2024	Elisabeta Canaj [Kërkues] DRSSH VLORE [Person i Tretë]	Ertit Meçaj
581	09:30:00	08	21234-00722-61-2024	Alfred Zyka [Pacitës] Minevera Shenaj [Pacitës] Vullnet Zyka [Pacitës] Vajsi Zyka [Pacitës] Liljana Kobuzi [Pacitës] Meriza Koka [Pacitës] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike [i Paditur] Operatori i Sistemit të Shpërndarjes [i Paditur]	Eranda Cufo
582	09:45:00	10	10935-00480-61-2024	Juljan Mamushi [Pacitës] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike-GROUP [i Paditur] Furnizuesi Universal i Shërbimit [i Paditur] Operatori i Sistemit të Shpërndarjes [i Paditur]	Dorina Stroka
583	10:00:00	03	53806-01726-61-2024	Adriatik Gjina [i Pandehur] Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdikcionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkues]	Artan Çirraga

10/31/2025

Page 90

## Ilustrim B.

*\*Nisur edhe nga komunikimet me gjykatën si dhe nga konstatimet në analizimin e të dhënave, rezulton se sistemi ICMS në paraqitjen e këtij raporti, parashikon vetëm emrin e gjyqtarit përfundimtar të çështjes duke i atribuuar edhe të gjitha seancat gjyqësore të planifikuara ose të zhvilluara më parë, tek gjyqtari i fundit i çështjes. Kjo passjell paraqitjen e të dhënave të gabuara statistikore, të cilat ekspertojnë më pas gabimin edhe në Raportimet e Gjykatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.*

## Rasti 2.


E njëjta situatë është konstatuar edhe në lidhje me planifikimin e seancës datë 29.01.2025 nga gjyqtari Fjorald Behari, i cili ka planifikuar dy seanca në ora 09:30, për çështje të ndryshme konkretisht, (i) në sallën 12 për çështjen nr. 23004-01196-61-2023 dhe (ii) në sallën 13 për çështjen me nr. 53101-03242-61-2021. Nga verifikimi paraprak, procesverbalet e seancave përkatëse, rezulton se ka mospërputhje të këtyre të dhënave. Konstatohet se ka qenë gjyqtare Mirela Mishgjoni ajo që ka planifikuar dhe zhvilluar seancën për çështjen e parë, ndërsa çështja e dytë është planifikuar dhe zhvilluar nga gjyqtar Fjorald Behari.

Çështja me nr. 23004-01196-61-2023, është regjistruar më datë 12.06.2023 dhe shortuar fillimisht pranë Gjyqtarit Hektor Sinanaj. Në datën 12.11.2024 kjo çështje i është rishortuar gjyqtares Mirela Mishgjoni, e cila ka planifikuar në datën 29.01.2025. Në datën 25.04.2025 për shkak të vendimit të KPA për ish magjistraten Mirela Mishgjoni, çështja është rishortuar pranë Gjyqtarit Fjoral Behari, i cili ka planifikuar më pas edhe tre seanca të tjera në datën 23.06.2025; 09.07.2025 dhe 16.09.2025.

Ashtu si dhe në rastin e parë të konstatuar më lart, edhe në këtë rast kemi të bëjmë me paraqitjen e gabuar të të dhënave lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore për shkak të gabimeve të sistemit.

Rasti 3.

Në kalendarin e seancave për datën 03.03.2025, pasqyrohet se gjyqtari Erti Meçaj ka planifikuar dy seanca në ora 10:30, për çështje të ndryshme konkretisht, (i) në sallën 12 për çështjen nr. 23004-01588-61-2024 dhe (ii) në sallën 02 për çështjen me nr. 23012-01759-61-2024. Nga verifikimi paraprak, procesverbalet e seancave përkatëse, rezultojnë se ka mospërputhje të këtyre të dhënave.

  
 REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORE  
 LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM  
 DATA: 03/03/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTAR\E
1	09:00:00	02	50100-01711-61-2024	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuues] Antonio Shanaj [i Pandehur] Xhino Tari [i mitur në konflikt me ligjin] Rei Mataj [Persona Nën Hetim]	Erti Meçaj
2	09:30:00	02	50149-00167-61-2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuues] [i Akuzuar] Olga Bell [Palë e Interesuar]	Erti Meçaj
3	10:00:00	02	21271-01762-61-2023	Kristaq Monçe [Paditës] OSHIE Group sh.a Tirane [i Paditur] Furnizuesi i Shterbimeve Universal [i Paditur]	Erti Meçaj
4	10:30:00	12	23004-01588-61-2024	Klaudia Hekurani [Paditës] Eduard Bani [i Paditur]	Erti Meçaj
5	10:30:00	02	23012-01759-61-2024	Anjeza Lela [Paditës] Edison Malaj [i Paditur]	Erti Meçaj
6	11:00:00	02	23004-00225-61-2025	Ergys Skëndaj [Paditës] Vjola Rrapaj [i Paditur]	Erti Meçaj
7	11:30:00	02	23004-00250-61-2025	Rudina Balliaj [Paditës] Skerdian Ballaj [i Paditur]	Erti Meçaj
8	12:00:00	02	71001-00248-61-2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuues] Memisha Dredhaj [Palë e Interesuar]	Erti Meçaj

Ilustrim C.

Nga verifikimi pranë sistemit ICMIS të Gjykatës, rezultoi se çështja e parë me nr. 23004-01588-61-2024 është shortuar fillimisht pranë gjyqtares Mirela Mishgjoni, dhe seanca e datës 03.03.2025 është seancë e planifikuar nga kjo gjyqtare dhe nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja është me leje vjetore. (shënim nga sistemi)<sup>126</sup> Kjo çështje i është rishortuar gjyqtarit Erti Meçaj më datë 25.04.2025 pas vendimit të KPA lidhur me gjyqtaren Mirela Mishgjoni.

<sup>126</sup> Seanca e datës 03.03.2025, ora 10.30, nuk u çel për shkak se gjyqtaria e çështjes Mirela Mishgjoni sipas shkresës datë 14.02.2025, të Kryetarit të Gjykatës z. Enkel Peza. Gjyqtaria është duke kryer një pjesë të lejes vjetore sipas ligjit nr. 96/2016 nga data 25.02.2025-27.02.2025 dhe 03.03.2025-06.03.2025 që konsiston në 7 ( shtatë) ditë pune.- 08.04.2025,ora 11:30. Afati i gjatë i caktimit të seancës gjyqësore për shkak të ngarkesës në punë dhe faktit që gjyqtarja është me leje -Të njoftohen palët.

Ndërkohë lidhur me çështjen e dytë gjyqësore me nr. 23012-01759-61-2024, rezulton e regjistruar pranë kësaj Gjykate në datën 24.10.2024 dhe është shortuar pranë gjyqtarit Ertit Meçaj në këtë datë. Ndërsa seanca gjyqësore e planifikuar për datën 03.03.2025 ka nisur në orën 10:40:03 dhe është shtyrë për mungesën e justifikuar të përfaqësuesit ligjor të palës. (mbyllur seanca në orën 10:41:44).

Në Raportin e Planifikimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton vetëm emri i gjyqtarit përfundimtar të çështjes, z. Ertit Meçaj, duke ndryshuar kështu edhe të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga gjyqtarët respektiv dhe në këtë rast rezulton se është një seancë gjyqësore e cila nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja e çështjes znj. Mirela Mishgjoni ka qenë më leje vjetore.

Rasti 4.

Në datën 05.06.2025, referuar Listës së çështjeve për gjykim, rezulton se gjyqtare Arbana Selmanaj ka planifikuar seancë gjyqësore në orën 10:30, për çështjen me nr. 10900-00523-61-2024 në sallën me nr. 11. Në të njëjtën orë, 10:30, gjyqtare Arbana Selmanaj ka planifikuar edhe seancën gjyqësore për çështjen me nr. 21235-00767-61-2022.

Nga verifikimi i rastit në sistemin e Gjykatës rezulton se lidhur me çështjen me nr. 10900-00523-61-2024, është çelur seanca gjyqësore në datën 05.06.2025, në orë 10:20:57 dhe është mbyllur në orën 10:50:51. (Foto ilustrim nga sistemi, më poshtë)

Procesverbali:

<b>Description</b>	10900-00523-61-2024	
<b>Date</b>	6/5/2025	<b>Location</b> Salla 11
<b>Time</b>	<b>Speaker</b>	<b>Note</b>
10:20:57 AM		Celet senaca per kryerjen e veprimeve per gatitore te ceshtjes civile me nr 1161 date 12.03.2024.
Verifikohet prezenca e paleve		

Ilustrim D.

Ndërkohë që lidhur me çështjen me nr. 21235-00767-61-2022, edhe kjo e planifikuar në orën 10:30, në sallën 11, nga verifikimi në sistemin e gjykatës rezulton se procesverbali është çelur në orën 10:20:57 (e njëjtë me orën në çështjen e cituar më lart) por është mbyllur në orën 11:11:23. (Foto ilustrim nga sistemi, më poshtë)

Procesverbali:

<b>Description</b>	21235-00767-61-2022	
<b>Date</b>	6/5/2025	<b>Location</b> Salla 11
<b>Time</b>	<b>Speaker</b>	<b>Note</b>
10:20:57 AM		Celet seanca per gatitore per shqyrtimin e ceshtjes civile me nr 1216/10.05.2022.
Verifikohet prezenca e paleve		

Arsyet e Voneses:

Ilustrim E.

\*Për sa më lart, nga verifikimi i të dhënave në sistemin e gjykatës, rezulton se të dyja çështjet gjyqësore janë planifikuar të zhvillohen në datën 05.06.2025 në orën 10:30 në sallën gjyqësore nr. 11, dhe të dyja seancat rezultojnë të çelura në orën 10:20:57, por të përfunduara në orare të ndryshme, duke krijuar dyshimin se pavarësisht se janë çelur në të njëjtën orë, janë zhvilluar njëra pas tjetrës, duke pasjellë më pas edhe vonesa në fillimin e çështjeve të radhës me nr. çështje 21250-00914-61-2024.

Rasti 5.

Në datën 01.10.2025, referuar Listës së çështjeve për gjykim, rezulton se gjyqtari Fjoralid Behari ka planifikuar seancë gjyqësore në orën 12:00, për çështjen me nr. 21246-00165-61-2025 në sallën me nr. 13. Në të njëjtën orë, 12:00, ka planifikuar edhe seancën gjyqësore për çështjen me nr. 21234-01458-61-2024.

E njëjta situatë është përsëritur në të njëjtën ditë, për seancat vijuese pasi në orën 13:00 ka planifikuar seancë gjyqësore për çështjen me nr. 50527-00095-61-2025 në sallën me nr. 13. Në të njëjtën orë, 13:00, ka planifikuar edhe seancën gjyqësore për çështjen me nr. 21235-02046-61-2024.

**LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM**  
DATA: 01/10/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTARË
6	12.00.00	13	21246-00165-61-2025	Niqita Zoto [i Paditur] Kleanthi Zoto [i Paditur] Irakli Zoto [i Paditur] Agjencia e Kombit dhe Kompenzimit te Pronave [i Paditur] Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Palubehrove Vlore [i Paditur] Keshilli i Ministrave i Republikës se Shqiperise [i Paditur]	Fjoralid Behari
7	12.00.00	13	21234-01458-61-2024	Hyso Rapaj [i Paditur] CSPIHES sh.p [i Paditur] FSHU [i Paditur]	Fjoralid Behari
8	13.00.00	13	50527-00095-61-2025	Prokuroria prane Gjykatës se Shkallës se Pare te Jurisdikcionit te Pergjithshem Vlore (Kërkues) Davido Tushaj [i Paditur] Bujar Cingerrima [i Paditur] Përsoni Juridik Cingerrima shpk [i Paditur] Gj. Troci [i Paditur] Kledion Ramaj [i Paditur] Zambak Selmani [i Paditur] Mansur Ismaili [i Paditur] Elisado Shebanaj [i Paditur] Abdoo Imami [i Paditur] Alfred Murgu [i Paditur]	Fjoralid Behari
9	13.00.00	13	21235-02046-61-2024	Shoqëria "Erva-Zin" shpk [i Paditur] Shoqëria "Biva 2000" shpk [i Paditur] Shoqëria "Kuteri" shpk [i Paditur]	Fjoralid Behari
10	13.30.00	13	21283-00973-61-2024	Vasa Ceausni [i Paditur] Shoqëria "Chima Konstruksion" shpk [i Paditur]	Fjoralid Behari
11	14.00.00	13	21017-01270-61-2025	Mariol Gava [i Paditur] Lando Foni [i Paditur]	Fjoralid Behari

Ilustrim F.

Nga verifikimi i rasteve në sistemin e Gjykatës rezulton se lidhur me çështjen me nr. 21246-00165-61-2025, është çelur seanca gjyqësore në datën 01.10.2025, në orë 12:33:20 (pra 33 minuta me vonesë) dhe është mbyllur në orën 12:46:17. (Foto ilustrim nga sistemi, më poshtë).

Procesverbali:

Description 21246-00165-61-2025		
Date	10/1/2025	Location Salla 13
Time	12:33:20 PM	Note
Speaker		Celet seanca per shqyrtimin e ceshtjes civile me nr. 1074 akti date rregjistrimi 29.01.2025, me pale paditese: Keshilli i Ministrave i Republikës se Shqiperise, I paditur : Niqita Zoto, Kleanthi Zoto, Irakli Zoto, etj me objekt: Detvrimit nër nishie

Arsyet e Vonës:

Ilustrim G.

Ndërkohë që lidhur me çështjen me nr. 21234-01458-61-2024, edhe kjo e planifikuar në orën 12:00, në sallën 13, nga verifikimi në sistemin e Gjykatës rezulton se procesverbali është çelur në orën 12:21:01 (21 minuta me vonesë) dhe është mbyllur në orën 12:26:20 (Foto ilustrim nga sistemi, më poshtë).

Procesverball:

Description	21234-01458-61-2024		
Date	10/1/2025	Location	Salla 13
Time	Speaker	Note	
12:21:01 PM		Celet seanca per shqyrtimin e ceshtjes civile nr.1603 akti date rregjistrimi 11.10.2024, me pale paditese :Hyso Rapaj : pale e paditur O.SH.E.E sh.a ,FSHU ,me object: Detyrimi I paleve te paditura te paguajne demin e shkatuar ne nriekti si dhe nalciave	

Arsyet e Voneses:

Ilustrim H.

E njëjta situatë paraqitet edhe për seancat në vijim planifikuar në orën, 13:00, ku seanca me nr. 50527-00095-61-2025 është çelur në orën 13:23:28 (23 minuta me vonesë) dhe ka përfunduar në orën 13:28:04, ndërkohë që seanca gjyqësore me nr. 21235-02046-61-2024 është çelur në orën 13:11:38 (11 minuta me vonesë) dhe ka përfunduar në orën 13:16:29.

*\*Për sa më lart, nga verifikimi i të dhënave në sistemin e Gjykatës, rezultojnë se konstatohen në disa raste planifikime të çështjeve seancave gjyqësore në të njëjtën orë për çështje të ndryshme, duke pasqyruar më pas edhe vonesat në fillimin e çështjeve të radhës. Për këtë arsye nevojitet të realizohet një planifikim më i drejtë dhe i saktë i seancave gjyqësore në përputhje me kalendarin digjital dhe/ose atë manual që mbajnë gjyqtari dhe sekretaria gjyqësore. Një problematikë e tillë nevojitet të adresohet edhe në mbledhjen e gjyqtarëve me qëllim rritjen e efikasitetit të planifikimit të seancave dhe mënjanimin e përplasjeve të orareve të njëjta për çështje të ndryshme, duke respektuar të drejtat e palëve në proces.*

### iii. Planifikimi i seancave gjyqësore për çështjet me trupë prej tre gjyqtarësh

Rasti 1.

Në datën 11.03.2025, referuar Listës së çështjeve për gjykim, rezultojnë se gjyqtare Eranda Cufo ka planifikuar seancë gjyqësore në orën 11:00, për çështjen me nr. 520005-00733-61-2024 në sallën me nr. 08. Në të njëjtën orë, 11:00, rezultojnë e planifikuar edhe seanca gjyqësore për çështjen me nr. 520003-00255-61-2025 në sallën me nr. 08, si dhe rezultojnë e planifikuar edhe seanca me trupë gjyqësore për çështjen me nr. 21013-00052-61-2025.

#### LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM

DATA: 11/03/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALËT	GJYQTARË
46	09:00:00	13	56328-00766-61-2024	Prokuroria prane Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuës] Lorenç Xhaferi [i Padëhur] Ledjon Zahaj [i Padëhur] Dëftrim Pashaj [Pala e Interesuar] Gentjan Metushi [i Padëhur] Anxhelo Pashaj [Pala e Interesuar] Edmond Begaj [Pala e Interesuar]	Bevël Beqiraj Eranda Cufo Fjoralid Behari
47	09:30:00	08	23012-01558-61-2024	Ened Alikaj [Paditës] Sara Kume [i Paditur]	Eranda Cufo
48	10:00:00	12	21234-01138-61-2022	Deli Habibaj [Paditës] Shoqëria Desi shpk [i Paditur] Zyra Përbarimtare Vlorë [Person i Tretë]	Eranda Cufo
49	10:00:00	08	21264-01592-61-2024	Enriko Fejzo [Paditës] Bashkia Vlorë [i Paditur]	Eranda Cufo
50	10:30:00	08	21234-01931-61-2023	Etleva Kondi [Paditës] Thimio Boci [i Paditur]	Eranda Cufo
51	11:00:00	13	21013-00052-61-2025	Brunilda Avdiraj [Kërkuës] Sektori i Ndhimes dhe Shërbimeve Sociale, Komuna Shushice [Person i Tretë]	Eranda Cufo Fjoralid Behari Vjola Cenej
52	11:00:00	08	520005-00733-61-2024	Prokuroria prane Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuës] Personi juridik Rascala Boats [i Padëhur] Daniele Rizzo [i Padëhur]	Eranda Cufo
53	11:00:00	08	520003-00255-61-2025	Prokuroria prane Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuës]	Eranda Cufo
54	11:30:00	08	53801-00273-61-2025	Prokuroria prane Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuës] Anxhelo Mato [i Padëhur]	Eranda Cufo

12/2/2025

Page 12

## Ilustrim J.

Nga verifikimi i rasteve në sistemin e gjykatës rezulton se lidhur me çështjen me nr. 520005-00733-61-2024, është çelur seanca gjyqësore në datën 11.03.2025, në orën 10:57:44 dhe është mbyllur në orën 11:06:39. (Foto ilustrim nga sistemi, më poshtë).

Description	520003-00255-61-2025		
Date	3/11/2025	Location	Salla 8
Time	Speaker	Note	
10:57:44 AM		Celim seancen per shqyrtimin e ceshtjes penale. Verifikohet prezenca e paleve.	

## Ilustrim I.

Ndërkohë lidhur me çështjen me nr. 520003-00255-61-2025, është çelur seanca gjyqësore në datën 11.03.2025, në orë 11:06:52 (d.m.th., në mbarim të seancës së cituar më lart) dhe është mbyllur në orën 11:14:30.

Lidhur me seancën e tretë gjyqësore të planifikuar për datën 11.03.2025 e cila i përket çështjes me nr. 21013-00052-61-2025, e cila është më trupë gjyqësore: Eranda Cufo, Fjorald Behari dhe Vjola Canaj, nga verifikimi në sistemin e Gjykatës rezultoi se kjo çështje është regjistruar më datë 20.01.2025 dhe është shortuar pranë Gjyqtarit të vetëm Fjorald Behari. Në seancën përgatitore të datës 11.03.2025 është konstatuar se çështja objekt gjykimi duhet të gjykohet me trup gjykues dhe për sa më sipër është shtuar paneli gjykues me gjyqtarët Eranda Cufo dhe Vjola Canaj.<sup>[127]</sup> Vetëm në seancën e datës 21.05.2025 (ora 09:00), është zhvilluar me prezencën e trupës gjyqësore përfshirë gjyqtaren Eranda Cufo, e cila përpara kësaj date nuk ka qenë gjyqtare e ngarkuar me shqyrtimin e çështjes.

*\*Për sa më sipër, rezulton se në datën 11.03.2025, jo vetëm janë planifikuar nga Gjyqtarja dy seanca gjyqësore në të njëjtën orë, (të cilat nuk kanë sjellë vonesa në seancat pasardhëse) por gjithashtu nga shfaqja e të dhënave në sistemin ICMIS rezulton se gjyqtare Eranda Cufo ka qenë pjesë e trupës gjyqësore edhe në një seancë tjetër në të njëjtën orë. Ndërkohë që kjo seancë nuk është zhvilluar me trupe gjyqësore në datën 11.03.2025 por vetëm me prezencën e gjyqtarit të vetëm. Vetëm në datën 21.05.2025 kjo çështje është zhvilluar me trupë gjyqësore. Paraqitja e të dhënave në Listën e çështjeve për gjykim rezulton e gabuar duke paraqitur çështjen gjyqësore si çështje me trupë gjyqësore që në fillim dhe planifikimin e seancave në mënyrë të gabuar duke ndryshuar të dhënat për gjyqtarët respektive Eranda Cufo dhe Vjola Canaj, për datën 11.03.2025.*

<sup>127</sup> Pjesë nga Vendimi Nr. 61-2025-1690 (295) datë 21.05.2025: "Gjithashtu, me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, gjyqtari i vetëm, bazuar në nenin 35 të K. Pr. Civile, i kërkoi Zv/Kryetarit të Gjykatës plotësimin e trupit gjykues pasi çështja objekt gjykimi duhet të gjykohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Nga shorti elektronik i zhvilluar, trupë gjykues u plotësua me gjyqtarët Eranda Cufo dhe Vjola Canaj".

Rasti 2.

Në datën 02.06.2025, referuar Listës së çështjeve për gjykim, rezulton se gjyqtari Artan Çirraga ka planifikuar seancë gjyqësore në orën 11:00, për çështjen me nr. 23004-00307-61-2025 në sallën me nr. 12. Në të njëjtën orë, 11:00, rezulton e planifikuar edhe seanca me trupë gjyqësore për çështjen me nr. 21253-00936-61-2024.

Nga verifikimi i rasteve në sistemin e Gjykatës rezulton se lidhur me çështjen me nr. 23004-00307-61-2025, është çelur seanca gjyqësore në datën 02.06.2025, në orë 11:10:25 dhe është mbyllur në orën 11:18:20.

Ndërkohë lidhur me çështjen me nr. 2125300936-61-2024, e cila është më trupë gjyqësore: Artan Cirraga, Fjoral Behari dhe Vjola Canaj, nga verifikimi në sistemin e Gjykatës rezultoi se kjo çështje është regjistruar më datë 27.05.2025 dhe është shortuar pranë Gjyqtarit të vetëm Fjoral Behari. Në seancën e datës 31.10.2025 është konstatuar se çështja objekt gjykimi duhet të gjykohet me trup gjykues me tre anëtarë dhe për sa më sipër është shtuar paneli gjykues me gjyqtarët Artan Cirraga dhe Vjola Canaj.<sup>[128]</sup>

03/11/2025	..... Seanca u planifikua. Numri i Çështjes:21253-00936-61-2024,Data e Planifikuar:2025/11/13 14:00:00	Dolores Zemanaj
31/10/2025	U aktivizua Trupi Gjykues në Çështje	Fjoral Behari
31/10/2025	Studimi i çështjes u ruajt. Arsyja:kjo ceshtje do te gjykohet me trup gjykues e perbere nga tre anetare.	Dolores Zemanaj
08/10/2025	.	Dolores Zemanaj

#### Ilustrim nga RIV

Vetëm në seancën e datës 13.11.2025 (ora 02:10), është zhvilluar me prezencën e trupës gjyqësore përfshirë gjyqtarin Artan Cirraga, i cili përpara kësaj date nuk ka qenë gjyqtar e ngarkuar me shqyrtimin e çështjes.<sup>[129]</sup>

Në Raportin e Planifikimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se çështja gjyqësore me trupë gjykuese prej tre gjyqtarësh në të gjitha seancat e planifikuara pavarësisht faktit se paneli i gjyqtarëve është shtuar vetëm në datën 31.10.2025, duke ndryshuar kështu edhe të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga gjyqtarët respektivë përgjatë vitit.

<sup>128</sup> Pjesë nga vendimi nr. 61-2025-1690 (295) vendimi datë 21.5.2025: “Gjithashtu, me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, gjyqtari i vetëm, bazuar në nenin 35 të K. Pr. Civile, i kërkoi Zv/Kryetarit të Gjykatës plotësimin e trupit gjykues pasi çështja objekt gjykimi duhet të gjykohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Nga shorti elektronik i zhvilluar, trupi gjykues u plotësua me gjyqtarët Eranda Cufo dhe Vjola Canaj”.

<sup>129</sup> Pjesë nga procesverbali i seancës: “Gjykata bën me dije palët se trupi gjykues është i plotësuar nga dy anëtarë të tjerë përveç gjyqtarit –Fjoral Behari, anëtarë të trupit janë gjyqtarët Artan Çirraga dhe Vjola Canaj”.

Rasti 3.

Në datën 18.06.2025, referuar listës së çështjeve për gjykim, rezultoi se gjyqtare Alba Ngresi ka planifikuar seancë gjyqësore në orën 09:00, për çështjen me nr. 23004-00805-61-2025 në sallën me nr. 09. Në të njëjtën orë, 09:00, rezultoi e planifikuar edhe seanca me trupë gjyqësore për çështjen me nr. 50192-01900-61-2022. Në po të njëjtën ditë, rezultoi e planifikuar seanca gjyqësore në orën 10:30 për çështjen me nr. 21013-02755-61-2022 R, me trupë gjyqësore, si dhe seanca për çështjen me nr. 23004-00802-61-2025 në të njëjtën orë.

LISTA E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM  
DATA: 18/06/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTARË
97	09:00:00	09	23004-00805-61-2025	Anisa Leka [Paditës] Minella Leka [I Paditur]	Alba Ngresi
98	09:00:00	13	50192-01900-61-2022	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë [Kërkuar] Besnik Sinanaj [I Pandehur] Enesa Xhakollari [I Pandehur] Igli Tari [I Pandehur] Kevin Bora [I Pandehur] Robert Lushaj [I Pandehur]	Alba Ngresi/ Ertil Meçaj/ Fjoralid Behari
99	09:30:00	09	23005-02068-61-2024	Elisbona Çela [Paditës] Renard Çelo [I Paditur]	Alba Ngresi
100	10:00:00	09	21014-01614-61-2024	Tomor Demiraj [Kërkuar] Ondra e Personal Rekrutimit Tirane (Person i Tretë)	Alba Ngresi
101	10:30:00	11	21013-02755-61-2022-R	Tomor Hoxhaj [Kërkuar] Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë [Falë e Interesuar]	Alba Ngresi/ Arbana Selimani/ Dorina Stroka
102	10:30:00	09	23004-00802-61-2025	Anisa Nazaj [Paditës] Arben Nazaj [I Paditur]	Alba Ngresi
103	11:00:00	09	21234-01145-61-2024	Ornelisa Sadiku [Paditës] Kroftina Naka [I Paditur]	Alba Ngresi
104	11:30:00	09	23009-06804-61-2024	Luan Hodaj [Paditës] Shoqëria Tregtare Albatrol sht.a [I Paditur]	Alba Ngresi
105	12:00:00	09	50149-01702-61-2023	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [Kërkuar] Haxhido Vespa [I Pandehur]	Alba Ngresi
106	13:00:00	09	23000-00190-61-2024	Mihal Golloshi [Paditës] Shoqëria Albatrol sht.a [I Paditur]	Alba Ngresi

Ilustrim K.

Nga verifikimi i rasteve në sistemin e Gjykatës rezultoi se lidhur me çështjen me nr. 23004-00805-61-2025, është çelur seanca gjyqësore në datën 18.06.2025, në orë 8:57:48 dhe është mbyllur në orën 9:02:39.

Ndërkohë lidhur me çështjen me nr. 50192-01900-61-2022, e cila është më trupë gjyqësore: Alba Ngresi, Fjoralid Behari dhe Ertil Meçaj, nga verifikimi në sistemin e Gjykatës rezultoi se kjo çështje është regjistruar më datë 04.11.2022 dhe është shortuar pranë Gjyqtarit të vetëm gjyqtarit H. Sinanaj dhe pasi ka kaluar me short elektronik nga një gjyqtar në tjetër, përfundimisht: “Nga shorti elektronik i datës 8.5.2025 çështja objekt gjykimi i kaloi në cilësinë e kryesuesit gjyqtarit F. Behari me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët M. Mishgjoni dhe A. Ngresi në kushtet kur gjyqtare M. Mishgjoni ndodhet në pamundësi të ushtrimit të funksionit për shkak të vendimit të Komisionit të Posaçëm të Apelimit, me kërkesën e datës 17.4.2025 i është kërkuar Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë plotësimi i trupit gjykues me 1 (një) anëtar. Më datë 22.4.2025 trupi gjykues u plotësua me gjyqtarin E. Meçaj.”<sup>[130]</sup>

Seanca e datës 18.06.2025 ka nisur në orën 9:26:09 (26 min., me vonesë) dhe ka përfunduar në orën 9:29:13. Rezultoi se në këtë rast kemi të bëjmë me përplasje oraresh

<sup>130</sup> Pjesë nga vendimi 61-2025-2598, datë 23.07.2025 i gjyqtarëve Fjoralid Behari, Alba Ngresi dhe Ertil Meçaj.

ndërmjet proceseve si gjyqtar i vetëm dhe proceseve ku gjyqtarja ka qenë në cilësinë e anëtares së trupës gjyquese.

*\*Ajo që bie në sy është fakti se në paraqitjen e seancave gjyqësore sipas Listës së Çështjeve në Gjykim, gjeneruar nga sistemi, edhe seancat gjyqësore të planifikuara përpara datës 08.05.2025 (datë kur është caktuar me short përbërja përfundimtare e trupit gjykues), rezulton se të dhënat paraqesin si trup gjykues gjyqtarët Alba Ngresi, Fjoralid Behari dhe Ertit Meçaj të cilët nuk rezultojnë gjyqtarë përpara kësaj date, duke ndryshuar kështu të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore për gjyqtarët përkatës. (shih shembullin më poshtë).*

DATA: 28/03/2025

NR.	ORA	SALLA	NR. ÇËSHTJES	PALET	GJYQTAR\E
736	12:30:00	09	21013-00546-61-2024	Thodhona Rondo (Kërkuar) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdikcionit të Përgjithshëm Vlorë (Person i Tretë) Bashkia Himare, Zyra e Sherbimeve Sociale (Person i Tretë)	Alba Ngresi Dorina Stroka Fjoralid Behari
737	12:30:00	13	50182-01800-61-2022	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (Kërkuar) Besnik Sinanaj (i Pandehur) Enesa Xhakollari (i Pandehur) Igli Tari (i Pandehur) Kevin Boraz (i Pandehur) Robert Lushaj (i Pandehur)	Alba Ngresi Ertit Meçaj Fjoralid Behari

Ilustrim L.

Lidhur me seancën gjyqësore të planifikuar për në orën 10:30 e cila i përket çështjes me nr. 23004-00802-61-2025, rezulton se është çelur seanca gjyqësore në datën 18.06.2025, në orën 10:37:21 dhe është mbyllur në orën 10:41:09.

Ndërkohë seanca që i përket çështjes gjyqësore me nr. 21013-02755-61-2022 R është zhvilluar nga gjyqtari i vetëm Arbana Selmanaj në orën 10:46:19, dhe vetëm pas datës 23.06.2025, kjo çështje do të gjykohet me trupë gjykues (përfshirë gjyqtaren Alba Ngresi). Ndërkohë të dhënat e paraqitura nga sistemi e paraqesin planifikimin e seancës nga trupa gjyqësore me përbërje Alba Ngresi, Arbana Selmanaj dhe Dorina Stroka, duke paraqitur kështu në mënyrë të gabuar të dhënat lidhur me planifikimin e seancave nga gjyqtarët respektivë.

*\*Për sa më sipër rezulton se të dhënat e paraqitura në Listës së Çështjeve në Gjykim gjeneruar nga sistemi ICMIS i Gjykatës, përmbajnë pasaktësi lidhur me oraret e planifikimit të seancave gjyqësore në raport me emrin e gjyqtarit, pasi rezulton se vetëm Gjyqtari përfundimtar, ose trupa gjyqësore përfundimtare e çështjes gjyqësore, pasqyrohet në listat e planifikimit edhe në seancat e mëparshme duke ndikuar kështu në të dhënat statistikore të gjyqtarëve respektivë.*

Gjithashtu rezulton se në raste të tjera, shfaqen problematika lidhur me menaxhimin e orareve të planifikimit të seancave gjyqësore si trupë gjyquese dhe si gjyqtar i vetëm duke sjellë herë pas here edhe përplasje ndërmjet orareve të planifikimit të seancave gjyqësore. Nevojitet një koordinim më i mirë ndërmjet gjyqtarëve për të planifikuar seancat gjyqësore në kohë dhe në përputhje me disponibilitetin e gjyqtarëve.

iv. **Paraqitja e gabuar e të dhënave në Listën e Çështjeve Gjyqësore**

Rasti 1.

Referuar të dhënave në Listën e Çështjeve Gjyqësore, rezulton se në datën 21.01.2025, është planifikuar çështja me nr. 21246-00758-61-2023, me trupë gjyqësore Arbana Selmanaj, Dorina Stroka dhe Lirëza Sinollari. Ndërkohë nga informacioni i marrë nga Gjykata rezulton se gjyqtare Lirëza Sinollari është kthyer nga leja e lindjes në datë 18 Shkurt 2025.

Nga verifikimi i të dhënave në sistemin e Gjykatës rezultoi se seanca e datës 21.01.2025 është mbajtur nga gjyqtari i vetëm i çështjes znj. Dorina Stroka, dhe çështja ka kaluar në gjykim me trupë gjyqësore vetëm në datën 28.10.2025.

38	03/11/2025	[ecufu] iu shtua Trupit Gjyqësor: [2]	Fjoralid Behari
39	03/11/2025	[aselmanaj] u bë Inaktiv në Trupin Gjyqësor: [2].	Fjoralid Behari
40	28/10/2025	U aktivizua Trupi Gjyqësor në Çështje	Dorina Stroka
41	28/10/2025	Studimi i ??shtjes u ruajt. Arsyeja:kjo ceshtje do te gjykohet me trup gjyqesore e perbere nga tre anetare	Suela Lena
42	25/09/2025	Planifikimi për [21246-00758-61-2023] është anuluar nga	Dorina Stroka

Ilustrim nga RIV

Ndërkohë rezulton se të gjitha seancat e planifikuara gjatë vitit, edhe ato përpara se çështja të kalojë me trupë gjyqësore, pasqyrohen si seanca të planifikuara me tre gjyqtarë, (shih seancën e datës 25.02.2025 në orën 12:30, salla 10) duke ndryshuar kështu të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave nga gjyqtarët respektiv.

Rasti 2.

Në kalendarin e seancave për datën 20.03.2025, pasqyrohet se gjyqtari Etien Isak ka planifikuar një seancë gjyqësore në orën 10:00 në sallën 12 për çështjen nr. 21240-00442-61-2024. Nga informacioni i administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, rezulton se gjyqtari Etien Isak ka filluar ushtrimin e detyrës pranë kësaj gjykate në datën 22.10.2025.

Nga verifikimi i seancës gjyqësore në sistemin e Gjykatës rezulton se kjo çështje është shortuar fillimisht pranë gjyqtarës Mirela Mishgjoni dhe pas largimit nga detyra të gjyqtarës me vendimin e K.P.A, dosjet u rishortuan dhe çështja e sipërcituar i ka kaluar si relator gjyqtarit Etien Isak i cili ka planifikuar seancën e radhës 04.11.2025,

Regjistrimi	Procedimi i Çështjes	Arkiva	Manaxhimi i Gjykatës	Administrim	Përcaktime	Jzebi	
Nr. i Çështjes: 21240-00442-01-2024		Titulli i Çështjes: Hyda Bari (Padrës) Kundër: Cemal Lamoe ( ) Padur)					
Regjistri: Civile Themel		Nr. i Aktit: 1133/730					
Procesi: Mbyllur		Faza e Çështjes: Mbyllur					
Cjyq		Tipi i Çështjes: Kërim Lëksh					
Info. mbi Çështjen		Paliet		Vendimetë Haparshme		Dokumenta	
Provat		Pagesat		Kontrollet		Printim ar ekran	
Printo Dosje (FTB)		Gjyq dhe Trupi Gjyqësor		Shënime		Studimi i Çështjes	
Gjyq		Vendimi		Mbyllja e Çështjes		Ashendat	
RIV		Historiku					
<input checked="" type="radio"/> Procesverbalet		<input type="radio"/> Dispozitivi					
						Mbyllja e Procesverbaletve <input type="checkbox"/>	
Data e Seancës	Orari i Seancës	Gjyqtari	Tipi i Dispozitivit	Plotësuar nga Arkiva			
<input type="checkbox"/> 23/10/2024	09:12-10:00	Mirela Miahgjoni		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> 27/11/2024	10:26-11:00	Mirela Miahgjoni		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> 09/02/2025	11:44-12:00	Mirela Miahgjoni		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> 20/03/2025	10:25-11:00	Mirela Miahgjoni		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> 04/11/2023	10:55-11:30	Etien Isak		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> 25/11/2025	12:01-12:30	Etien Isak	Pushim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

Ilustrim M.

Ndërkohë rezulton se në Raportin e Planifikimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton vetëm emri i gjyqtarit përfundimtar të çështjes, z. Etien Isak, duke ndryshuar kështu edhe të dhënat statistikore lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga gjyqtarët respektiv.

### Rasti 3.

Referuar Listës së Çështjeve për Gjykim të datës 23.06.2025, çështja me nr. 21235-02280-61-2023 është planifikuar të zhvillohet në orën 10:45, në sallën 01, me trupë gjyqësore Etien Isak, Lirëza Sinollari dhe Vjola Canaj. Ndërkohë rezulton se gjyqtari Etien Isak ka filluar ushtrimin e detyrës pranë kësaj gjykate në datën 22.10.2025.

Nga verifikimi në sistemin e Gjykatës rezulton se çështja me nr. 21235-02280-61-2023 është regjistruar në datën 12.06.2023 duke u shortuar fillimisht tek gjyqtarja Vjola Canaj, e cila ka zhvilluar seancat gjyqësore më datë 27.03.2025, datë 19.06.2025, datë 23.06.2025 dhe datë 09.07.2025 ku është vendosur ti kërkohet kryetarit të gjykatës caktimin e dy gjyqtarëve të tjerë për të plotësuar trupën gjyqësore.<sup>131</sup>

Gjyqtari Etien Isak është bërë pjesë e panelet të gjyqtarëve me shortin e datës 24.10.2025 për shkak të zëvendësimit të anëtarit të trupës gjyqësore Enkel Peza pasi ky i fundit është transferuar në Gjykatën Tiranë më datë 17.09.2025 sipas vendimit të KLGJ-së.

<sup>131</sup> Shënim nga PV i gjykatës më datë 09.07.2025: Gjykata, Bazuar ne nenin 35 të K. Pr. Civile do i drejtohet kryetarit të gjykatës për caktimin e dy gjyqtarëve të tjerë për shkak se vlera e padisë është më shumë se 50 milion lekë.

No.	Date	Description	Employee
1	24/10/2025	Eshtë ndryshuar Paneli. Arsyja e Ndryshimit: [çaktivizim i anetarit e peza pasi është transferuar në gjykatë tjetër në datën 18.09.2025, me kërkesën e gjyqtarit relator dhe të miratuar me dt 20.10.2025 trupit gjykues do të plotësohet me një anetar të ri me short elektronik]	Fjoralid Behari
2	24/10/2025	[elsak] iu shtua Trupit Gjykses: [1]	Fjoralid Behari
3	24/10/2025	[epeza] u bë Inaktiv në Trupin Gjykses: [1].	Fjoralid Behari
4	15/07/2025	Eshtë ndryshuar Paneli. Arsyja e Ndryshimit: [plotësim i trupit gjykues me një anetar me short elektronik në bazë të kërkesës së gjyqtarit relator me datë 10.07.2025 të miratuar.]	Enkel Peza
5	15/07/2025	[Isinollari] iu shtua Trupit Gjykses: [1]	Enkel Peza
6	15/07/2025	U aktivizua Trupi Gjykses në Çështje	Vjola Canaj
7	15/07/2025	Studimi i çështjes u ruajt. Arsyja: kjo çështje do të gjykohej me trup gjykues e perbere nga tre anetare.	Rezarta Laze
8	09/07/2025	Përfundoi Proçesverbali. Data e Gjyqit :09/07/2025 14:06:00 - 14:30:00	Rezarta Laze

#### Ilustrim N.

\*Nisur edhe nga komunikimet me Gjykatën si dhe nga konstatimet në analizimin e të dhënave, rezulton se sistemi ICMIS në paraqitjen e këtij raporti, parashikon vetëm emrin e gjyqtarit përfundimtar të çështjes duke i atribuuar edhe të gjitha seancat gjyqësore të planifikuara ose të zhvilluara më parë, tek gjyqtari i fundit i çështjes. Kjo passjell paraqitjen e të dhënave të gabuara statistikore, të cilat eksportojnë më pas gabimin edhe në Raportimet e Gjykatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

### 3.5. Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e planifikimeve të seancave, si dhe nga raportet për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, nga përpunimi i të dhënave për secilin gjyqtar konstatohet si më poshtë:

\*Në vijim po paraqesim të dhëna lidhur me raportin ndërmjet numrit të seancave të planifikuara dhe numrit të seancave të zhvilluara, referuar të dhënave të dërguara nga Gjykata. Duhet mbajtur parasysh fakti se diferencat në të dhënat e paraqitura mund të jenë si pasojë e paraqitjes së gabuar të të dhënave në sistemin e gjykatës.

Gjyqtari	Alba Ngresi		Arbana Selmanaj		Artan Çirraga		Bevil Beqiraj		Dorina Stroka	
	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio
Janar	78	88.46%	73	100.00%	66	86.36%	73	98.63%	98	79.59%
Shkurt	128	92.19%	117	95.73%	133	87.97%	112	93.75%	146	94.52%
Mars	91	92.31%	100	93.00%	89	80.90%	85	80.90%	92	8.13%
Prill	134	79.85%	108	99.07%	140	92.20%	122	91.80%	132	87.88%
Maj	129	94.57%	107	95.33%	141	92.20%	124	95.16%	116	94.83%
Qershor	149	95.30%	129	97.67%	145	86.90%	135	92.59%	128	85.16%
Korrik	123	91.87%	46	95.65%	145	86.90%	124	92.74%	111	95.50%
Gusht	8	100.00%	5	100.00%	0	0.00%	6	100%	11	100.00%
Shtator	106	84.91%	71	78.87%	97	83.51%	95	82.11%	87	56.32%
Tetor	123	85.37%	128	86.72%	124	75.00%	117	87.18%	138	81.88%

<b>Total</b>	<b>1069</b>	<b>884</b>	<b>1080</b>	<b>1247</b>	<b>1059</b>
--------------	-------------	------------	-------------	-------------	-------------

Gjyqtari	Eranda Cufo		Ertil Mecaj		Fjorald Behari		Mirela Mishgjoni		Uran Kurra	
	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio
Janar	90	95.56%	67	85.07%	102	89.22%	28	57.14%	56	92.86%
Shkurt	130	92.31%	102	95.10%	127	91.34%	28	71.43%	73	86.30%
Mars	94	85.11%	81	92.59%	80	92.50%	6	16.67%	67	86.57%
Prill	150	85.67%	128	98.44%	165	91.52%	0	0.00%	92	89.13%
Maj	137	98.54%	123	91.87%	116	83.62%	0	0.00%	109	99.08%
Qershor	141	97.87%	135	89.63%	128	92.97%	0	0.00%	111	95.50%
Korrik	123	91.06%	89	89.89%	124	91.13%	0	0.00%	123	85.37%
Gusht	5	80.00%	10	100.00%	10	90.00%	0	0%	9	77.78%
Shtator	107	76.64%	82	78.05%	91	80.22%	0	0.00%	97	79.38%
Tetor	126	78.57%	166	81.93%	146	74.66%	0	0.00%	107	83.18%
<b>Total</b>	<b>1103</b>		<b>983</b>		<b>1089</b>		<b>62</b>		<b>844</b>	

Gjyqtari	Enkel Peza		Larëza Sinollari		Vjola Canaj		Etien Isak <sup>[132]</sup>	
	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio	Nr. Seancave Audio	% E Seancave Audio
Janar	37	83.78%	1	100.00%	103	90.29%	6	100.00%
Shkurt	67	77.61%	7	85.71%	184	85.78%	7	42.86%
Mars	34	85.29%	20	70.00%	162	79.63%	6	16.67%
Prill	86	73.26%	40	65.00%	156	71.79%	4	75.00%
Maj	59	77.97%	45	82.22%	160	76.25%	4	100.00%
Qershor	63	82.54%	52	94.23%	161	89.44%	8	100.00%
Korrik	42	83.33%	27	88.89%	119	91.60%	4	100.00%
Gusht	0	0.00%	8	87.50%	10	70.00%	0	0.00%

<sup>132</sup> Gjyqtari është emëruar vetëm në muajin tetor 2025 por rezultoi si e dhënë në tabelat e vendosura në dispozicion nga gjykata.

Shtator	3	0.00%	27	85.19%	107	56.07%	2	0.00%
Tetor	0	0.00%	75	77.33%	162	60.49%	5	40.00%
<b>Total</b>	<b>391</b>		<b>302</b>		<b>1324</b>		<b>46</b>	

\*Nxjerrja dhe përpunimi i të dhënave lidhur me numrin e seancave gjyqësore të planifikuara përgjatë periudhës së inspektimit, është gjeneruar nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë sa i përket Listës së Çështjeve për Gjykim. Gjithashtu të dhënat statistikore për secilin magjistrat lidhur me përdorimin e sistemit të regjistrimit audio për çdo gjyqtar janë dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe krahasuar me të dhënat e nxjerra nga sistemi.

\*Diferencat e shprehura në përqindje (%) ndërmjet numrit të seancave të planifikuara dhe numrit të seancave sipas RDA-së, tregojnë një diferencë të lehtë në disa raste dhe deri në një diferencë të konsiderueshme për njërin magjistrat. Arsyet e këtyre diferencave mund të qëndrojnë në faktin e mospërputhjeve që krijon vetë sistemi i të dhënave lidhur me emrin e gjyqtarit që planifikon dhe zhvillon seancat gjyqësore, problematika të konstatuara më lart.

\*Nisur nga të dhënat e dërguara nga gjykata, lidhur me çështjet e rishortuara gjyqësore, rezultojnë se numri i rishortimeve gjatë periudhës së inspektimit është 313 çështje. Nga funksionimi i sistemit kuptohet se paraqitja e të dhënave bëhet vetëm me gjyqtarin fundor të çështjes gjyqësore, dhe në rastin e rishortimeve, kjo problematike shfaqet drejtpërdrejtë duke krijuar të dhëna të pasakta lidhur me secilin gjyqtar. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë numrin e lartë të çështjeve të rishortuara, edhe përfundimet dhe diferencat e krijuara ndërmjet seancave të planifikuara dhe seancave të mbajtura realisht janë të gabuara. Në rastin e magjistratit Enkel Peza, ku diferencat shfaqen në përqindjen më të lartë 34%, një e dhënë e tillë rezultojnë edhe nga fakti se magjistrati është transferuar në Shtator të vitit 2025 në Gjykatën Tiranë, ndaj dhe çështjet e tij janë rishortuar në gjyqtarë të tjerë, duke pasqyruar edhe ndryshime në paraqitjen e të dhënave në sistem të cilat shfaqen në formë të gabuar.

## I. Konkluzione

Nga analiza e të dhënave të kalendarit të seancave gjyqësore referuar urdhrin të kryetarit për planifikimin gjykimeve në sallat e gjykimeve, nuk janë konstatuar përplasje në përdorimin e sallave të gjykimit nga gjyqtarë të ndryshëm, duke marrë në konsideratë edhe numrin e konsiderueshëm të sallave në dispozicion të Gjykatës.

Nisur edhe nga komunikimet me Gjykatën si dhe nga konstatimet në analizimin e të dhënave, rezultojnë se sistemi ICMIS parashikon vetëm emrin e gjyqtarit përfundimtar të çështjes duke i atribuuar edhe të gjitha seancat gjyqësore të planifikuara ose të zhvilluara më parë, tek gjyqtari i fundit i çështjes. Kjo sjell paraqitjen e të dhënave të gabuara

statistikore, të cilat eksportojnë më pas gabimin edhe në Raportimet e Gjykatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Përpunimi i të dhënave të planifikimit të seancave gjyqësore evidenton një përqendrim më të madh të tyre në ditët e para të javës (të hënë – të mërkurë), ndërsa në ditët në vijim të javës numri i seancave rezulton më i ulët, veçanërisht ditën e premte. Rregullorja në fuqi nuk ka të parashikuar në dispozitat e saj parashikime lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore nga trupa e magistratëve në funksion të shpërndarjes sa më të drejtë të seancave gjyqësore për të mënjanuar mbingarkesën në trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe respektimin dhe garantimin e të drejtave ligjore e procedurale të palëve në proceset gjyqësore.

Materialet e përcjella nga gjykata janë paraqitur në format pdf, në pamundësi për t'i gjeneruar në formatin excel ose word, çka ka kufizuar mundësinë e përpunimit automatik të të dhënave dhe ka kërkuar kryerjen e verifikimeve dhe përpunimeve manuale për analizimin e informacionit.

Raportet e gjeneruara nga sistemi ICMIS për secilin gjyqtar paraqiten kryesisht sipas sallave të gjykimit dhe jo sipas rendit kronologjik të planifikimit të seancave. Një paraqitje e tillë e të dhënave e bën më të vështirë analizën e kalendarit të seancave për secilin gjyqtar dhe kërkon ndërhyrje shtesë për sistemimin e informacionit. Pasi në kushtet aktuale është e pamundur të gjenerohen të dhëna nga përdorues të tjerë të autorizuar, por ato bëhen të mundura vetëm duke aksesuar në llogarinë e secilit gjyqtar.

Në disa raste janë identifikuar planifikime të seancave gjyqësore në të njëjtën orë për çështje të ndryshme, situatë e cila mund të çojë në vonesa në zhvillimin e proceseve gjyqësore në vijim.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë).*

# **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**

## **1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara**

### **1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit**

Në kuadër të marrjes së të dhënave për realizimin e këtij inspektimi pas shkresës së nisur nga ILD për marrje informacioni, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, janë dërguar informacionet si vijon: Shkresa nr. 1170/1 prot., datë 31.10.2025 e Gjykatës Së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2926/1 prot., datë 06.11.2025, në të cilën janë<sup>[133]</sup> përcjellë materialet fizike. Pas zhvillimit të një vizite pranë kësaj gjykate nga grupi i inspektimit i përbërë nga inspektori Albert Kazia dhe ndihmës inspektorët Aulona Levani dhe Vildan Kaloshi, me shkresën nr. 2926/2 prot., datë 14.11.2025 nga kjo gjykatë janë marrë sipas procesverbalit përkatës<sup>[134]</sup> kopjet e akteve që nuk ishin dërguar bashkëlidhur shkresës së parë me informacione dhe gjithashtu pas shkresës së nisur nga ILD për të saktësuar informacionin, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka dërguar materialin nr. 1353/1 prot., datë 27.11.2025 i cili është regjistruar pranë ILD-së me nr. 2926/4 prot., datë 04.12.2025 në të cilën<sup>[135]</sup> është saktësuar informacioni sipas kërkesës së drejtuar gjykatës.

## **2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative**

<sup>133</sup> Në këtë shkresë Gjykata e Shkallës e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka dërguar: ... 1) të dhënat statistikore në lidhje me ngarkesën e çështjeve, të mbartura, të reja dhe vendimet e shpallura së bashku me numrin e seancave për secilën çështje dhe për secilin gjyqtar për periudhën e inspektuar. 2) Kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën e inspektuar për 9 gjyqtarë. 3) Kopje të vendimit nr. 316 prot., datë 31.03.2023 @ Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në zbatim të vendimit nr. 133, datë 28.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor së bashku me tabelën mbi detajimin e pozicioneve të punës të miratuara nga këshilli i kësaj gjykate, si dhe kopjen e strukturës organizative në fakt që i përket muajve Janar – Tetor 2025. 4) Kërkesat për leje të gjyqtarëve së bashku me praktikën e pranimit të tyre si dhe 14 fletë raporte për paaftësi në punë të gjyqtarëve për periudhën e inspektuar. 5) Bëjmë me dije se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë zhvillon gjykime në 5 salla gjykimi.....

<sup>134</sup> Procesverbali dhe dokumentacioni i tërhequr nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është regjistruar me nr. 2926/2 prot., datë 14.11.2025.

<sup>135</sup> Në këtë shkresë gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përgjigje të kërkesës tonë për të të dhënë informacion sa i përket mospërputhjeve të të dhënave të kalendarit të seancave të planifikuara për çështjet e rishortuara, me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, ka bërë me dije se mospërputhjet në planifikimin e seancave të cilat janë printuar nga sistemi ICMIS më të cilin operon kjo gjykatë, janë pasojë e rishortimit të çështjeve të gjyqtarit të larguar Renis Shehi, dhe sistemi në mënyrë automatike ja kalon të gjitha të dhënat e çështjes gjyqtarit tek i cili është rishortuar kjo çështje. Bashkëlidhur këtij materiali Gjykata e Shkallës Së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë përveç të tjerash ka dërguar edhe tabelat exel të rregulluara manualisht sipas planifikimit real për secilin gjyqtar.

## 2.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë funksionon sipas vendimit nr. 29 datë 31.03.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimeve të punës të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nxjerrë në zbatim të vendimit nr. 150 datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”. Sipas këtij vendimi ndër të tjera përcaktohet që numri i gjyqtarëve pranë kësaj gjykate është 9 (nëntë).

- **Lidhur me periudhën e gatishmërisë me të cilën ka funksionuar kjo gjykatë rezulton se:**

### **Lista e gatishmërisë për muajin janar 2025<sup>[136]</sup>**

Nga data 01 deri më datë 04, gjyqtar Eglantina Biba; Nga data 05 deri më datë 08 gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 09 deri më datë 11 gjyqtar Irma Cacaj; Nga data 12 deri më datë 14 gjyqtare Edlira Çota; Nga data 15 deri më datë 17, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 18 deri më datë 20, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 21 deri më datë 23 gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 24 deri më datë 27, gjyqtar Elvis Sulejmani; Nga data 28 deri më datë 31, gjyqtari Renis Sheshi;

### **Lista e gatishmërisë për muajin shkurt 2025<sup>[137]</sup>**

Nga data 1 deri më datë 3, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 4 deri më datë 6, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 7 deri më datë 10, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 11 deri më datë 13, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 14 deri më datë 16, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 17 deri më datë 19, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 20 deri më datë 22, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 23 deri më datë 25, gjyqtari Elvis Sulejmani; Nga data 26 deri më datë 28, gjyqtari Renis Sheshi;

### **Lista e gatishmërisë për muajin mars 2025<sup>[138]</sup>**

Nga data 1 deri më datë 3, gjyqtari Eglantina Biba; Nga data 4 deri më datë 6, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 7 deri më datë 9, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 10 deri më datë 13, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 14 deri më datë 17, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 18 deri më datë 21, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 22 deri më datë 25, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 26 deri më datë 28, gjyqtari Elvis Sulejmani; Nga data 29 deri më datë 31, gjyqtari Renis Sheshi;

<sup>136</sup> Urdhri nr. 142, datë 31.12.2024.

<sup>137</sup> Urdhri nr. 14, datë 30.01.2025.

<sup>138</sup> Urdhri nr. 25, datë 28.02.2025.

### **Lista e gatishmërisë për muajin prill 2025<sup>[139]</sup>**

Nga data 1 deri më datë 4, gjyqtar Eglantina Biba; Nga data 5 deri më datë 7, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 8 deri më datë 10, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 11 deri më datë 13, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 14 deri më datë 16, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 17 deri me datë 19, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 20 deri me datë 22, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 23 deri me datë 26, gjyqtari Elvis Sulejmani; date 27 deri me datë 30 gjyqtari Renis Sheshi;

### **Lista e gatishmërisë për muajin maj 2025<sup>[140]</sup>**

Nga data 1 deri më datë 4, gjyqtari Eglantina Biba; Nga data 5 deri me datë 8, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 9 deri me datë 12, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 13 deri me datë 16, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 17 deri me datë 19, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 20 deri me datë 22, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 23 deri me datë 25, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 26 deri me datë 28, gjyqtari Renis Sheshi; Nga data 29 deri me datë 31, gjyqtari Elvis Sulejmani;

### **Lista e gatishmërisë për muajin qershor 2025<sup>[141]</sup>**

Nga data 1 deri me datë 3, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 4 deri me datë 6, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 7 deri me datë 10 gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 11 deri me datë 14, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 15 deri me datë 18, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 19 deri me datë 22, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 23 deri me datë 26, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 27 deri me datë 30, gjyqtari Elvis Sulejmani;

### **Lista e gatishmërisë për muajin korrik 2025<sup>[142]</sup>**

Nga data 1 deri me datë 4, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 5 deri më datë 8, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 9 deri më datë 11, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 12 deri më datë 15, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 16 deri më datë 19, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 20 deri më datë 23, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 24 deri me date 27, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 28 deri më datë 31, gjyqtari Elvis Sulejmani.

### **Lista e gatishmërisë për muajin gusht 2025<sup>[143]</sup>**

Nga data 1 deri me datë 4, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 5 deri me datë 8, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 9 deri më datë 12, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 13 deri me datë 15, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 16 deri me datë 19, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 20 deri me datë 23, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 24 deri me datë 27, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 28 deri me datë 31, gjyqtari Elvis Sulejmani.

<sup>139</sup> Urdhri nr. 46, datë 03.04.2025.

<sup>140</sup> Urdhri nr. 60, datë 30.04.2025.

<sup>141</sup> Urdhri nr. 68, datë 29.05.2025.

<sup>142</sup> Urdhri nr. 80, datë 30.06.2025.

<sup>143</sup> Urdhri nr. 91, datë 23.07.2025.



### **Lista e gatishmërisë për muajin shtator 2025<sup>[144]</sup>**

Nga data 1 deri me datë 4, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 5 deri me datë 8, gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 9 deri me datë 12, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 13 deri me datë 16, gjyqtare Edlira Çota; Nga data 17 deri me datë 19, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 20 deri me datë 22, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 23 deri me datë 24, gjyqtari Ilir Përdeda; Nga data 25 deri me datë 27, gjyqtari Elvis Sulejmani; Nga data 28 deri me datë 30, gjyqtari Ilir Përdeda.

### **Lista e gatishmërisë për muajin tetor 2025<sup>[145]</sup>**

Nga data 1 deri me datë 6, gjyqtari Aldi Kareco; Nga data 7 deri me datë 11 gjyqtari Lirim Bulica; Nga data 12 deri me datë 16, gjyqtare Eglantina Biba; Nga data 17 deri me datë 21, gjyqtare Irma Cacaj; Nga data 22 deri me datë 26, gjyqtari Delvijot Llusha; Nga data 27 deri me datë 31, gjyqtari Ilir Përdeda.

Gatishmëria e gjyqtarëve të kësaj gjykate për periudhën e inspektuar, gjendet në mënyrë tabelare në ankesin 2 të këtij raporti inspektimi.

**Lidhur me lejet vjetore të gjyqtarëve**, konstatohet se përgjatë vitit 2025 me urdhrin nr. 99, datë 31.07.2025, janë miratuar lejet vjetore për trupën gjyqësore bazuar dhe në kërkesat e tyre. Konkretisht rezulton se:

1. Gjyqtari Aldi Kareco nga data 04.08.2025 deri me datë 07.08.2025, nga data 18.08.2025 deri me datë 29.08.2025;
2. Gjyqtari Delvijot Llusha nga data 04.08.2025 deri me datë 10.08.2025, nga data 11.08.2024 deri me datë 17.08.2025 si dhe nga data 25.08.2025 deri me datë 31.08.2025;
3. Gjyqtare Edlira Çota nga data 01.08.2025 deri me datë 15.08.2025, nga data 25.08.2025 deri me datë 31.08.2025;
4. Gjyqtare Eglantina Biba nga data 11.08.2025 deri me datë 31.08.2025;
5. Gjyqtari Elvis Sulejmani nga data 05.08.2025 deri me datë 23.08.2025, nga data 01.09.2025 deri me datë 03.09.2025;
6. Gjyqtari Ilir Përdeda nga data 01.08.2025 deri me datë 21.08.2025;
7. Gjyqtare Irma Cacaj nga data 01.08.2025 deri me datë 08.08.2025, nga data 18.08.2024 deri me datë 24.08.2025, si dhe nga data 25.08.2025 deri me datë 31.08.2025;
8. Gjyqtari Lirim Bulica nga data 11.08.2025 deri me datë 29.08.2025

Gjithashtu gjatë vitit 2025 nga ana e zëvendëskryetarit të gjykatës janë miratuar ditë leje për gjyqtarët, bazuar në kërkesat e tyre për të marrë këto ditë nga leja vjetore e paguar ashtu dhe për ndodhi të ndryshme familjare për të cilat legjislacioni në fuqi u jep të drejtën për të marrë leje. Konkretisht:

<sup>144</sup> Urdhri nr. 102, datë 28.08.2025, ndryshuar me urdhrin nr. 114, datë 24.09.2025;

<sup>145</sup> Urdhri nr. 122, datë 30.09.2025;

1. Gjyqtari Lirim Bulica ka marrë leje miratuar më datë 31.01.2025, për dy ditë leje, të mbetura nga leja vjetore e vitit 2024; për periudhën nga 11.03.2025 deri më 21.03.2025 (nga leja vjetore e vitit 2024); për periudhën nga 24.03.2025 deri më 26.03.2025 (për shkak të lindjes së fëmijës; për periudhën nga 23.06.2025 deri më 25.06.2025 (nga leja vjetore);
2. Gjyqtari Delvijot Llusha ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 05.03.2025 deri më 13.03.2025;

Gjyqtare Eglantina Biba ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 10.03.2025 deri më 15.03.2025; për periudhën nga 21.05.2025 deri më 24.05.2025; si dhe për periudhën nga 23.06.2025 deri më 27.06.2025 (për shkak të ndërrimit të jetës së nënës);

1. Gjyqtari Elvis Sulejmani ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 13.03.2025 deri më 25.03.2025;
2. Gjyqtari Renis Shehu ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 10.03.2025 deri më 13.03.2025;
3. Gjyqtari Aldo Kareco ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 10.03.2025 deri më 13.03.2025, dhe nga 23.03.2025 deri më 26.03.2023;
4. Gjyqtare Edlira Çota ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 18.03.2025 deri më 21.03.2025, si dhe për datën 28.03.2025, si dhe për periudhën nga 02.06.2025 deri më 03.06.2025;
5. Gjyqtare Irma Cacaj ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 22.04.2025 deri më 23.04.2025;

▪ Lidhur me mungesës për paaftësi në punë për sëmundje:

1. Gjyqtare Irma Cacaj ka marrë 3 ditë raport mjekësor, për periudhën nga 30.07.2025 deri më 01.08.2025;
2. Gjyqtare Eglantina Biba ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 30.01.2025;
3. Gjyqtari Aldo Kareco ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 27.03.2025;
4. Gjyqtari Ilir Përdeda ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 20.05.2025;
5. Gjyqtare Edlira Çota ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 15.09.2025; për 2 ditë raport mjekësor, në periudhën 07.05.2025 dhe 08.05.2025; 2 ditë raport mjekësor, në periudhën 15.04.2025 dhe 16.04.2025; 1 ditë raport mjekësor, për datën 01.04.2025; 2 ditë raport mjekësor, në periudhën 04.02.2025 dhe 05.02.2025;
6. Gjyqtari Lirim Bulica ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 13.01.2025; 1 ditë raport mjekësor, në datën 10.03.2025; 1 ditë raport mjekësor, në datën 14.10.2025;
7. Gjyqtari Delvijot Llusha ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 30.05.2025; 1 ditë raport mjekësor, në datën 10.10.2025;

## **2.2. Konstatimet mbi seancat përse i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë (ICMIS apo ARKIT)**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, operon me sistemin e menaxhimit të çështjeve ICMIS dhe nga të dhënat e dërguara për planifikimin e seancave gjyqësore nga gjyqtarët e kësaj gjykate rezultojnë disa problematika të cilat në mënyrë të përmbledhur po paraqiten si vijon:

Sikundër është konstatuar ky sistem në rastet e rishortimeve kalon të gjithë informacionin e çështjes së rishortuar, gjyqtarit të ri të cilit i është caktuar me short nga rishortimi, duke rritur fiktivisht ngarkesën e këtij gjyqtari, pasi çështja konkrete deri në momentin e rishortimit është trajtuar nga gjyqtari i mëparshëm. Në këtë aspekt rregullimi i këtij ngërçi të sistemit, është përtej mundësive të gjykatës, e pikërisht për këtë arsye nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u kërkua një informacion i dytë nga gjykata për të nxjerrë manualisht ngarkesën reale të secilit gjyqtar si dhe planifikimin real të seancave të çështjeve që trajtojnë.

## **2.3. Fakte të konstatuar në lidhje me përputhjen e të dhënave të hedhura në regjistrin fizik si dhe në sistemin elektronik (procesverbalet e seancave) përse i përket numrit të seancave**

Në lidhje me përputhshmërinë e të dhënave të gjeneruara nga sistemi dhe atyre të mbajtura në regjistrat fizikë, ka rezultuar që në rastet e rishortimit të çështjeve gjyqësore ato me tej dalin në ngarkim të gjyqtarit të fundit të cilit i janë rishortuar, duke rritur fiktivisht ngarkesën e këtij gjyqtare dhe duke ulur ngarkesën e gjyqtarit të parë. Nga ana tjetër edhe planifikimi i seancave për këto çështje i kalon gjyqtarit që është rishortuar, duke e bërë të pamundur verifikimin e saktë të planifikimit për këto çështje.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për periudhën e inspektuar janë kryer në total 2 (dy) rishortime, përkatësisht për çështjet gjyqësore të gjyqtarit Renis Sheshi i cili është larguar nga kjo gjykatë në muajin Maj 2025, në zbatim të vendimit nr. 230 datë 23.04.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas të cilit magjistrati Renis Sheshi komandohet si “ndihmës magjistrat”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Në funksion të rishortimit të çështjeve të këtij gjyqtari janë marrë 2 urdhra për rishortim, urdhri nr. 73, datë 10.06.2025 dhe urdhri nr. 758 prot., datë 16.07.2025 të Zëvendëskryetarit të Gjykatës.

- Sipas urdhrimit nr. 73, datë 10.06.2025, ndër të tjera është vendosur, që çështjet penale me natyrë të ngutshme të gjyqtarit Renis Sheshi të rishortohen elektronikisht më datë 10.06.2025, në rishortim përfshihen të gjithë gjyqtarët efektivë të kësaj gjykate. Sipas këtij urdhri dhe materialit shoqërues për rishortimin rezulton se në datën 10.06.2025 janë shortuar gjithsej 12 çështje penale të ngutshme sipas tabelës në vijim.

Datë Rishortimi 10.06.2025			
Nr.	Numër i çështjes	Gjyqtari i parë	Gjyqtari i rishortuar
1.	51010-00851-53-2025	Renis Sheshi	Eglantina Biba
2.	52104-00128-53-2025	Renis Sheshi	Edlira Çota
3.	58345-02083-53-2024	Renis Sheshi	Eglantina Biba
4.	61008-00566-53-2025	Renis Sheshi	Irma Cacaj
5.	71003-00411-53-2025	Renis Sheshi	Illir Përdeda
6.	71028-00180-53-2025	Renis Sheshi	Lirim Bulica
7.	71028-00475-53-2025	Renis Sheshi	Eglantina Biba
8.	71028-00643-53-2025	Renis Sheshi	Delvijot Llusha
9.	71028-01037-53-2023	Renis Sheshi	Delvijot Llusha
10.	71028-01678-53-2024	Renis Sheshi	Elvis Sulejmani
11.	71028-01789-53-2024	Renis Sheshi	Illir Përdeda
12.	71028-02096-53-2024	Renis Sheshi	Aldi Kareco

Nga verifikimi i kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve me të cilin operon kjo gjykatë, rezultoi që të 12 rastet e mësipërme edhe pse i janë shortuar fillimisht gjyqtarit Renis Sheshi, pas rishortimit të tyre janë transferuar të gjitha të dhënat tek gjyqtari i ri i rishortuar, duke kaluar si ngarkesë që nga momenti i hedhjes së tyre në short te gjyqtari i fundit. Këta shembuj të mësipërm tregojnë se realisht ky sistem nuk paraqet në mënyrë të saktë të dhënat e çështjes duke llogaritur si gjyqtar të vetëm të çështjes gjyqtarin e fundit të rishortuar [kjo problematikë duhet rekomanduar dhe të mbahet në konsideratë në inspektimet që bëhen për ndarjen dhe rindarjen me short të çështjeve].

- Sipas urdhrit nr. 758, datë 16.07.2025 të Zëvendëskryetarit të Gjykatës, ndër të tjera është vendosur, që çështjet civile të gjyqtarit Renis Sheshi të rishortohen elektronikisht vetëm midis gjyqtarëve Irma Cacaj dhe Delvijot Llusha secili me 100%, ndërsa për shkak të ngarkesës të gjithë gjyqtarët e tjerë pranë kësaj gjykate përjashtohen nga shortimi, ndërsa përsa i përket çështjeve penale të gjyqtarit Renis Sheshi, në rishortim përfshihen të gjithë gjyqtarët efektivë të kësaj gjykate. Sipas këtij urdhri dhe materialit shoqëruar për rishortimin rezultoi se në datë 16.07.2025 janë shortuar gjithsej 149 çështje civile dhe penale të cilat paraqiten të përmbledhura sipas tabelës në vijim:

Rishortimet e datës 16.07.2025	
Gjyqtari	Numri i çështjeve që i është rishortuar
Irma Cacaj	55
Delvijot Llusha	54
Lirim Bulica	7
Elvis Sulejmani	7
Edlira Çota	6
Aldi Kareco	7
Illir Përdeda	6
Eglantina Biba	7

Këto të dhëna për rishortimet në këto dy data pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ndodhen gjithashtu në aneksin 5, pjesë e këtij raporti inspektimi.

### 3. Analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

#### 3.1. Numri i çështjeve të çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nga informacioni i grumbulluar rezulton se *volumi i çështjeve të mbartura për vitin 2025 është 1287 çështje*, ndërsa numri i çështjeve të reja gjatë periudhës së inspektimit 01.01.2025 – 20.10.2025, është 2792 çështje. Ndarë kjo sipas gjyqtarëve rezulton se: gjyqtari Aldi Kareco ka të mbartura 189 çështje dhe 329 çështje të reja, gjyqtari Delvijot Llusha 48 çështje të mbartura ndërsa ka marrë 391 çështje të reja, gjyqtare Edlira Çota 139 çështje të mbartura ndërsa ka marrë 315 çështje të reja, gjyqtare Eglantina Biba mbartur 140 dhe të reja 338 të tilla, gjyqtari Elvis Sulejmani 134 çështje të mbartura nga 2024 ndërsa të reja 304, gjyqtari Ilir Përdeda ka mbartur 206 çështje ndërkohë të reja ka marrë 354, gjyqtare Irma Cacaj 40 çështje të mbartura dhe të reja 395, gjyqtari Lirim Bulica 186 çështje të mbartura dhe 310 të reja dhe gjyqtari Renis Sheshi 205 çështje të mbartura nga viti 2024 dhe 56 të reja.

Nr.	Gjyqtari	Nr. i çështjeve të mbartura nga viti 2024	Nr. i çështjeve të reja për periudhën 01.01.2025-20.10.2025	Nr. i çështjeve gjithsej në datë 20.10.2025
		<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c=(a+b)</i>
1	ALDI KARECO	189	329	518
2	DELVIJOT LLUSHA	48	391	439
3	EDLIRA ÇOTA	139	315	454
4	EGLANTINA BIBA	140	338	478
5	ELVIS SULEJMANI	134	304	438
6	ILIR PËRDEDA	206	354	560
7	IRMA CACAJ	40	395	435
8	LIRIM BULICA	186	310	496
9	RENIS SHESHI	205	56	261

#### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nr.	Gjyqtari	Nr. i vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025
1	ALDI KARECO	322

2	DELVIJOT LLUSHA	277
3	EDLIRA ÇOTA	286
4	EGLANTINA BIBA	333
5	ELVIS SULEJMANI	317
6	ILIR PËRDEDA	367
7	IRMA CACAJ	312
8	LIRIM BULICA	320
9	RENIS SHESHI	154

Në total numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës së inspektimit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është 2688 vendime. Të dhënat specifike për këtë gjykatë përsa i përket ngarkesë, planifikimit dhe realizimit të seancave janë pjesë e aneksit 3 dhe 4, pjesë të këtij inspektimi.

### 3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar. (bashkëngjitur në aneks kalendari për seancat e planifikuara nga secili gjyqtar në një ditë.)

#### 3.3.1. Analiza e planifikimi të seancave brenda një dite:

- Referuar analizës së të dhënave në lidhje me planifikimin e seancave u konstatua se ndodh që në planifikimin e çështjeve nga gjyqtarët, e njëjta çështje të jetë planifikuar 2 herë nga gjyqtari në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë. Në këtë aspekt vërehet se ka raste kur ngarkesa me planifikime e gjyqtarëve nga këto lloj planifikimesh të rritet në mënyrë jo reale. Nga të dhënat e marra për këtë inspektim tematik, nuk mund të arrihet në një konkluzion të qartë nëse kemi të bëjmë me planifikim në sistem të çështjes dhe nga gjyqtari dhe nga sekretarja gjyqësore, apo është e qëllimshme që këto çështje planifikohen në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë. Për të dhënë një kuptim më të plotë të një situatë të tillë po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur shembullin e poshtëshënuar:
  - Gjyqtari D. Ll., më datë 24.02.2025 ka planifikuar çështjen civile me nr. 21234-01131-35-2018 në orën 14:00 **dy herë**, dhe në shënimin e momentit të çeljes së seancës pasqyrohet e çelur në orën 14:15 dhe orën 14:30, pra e njëjta seancë e planifikuar dhe e çelur dy herë në dy orare të ndryshme.
- Nga të dhënat e nisura nga gjykata, gjatë analizimit dhe përpunimit të tyre, vihet re se në disa raste, **dy çështje të ndryshme të të njëjtit gjyqtar janë planifikuar në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë**. Menaxhimi i ecurisë së çështjeve të një gjyqtari është pjesë e punës së tij, për të bërë një planifikim sa më të mirë në mënyrë që seancat e planifikuara të mos të dështojnë dhe puna e gjyqtarit të jetë efikase. Planifikimi i dy çështjeve të ndryshme në të njëjtën datë dhe orë do të sjell patjetër ose vonesa për njërin nga çështjet ose dështim të njëres prej seancave. Kjo problematikë mund të jetë një pakujdesi e gjyqtarit në planifikim, por edhe problematikë e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Nëse bëhen ndryshimet e nevojshme në sistem dhe pas planifikimit të seancës sistemi të mos

lejonte planifikimin e një seance tjetër në të njëjtin orar, do të bëhej e mundur edhe evitimi i këtij lloj planifikimi. Për të ilustruar situatën, në vazhdim gjeni shembuj për sa më sipër, analizuar:

- gjyqtarja E. B., në datën 02.07.2025 ka planifikuar 2 seanca të ndryshme në orën 09:30, njëra prej të cilave kërkesë penale me nr. 52809-00714-53-2025 dhe tjetra vlerësim mase arresti me nr. 61005-00978-53-25;
  - gjyqtarja E. Ç., në datën 17.09.2025 ka planifikuar në orën 09:30 dy çështje të ndryshme përkatësisht një çështje kërkesë penale me nr. 71028-00997-53-2025 dhe çështjen civile nr. 21001-00448-53-2025.
- Gjatë analizimit të të dhënave të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, u vu re që planifikimi i seancave nga gjyqtarët e kësaj gjykate është bërë përgjithësisht me frekuencë kohore nga 15 min., nga njëra-tjetra brenda një dite. Ashtu sikundër është edhe përcaktuar seancat duhet të jenë të planifikuara minimalisht 15 min., larg njëra-tjetrës, por vihet re që në ditët e ngarkuara me shumë seanca të planifikuara këto afate variojnë nga 15 në 10 dhe 5 minuta larg njëra-tjetrës. Në këtë këndvështrim, pavarësisht nga lloji i çështjes së planifikuar, është në dhomë këshillimi apo me palë, pavarësisht nga mënyra e realizimit të seancës në zyrë apo në sallë, një diferencë kaq e vogël në orarin e planifikimit bëhet shkas për një mbivendosje të mundshme të seancave. Për të pasqyruar sa më sipër shembujt si më poshtë:
  - Gjyqtari L. B., ka planifikuar seancën e çështjes 70011-01028-53-2024, më datë 23.07.2025 në orën 14:10 dhe po në këtë datë në orën 14:15 ka planifikuar seancën për çështjen 21233-00778-53-2025.
  - Gjyqtari I. P., ka planifikuar seancën e çështjes 21250-01510-53-2024 më datë 04.02.2025 ora 09:00 dhe po në këtë datë ka planifikuar seancën për çështjen 23004-01045-53-2024 në orën 09:10 min.

### 3.3.2. Analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor

- Planifikimi i seancave në fillim të vitit ka filluar më 13 janar të viti 2025 duke mbajtur parasysh që ditët e para të muajit janar, për çdo vit kalendarik, shërben si periudhë e bartjes së dosjeve gjyqësore të papërfunduara nga viti pararendës;
- Në shqyrtimin e mënyrës së planifikimit të seancave nga magjistratët pranë kësaj gjykate janë mbajtur parasysh si ditët e pushimeve zyrtare ashtu edhe ditët e festave zyrtare së bashku më lejet vjetore të konsumuara nga gjyqtari përkatës.
- Nga analiza mbi seancat gjyqësore të planifikuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konstatohet se në bazë mujore, numri më i madh i ditëve në të cilat janë planifikuar seanca gjyqësore ka qenë 22 ditë në muaj

me seanca, nga vetëm 1 gjyqtar pranë kësaj gjykate, nga gjyqtari (I. P.) vetëm për muajin tetor 2025.

- Në përgjithësi nga muaji Janar deri në muajin Tetor 2025, në rang mujor (ku llogariten 22 ditë pune) **janë planifikuar maksimalisht 19 ditë me seanca, dhe minimalisht 11 ditë me seanca në muaj**, përjashto këtu muajin gusht 2025, që është muaji në të cilin magistratët konsumojnë lejen vjetore, ku seancat janë planifikuar në bazë të gatishmërisë së gjyqtarëve sipas një urdhri të përcaktuar.
- U konstatua se **shpërndarja e seancave gjyqësore nuk është e njëtrajtshme, kështu ka ditë të javës të planifikuar me një maksimum prej 25 seancash gjyqësore, sikundër ka ditë ku planifikohet vetëm 1 seancë gjyqësore.**
- U konstatua se përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve me të cilin punon kjo gjykatë, konkretisht sistemi ICMIS, në të dhënat që gjeneron në lidhje me planifikimin e seancave për secilin gjyqtar, nuk pasqyrohet gjendja reali, pasi në rishortimin e çështjeve, të gjitha planifikimet dhe seancat e zhvilluara i ngarkohen gjyqtarit të ri dhe i largohen gjyqtarit të parë, duke rritur fiktivisht ngarkesën me planifikime të gjyqtarit pas rishortimit dhe duke zëruar ngarkesën dhe planifikim e gjyqtarit të larguar.
- Rezultoi se janë planifikuar çështje edhe në ditët e pushimit zyrtar në disa raste, të cilat lidhen me shpalljet e ditëve të pushimit gjatë vitit kalendarik ose me planifikimin e çështjeve të ngutshme (masat e sigurimit) sipas planifikimit të bërë për gatishmërinë.

Faktet e konstatuara në nivel gjykate:

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për periudhën e inspektuar, ka pasur 4079 çështje në gjykim (që përfshijnë çështjet e mbartura dhe të regjistruarat rishtas). Gjithashtu në të njëjtën periudhë kohore pranë kësaj gjykate janë përfunduar së shqyrtuari dhe shpallur 2688 çështje gjyqësore, pra rreth 65.9 % e çështjeve.
- Nga të dhënat e dërguara, rezulton së në nivel mesatar mujor, për të gjithë gjyqtarët pranë kësaj gjykate, numri i ditëve në të cilat janë planifikuar seanca për çdo muaj është: Janar 9 ditë; Shkurt 16 ditë; Mars 14 ditë; Prill 17 ditë; Maj 17 ditë; Qershor 14 ditë; Korrik 15 ditë; Gusht 3 ditë; Shtator 13 ditë dhe Tetor 15 ditë.
- Në lidhje me numrin e seancave të planifikuar në këtë gjykatë, për periudhën e inspektuar, po në nivel mesatar për të gjithë gjyqtarët rezultoi si vijon. Mesatarisht seancat e planifikuara mujore: Janar 58 seanca; Shkurt 66 seanca; Mars 59 seanca; Prill 70 seanca; Maj 74 seanca; Qershor 62 seanca; Korrik 56 seanca; Gusht 4 seanca; Shtator 47 seanca; Tetor 54 seanca.
- Rezulton se mesatarja mujore për këtë gjykatë për çështjet që janë planifikuar dhe realizuar, pra seancat janë zhvilluar, për të gjithë periudhën e inspektuar shfaqet si vijon: Janar 53 seanca; Shkurt 60 seanca; Mars 52 seanca; Prill 61 seanca; Maj 62 seanca; Qershor 52 seanca; Korrik 46 seanca; Gusht 4 seanca; Shtator 36 seanca; Tetor 42 seanca.

Faktet e konstatuara në nivel gjyqtari:

- Nga përpunimi i të dhënave të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, është bërë i mundur përpunimi për secilin gjyqtar të kësaj gjykate, duke nxjerrë për secilin prej tyre, në nivel mujor, numrin e ditëve të muajit që kanë planifikuar seanca, ditët e javës në të cilat janë planifikuar seancat si dhe numri e seancave të realizuara për çdo muaj. Të gjitha këto të dhëna janë nxjerrë pasi gjykata ka zbritur manualisht numrin e seancave gjyqësore të planifikuara dhe të zhvilluara të çështjeve të rishortuara, të cilat nga sistemi i menaxhimit të çështjeve i kanë kaluar të gjitha gjyqtarit të rishortuar. Në këtë këndvështrim në vijim paraqitën në mënyrë të përmbledhur këto të dhëna për secilin gjyqtar të kësaj gjykate që ka ushtruar efektivisht detyrën gjatë periudhës së inspektimit Janar – Tetor 2025. Të gjitha të dhënat e mëposhtme janë pjesë e aneksit 1 pjesë përbërëse e këtij raporti inspektimi.

1. Gjyqtari Aldi Kareco:

- Për muajin janar ka planifikuar 11 ditë me seanca për 111 çështje gjyqësore ndërsa ka realizuar 85 prej tyre. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 18 ditë me seanca gjyqësore, ka planifikuar 175 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 128 seanca gjyqësore. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte.
- Për muajin mars ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 141 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 89 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [Përgjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore, në periudhat nga 10.03.2025 deri më 13.03.2025, dhe nga 23.03.2025 deri më 26.03.2025, si dhe ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 27.03.2025].
- Për muajin prill ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 181 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 127 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte.
- Për muajin maj ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 175 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 117 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 6 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin qershor ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 176 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 126 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin korrik ka planifikuar 16 ditë me seanca, ka planifikuar 171 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 106 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 0 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte , 1 ditë të premte, 2 ditë të shtunë dhe 1 ditë të diel.

- Për muajin gusht ka planifikuar 3 ditë me seanca, për 7 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 7 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [Gjyqtar Aldi Kareco gjatë këtij muaji ka qenë me leje nga data 04.08.2025 deri me datë 07.08.2025 dhe nga data 18.08.2025 deri me datë 29.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 10 ditë me seanca, për 133 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 71 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 0 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë.
- Për muajin tetor ka planifikuar 14 ditë me seanca, për 152 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 81 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte dhe 1 ditë të diel.

## 2. Gjyqtari Delvijot Llusha:

- Për muajin janar ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 77 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 74 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 18 ditë me seanca, për 123 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 120 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin mars ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 110 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 106 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [Përgjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 05.03.2025 deri më 13.03.2025].
- Për muajin prill ka planifikuar 18 ditë me seanca, për 150 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 144 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 1 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte.
- Për muajin maj ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 142 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 133 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 5 ditë të premte. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 30.05.2025].
- Për muajin qershor ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 87 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 80 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin korrik ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 80 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 76 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin gusht ka planifikuar 2 ditë me seanca, për 4 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 4 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [Gjyqtari Delvijot Llusha ka qenë me leje për periudhat nga data 04.08.2025 deri me datë 10.08.2024 data 11.08.2024 deri me datë 17.08.2025 si dhe nga data 25.08.2025 datë 31.08.2025].

- Për muajin shtator ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 90 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 84 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin tetor ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 168 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 150 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 5 ditë të premte. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë 1 ditë raport mjekësor, në datën 10.10.2025].

### 3. Gjyqtarja Edlira Çota:


- Për muajin janar ka planifikuar 10 ditë me seanca, për 88 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 90 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 0 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 141 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 98 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë për 2 ditë me raport mjekësor, në periudhën 04.02.2025 dhe 05.02.2025].
- Për muajin mars ka planifikuar 14 ditë me seanca, për 132 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 109 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka marrë leje nga leja vjetore për periudhat nga 18.03.2025 deri më 21.03.2025, si dhe për datën 28.03.2025].
- Për muajin prill ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 182 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 123 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë për 2 ditë me raport mjekësor, në periudhën 15.04.2025 dhe 16.04.2025 dhe 1 ditë me raport mjekësor, për datën 01.04.2025].
- Për muajin maj ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 184 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 132 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë për 2 ditë me raport mjekësor, në periudhën 07.05.2025 dhe 08.05.2025].
- Për muajin qershor ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 166 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 122 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të Hënë, 2 ditë të Martë; 4 ditë të Mërkura, 2 ditë të Enjte dhe 3 ditë të Premte. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga 02.06.2025 deri më 03.06.2025]
- Për muajin korrik ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 192 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 135 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 të shtunë.
- Për muajin gusht ka planifikuar 4 ditë me seanca, për 13 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 13 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 1 ditë të martë, 1 ditë të mërkurë dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë

me leje vjetore nga data 01.08.2025 deri me datë 15.08.2025. data 25.08.2025 deri me datë 31.08.2025].

- Për muajin shtator ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 127 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 59 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë për 1 ditë me raport mjekësor, për datën 15.09.2025].
- Për muajin tetor ka planifikuar 9 ditë me seanca, për 40 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 21 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.

#### 4. Gjyqtarja Eglantina Biba:

- Për muajin janar ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 100 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 85 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të diel.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 143 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 136 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte.
- Për muajin mars ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 122 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 111 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të diel. [gjatë këtij muaji gjyqtarja ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga 10.03.2025 deri më 15.03.2025]
- Për muajin prill ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 151 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 141 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte , 1 të shtunë dhe 1 ditë të diel.
- Për muajin maj ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 163 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 149 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte. [gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga 21.05.2025 deri më 24.05.2025]
- Për muajin qershor ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 176 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 140 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte. [gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka munguar për periudhën nga 23.06.2025 deri më 27.06.2025 (për shkak të ndërrimit të jetës së nënës)].
- Për muajin korrik ka planifikuar 14 ditë me seanca, për 174 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 156 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte.
- Për muajin gusht ka planifikuar 2 ditë me seanca, për 6 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 5 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 1 ditë të



- enjte. [gjatë këtij muaji gjyqtare Eglantina Biba ka marrë leje vjetore për periudhën nga data 11.08.2025 deri me datë 31.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 18 ditë me seanca, për 150 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 133 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 3 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë dhe 1 ditë e diel.
  - Për muajin tetor ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 194 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 151 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 5 ditë të premte.

5. Gjyqtari Elvis Sulejmani:

- Për muajin janar ka planifikuar 8 ditë me seanca, për 110 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 98 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 0 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 2 ditë të shtunë.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 149 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 133 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 0 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin mars ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 95 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 89 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga 13.03.2025 deri më 25.03.2025].
- Për muajin prill ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 145 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 119 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 0 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte , 2 të shtunë.
- Për muajin maj ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 138 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 90 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 2 ditë të shtuna.
- Për muajin qershor ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 138 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 94 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin korrik ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 148 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 102 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin gusht ka planifikuar 4 ditë me seanca, për 6 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 5 seanca. gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të mërkurë, 1 ditë të premte dhe 1 ditë të diel. [gjatë kësaj periudhe gjyqtar ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga data 05.08.2025 deri me datë 23.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 89 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 41 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 0 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga data 01.09.2025 deri me datë 03.09.2025].

- Për muajin tetor ka planifikuar 10 ditë me seanca, për 68 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 16 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.

#### 6. Gjyqtari Ilir Përdeda:

- Për muajin janar ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 119 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 113 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 205 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 190 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të diel.
- Për muajin mars ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 206 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 270 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin prill ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 278 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 141 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin maj ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 246 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 237 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 2 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 20.05.2025].
- Për muajin qershor ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 252 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 246 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 2 ditë të shtuna.
- Për muajin korrik ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 230 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 228 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të diel.
- Për muajin gusht ka planifikuar 3 ditë me seanca, për 18 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 18 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 1 ditë të martë dhe 1 ditë të mërkurë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje vjetore për periudhën nga data 01.08.2025 deri me datë 21.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 188 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 187 seanca. gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin tetor ka planifikuar 22 ditë me seanca, për 257 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 244 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 5 ditë të enjte dhe 4 ditë të premte dhe 1 ditë e shtunë.

7. Gjyqtarja Irma Cacaj:

- Për muajin janar ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 75 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 71 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 119 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 114 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të diel.
- Për muajin mars ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 111 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 106 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin prill ka planifikuar 19 ditë me seanca, për 146 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 134 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte , 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore për periudhën nga 22.04.2025 deri më 23.04.2025].
- Për muajin maj ka planifikuar 17 ditë me seanca, për 148 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 133 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin qershor ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 100 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 90 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin korrik ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 106 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 92 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 1 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të diel. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka qenë me 2 ditë raport (3 ditë raport mjekësor, për periudhën nga 30.07.2025 deri më 01.08.2025].
- Për muajin gusht ka planifikuar 3 ditë me seanca, për 12 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 12 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të martë, 1 ditë të mërkurë, 1 ditë të enjte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë lejen vjetore nga data 01.08.2025 deri me datë 08.08.2025, nga 18.08.2024 deri me datë 24.08.2025 si dhe nga data 25.08.2025 deri m 31.08.2025; gjatë këtij muaji gjyqtarja ka qenë edhe me 1 ditë raport, datë 01.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 105 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 82 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin tetor ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 193 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 176 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte, 1 ditë të shtunë dhe 1 ditë të diel.

8. Gjyqtari Lirim Bulica:

- Për muajin janar ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 136 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 119 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë 1 ditë raport mjekësor, për datën 13.01.2025, si dhe ka marrë leje nga leja e vitit 2024, për më datë 31.01.2025];
- Për muajin shkurt ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 164 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 155 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte. [gjatë këtij muaji ka marrë leje nga leja e vitit 2024, për më datë 01.02.2025].
- Për muajin mars ka planifikuar 11 ditë me seanca, për 70 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 52 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte dhe 1 ditë të diel. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka 1 ditë raport mjekësor, në datën 10.03.2025; ka marrë leje nga leja vjetore e vitit 2024 për periudhën nga 11.03.2025 deri më 21.03.2025, si dhe leje për periudhën nga 24.03.2025 deri më 26.03.2025 (për shkak të lindjes së fëmijës)].
- Për muajin prill ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 174 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 165 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 5 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin maj ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 145 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 124 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte.
- Për muajin qershor ka planifikuar 12 ditë me seanca, për 145 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 138 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 2 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin korrik ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 182 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 165 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 5 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte.
- Për muajin gusht ka planifikuar 2 ditë me seanca, për 8 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 8 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 1 ditë të mërkurë, 1 ditë të diel. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë lejen vjetore për periudhën nga data 11.08.2025 deri me datë 29.08.2025].
- Për muajin shtator ka planifikuar 13 ditë me seanca, për 96 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 90 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 2 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë.
- Për muajin tetor ka planifikuar 14 ditë me seanca, për 171 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 122 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 4 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë 1 ditë raport mjekësor, në datën 14.10.2025].

## 9. Gjyqtari Renis Sheshi:

- Për muajin janar ka planifikuar 10 ditë me seanca, për 61 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 61 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 1 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 3 ditë të enjte dhe 0 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë.
- Për muajin shkurt ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 95 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 104 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 3 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 1 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të shtunë.
- Për muajin mars ka planifikuar 16 ditë me seanca, për 79 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 78 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 5 ditë të hënë, 3 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 2 ditë të premte dhe 1 ditë të diel. [gjatë këtij muaji gjyqtari ka marrë leje nga leja vjetore, për periudhën nga 10.03.2025 deri më 13.03.2025].
- Për muajin prill ka planifikuar 14 ditë me seanca, për 58 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 58 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 3 ditë të mërkura, 2 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.
- Për muajin maj ka planifikuar 15 ditë me seanca, për 59 çështje gjyqësore dhe ka realizuar 59 seanca. Gjatë këtij muaji ka gjykuar seanca 4 ditë të hënë, 4 ditë të martë; 2 ditë të mërkura, 4 ditë të enjte dhe 1 ditë të premte.

### 3.3.3. Korrelacioni midis ngarkesës/planifikimit/ vendimeve të shpallura

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në informacionin e nisur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka vendosur në dispozicion edhe raportimet tre mujore që kjo gjykatë ka detyrim ligjor t'i bëjë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga ky material i nisur nga gjykata vihet re, që është gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të çështjeve me të cilin kjo gjykatë operon (ICMIS), se të dhënat për planifikimet për secilin gjyqtar përfshijnë edhe të dhënat mbi çështjet e rishortuara, duke i bërë këto të dhëna të pasakta, sipas vetë shpjegimit që kjo gjykatë ka dhënë në shkresën përcjellëse të materialit. Pas rikërkimit të të dhënave nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjykata manualisht bëri rregullimet e nevojshme dhe vendosi në dispozicion të dhëna reale. Për këtë arsye të dhënat e tremujoreve të nisura si raportime pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk janë marrë në konsideratë për nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave të pasqyruara në këtë raport.
- Përsa i përket çështjeve të rishortuara pranë kësaj gjykate, ato janë trajtuar si nëndarje më vetë në këtë raport dhe janë llogaritur në ngarkesën e përgjithshme të secilit gjyqtar, por jo në planifikimin e seancave deri në ditën kur ka ndodhur ky rishortim.
- Nga analiza e të dhënave mbi planifikimet e seancave të gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nuk mund të konkludohet në një model tip, të planifikimit të seancave nga gjyqtarët, por vihet re që përgjithësisht gjyqtarët planifikojnë tre ditë me seanca në javë. Ndërkohë edhe pse ka edhe javë në të cilat janë planifikuar të gjitha ditët me seanca, por numri i tyre

në ditë është shumë me i ulët se numri i seancave në ditët që normalisht zhvillohen seanca pranë kësaj gjykate.

- Përsa i përket raportit midis ngarkesës se gjyqtarit dhe vendimeve të shpallura edhe pse nuk mund të dilet në një konkluzion se cili gjyqtar ka qenë më efikas në evadimin e çështjeve, sepse kjo do të ishte pjesë e një analize më të thelluar, duke mbajtur parasysh përveç ngarkesës aritmetike, llojin e çështjeve, numrin e palëve në një çështje etj., vihet re se të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kanë përfunduar mbi 60 % të çështjeve në shqyrtim.

### 3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur, paraqitet situata e seancave të planifikuara nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si dhe mesatarja mujore e seancave të planifikuara nga kjo gjykatë për secilin muaj të periudhës së inspektimit.

Kalendar lidhur me seancat e planifikuara për secilin gjyqtar pas verifikimit të tabelave të ridërguara											
Gjyqtari	Aldi Kareco	Delvijot Llusha	Edlira Çota	Eglantina Biba	Elvis Sulejmani	Illir Perdeda	Irma Cacaj	Lirim Bulica	Renis Shehi	Totali seancave për periudhën e inspektimit	Numri mesatar në nivel Gjykate
Janar	111	77	88	100	110	119	75	136	61	877	97
Shkurt	175	123	141	143	149	205	119	164	95	1314	146
Mars	141	110	132	122	95	206	111	70	79	1066	118
Prill	181	150	182	151	145	278	146	174	58	1465	163
Maj	175	142	184	163	138	246	148	145	59	1400	155
Qershor	176	87	166	176	138	252	100	145	0	1240	138
Korrik	171	80	192	174	148	230	106	182	0	1283	143
Gusht	7	4	13	6	6	18	12	8	0	74	8
Shtator	133	90	127	150	89	188	105	96	0	978	108
Tetor	152	168	40	194	68	257	193	171	0	1243	138
Totali seancave për periudhën e inspektimit	1422	1031	1265	1379	1086	1999	1115	1291	352	10940	

### 4. Konkluzione

- Rezulton se jo në të gjitha ditës e punës, planifikohen seanca nga gjyqtarët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
- Rezulton se shpërndarja e seancave të planifikuara nuk është e njëjtë ose e përafërt në të gjitha ditët e javës. Ka ditë në të cilat janë planifikuar maksimumi 26 (L. B.) seanca dhe ditë me 1 seancë gjyqësore.
- Rezulton që secili gjyqtar i kësaj gjykate, të paktën një ditë në javë të mos planifikojë seanca gjyqësore.

- Rezulton që ka gjyqtarë që nuk planifikojnë seanca gjyqësore për disa ditë brenda të njëjtës javë, dhe shtojnë numrin e seancave të planifikuara në javët në vazhdim, duke vendosur në pikëpyetje cilësinë e seancave në ditën e ngarkuara.
- Rezulton që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, funksiononte, deri në momentin e kryerjes së këtij inspektimi, me 9 gjyqtarë. Ndërkohë struktura e saj është plotësuar dhe funksionon me 12 gjyqtarë.
- Rezulton që sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, me të cilin operon kjo gjykatë, shfaq probleme në drejtim të çështjeve të rishortuara, duke i bashkëngjitur të gjitha të dhënat, gjyqtarit të cilit i kalon në rishortim çështja dhe rrit artificialisht ngarkesën e gjyqtarit të ri, dhe eliminon të dhënat për ngarkesën e gjyqtarit të mëparshëm.
- Rezulton se përgjithësisht seancat e planifikuara nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë realizuar në masën 85% - 97%.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë).*

# ‡ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

## 1. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

### 1.1. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2925 prot, datë 20.10.2025, në kuadër të inspektimit tematik të Gjykatave me objekt: *“Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”* i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me kërkesë për informacion i cili duhet të dërgohej brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me shkresën nr. 1917/1 prot., datë 06.11.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2925/1 prot., datë 10.11.2025, ka përcjellë informacionin në lidhje me procedurën e ndjekur për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në këtë gjykatë.

Më datë 14.11.2025, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, u krye një vizitë nga grupi i inspektimit i përbërë nga: Inspektori përgjegjës z. Albert Kazia dhe ndihmësinsektorët znj. Aulona Levani dhe z. Vildan Kaloshi, të ngarkuar për sqarimin dhe marrjen e dokumentacionit të plotë të kërkuar me shkresën nr. 2925 prot., datë 20.10.2025, pranë subjektit të inspektuar.

Gjatë vizitës më datë 14.11.2025 ora 13:30, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në kuadër të zhvillimit të procedurës së inspektimit tematik me objekt: *“Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”*, nga grupi i inspektimit i përbërë nga: Inspektori përgjegjës z. Albert Kazia dhe ndihmësinsektorët znj. Aulona Levani dhe z. Vildan Kaloshi, u krye verifikimi në ambientet e gjykatës, si dhe u zhvilluan intervista me Kancelaren dhe përfaqësues të administratës gjyqësore<sup>[146]</sup>.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër më datë 19.11.2025, në vijim të informacioneve të administruara nga grupi inspektimit gjatë vizitës në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është dërguar nëpërmjet adresës elektronike: [info@ild.al](mailto:info@ild.al) me e-mail informacione shtesë në vijim të informacioneve të kërkuara nëpërmjet shkresës me nr. 2925 prot., datë 20.10.2025 e cila është protokolluar me nr. 2925/3 prot., datë 19.11.2025.

[146] Aktet e tërhequra gjatë verifikimit u bënë në hyrje në zyrën e arkiv-protokollit me shkresën nr. 2925/2 prot., datë 14.11.2025.

Në vijim Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2925/4 prot., datë 20.11.2025, në kuadër të inspektimit tematik të gjykatave me objekt: “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” pas analizimit të informacionit të administruar deri në datë 20.11.2025, u pa e arsyeshme për t’iu drejtuar përsëri Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me kërkesë për informacion i cili duhet të dërgohej brenda datës 27.11.2025.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me shkresën nr. 1917/4 prot., datë 27.11.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2925/5 prot., datë 04.12.2025, ka përcjellë informacionin e kërkuar me shkresën nr. 2925/4 prot., datë 20.11.2025.

Në lidhje me gatishmërinë e gjyqtarëve për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka dërguar: -urdhër nr. 206 datë 31.12.2025<sup>[147]</sup> “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 06.01.2025 deri me datë 02.03.2025”; -urdhër nr. 208, datë 31.12.2024 “Për përcaktimin e gatishmërisë për gjykimin e kërkesave administrativo-penale, seksioni i të miturve për periudhën nga data 01.01.2025 deri me datë 31.03.2025”; -urdhër nr. 20, datë 28.01.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 03.02.2025 deri me datë 30.03.2025”; -urdhër nr. 83, datë 28.03.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 31.03.2025 deri me datë 06.04.2025”; -urdhër nr. 89, datë 01.04.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë për gjykimin e kërkesave administrativo-penale, seksioni i të miturve për periudhën nga data 01.04.2025 deri me datë 30.06.2025”; -urdhër nr. 95, datë 03.04.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 06.04.2025 deri me datë 04.05.2025”; -urdhër nr. 125, datë 30.04.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 05.05.2025 deri me datë 31.07.2025”; -urdhër nr. 164, datë 30.06.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë për gjykimin e kërkesave administrativo-penale, seksioni i të miturve për periudhën nga data 01.07.2025 deri me datë 31.07.2025”; -urdhër nr. 174, datë 25.07.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 01.08.2025 deri me datë 31.08.2025”; -urdhër nr. 176, datë 25.07.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 01.09.2025 deri me datë 30.09.2025”; -urdhër nr. 185, datë 01.09.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë për gjykimin e kërkesave administrativo-penale, seksioni i të miturve për periudhën nga data 01.09.2025 deri me datë 30.09.2025”; -urdhër nr. 200, datë 30.09.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë së gjyqtarëve për periudhën nga data 01.10.2025 deri me datë 31.10.2025”; -urdhër nr. 201, datë 30.09.2025 “Për përcaktimin e gatishmërisë për gjykimin e kërkesave administrativo-penale, seksioni i të miturve për periudhën nga data 01.10.2025 deri me datë 31.10.2025”; dhe -urdhër nr. 201/1, datë 08.10.2025 “Për ndryshimin e urdhrës të brendshëm nr. 201, datë 30.09.2025”.

[147] Viti 2015, referuar përmbajtjes së aktit, rezulton se është pasqyruar gabim dhe bëhet fjalë për vitin 2024.

Gjithashtu në përgjigje të kërkesës së ILD-së, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka dërguar: “Analizën vjetore të vitit 2024” (shkresa nr. 647 prot., datë 28.03.2025).

## 2. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

### 2.1 Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi

Në kohën e inspektuar pozicioni i Kryetarit të gjykatës ka qenë vakant, por gjykata është drejtuar nga gjyqtari z. Enri Rista, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin e datës 29.09.2025, në detyrën e zëvendëskryetarit<sup>[148]</sup> për një mandat 1-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje (shkresa nr. 1657/2 prot., datë 29.09.2025, që gjykata i ka dërguar KLGJ-së). Kancelare e gjykatës është znj. Florinda Cungeli (Gega), [caktuar nga Këshilli i Gjykatës me vendimin nr. 12, datë 16.04.2025 (shkresa nr. 758 prot., datë 16.04.2025),]<sup>[149]</sup>.

**Organizimi i brendshëm dhe rregullorja:** Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ushtron veprimtarinë administrative pa një rregullore të brendshme të miratuar, duke zbatuar në mënyrë të plotë Vendimin nr. 150, datë 29.03.2023, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky akt normativ përbën dokumentin kryesor rregullator për funksionimin administrativ, përderisa gjykata nuk ka një rregullore të brendshme të posaçme. Aktualisht po punohet për draftin e rregullores së re<sup>[150]</sup>.

<sup>[148]</sup> Sipas pikës 1 (iii), të vendimit nr. 324, datë 22.07.2021, për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, në të cilin është parashikuar: “... iii. Neni 7 pika 2, ndryshohet si më poshtë: “2.Në rastet kur nuk konkurrojnë kandidatë që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale, ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.”,...etj.”.

<sup>[149]</sup> Znj. Florinda Cungeli (Gega), ushtron detyrën e Shefes së Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve dhe ka zëvendësuar kancelaren e gjykatës znj. V. S., së cilës i është ndërprerë marrëdhënia e punës në zbatim të urdhrit nr. 84, datë 01.04.2025 të Zv/Kryetares së Gjykatës, urdhër i cili është marrë në mbështetje të vendimit nr. 691, datë 15.11.2023 të KLGJ-së dhe vendimit nr. 33, datë 18.03.2025 të Gjykatës së Administrative të Apelit.

<sup>[150]</sup> Në takimin e punës zhvilluar me datë 14.11.2025, datë në të cilën u krye edhe vizita në organin e inspektuar, na u sqarua nga Kancelarja e Gjykatës, se nga Këshilli i Gjykatës me vendimin nr. 24, datë 06.11.2024 (shkresa nr. 297/7 prot., datë 06.11.2024), është ngritur grupi i punës, dhe se po punohej për draftin e rregullores së gjykatës, i cili pritej të miratohej së shpejti.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është e organizuar në tre seksione gjyqësore, përkatësisht: Seksionin Civil<sup>[151]</sup>, Seksionin Penal<sup>[152]</sup> dhe Seksionin Penal për të Mitur.

**Planifikimi i sallave të gjykimit.** Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përbëhet nga 3 kate dhe ka 7 salla gjykimi nga të cilat: 5 salla gjykimi janë standarde<sup>[153]</sup> dhe 2 salla gjykimi janë të improvizuara. Në katin e parë ndodhet salla nr. 1 dhe salla nr. 2, në katin e tretë ndodhet salla nr. 3, salla nr. 4 dhe salla nr. 5, ndërsa në katin e dytë ndodhen 2 salla gjykimi të improvizuara. Lidhur me rregullin e ndarjes së sallave të gjykimit, rezulton se nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nuk ka pasur dhe nuk ka aktualisht një urdhër të posaçëm për ndarjen e sallave të gjykimit, ndërmjet gjyqtarëve gjatë viteve të fundit. Për këtë arsye sallat e gjykimit ishin ndarë mbi bazën e marrëveshjes ndërmjet vetë gjyqtarëve, ndarje e cila ka qenë e kushtëzuar nga numri i kufizuar i sallave në dispozicion (*5 salla gjykimi dhe 2 salla të improvizuara*), si dhe nga fakti se këto të fundit aksesohen në pjesën e brendshme të gjykatës, në përdorim të përbashkët me gjyqtarët dhe administratën, në raport me numrin e gjyqtarëve dhe nevojën për respektimin e protokolleve të sigurisë në institucion. Seancat zhvillohen kryesisht në salla të pajisura me sistem audio-viziv.

**Organika e gjykatës:** Në lidhje me organizimin strukturor, gjykata ushtronte veprimtarinë e saj në godinën e ish-Gjykatës së Apelit Shkodër<sup>[154]</sup> dhe funksiononte në bazë të organikës së miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, fillimisht me Vendimin nr. 4, datë 31.03.2023, të Këshillit të Gjykatës<sup>[155]</sup>, më pas organika e miratuar ka pësuar ndryshime,

[151] Referuar vendimit të Këshillit të Gjykatës nr. 21, datë 07.10.2024 “Për riorganizimin e seksioneve dhe ndarjen e trupave gjyqësore”, (*shkresa nr. 1701 prot., datë 07.10.2024*), i ndryshuar.

[152] Referuar vendimit të Këshillit të Gjykatës nr. 5, datë 19.03.2025 “Për riorganizimin e seksioneve dhe ndarjen e trupave gjyqësore”, (*shkresa nr. 580 prot., datë 19.03.2025*), ndryshuar me vendimin nr. 51, datë 17.07.2025 “Për riorganizimin e seksioneve dhe ndarjen e trupave gjyqësore”, (*shkresa nr. 1391 prot., datë 17.07.2025*).

[153] Gjykata disponon 7 (*shtatë*) salla gjykimi të cilat u inspektuan edhe nga afër nga grupi i inspektimit gjatë vizitës më datë 14.11.2025, të cilat përdorshin për zhvillimin e seancave sipas planifikimit të realizuar nga vetë gjyqtarët në raport me ngarkesën individuale dhe natyrën e çështjeve të caktuara. Theksojmë se të dhënat e mësipërme, si referencë burimin për 5 sallat e gjykimit që janë standarde bazohen edhe në vendimin nr. 23, datë 06.11.2024 “Mbi ndryshimin e selisë qendrore dhe akomodimin e Dhomës Penale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe stafit mbështetës, në godinën e ish-Gjykatës së Apelit Shkodër”, të Këshillit të Gjykatës (*shkresa nr. 158/2 prot., datë 06.11.2024*), i ndryshuar me vendimin nr. 23/1 datë 20.11.2024 (*shkresa nr. 158/4 prot., datë 20.11.2024*).

[154] Adresa: Rruga “Et’hem Osmani”, Shkodër 4001, sipas vendimit nr. 23, datë 06.11.2024, të Këshillit të Gjykatës, i ndryshuar.

[155] Detajimin e pozicioneve të punës për punonjësit e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Miratimin e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve, e të nëpunësve civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sipas anekseve bashkëlidhur vendimit nr. 150 datë 29.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” Për miratimin e rregullave standarde. për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të

duke u rritur nga 75 në 79 punonjës me vendimin nr. 6, datë 03.03.2025<sup>[156]</sup> të Këshillit të Gjykatës.

Trupa gjyqësore e miratuar është prej 15 gjyqtarësh<sup>[157]</sup>, por në fakt në periudhën e inspektimit ka funksionuar me kapacitet të reduktuar.

**Gjendja e trupës gjyqësore:** Nga verifikimi i organikës faktike rezultoi se gjykata ka funksionuar me trupa gjyqësore të reduktuara, ku numri i gjyqtarëve ka qenë nga **8 deri në 10** dhe në ndryshim të vazhdueshëm, për shkak të transferimeve, pezullimeve, rikthimeve në detyrë dhe lejeve të veçanta të gjyqtarëve, përkatësisht si vijon për gjyqtarin:

1. Albert Keraj me vendimin nr. 130, datë 06.03.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “...transferimin me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan...etj.”;
2. Ermira Dedja<sup>[158]</sup> me vendimin nr. 24, datë 25.03.2025, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur: “... ndryshimin e vendimit nr. 496 datë 12.01.2022 të KPK-së dhe konfirmimin e saj në detyrë...etj.”. Pra për periudhën 12.01.2022 -

Juridiksionit të Përgjithshëm”, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi. Sa më sipër organika e gjykatës ka qenë si më poshtë: • Trupa gjyqësore e përbërë nga 15 gjyqtarë, ndër të cilët 1 (një) kryetar dhe 1 (një) zëvendëskryetar: (gjithsej 140); • Kancelari 1 (një); • Kryesekretaria dhe sekretarët gjyqësore janë 2 (dy) kryesekretare dhe 18 (tetëmbëdhjetë) sekretare (gjithsej 20); • Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, përbëhet nga shef sektori 1 (një), specialist buxheti 1 (një), specialist finance 1 (një) dhe 2 (dy) magaziniere, (gjithsej 5 pesë); • Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve përbëhet nga: Shef Sektori 1 (një), Specialist Burime Njerëzore dhe Shërbime Mbështetëse 1 (një), Specialist Prokurime 1 (një), sanitar 4 (katër), shofer 2 (dy); Mirëmbajtës 2 (dy), Punonjës sigurie 3 (tre), Nëpunës gjyqësor 5 (pesë), Ftues 5 (pesë), gjithsej 24 (njëzet e katër); • Sektori i IT-së, Statistikë dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Median përbëhet nga: Shef Sektori 1 (një), Specialist IT-së 1 (një), Specialist IT-së dhe Statistike 1 (një), Specialist Marrëdhënieve Publikun dhe Median dhe Jashtë 1 (një), gjithsej 4 (katër); • Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë që përbëhet: Shef Sektori 1 (një), Specialist Protokoll 1 (një), Specialist Arkivë 1 (një), dhe Zyra e Shërbimit Pukë e përbërë nga 3 (tre) nëpunës civil gjyqësor.

<sup>[156]</sup> Organika e gjykatës është ndryshuar si më poshtë: Në Sektorin e Shërbimeve Gjyqësore janë shtuar 2 (dy) sekretare (nga 18 janë bërë 20 sekretare gjyqësore); Në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Jashtë është shtuar 1 (një) Specialist Statistike (nga 3 specialistë dhe 1 shef sektori janë bërë 4 specialistë dhe 1 shef sektori); Në Sektorin e Burimeve Njerëzore Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, është shtuar 1 (një) punonjës sigurie (nga 3 punonjës sigurie janë bërë 4 punonjës sigurie).

<sup>[157]</sup> Shih vendimin nr. 6, datë 19.03.2025 të Këshillit të Gjykatës: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me kërkesën nr. 2084 prot., datë 03.12.2024 i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për shtimin e organikës së kësaj gjykate në disa zëra të organikës. Këshilli të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 15 datë 21.01.2025 ka shtuar organikën vetëm për administratën gjyqësore, duke vendosur që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ta ushtroj veprimtarinë e saj po me 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

<sup>[158]</sup> Me vendimin nr. 496, datë 12.1.2022 të KPK-së është vendosur: “...shkarkimi nga detyra i gjyqtarës Ermira Dedja...etj.”, dhe për periudhën 21.12.2022 - 03.07.2025 - gjyqtari ka qenë i **pezulluar ex lege** nga detyra, për shkak të shkarkimit nga KPK.

25.03.2025, gjyqtarja ka qenë e pezulluar ex lege nga detyra, për shkak të shkarkimit nga KPK;

3. Andri Ymeri<sup>[159]</sup> me vendimin nr. 51, datë 03.07.2025 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur: “...lënien në fuqi të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022 të KPK-së, për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Andri Ymeri...etj.”, pra për periudhën 21.12.2022 - 03.07.2025, gjyqtari ka qenë i pezulluar ex lege nga detyra, për shkak të shkarkimit nga KPK;
4. Gentjan Jahjollli<sup>[160]</sup> me vendimin nr. 655, datë 23.09.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “...transferimin e gjyqtarit Gentian Jahjollli, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë...etj.”;
5. Tonin Sterkaj me vendimin nr. 795, datë 04.09.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “... shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Tonin Sterkaj, nga detyra e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër...etj.”. Pra për periudhën 05.09.2024 e në vazhdim, gjyqtari ka qenë i pezulluar ex lege nga detyra, për shkak të shkarkimit nga KPK;
6. Izabela Radovani me vendimin nr. 647, datë 14.04.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “... shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit znj. Izabela Radovani, nga detyra e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër...etj.”, ndërsa Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin e datës 30.09.2025, ka vendosur: “... lënien në fuqi të vendimit nr. 647, datë 14.04.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm. U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.09.2025....etj.”;
7. Arta Llazari me vendimin nr. 189, datë 02.04.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “...pezullim nga detyra për një periudhë prej 6 muajsh....etj.”, ndërsa me vendimin nr.671 datë 01.10.2025, Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka miratuar: “... kërkesën e gjyqtarës për dhënie leje të papaguar për një periudhë 3-mujore nga data 03.10.2025-03.01.2026...etj.”;
8. Egla Mirashi gjatë periudhës 16.05.2025 deri me datë 18.07.2025, ka qenë me raport barrë lindje.

[159] Me vendimin nr. 604, datë 21.12.2022 të KPK-së është vendosur: “...shkarkimi nga detyra e gjyqtarit Andri Ymeri...etj.”, dhe për periudhën 21.12.2022 - 03.07.2025 - gjyqtari ka qenë i pezulluar ex lege nga detyra, për shkak të shkarkimit nga KPK.

[160] a) Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 731, datë 07.12.2023 ka vendosur: “...Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për një afat deri më 31.12.2024...etj.” dhe b) Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 750, datë 18.12.2024 ka vendosur: “...Përsëritjen e komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin e “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për një afat deri 31.08.2025. 2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 01.01.2025....etj.”. c) Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 731, datë 07.12.2023 ka vendosur: “Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në fund të afatit të komandimit, më datë 31.08.2025. 2. Kthimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër...etj.”.

Në mënyrë të përmbledhur për periudhën e inspektimit theksojmë se me datë 1 janar 2025 trupa gjyqësore është përbërë nga 10 gjyqtarë efektiv, në datë 06.03.2025 është larguar për shkak të transferimit, gjyqtari Albert Keraj, duke mbetur me 9 gjyqtarë efektiv, me datë 25.03.2025 është rikthyer gjyqtarja Ermira Dedja, duke u bërë 10 gjyqtarë efektiv, në datë 02.04.2025 është vendosur pezullimi i gjyqtares Arta Llazari nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mbetur me 9 gjyqtarë efektiv, me datë 16.05.2025 është larguar gjyqtarja Eglja Mirashi për shkak të lejes së barrëlindjes, duke mbetur me 8 gjyqtarë efektiv, me datë 06.09.2025 është rikthyer nga leja e lindjes gjyqtarja Eglja Mirashi, duke u bërë 9 gjyqtarë efektiv, dhe me datë 01.10.2025 është transferuar gjyqtari Orgent Nazaj, duke mbetur me 8 gjyqtarë efektiv.

Ndërkohë, në datën 22.10.2025 janë emëruar 5 gjyqtarë të rinj konkretisht gjyqtarët z. Alfred Vokri, znj. Ermira Shkreta, znj. Jola Sado, znj. Zamira Lila dhe znj. Ketjona Kaçupi, të cilët nuk përfshihen në analizën e këtij inspektimi, pasi kanë filluar detyrën pas përfundimit të periudhës së inspektimit, fakt i cili konstatohet se për çështjet që kanë marrë me short, planifikimin e seancave gjyqësore e kanë bërë në muajin nëntor e në vazhdim.

## **2.2 Konstatimet mbi seancat përsa i përket sistemit të menaxhimit të çështjeve funksionale në gjykatë (ICMIS)**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të gjykimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Në analizë të informacioneve të administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të dhënat që raporton sistemi në lidhje me planifikimet ditore të gjyqtarëve nuk janë të sakta në shpërndarjen e tyre. Ato kanë saktësi sa i përket numrit të seancave ditore por jo shpërndarjes së tyre në gjyqtarë. Ky fakt është konstatuar nga ana e Sektorit të Statistikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe shkak ka qenë ndryshimet e shpeshta të trupës gjyqësore, për shkak të transferimeve, (p.sh. në rastin e gjyqtarit Albert Keraj), pezullimit (p. sh., në rastin e gjyqtares Arta Llazari), apo edhe lejes së lindjes (p.sh. në rastin e gjyqtares Eglja Mirashi), ku çështjet e tyre janë rishortuar në gjyqtarët e tjerë të seksionit. Me rishortimet e çështjeve edhe planifikimi i tyre i mëparshëm, është transferuar pranë gjyqtarit të ri, duke bërë që sistemi të raportojë jo saktë të dhënat sa i përket planifikimeve (shembull: Gjyqtarit z. Albert Keraj i cili është transferuar në datë 06.03.2025 i dalin planifikim vetëm seancat gjyqësore që i referohen çështjeve të përfunduara nga ana e tij, ndërsa seancat e çështjeve që ky ka pasur ngarkesë, me transferimin e tij i janë rishortuar gjyqtarëve të tjerë, dhe rezultojnë tashmë si planifikim i tyre. Shembull tjetër: Gjyqtarja znj. Ermira Dedja është rikthyer në gjykatë në datë 25.03.2025, dhe ka marrë ngarkesë të re si dhe ngarkesën e rishortuar nga gjyqtarja

znj. Arta Llazari. Në sistem gjyqtarja znj. Ermira Dedja rezulton se ka gjykuar edhe gjatë muajve janar 2025, shkurt 2025 dhe mars 2025, që në fakt janë planifikime të çështjeve që ka pasur gjyqtarja znj. Arta Llazari dhe pas rishortimit i kanë kaluar znj. Ermira Dedja).

Në lidhje me numrin ditor të seancave të gjykatës, numrin mujor dhe pastaj edhe të periudhës së inspektimit rezultojnë se janë në sinkron me numrin e seancave të zhvilluara në ditët, muajt dhe periudhën e pasqyruar në tabelat e shpërndarjes së ngarkesës ditore të seancave gjyqësore pranë kësaj gjykate. Në të njëjtën linjë këto raporte pasqyrojnë shfrytëzueshmërinë e sistemit Audio dhe gjykimit në zyrë, (kjo e fundit përgjithësisht për shkak të gjykimeve në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve ligjore dhe shumë rrallë ka ardhur si rezultat i mospasjes në dispozicion të sallave të gjykimit).

Gjithashtu, 7 sallat e gjykimit rezultojnë se janë ndarë me ditë mes gjyqtarëve me mirëkuptim, jo në mënyrë të prerë, por në vija të përgjithshme janë përkujdesur të gjithë për shfrytëzimin e tyre, duke realizuar pjesën dërrmuese të seancave në salla gjykimi me sistem audio-viziv.

Në lidhje me këtë pikë vlen të theksohet se edhe mos çeljet në të shumtën e rasteve realizohen në ambientet e zyrës. (Shembull i fundit është në javën 7-10 tetor kur për shkak të ngjarjes së rëndë të vdekjes së gjyqtarit A.K, u vendos moszhvillimi i asnjë seance gjyqësore, ku nga sekretaret janë bërë mos çelje të cilat sistemi i raporton në zyrë ose dhomë këshillimi, që do të thotë nuk janë në audio.)

Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në kalendarin e seancave të planifikuara, konstatohet se ka mospërputhje të të dhënave për çështjet e rishortuara me të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi, në mënyrë të veçantë përse i përket emrit të gjyqtarit. Referuar informacionin të administruar nga Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në lidhje me arsyen e këtyre mospërputhjeve, saktësimin e tyre si dhe ridërgimin e të dhënave në lidhje me seancat e planifikuara (në fakt) për çdo ditë, nga secili gjyqtar (në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, kryetarit, anëtarit) si dhe seancat e zhvilluara, në nivel mujor për secilin gjyqtar për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, kjo pasaktësi ka ndodhur si rezultat i ndryshimeve në trupën gjyqësore (relatorit të çështjes) për shkak të transferimit. Me kalimin e çështjes nga një gjyqtar tek tjetri edhe planifikimet e të parit, kanë kaluar nën llogarinë (emrin) e gjyqtarit që ka marrë çështjen pas rishortimit, duke prodhuar pasaktësinë e konstatuar.

Mbas informacioneve dhe sqarimeve të kërkuara nga ana e grupit të inspektimit lidhur me këto pasaktësi, të dhënat u përpunuan saktë nga Sektori i Statistikave pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sipas ngarkesës reale të gjyqtarëve që kanë planifikuar dhe zhvilluar seanca në çdo datë të periudhës së inspektimit.

Bazuar në informacionet e administruara gjatë inspektimit të dhënat e kërkuara dhe të analizuara mbulojnë periudhën nga **01 Janar 2025 deri më 31 Tetor 2025**.

Gjatë verifikimit u konstatua se të dhënat e sistemit nuk ishin të sakta sa i përket shpërndarjes së seancave tek gjyqtarët, për shkak të ndryshimeve të shpeshta në trupën gjyqësore (*transferime, leje lindjeje, ...etj.*).

Me kalimin e çështjeve nga një gjyqtar tek tjetri (*p. sh., rastet e gjyqtarëve z. Albert Keraj dhe znj. Ermira Dedja*), planifikimet e vjetra kalonin në llogarinë e gjyqtarit të ri, duke krijuar raporte jo reale në sistem.

Pas kërkesave të grupit të inspektimit, Sektori i Statistikave në gjykatë bëri **përpunimin e saktë të të dhënave** sipas ngarkesës reale për çdo datë të periudhës së inspektimit.

Në javën **07-10 tetor 2025**, për shkak të vdekjes së gjyqtarit A. K., u vendos moszhvillimi i seancave, fakt i cili nga sekretaret janë bërë “mosçelje” në sistem figuron si në zyrë apo dhomë këshillimi.

Rishortimet e çështjeve (*të shkaktuara nga largimet apo transferimet, pezullimet dhe lejet e lindjes së gjyqtarëve*) kanë pasur pasoja të ndjeshme në saktësinë e të dhënave të sistemit ICMIS në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Pasojat kryesore janë konstatuar në:

- **Pasaktësia në shpërndarjen e ngarkesës:** Edhe pse sistemi raporton saktë numrin total të seancave ditore, ai nuk tregon shpërndarjen e saktë të tyre tek gjyqtarët konkretë;
- **Transferimi automatik i planifikimeve:** Kur një çështje rishortohet (*rindahet*) tek një gjyqtar i ri, të gjitha *planifikimet e mëparshme të bëra nga gjyqtari i parë kalojnë automatikisht në llogarinë e gjyqtarit të ri*. Kjo prodhon të dhëna jo reale, pasi sistemi e paraqet sikur seancat janë planifikuar nga gjyqtari që ka marrë çështjen së fundmi;
- **Raportimi i aktivitetit në periudha kur gjyqtarët nuk kanë qenë në punë:** Sistemi tregon se gjyqtarët kanë zhvilluar seanca edhe në periudha kur nuk kanë qenë fare në detyrë. Për shembull, gjyqtarja Ermira Dedja figuronte në sistem se kishte gjykuar gjatë muajve Janar-Mars 2025, ndërkohë që ajo ishte rikthyer në gjykatë vetëm më 25 mars 2025 (*ato seanca ishin në fakt planifikime të mëparshme të gjyqtarës Artta Llazari*);
- **Për gjyqtarët e larguar:** Për gjyqtarët e transferuar, si rasti i Albert Keraj, sistemi raporton vetëm seancat e çështjeve që ai ka arritur t'i përfundojë. Seancat e tjera që ai kishte në ngarkesë, pas rishortimit (*pasi këtë term pasqyron sistemi, ndërsa nga KLGJ në vendimin nr. 724, datë 07.12.2023, përdoret termi “rindarje”*), figurojnë si planifikime të gjyqtarëve pasardhës, duke mos pasqyruar volumin real të punës që ai ka kryer deri në momentin e transferimit;
- **Mospërputhje në kalendarin e seancave:** U konstatuan mospërputhje ndërmjet kalendarit të seancave të planifikuara dhe procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi, veçanërisht sa i përket emrit të gjyqtarit relator;

Për shkak të këtyre pasojave, të dhënat e sistemit nuk mund të merreshin si të mirëqena dhe u desh **përpunimi manual i tyre nga Sektori i Statistikave** për të nxjerrë ngarkesën reale për çdo gjyqtar gjatë periudhës së inspektimit.

Përpunimi i të dhënave nga Sektori i Statistikave i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, u krye si një proces korrigjues pas kërkesës së grupit të inspektimit të ILD-së për të sqaruar pasaktësitë e konstatuara në sistemet elektronike.

- Sektori i statistikave bëri një përpunim të detajuar të të dhënave **sipas ngarkesës reale** të gjyqtarëve. Kjo do të thotë se u verifikua se kush i kishte planifikuar dhe zhvilluar seancat në çdo datë të periudhës së inspektimit, duke mos u mjaftuar vetëm me raportimet automatike të sistemit;
- Duke qenë se sistemi ICMIS i transferonte automatikisht planifikimet e vjetra tek gjyqtari i ri që merrte çështjen, Sektori i Statistikave ndërhyri për të pasqyruar historikun e vërtetë. Për shembull, u desh të korrigjoheshin rastet ku gjyqtarët figuronin me seanca në periudha kur ishin me leje ose nuk kishin filluar ende detyrën (*si rasti i gjyqtarës Ermira Dedja*);
- Përpunimi u fokusua në ridërgimin e të dhënave të saktësuara për seancat e planifikuara dhe të zhvilluara në **nivel mujor për secilin gjyqtar** gjatë periudhës 1 janar 2025 deri më 31 tetor 2025. Kjo përfshinte specifikimin e rolit të gjyqtarit si gjyqtar i vetëm, kryetar apo anëtar i trupës gjyqësore;
- Sektori i Statistikave punoi për të eliminuar mospërputhjet midis **kalendarit të seancave të planifikuara dhe procesverbaleve** të gjeneruara nga sistemi, ku shpesh emri i gjyqtarit relator nuk korrespondonte me atë që kishte kryer veprimin në fakt;

Ky përpunim ishte i nevojshëm pasi, ndonëse sistemi raportonte saktë numrin total të seancave të gjykatës, ai ishte i pasaktë në shpërndarjen e tyre te gjyqtarët konkretë për shkak të lëvizjeve të shpeshta të trupës gjyqësore.

Nga verifikimi i seancave të planifikuara për secilin gjyqtar, konstatohen probleme në drejtim të mbarëvajtjes së procesit të planifikimit dhe realizimit, ku janë evidentuar përplasje oraresh në të njëjtën sallë nga gjyqtarë të ndryshëm.

**Së fundmi:** Regjistri në lidhje me planifikimin e seancave përmban: Sallën e gjykimit dhe Datën e gjykimit<sup>[161]</sup>.

Theksojmë se regjistri është i kompozuar edhe me treguesit e tjerë dhe pasqyron për secilën çështje: **i)** objektin; **ii)** palët; **iii)** orën e fillimit të seancës gjyqësore; **iv)** orën e mbarimit të seancës gjyqësore; dhe **v)** gjyqtarin e çështjes.

[161] Sipas tabelave të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë kësaj gjykate (ICMIS).

### 2.3 Dokumentacioni fizik (regjistrat) i ndodhur në gjykatë përse i përket pasqyrimin të seancave

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër informon se, përse i përket numrit të seancave për secilën çështje të përfunduar, apo kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, janë gjeneruar nga sistemi ICMIS.

Nga komunikimi me kancelaren<sup>162</sup> e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, informohemi se kjo gjykatë nuk mban regjistra fizik për planifikimin e seancave. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të gjykimeve, duke përfshirë këtu edhe procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Në regjistrat fizik pasqyrohet vetëm numri i seancave të çështjeve penale të themelit dhe të çështjeve civile të themelit, sa i përket çështjeve të përfunduara. Në këto regjistra ose të quajtur ndryshe numërorët e vendimeve, hidhen numrat e seancave të çështjeve në kohën që çështja përfundon dhe merr numër vendimi, *(ku sekretarja e seancës në momentin që paraqitet në kryesekretari të gjykatës, për të marrë numrin kronologjik të vendimit, pasqyron edhe numrin e seancave që kanë bërë të mundur gjykimin e çështjes)*. Vlen të theksojmë se numri i seancave të çështjeve jo gjithmonë pasqyrohet i saktë, pasi në këtë numër ka raste që përfshihen edhe seancat jo produktive, që sekretarja gjyqësore ka mbajtur për shkak të moszhvillimit të seancave, kur ka munguar gjyqtari i çështjes qoftë me arsye të justifikuara, qoftë për arsye objektive apo pa arsye të justifikuara/objektive.

### 3. Faktet e konstatuara, analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

#### 3.1. Numri i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2024 dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Nga analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit bazuar në të dhënat e administruara për veprimtarinë gjyqësore të gjykatës, rezulton se për gjyqtarët janë mbartur nga viti 2024 dhe janë regjistruar çështje të reja për periudhën 01.01.2025 deri 20.10.2025, si më poshtë:

Nr.	Gjyqtari:		Numri i çështjeve të:		Totali:	Nr. i çështjeve në gjykim në datë 20.10.2025
	Emër	Mbiemër	Të mbartura nga viti 2024	Të reja për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025		
1	Egla	Mirashi	91	251	342	98

<sup>162</sup> Nga komunikimet me telefon.

2	Orgent	Nazaj	131	378	509	10
3	Arta	Llazari	36	9	45	0
4	Albert	Keraj	72	33	105	0
5	Elona	Mërtiri	105	589	694	179
6	Anisa	Brinja	96	551	647	244
7	Enri	Rista	274	382	656	250
8	Eni	Naqellari	263	348	611	275
9	Teftë	Xhanari	254	382	636	253
10	Irida	Barkaj	248	376	624	225
11	Ermira	Dedja	118	176	294	148
12	Sokol	Shehu	1	1	2	0
Totali:			1689	3476	5165	1682

Referuar të dhënave në tabelë konstatohet se trendi i çështjeve të pazgjidhura që janë mbartur nga viti 2024 për në vitin 2025, pothuajse është i njëjti në shifër me çështjet që kanë mbetur për gjykim pas datës 20.10.2025. Sa më sipër rezulton se gjykata ka planifikuar dhe ka evaduar 3476 çështje gjyqësore të regjistruara të reja për periudhën 01.01.2025-20.10.2025 dhe 7 çështje gjyqësore që kanë rezultuar si pjesë e çështjeve të mbartura nga viti 2024 ose gjithsej 3483 çështje gjyqësore, (aq sa është edhe numri i vendimeve të shpallura për të njëjtën periudhë).

### 3.2. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës objekt inspektimi në rang gjykate dhe për secilin gjyqtar

Gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 20.10.2025, numri i vendimeve të shpallura (të zgjidhura me vendim përfundimtar) nga secili gjyqtar është:

Nr.	Gjyqtari:		Numri i vendimeve të shpallura për periudhën 01.01.2025-20.10.2025
	Emër	Mbiemër	
1	Egla	Mirashi	244
2	Orgent	Nazaj	499
3	Arta	Llazari	45
4	Albert	Keraj	105
5	Elona	Mërtiri	515
6	Anisa	Brinja	403
7	Enri	Rista	406
8	Eni	Naqellari	336
9	Teftë	Xhanari	383
10	Irida	Barkaj	399
11	Ermira	Dedja	146
12	Sokol	Shehu	2
Totali:			3483

**3.3. Fakte të konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për gjykatën dhe secilin gjyqtar**

Gjatë periudhës Janar-Tetor 2025, janë planifikuar gjithsej **11,781 seanca**.

**I. Shpërndarja mujore e seancave të planifikuara për të gjithë trupën gjyqësore për periudhën 01.01.2025-31.10.2025, është:**

Nr.	Periudha	Numri i seancave të zhvilluara
1	Janar	915
2	Shkurt	1430
3	Mars	1173
4	Prill	1342
5	Maj	1287
6	Qershor	1365
7	Korrik	1351
8	Gusht	89
9	Shtator	1160
10	Tetor	1669
<b>Totali:</b>		<b>11781</b>

**II. Shpërndarja e seancave të planifikuara sipas gjyqtarëve, për të gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 duke e përcaktuar për ditët e javës është:**

Nr.	Gjyqtari		Ditët e javës							Totali
	Emër	Mbiemër	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel	
1	Egla	Mirashi	263	301	258	48	3	2	0	875
2	Orgent	Nazaj	584	600	545	10	4	0	0	1743
3	Arta	Llazari	41	50	43	32	17	0	0	183
4	Albert	Keraj	240	207	16	2	4	1	0	470
5	Elona	Mërtiri	752	827	100	47	3	1	0	1730
6	Anisa	Brinja	771	775	87	117	4	2	0	1756
7	Enri	Rista	223	17	406	417	8	36	13	1120
8	Eni	Naqellari	103	45	475	457	6	37	15	1138
9	Teftë	Xhanari	89	106	483	488	21	38	25	1250
10	Irida	Brakaj	24	93	494	477	18	11	31	1148
11	Ermira	Dedja	85	84	64	76	34	8	6	357
12	Sokol	Shehu	0	11	0	0	0	0	0	11
<b>Totali:</b>			<b>3175</b>	<b>3116</b>	<b>2971</b>	<b>2171</b>	<b>122</b>	<b>136</b>	<b>90</b>	<b>11781</b>

Nga analizimi i tabelës së mësipërme, duke marrë mesatarisht numrin e gjyqtarëve 12 gjyqtarë si efektiv për një periudhë 10-mujore, rezulton se një gjyqtar të ketë realizuar 4.46 seanca në ditë<sup>163</sup> (ose afërsisht 5 seanca në ditë për gjyqtar).

**III. Shpërndarja e seancave të planifikuara sipas gjyqtarëve, të zhvilluara në sistemin RAD në audio, sallë dhe zyrë në periudhën 01.01.2025-31.10.2025, është si më poshtë:**

Nr.	Gjyqtari:		Numri i seancave në:			Totali i seancave të mbajtura:	% e seancave audio
	Emër	Mbiemër	Audio	Sallë	Zyrë		
1	Albert	Keraj	238	230	29	259	91.90%
2	Anisa	Brinja	1696	88	1935	2023	83.80%
3	Arta	Llazari	34	31	39	70	48.60%
4	Egla	Mirashi	728	20	761	781	93.20%
5	Elona	Mërtiri	1975	1624	411	2035	97.10%
6	Eni	Naqellari	982	898	258	1156	84.90%
7	Enri	Rista	976	918	213	1131	86.30%
8	Ermira	Dedja	305	293	95	388	78.60%
9	Irida	Barkaj	966	394	754	1148	84.10%
10	Orgent	Nazaj	1350	60	1440	1500	90.00%
11	Sokol	Shehu	11	2	9	11	100.00%
12	Teftë	Xhanari	1028	439	840	1279	80.40%
Totali:			10289	4997	6784	11781	87.30%

**IV. Shpërndarja e seancave të planifikuara sipas gjyqtarëve në ditët e javës për çdo muaj për periudhën 01.01.2025-31.10.2025 është:**

**Janar 2025**

Gjatë këtij muaji janë planifikuar gjithsej **915 seanca**. Shpërndarja sipas gjyqtarëve është:

- **Egla Mirashi:** 147 seanca;
- **Orgent Nazaj:** 124 seanca;
- **Albert Keraj:** 132 seanca;
- **Elona Mërtiri:** 126 seanca;
- **Anisa Brinja:** 102 seanca.

Gjyqtarët e tjerë si **Arta Llazari** (31 seanca), **Enri Rista** (43 seanca), **Teftë Xhanari** (59 seanca), **Irida Barkaj** (75 seanca) dhe **Ermira Dedja** (75 seanca) rezultojnë se kanë një ngarkesë më të ulët planifikimi.

**Shkurt 2025**

<sup>163</sup> Nga numri total prej 11781 seanca, e pjesëtojmë me 10 muaj (për të nxjerrë mesataren në muaj, ku del 1178.1 seanca), e pjesëtojmë me 12 gjyqtarë (ku del 98.175 seanca për gjyqtar) dhe në vazhdim këtë shifër e pjesëtojmë me 22 ditë punë në muaj del 4.46 seanca në ditë (ose 5 seanca në ditë për gjyqtar).

Gjatë këtij muaji janë planifikuar gjithsej **1,430 seanca**, konstatohet se numri i seancave të planifikuara është rritur ndjeshëm.

- **Orgent Nazaj** kryesoi me 214 seanca, i ndjekur nga **Albert Keraj** me 190 seanca dhe **Egla Mirashi** me 182 seanca;
- **Elona Mërtiri** dhe **Anisa Brinja** planifikuan respektivisht 176 seanca dhe 172 seanca;
- **Eni Naqellari** (111 seanca), **Irida Barkaj** (102 seanca) dhe **Enri Rista** (100 seanca).

### Mars 2025

Gjithsej janë planifikuar **1,173 seanca**.

- **Orgent Nazaj** (197 seanca) dhe **Albert Keraj** (140 seanca) kishin numrin më të lartë, ndonëse A. Keraj u transferua me datë 6 mars 2025;
- **Teftë Khanari** pati një rritje në 136 seanca, ndërsa **Anisa Brinja** planifikoi 134 seanca;
- **Ermira Dedja** u rikthye në detyrë me datë 25 mars 2025.

### Prill 2025

Në këtë muaj janë planifikuar **1,342 seanca**.

- **Elona Mërtiri** (213 seanca) dhe **Orgent Nazaj** (201 seanca) kanë pasur ngarkesën më të madhe;
- **Egla Mirashi** planifikoi 186 seanca dhe **Anisa Brinja** 178 seanca;
- **Arta Llazari** u pezullua me datë 2 prill 2025, duke pasur vetëm 5 seanca të planifikuara.

### Maj 2025

Janë planifikuar **1,287 seanca**.

- **Orgent Nazaj** ka punuar me volum të lartë (238 seanca), i ndjekur nga **Anisa Brinja** (191 seanca) dhe **Elona Mërtiri** (177 seanca);
- **Egla Mirashi** ka planifikuar 105 seanca deri me datë 16 maj 2025, mbas kësaj periudhe ka filluar lejen e lindjes.

### Qershor 2025


U planifikuan **1,365 seanca**.

- Gjyqtarja **Anisa Brinja** me 264 seanca ku konstatohet numri më i lartë i seancave të planifikuara, **Elona Mërtiri** me 255 seanca dhe **Orgent Nazaj** me 254 seanca;
- **Teftë Khanari** (154 seanca), **Irida Barkaj** (132 seanca) dhe **Eni Naqellari** (129 seanca) kanë treguar rritje të volumit të seancave të planifikuara.

### Korrik 2025

Në këtë muaj janë planifikuar **1,351 seanca**.

- **Orgent Nazaj** regjistroi numrin më të lartë të seancave për këtë muaj me 262 seanca të planifikuara;



- **Anisa Brinja** (209 seanca), **Elona Mërtiri** (174 seanca) dhe **Enri Rista** (171 seanca);
- **Egla Mirashi** është rikthyer nga leja me datë 18 korrik 2025, duke planifikuar vetëm 2 seanca.

### Gusht 2025

Për shkak të lejes vjetore janë planifikuar vetëm **89 seanca** urgjente.

- **Enri Rista** planifikoi 23 seanca, ndërsa **Teftë Xhanari** 19 seanca dhe **Eni Naqellari** 17 seanca;
- **Ermira Dedja** planifikoi 14 seanca, Irida Brakaj 12 seanca, Elona Mërtiri 3 seanca dhe Egla Mirashi 1 seancë.

### Shtator 2025

Pas periudhës së pushimeve, numri i seancave ishte **1,160**.

- **Anisa Brinja** kryesoi me 243 seanca;
- **Orgent Nazaj** (182 seanca), **Elona Mërtiri** (157 seanca) dhe **Teftë Xhanari** (141 seanca) vijuan me ngarkesë të lartë.

### Tetor 2025

Ky muaj shënon numrin më të lartë të planifikimeve me **1,669 seanca**.

- **Elona Mërtiri** pati volumin më të lartë rekord me **311 seanca**;
- **Anisa Brinja** planifikoi 263 seanca dhe **Teftë Xhanari** 222 seanca;
- **Enri Rista** (200 seanca), **Eni Naqellari** (204 seanca) dhe **Irida Brakaj** (190 seanca) kishin gjithashtu shifra të larta;
- **Orgent Nazaj** planifikoi 71 seanca deri në transferimin e tij me datë 6 tetor 2025.

### V. Fakte mbi statusin e gjyqtarëve:

- Egla Mirashi: Ka qenë me leje lindje fëmijë nga data 16.05.2025 deri me datë 18.07.2025;
  - Orgent Nazaj: Është transferuar me datë 06.10.2025;
  - Arta Llazari: Është pezulluar nga detyra me datë 02.04.2025;
  - Albert Keraj: Është transferuar me datë 06.03.2025; dhe,
  - Ermira Dedja: Është rikthyer në detyrë me datë 25.03.2025.
- Gjyqtarët e rinj: Alfred Vokri, Jola Sado, Ermira Shkreta, Ketjona Kaçupi dhe Zamira Lila janë emëruar me datë 22.10.2025, por nuk kanë marrë ngarkesë gjatë periudhës së raportuar.

Nga faktet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.10.2025 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe secilin gjyqtar, **referuar analizimit të tyre, rezulton se trupa gjyqësore, nuk ka bërë planifikime të seancave gjyqësore në të gjitha ditët e javës, me qëllim menaxhimin sa më të mirë të çështjeve gjyqësore dhe realizimin e këtij procesi, mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit,**

**barazisë së shpërndarjes së çështjeve të planifikuara dhe objektivitetit të këtij procesi, me qëllim marrjen e masave për zhvillimin e një gjykimi në përputhje me normat procedurale në fuqi.**

Ky konstatim del jo vetëm nga të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), por edhe nga zhvillimi i seancave gjyqësore në audio. Referuar analizimit të të dhënave gjatë inspektimit rezulton se sistemi aktual për të njëjtin gjyqtar pasqyron mospërputhje të të dhënave sa i përket seancave të zhvilluara në audio dhe seancave të zhvilluara prej tij në sallë.

Gjithashtu nga analizimi i të dhënave konstatohet se planifikimi i seancave gjyqësore nga gjyqtarët bëhet në orare tepër të ngushta nga njëra seancë në tjetër, ku varion nga 5 minuta deri në 15 minuta, çka tregon se gjyqtarët nuk i tregojnë vëmendjen e duhur zhvillimit të gjykimit dhe për rrjedhojë menaxhimin sa më të mirë të çështjeve gjyqësore dhe realizimin e këtij procesi, mbi bazën e parimit të transparencës dhe barazisë së shpërndarjes së çështjeve të planifikuara për gjykim brenda ditës që ato gjykojnë. Konstatohen raste gjithashtu që gjyqtari në kalendarin e planifikimit zgjatjen e një seance gjyqësore e llogarit nga një, dy apo tre minuta (*përmendim këtu seancat gjyqësore që kanë orë të fillimit 12:20, orë të mbarimit 12:21; orë të fillimit 11:45, orë të mbarimit 11:47; orë të fillimit 12:45, orë të mbarimit 12:48*)<sup>[164]</sup>.

**3.3.1. Analiza e planifikimit të seancave brenda një dite**

Nga analiza e materialeve të inspektimit, konstatohet se në:

- i) 449 raste** kalendarët e planifikimit të seancave kanë të pasqyruar për 898 çështje gjyqësore, (pra për dy çështje) të njëjtën orë në planifikim [këto çështje kanë të bëjnë me gjyqtarët; Orgent Nazaj (në 19 raste); Egla Mirashi (në 45 raste); Enri Rista (në 15 raste); Elona Mërtiri (në 91 raste); Eni Naqellari (në 7 raste); Teftë Xhanari (në 36 raste); Irida Brakaj (në 30 raste); Ermira Dedja (në 5 raste); Albert Keraj (në 1 rast); dhe Anisa (Tepelena) Brinja<sup>[165]</sup> (në 200 raste),];
- ii) 30 raste** kalendarët e planifikimit të seancave kanë të pasqyruar për 90 çështje gjyqësore, të njëjtën orë në planifikim [këto çështje kanë të bëjnë me gjyqtarët Elona Mërtiri (në 6 raste); Teftë Xhanari (në 2 raste); Egla Mirashi (në 3 raste); dhe Anisa (Tepelena) Brinja (në 19 raste),];
- iii) 4 raste** kalendarët e planifikimit të seancave kanë të pasqyruar për 16 çështje gjyqësore, (pra për katër çështje) të njëjtën orë në planifikim [këto çështje kanë të

<sup>164</sup> Shih për këtë planifikimin e seancave gjyqësore për çështjet nr. (520005-03161-51-2024) akti me gjyqtare znj. Egla Mirashi për seancën e datës 25.02.2025; nr. (58325-03541-51-2024) akti me gjyqtar z. Albert Keraj për seancën e datës 25.02.2025; si dhe nr. (520005-00091-51-2025) akti me gjyqtare znj. Anisa (Tepelena) Brinja për seancën e datës 25.02.2025...etj.

<sup>165</sup> Gjyqtarja Anisa Brinja referuar të dhënave të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, njihet dhe është shënuar edhe me të dhënat sa i përket gjeneraliteteve të saj edhe si: Anisa (Tepelena) Brinja.

bëjnë me gjyqtaren Egla Mirashi (në një rast) dhe Anisa (Tepelena) Brinja (në tre raste)]; dhe,

- iv) **10777 raste** kalendarët e planifikimit të seancave kanë të pasqyruar orare që nuk kanë përplasje për çështje të ndryshme nga i njëjti gjyqtar.

Për kategoritë e çështjeve të mësipërme të caktuar në të njëjtin orar në kalendarët e planifikimit në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një vlerësim objektiv, tërësor dhe transparent, u bë verifikimi, rastësor dhe i përfaqësueshëm proporcional, në procesverbalet e seancave, sipas llojit të çështjeve gjyqësore, nga ku rezultoi:

1. Për çështjet gjyqësore të kategorisë penale me nr. (53101-00384-51-2025) akti, dhe nr. (80101-02120-51-2024) akti, ku orë planifikimi të njëjtë kanë orën 10:20 si orë fillimi dhe orët 10:20 e 10:24 mbarimi, që i përkasin gjyqtarit Orgent Nazaj, rezultoi se gjyqtari që ka qenë sipas procesverbalit të seancës për të realizuar seancën gjyqësore të datës 18.02.2025 është Albert Keraj.

Seanca gjyqësore e datës 18.02.2025 për çështjen nr. (53101-00384-51-2025) akti, nuk është zhvilluar. Nga sekretarja gjyqësore është mbajtur procesverbal (*i mosçeljes së seancës gjyqësore*), me orë fillimi orën 10:18 ku ndër të tjera në këtë akt është cituar se: ".... për shkak se kryesuesi i seancës gjyqtar Albert Keraj për arsye shëndetësore është në pamundësi për t'u paraqitur, me urdhër dhe porosi të tij palët do të njoftohen me fletë-thirrje për seancën e radhës...etj.", dhe orë mbarimi orën 10:21.

Seanca gjyqësore e datës 18.02.2025 për çështjen nr. (80101-02120-51-2024) akti, nuk është zhvilluar. Nga sekretarja gjyqësore është mbajtur procesverbal (*i mosçeljes së seancës gjyqësore*), me orë fillimi orën 10:17 ku ndër të tjera në këtë akt është cituar se: ".... për shkak se kryesuesi i seancës gjyqtar Albert Keraj për arsye shëndetësore është në pamundësi për t'u paraqitur, me urdhër dhe porosi të tij palët do të njoftohen me fletë-thirrje për seancën e radhës...etj.", dhe orë mbarimi orën 10:19.

Theksoj se për caktimin e kësaj seance për tu zhvilluar në orën 10:20, gjyqtari e ka caktuar në seancën e mëparshme atë të datës 11.02.2025.

### **Konstatime:**

**Së pari:** Gjyqtari Albert Keraj ka planifikuar dy çështje në të njëjtën orë, dhe duke mos bërë një planifikim real objektiv dhe të realizueshëm për zhvillimin e seancave gjyqësore për këto dy çështje.

**Së dyti:** Raporti i Përgjithshëm "Planifikimi i seancave gjyqësore" që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, pasqyron të dhëna jo reale, pasi si gjyqtar jep gjyqtarin e fundit (konkretisht gjyqtarin Orgent Nazaj i cili referuar RIV-it të çështjes, këtë të fundit e ka marrë, në zbatim të urdhrit të brendshëm nr. 81, datë 25.03.2025, për shkak të procedurës

së rindarjes (rishortimit) të dosjeve që kanë qenë në gjykim të gjyqtarit Albert Keraj, i cili është transferuar në një gjykatë tjetër.)

**Së treti:** Sekretarja gjyqësore procesverbalin e seancës së çështjen nr. (53101-00384-51-2025) akti, e ka hapur në kohën që po mbante procesverbalin e seancës për çështjen nr. (80101-02120-51-2024) akti.

2. Për çështjen gjyqësore të kategorisë civile me nr. (21274-00219-51-2025) akti, ka dy orë planifikimi të njëjta orën 08:30 si orë fillimi dhe orët 08:34 dhe 08:48 të mbarimit, që i përket gjyqtares Teftë Xhanari.

Seanca gjyqësore e datës 02.04.2025 për çështjen nr. (21274-00219-51-2025) akti, është zhvilluar me orë fillimi orën 09:05 dhe orë mbarimi orën 09:17, nga gjyqtarja Teftë Xhanari.

**Konstatime:**

**Së pari:** Gjyqtarja Teftë Xhanari ka planifikuar një çështje në të njëjtën orë fillimi dhe në dy orë të ndryshme mbarimi, duke mos bërë një planifikim real objektiv dhe të realizueshëm për zhvillimin e seancës gjyqësore për këtë çështje.

**Së dyti:** Gjyqtarja Teftë Xhanari nuk e ka zhvilluar seancën në orën e fillimit që ka caktuar vetë për gjykimin e çështjes, por pas 35 minutash nga ora që ka planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore për këtë çështje dhe ka vendosur orë përfundimi tepër të shkurtër, duke mos vlerësuar natyrën e gjykimit të çështjes dhe duke bërë planifikim që nuk i përgjigjet kohës dhe seancës gjyqësore të mbajtur për këtë qëllim.

**Së treti:** Planifikimi i zhvillimit të seancës gjyqësore për të njëjtën çështje dy herë, nga gjyqtarja Teftë Xhanari, rrit numrin e seancave të planifikuara, nga ato të zhvilluara në fakt, çka tregon fiktivitet në punën e saj, për të treguar se ajo ka numër të lartë të planifikimit dhe zhvillimit të seancave.

3. Për çështjet gjyqësore të kategorisë penale me nr. (71022-01232-51-2024) akti, nr. (71013-03218-51-2024) akti dhe nr. (50506-03065-51-2024) akti, ku orë planifikimi të njëjtë kanë orën 10:30 si orë fillimi dhe orën 10:35 të mbarimit, që i përketin gjyqtares Elona Mërtiri.

Seanca gjyqësore e datës 13.01.2025 për çështjen nr. (71022-01232-51-2024) akti, është zhvilluar, me orë fillimi orën 11:19, ndërsa në RDA me orë fillimi 10:08, dhe orë mbarimi orën 11:21. Për caktimin e seancës së datës 13.01.2025, ora 10:30 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 16.12.2024.

Seanca gjyqësore e datës 13.01.2025 për çështjen nr. (71013-03218-51-2024) akti, është zhvilluar, me orë fillimi orën 11:42, ndërsa në RDA me orë fillimi 11:40, dhe orë mbarimi orën 11:47. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është zhvilluar seanca, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 24.01.2025, ora 11:47.

Për caktimin e seancës së datës 13.01.2025, ora 10:30 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 10.12.2024.

Seanca gjyqësore e datës 13.01.2025 për çështjen nr. (50506-03065-51-2024) akti, është zhvilluar, me orë fillimi orën 11:55, ndërsa në RDA me orë fillimi 11:52, dhe orë mbarimi orën 12:11. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është zhvilluar seanca, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 24.01.2025, ora 12:12.

Për caktimin e seancës së datës 13.01.2025, ora 10:30 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 11.12.2024.

### **Konstatime:**

**Së pari:** Gjyqtarja Elona Mërtiri ka planifikuar tre çështje në të njëjtën orë, dhe duke mos bërë një planifikim real objektiv dhe të realizueshëm për zhvillimin e seancave gjyqësore për këto tre çështje. Në caktimin e seancave ajo nuk ka pasur në konsideratë kalendarin e planifikimit të seancës, pasi seancat janë caktuar nga zhvillimi i seancave të mëparshme, prej saj, për të cilat ajo ka pasur dijeni se në atë orar ka të planifikuar seance gjyqësore.

**Së dyti:** Gjyqtarja Elona Mërtiri nuk i ka zhvilluar seancat në orën e fillimit që ka caktuar vetë për gjykimin e çështjeve, por respektivisht pas 49 minutash nga ora që ka planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore për çështjen e parë, pas 72 minutash nga ora që ka planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore për çështjen e dytë dhe pas 85 minutash nga ora që ka planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore për çështjen e tretë. Ka vendosur orë përfundimi të tre çështjeve në sistem orën 10:35 tepër të shkurtër, duke mos vlerësuar natyrën e gjykimit të çështjeve dhe duke bërë planifikime që nuk i përgjigjet kohës dhe seancës gjyqësore të mbajtur për këtë qëllim.

**Së treti:** Sekretarja gjyqësore në procesverbalet e seancave të çështjeve sistemin e RDA e ka hapur më parë se atë të ICMIS, ku ka mospërputhje oraresh mes tyre sa i përket orës së fillimit të seancave, kryesisht vihet re në çështjen e parë ku ora e RDA është 73 minuta më parë se ajo e zhvillimit të seancës.

**Së katërti:** Procesverbalet e seancave gjyqësore për dy çështje kanë të pasqyruar datë tjetër nga ajo e zhvilluar nga gjyqtari, gjë e cila ka ndodhur në radhë të parë për shkak se sekretarja gjyqësore veprimet në sistem i ka lënë të hapura dhe të dhënat janë hedhur pas 11 ditësh nga zhvillimi i seancave gjyqësore, duke lënë mundësi keqinterpretimi dhe në radhë të dytë për mos planifikim real të seancave proceset gjyqësore që kanë qenë të planifikuara në atë datë kanë qenë të shumta dhe nuk kanë arritur për t'i përballuar si ngarkesë. Nga Raporti i Përgjithshëm "Planifikimi i seancave gjyqësore" që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për gjyqtaren Elona Mërtiri për datën 13.01.2025, janë planifikuar 32 seanca gjyqësore për tu zhvilluar, ndërsa në datën 24.01.2025 që kanë procesverbalet e seancave, nuk rezulton të jetë planifikuar e zhvilluar asnjë seancë nga gjyqtarja.

4. Për çështjen gjyqësore të kategorisë civile me nr. (21001-01366-51-2023) akti, e planifikuar për datën 23.04.2025, (dy herë) ku orë planifikimi të njëjtë kanë orën 10:00 si orë fillimi dhe orën 10:19 mbarimi, që i përkasin gjyqtarës Ermira Dedja, rezultoi se në sistem nuk ka të hedhur procesverbal dhe se ky planifikim, është bërë nga gjyqtare Arta Llazari, në seancën e mbajtur me datë 20.03.2025.

**Konstatime:**

**Së pari:** Raporti i Përgjithshëm “Planifikimi i seancave gjyqësore” që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, pasqyron të dhëna jo reale, pasi si gjyqtar jep gjyqtarin e fundit, konkretisht gjyqtaren Ermira Dedja [e cila referuar RIV-it të çështjes, këtë të fundit e ka marrë, në zbatim të urdhrorit të brendshëm nr. 145, datë 20.05.2025, për shkak të procedurës së rindarjes (rishortimit) të dosjeve që kanë qenë në gjykim të gjyqtarës Arta Llazari]. Gjyqtarja Arta Llazari, ka qenë e pezulluar për një periudhë 6 mujore nga data 02.04.2025 e në vazhdim, sipas vendimit nr. 189, datë 02.04.2025, të KLGJ-së).

**Së dyti:** Planifikimi i zhvillimit të seancës gjyqësore për të njëjtën çështje dy herë, nga gjyqtarja Arta Llazari, rrit numrin e seancave të planifikuara, nga ato të zhvilluara në fakt, çka tregon fiktivitet në punën e saj, për të treguar se ajo ka numër të lartë të planifikimit dhe zhvillimit të seancave.

5. Për çështjet gjyqësore të kategorisë penale me nr. (71022-00191-51-2025) akti, nr. (520005-03390-51-2024) akti, nr. (520003-03483-51-2024) dhe nr. (520005-00563-51-2025) akti, ku orë planifikimi të njëjtë kanë orën 14:00 si orë fillimi dhe respektivisht orët 14:15, 15:00, 14:15 e 14:15 të mbarimit, që i përkasin gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja.

Seanca gjyqësore e datës 13.05.2025 për çështjen nr. (71022-00191-51-2025) akti, nuk është zhvilluar, pasi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është bërë me dije mosprezenca e tyre në asnjë seancë gjyqësore, për shkak të zhvillimit të analizës vjetore të këtij institucioni, fakti i cili del nga procesverbali i mbajtur nga sekretarja gjyqësore me orë fillimi orën 15:25, në të cilin ndër të tjera rezulton se ky procesverbal është mbajtur pa regjistrim audio, jo në sallën e gjyqeve. Për caktimin e seancës së datës 13.05.2025, ora 14:00 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 29.04.2025. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është mbajtur nga sekretarja e seancës, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 05.11.2025, ora 15:30.

Seanca gjyqësore e datës 13.05.2025 për çështjen nr. (520005-03390-51-2024) akti, nuk është zhvilluar, pasi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është bërë me dije mosprezenca e tyre në asnjë seancë gjyqësore, për shkak të zhvillimit të analizës vjetore të këtij institucioni, fakti i cili del nga procesverbali i mbajtur nga sekretarja gjyqësore me orë fillimi orën 14:47, në të cilin

ndër të tjera rezulton se ky procesverbal është mbajtur pa regjistrim audio, jo në sallën e gjyqeve. Për caktimin e seancës së datës 13.05.2025, ora 14:00 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 28.04.2025. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është mbajtur nga sekretarja e seancës, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 11.07.2025, ora 14:48.

Seanca gjyqësore e datës 13.05.2025 për çështjen nr. (520003-03483-51-2024) akti, është zhvilluar, me orë fillimi orën 13:59, orë e cila është e njëjtë edhe në RDA, dhe orë mbarimi orën 14:00. Për caktimin e seancës së datës 13.05.2025, ora 14:00 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 05.05.2025. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është mbajtur nga sekretarja e seancës, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 11.06.2025, ora 14:00.

Seanca gjyqësore e datës 13.05.2025 për çështjen nr. (520005-00563-51-2025) akti, nuk është zhvilluar, pasi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është bërë me dije mosprezenca e tyre në asnjë seancë gjyqësore, për shkak të zhvillimit të analizës vjetore të këtij institucioni, fakti i cili del nga procesverbali i mbajtur nga sekretarja gjyqësore me orë fillimi orën 14:48, në të cilin ndër të tjera rezulton se ky procesverbal është mbajtur pa regjistrim audio, jo në sallën e gjyqeve. Për caktimin e seancës së datës 13.05.2025, ora 14:00 nga kryesuesi i trupit gjykues, është caktuar në procesverbalin e mëparshëm të seancës atë të datës 05.05.2025. Ka një mospërputhje në fund të procesverbalit me datën në të cilën është mbajtur nga sekretarja e seancës, pasi thuhet se procesverbali u mbajt në Shkodër, më 02.08.2025, ora 14:50.

### **Konstatime:**

**Së pari:** Gjyqtarja Anisa (Tepelena) Brinja ka planifikuar katër çështje në të njëjtën orë, dhe duke mos bërë një planifikim real objektiv dhe të realizueshëm për zhvillimin e seancave gjyqësore për këto katër çështje. Në caktimin e seancave ajo nuk ka pasur në konsideratë kalendarin e planifikimit të seancës, pasi seancat janë caktuar nga zhvillimi i seancave të mëparshme, prej saj, për të cilat ajo ka pasur dijeni se në atë orar ka të planifikuar seancë gjyqësore.

**Së dyti:** Sekretarja gjyqësore procesverbalet e tre seancave të çështjeve, të cilat nuk janë zhvilluar, nuk i ka mbajtur në sallën e gjykimit, por në zyrë duke mos pritur palët ndërgjyqësore, me qëllim që ato të informoheshin në lidhje me moszhvillimin e seancës dhe shkaqet e shtyrjes së seancave të tyre.

**Së treti:** Procesverbali i seancës gjyqësore për çështjen e zhvilluar nga gjyqtarja si dhe tre procesverbalet e tjera të mbajtura nga sekretarja gjyqësore (pa regjistrim audio, jo në sallën e gjyqeve) kanë të pasqyruar në fund të tyre datë tjetër, gjë e cila ka ndodhur në

radhë të parë për shkak se sekretarja gjyqësore veprimet në sistem i ka lënë të hapura dhe të dhënat janë hedhur në data që pasqyrojnë aktet e mësipërme, duke lënë mundësi keqinterpretimi dhe në radhë të dytë për mos planifikim real të seancave proceset gjyqësore që kanë qenë të planifikuara në atë datë kanë qenë të shumta dhe nuk kanë arritur për ti përballuar si ngarkesë. Nga Raporti i Përgjithshëm “Planifikimi i seancave gjyqësore” që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për gjyqtaren Anisa (Tepelena) Brinja për datën 13.05.2025, janë planifikuar 28 seanca gjyqësore për tu zhvilluar, ndërsa në datën 11.06.2025 që ka procesverbali i seancës, nuk rezulton të jetë planifikuar e zhvilluar asnjë seancë nga gjyqtarja. Ky fenomen konstatohet edhe për datat 11.07.2025, 02.08.2025 dhe 05.11.2025 që mbajnë procesverbalet e mbajtura nga sekretarja e seancës, e cila rezulton se ka qenë e lirë për të bërë veprime, [përveç datës 11.07.2025 që ka pasur një gjyq të planifikuar për çështjen nr. (61011-01648-51-2025) akti në orën 11:45 (zhvilluar në dhomë këshillimi në orën 11:51 dhe procesverbali mban edhe këtu në fund datë 02.08.2025),], ndërsa për dy datat e tjera ajo 02.08.2025 dhe 05.11.2025, nuk kanë seanca të planifikuara.

Në kalendarët e planifikimit në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një vlerësim objektiv, tërësor dhe transparent, u bë verifikimi, rastësor dhe i përfaqësueshëm proporcional, në 5 (pesë) seanca gjyqësore të gjyqtarëve që çështjet nuk kanë përplasje oraresh në planifikim, konkretisht në procesverbalet e seancave, sipas llojit të çështjeve gjyqësore, nga ku rezultoi:

1. Për çështjen gjyqësore të kategorisë penale me nr. (58345-03493-51-2024) akti, ku datë planifikimi ka 11.02.2025, orë planifikimi ka orën 10:45 si orë fillimi dhe orën 10:47 mbarimi, që i përket gjyqtarit Albert Keraj, rezultoi se gjyqtari e ka zhvilluar seancën gjyqësore në datën 11.02.2025, me orë 10:55 fillimi, në RDA me orë fillimi 10:54, dhe orë mbarimi në RDA orën 11:05. Në fund të procesverbalit të seancës gjyqësore ndër të tjera thuhet se vendi ku është mbajtur ky procesverbal është Shkodër, më 11.02.2025, ora 11:00 (pra që përputhet me datën e zhvillimit të seancës gjyqësore).
2. Për çështjen gjyqësore të kategorisë civile me nr. (21236-01234-51-2023) akti, ku datë planifikimi ka 24.06.2025, orë planifikimi ka orën 11:50 si orë fillimi dhe orën 11:52 mbarimi, që i përket gjyqtarës Irida Barkaj, rezultoi se gjyqtarja e ka zhvilluar seancën gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 24.06.2025, me orë 11:52 fillimi, dhe me orë 15:00 mbarimi. Për këtë gjykim nuk rezulton seancë audio në RDA (për shkak të zhvillimit të seancës në dhomë këshillimi) dhe në fund të procesverbalit të seancës gjyqësore ndër të tjera, thuhet se vendi ku është mbajtur ky procesverbal është Shkodër, më 24.06.2025, ora 15:00 (pra që përputhet me zhvillimin e seancës gjyqësore përjashtuar orën që është tepër e largët, krahasuar me faktin që pasqyron procesverbali i seancës).
3. Për çështjen gjyqësore të kategorisë penale me nr. (520003-01163-51-2025) akti, ku datë planifikimi ka 23.06.2025, orë planifikimi ka orën 09:10 si orë

fillimi dhe orën 09:20 mbarimi, që i përket gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja, rezultoi se gjyqtarja e ka zhvilluar seancën gjyqësore në datën 23.06.2025, me orë 09:50 fillimi, në RDA me orë fillimi 09:49, dhe orë mbarimi në RDA orën 09:52. Në procesverbal nga gjyqtarja është relatuar vonesa e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe në fund të procesverbalit të seancës gjyqësore ndër të tjera, thuhet se vendi ku është mbajtur ky procesverbal është Shkodër, më 11.07.2025, ora 09:51.

4. Për çështjen gjyqësore të kategorisë civile me nr. (21286-00898-51-2022) akti, ku datë planifikimi ka 25.06.2025, orë planifikimi ka orën 10:30 si orë fillimi dhe orën 10:37 mbarimi, që i përket gjyqtarës Teftë Xhanari, rezultoi se gjyqtarja e ka zhvilluar seancën gjyqësore në datën 25.06.2025, me orë 11:14 fillimi, në RDA me orë fillimi 11:05, dhe orë mbarimi në RDA orën 11:22:20. Në procesverbal nga gjyqtarja nuk është relatuar vonesa e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe në fund të procesverbalit të seancës gjyqësore ndër të tjera, thuhet se vendi ku është mbajtur ky procesverbal është Shkodër, më 25.06.2025, ora 11:23 (pra që përputhet me datën e zhvillimit të seancës gjyqësore).
5. Për çështjen gjyqësore të kategorisë penale me nr. (80103-00714-51-2025) akti, ku datë planifikimi ka 17.09.2025, orë planifikimi ka orën 11:40 si orë fillimi dhe orën 11:45 mbarimi, që i përket gjyqtarit Orgent Nazaj, rezultoi se gjyqtari e ka zhvilluar seancën gjyqësore në datën 17.09.2025, me orë 13:21 fillimi, në RDA me orë fillimi 13:15, dhe orë mbarimi në RDA orën 13:21:48. Në procesverbal nga gjyqtari nuk është relatuar vonesa e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe në fund të procesverbalit të seancës gjyqësore ndër të tjera thuhet se vendi ku është mbajtur ky procesverbal është Shkodër, më 13.10.2025, ora 15:00 (pra që nuk përputhet me datën e zhvillimit të seancës gjyqësore).

### Konstatime:

**Së pari:** Gjyqtarët jo në të gjithë rastet kanë qenë objektiv në caktimin e seancave dhe nuk kanë pasur në konsideratë kalendarin e planifikimit të seancave, ku edhe pse seancat në planifikim nuk kanë përplasje oraresh me çështjet e tjera, rezulton se kanë planifikuar numër të madh seancash, të cilat për shkak të kohës së shkurtër dhe kohës që kanë marrë në fakt, kanë shtyrë njëra tjetrën, duke çuar në konkluzionin për planifikim jo real e transparent dhe të aksesueshëm për palët pjesëmarrëse në proces.

**Së dyti:** Gjyqtarët jo në të gjithë rastet pasqyrojnë në procesverbal shkaqet që kanë bërë të pamundur zhvillimin e seancës gjyqësore në kohën që kanë planifikuar nëpërmjet kalendarit të seancave. Konstatohen raste që për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarëve në punë, seancat nga sekretarët janë mbajtur në zyrë dhe jo në sallën e gjykimit, çka ka bërë që palët të mos marrin dijeni për shkaqet e moszhvillimit të seancave dhe datës së ardhshme që do të zhvillohet seanca.

**Së treti:** Procesverbalet e seancave gjyqësore në fund të tyre, pasqyrojnë data të ndryshme nga ajo e zhvillimit të seancës gjyqësore në fakt, duke bërë që të ketë mospërputhje të dhënash.

### 3.3.2. Analiza e planifikimit të seancave në nivel mujor

Gjatë analizimit të të dhënave në lidhje me zhvillimin e seancave u verifikuan edhe rastet kur gjyqtarët, ndonëse kanë planifikuar seanca gjyqësore, kanë bërë më pas kërkesë për leje vjetore të pashfrytëzuar të vitit 2024 apo nga leje e pakryer e vitit 2025, duke bërë që të mos zhvillojnë seancat gjyqësore. Konkretisht u bë verifikimi i çështjeve të planifikuara nga:

**Së pari:** Gjyqtare Irida Brakaj e cila me datën 11.03.2025 ka paraqit kërkesë për leje vjetore pranë Zv/Kryetares së gjykatës, për datat 24.03.2025 deri 28.03.2025<sup>166</sup>, kërkesë e cila i është miratuar me vendim “Për miratim dhënie leje”, datë 13.03.2025. Çështjet për të cilat kjo gjyqtare ka planifikuar dhe që nuk janë zhvilluar janë:

- a) Për datën 26.03.2025, çështjet: - nr. (21001-00097-51-2025) akti me orë fillimi 09:45 e orë mbarimi 09:46; - nr. (21282-01260-51-2024) akti me orë fillimi 10:30 e orë mbarimi 10:38;
- b) Për datën 27.03.2025, çështjet: - nr. (21001-00155-51-2025) akti me orë fillimi 09:00 e orë mbarimi 09:04; - nr. (21001-00120-51-2025) akti me orë fillimi 09:15 e orë mbarimi 09:16; - nr. (21001-00167-51-2025) akti me orë fillimi 09:30 e orë mbarimi 09:33; nr. (21001-00188-51-2025) akti me orë fillimi 09:45 e orë mbarimi 09:46; nr. (10901-00098-51-2025) akti me orë fillimi 10:00 e orë mbarimi 10:04.

**Së dyti:** Gjyqtarja Anisa (Tepelena) Brinja e cila me datë 21.07.2025 ka paraqitur kërkesë për të marrë 5 ditë leje, nga leja vjetore e vitit 2025 pranë Zv/Kryetares së gjykatës, për datat 21.07.2025 deri 25.07.2025, kërkesë e cila i është miratuar me vendim “Për miratim dhënie leje”, datë 21.07.2025. Çështjet për të cilat kjo gjyqtare ka planifikuar dhe që nuk janë zhvilluar janë:

- a) Për datën 21.07.2025, çështjet: - nr. (50555-03215-51-2024) akti me orë fillimi 08:30 e orë mbarimi 08:45; - nr. (80103-01418-51-2025) akti me orë fillimi 08:45 e orë mbarimi 09:00; - nr. (81004-00977-51-2025) akti me orë fillimi 09:00 e orë mbarimi 09:10; - nr. (520005-00946-51-2025) akti me orë fillimi 09:15 e orë mbarimi 09:30; - nr. (520005-01542-51-2025) akti me orë fillimi 09:15 e orë mbarimi 10:00; - nr. (520005-01236-51-2025) akti me orë fillimi 09:30 e orë mbarimi 09:45; - nr. (50025-01452-51-2025) akti me orë fillimi 10:00 e orë mbarimi 11:00; - nr. (81003-01121-51-2025) akti me orë fillimi 10:00 e orë mbarimi 10:15; - nr. (80104-01128-51-2025) akti me orë fillimi 10:15 e orë mbarimi 10:30; - nr. (520005-01547-51-2025) akti me orë fillimi 10:15 e orë

<sup>166</sup> Për datën 28.03.2025, çështja nr. (11115-00317-51-2025) akti me orë fillimi 12:00 e orë mbarimi 12:20. Për këtë çështje rezultoi se ka vendimmarrje në dhomë këshillimi ndonëse ka qenë me leje të miratuar.

mbarimi 11:00; - nr. (520005-01506-51-2025) akti me orë fillimi 10:15 e orë  
mbarimi 10:30; - nr. (58328-00942-51-2025) akti me orë fillimi 10:30 e orë  
mbarimi 11:00; - nr. (80103-00665-51-2025) akti me orë fillimi 10:45 e orë  
mbarimi 11:00; - nr. (80103-01338-51-2025) akti me orë fillimi 11:00 e orë  
mbarimi 11:15; - nr. (71003-01271-51-2025) akti me orë fillimi 11:10 e orë  
mbarimi 11:20; - nr. (80105-00217-51-2025) akti me orë fillimi 11:15 e orë  
mbarimi 11:30; - nr. (520005-01577-51-2025) akti me orë fillimi 11:15 e orë  
mbarimi 12:00; - nr. (520005-01560-51-2025) akti me orë fillimi 11:30 e orë  
mbarimi 12:00; - nr. (52809-01302-51-2025) akti me orë fillimi 11:30 e orë  
mbarimi 11:45; - nr. (80103-00738-51-2025) akti me orë fillimi 11:40 e orë  
mbarimi 12:00; - nr. (520005-00802-51-2025) akti me orë fillimi 12:00 e orë  
mbarimi 12:00; - nr. (520005-01558-51-2025) akti me orë fillimi 12:15 e orë  
mbarimi 13:00; - nr. (520005-01486-51-2025) akti me orë fillimi 13:00 e orë  
mbarimi 13:15; dhe - nr. (52111-01474-51-2025) akti me orë fillimi 13:15 e orë  
mbarimi 14:00.

### Konstatime:

Kërkesat për leje nga dy gjyqtaret e mësipërme<sup>[167]</sup>, dhe për rrjedhojë edhe lejet e miratuara nga ana e Zv/Kryetares së gjykatës, janë bërë e marrë duke mos zbatuar parashikimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 23, pika 11, në të cilën ndër të tjera thuhet se: “...11. Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre...etj. ”, pasi kërkesat nuk janë bërë para 1 (një) muaji nga marrja e lejes dhe se këto miratime lejesh, kanë ndikuar edhe në zhvillimin e seancave, ku gjyqtarja znj. Irida Barkaj, për 2 data, nuk ka zhvilluar 7 gjykime dhe gjyqtarja Anisa (Tepelena) Brinja, për 1(një) datë gjykimi, nuk ka zhvilluar 24 gjykime.

Krahas sa kemi relatuar më lart rezulton se planifikimi i seancave nga trupa gjyqësore është bërë në ditë të caktuara dhe jo në të gjithë ditët e javës konkretisht: gjyqtarët Egla Mirashi; Orgent Nazaj; Albert Keraj; Elona Mërtiri; Anisa Brinja dhe Enri Rista, kanë planifikuar ditët e hëna, të marta dhe të mërkura dhe më pak të enjten, ndërkohë që

<sup>167</sup> Kërkesa për marrje leje kanë bërë edhe gjyqtarët e tjerë: - znj. Eni Naqellari me datë 10.01.2025 (për datën 13.01.2025 dhe 14.01.2025); - znj. Irida Barkaj me datë 15.01.2025 (për datën 17.01.2025); - znj. Elona Mërtiri me datë 16.01.2025 (për datën 17.01.2025); - znj. Anisa (Tepelena) Brinja me datë 18.02.2025 (për datën 21.02.2025); - znj. Eni Naqellari me datë 13.03.2025 (për periudhën 25.03.2025 deri me datë 28.03.2025); - z. Enri Rista me datë 17.03.2025 (për periudhën 25.03.2025 deri me datë 28.03.2025); - znj. Elona Mërtiri me datë 25.03.2025 (për periudhën 10.04.2025 deri me datë 11.04.2025 dhe 17.04.2025 deri me datë 18.04.2025); -znj. Elona Mërtiri me datë 25.04.2025 (për periudhën 21.07.2025 deri me datë 25.07.2025); -znj. Ermira Dedja me datë 05.06.2025 (për datën 09.06.2025); -znj. Eni Naqellari me datë 03.07.2025 (për datën 15.07.2025 dhe 16.07.2025); dhe - znj. Anisa (Tepelena) Brinja me datë 17.07.2025 (për datën 17.07.2025 dhe 18.07.2025), por nga verifikimi i kalendarit të planifikimeve të seancave në datat e kërkuara nuk u konstatuan probleme.

gjyqtarët Eni Naqellari; Teftë Xhanari; Irida Brakaj kanë planifikuar më shumë në ditë të mërkura e të enjte dhe më pak ditë të hëna e të marta dhe rezultojnë edhe gjyqtarë që kanë shpërndarje të çështjeve çdo ditë konkretisht gjyqtarët: Arta Llazari dhe Ermira Dedja.

### 3.3.3 Korrelacioni midis ngarkesës/planifikimit/vendimeve të shpallura

Nga të dhënat e administruara në kuadër të inspektimit rezulton se edhe raportet 3-mujore që gjykata dërgon në KLGJ, ku nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë dërguar shkresat e datës: 11.04.2025 (me periudhë raportimi 01.01-31.03.2025); 08.07.2025 (me periudhë raportimi 01.04-30.06.2025); dhe 10.10.2025 (me periudhë raportimi 01.07-30.09.2025); sipas formatit të raportimit tremujor, bazuar në vendimin e KLGJ nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore” (ndryshuar me vendimin e KLGJ nr. 115, datë 09.07.2019), duke qenë se bazohen në të dhëna të marra nga RDA që pasqyron sistemin audio të seancave, të jenë të pasakta sa i përket treguesve të seancave të regjistruara në audio (SA) dhe seancave të paregjistruara (SP), pasi vetë RDA siç e kemi theksuar edhe më lart ka problematika, për të cilat KLGJ duhet të marrë masa për eliminimin e mangësive të hasura në praktikën e përditshme të zhvillimit të seancave nga trupat gjyqësore.

Në formularët e raportimit të cilat janë plotësuar me pasaktësi kanë ndikuar edhe rishortimet e realizuara nga gjykata në datën 25.03.2025, të çështjeve të gjyqtarit Albert Keraj; në datën 20.05.2025, të çështjeve të gjyqtares Arta Llazari; në datën 29.05.2025, të çështjeve të gjyqtares Egl Mirashi dhe në datën 20.10.2025, të çështjeve të gjyqtarit Orgent Nazaj.

Vlen të theksojmë se në planifikimin e seancave ka të bëjë edhe mënyra se si gjyqtari e organizon punën, ku konstatohet gjatë inspektimit se gjyqtarët që kanë planifikuar më shumë seanca, kanë shpallur më shumë vendime. Më poshtë në mënyrë tabelare po japim të dhënat duke krahasuar planifikimin e seancave nga gjyqtarët me vendimet e shpallura:

Nr.	Gjyqtari		Seanca të planifikuara (1 Janar–Tetor 2025)	Vendime të shpallura 01.01.2026-20.10.2025
	Emër	Mbiemër		
1	Egla	Mirashi	875	244
2	Orgent	Nazaj	1743	499
3	Arta	Llazari	183	45
4	Albert	Keraj	470	105
5	Elona	Mërtiri	1730	515
6	Anisa	Brinja	1756	403
7	Enri	Rista	1120	406
8	Eni	Naqellari	1138	336

9	Teftë	Xhanari	1250	383
10	Irida	Barkaj	1148	399
11	Ermira	Dedja	357	146
12	Sokol	Shehu	11	2
Totali:			11781	3483

### 3.4. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara nga secili gjyqtar

Nga të dhënat e administruara në kuadër të inspektimit tematik, rezulton se në mënyrë tabelare të dhënat në lidhje me numrin mesatar të seancave të planifikuara për secilin gjyqtar dhe në nivel gjykate është si më poshtë:

Nr.	Muaji	Egla Mirashi	Orgent Nazaj	Arta Llazari	Albert Keraj	Elona Mërtiri	Anisa Brinja	Enri Rista	Eni Naqellari	Teftë Xhanari	Irida Barkaj	Ermira Dedja	Sokol Shehu	Totali i seancave për periudhën e inspektimit	Nr. mesatar në nivel gjykate
1	Janar	147	124	31	132	126	102	43	59	75	75	0	1	915	76
2	Shkurt	182	214	85	190	176	172	100	111	97	102	0	1	1430	119
3	Mars	95	197	62	140	138	134	81	88	136	100	0	2	1173	98
4	Prill	186	201	5	8	213	178	120	146	131	148	4	2	1342	112
5	Maj	105	238	0	0	177	191	150	143	116	148	16	3	1287	107
6	Qershor	0	254	0	0	255	264	126	129	154	132	49	2	1365	114
7	Korrik	2	262	0	0	174	209	171	145	159	143	86	0	1351	112
8	Gusht	1	0	0	0	3	0	23	17	19	12	14	0	89	7
9	Shtator	54	182	0	0	157	243	106	96	141	98	83	0	1160	97
10	Tetor	103	71	0	0	311	263	200	204	222	190	105	0	1669	139
Totali:		875	1743	183	470	1730	1756	1120	1138	1250	1148	357	11	11781	982

Për sa i përket vëllimit të planifikimit individual (*shembuj të totalit të seancave të planifikuara në muaj*) rezulton se gjyqtari:

- Orgent Nazaj: Ka pasur një volum të lartë planifikimi, duke arritur deri në 262 seanca në muajin korrik dhe 254 seanca në muajin qershor;
- Anisa Brinja: Ka planifikuar mesatarisht rreth 130-150 seanca në muaj (*p. sh., 264 në qershor, 263 në tetor*);
- Elona Mërtiri: Ka shfaqur qëndrueshmëri në planifikim me rreth 130-150 seanca (*p. sh., 213 në prill, 255 në qershor*);
- Teftë Xhanari dhe Irida Barkaj: Kanë planifikuar rreth 100 seanca secila në muaj gjatë periudhave të ngarkuara.

Ky nivel planifikimi pavarësisht problematikave të konstatuara gjatë këtij inspektimi, tregon një angazhim intensiv të trupës gjyqësore, veçanërisht duke marrë parasysh numrin e lartë të vendimeve të shpallura në raport me çështjet e reja.

#### 4. Konkluzione

1. Pasaktësia e Sistemit Elektronik (ICMIS): Sistemi aktual nuk pasqyron në mënyrë reale volumin individual të punës për çdo gjyqtar. Për shkak të rishortimeve (rindarjeve) të shpeshta (si pasojë e largimeve apo transferimeve, pezullimeve si dhe lejes së barrë lindjeve të gjyqtarëve), planifikimet e mëparshme kalojnë automatikisht në llogarinë e gjyqtarit të ri, duke krijuar raporte jo reale ku gjyqtarët figurojnë me seanca të zhvilluara në periudha kur nuk kanë qenë fare në detyrë.
2. Pasaktësia e Sistemit RDA: Sistemi aktual për të njëjtin gjyqtar pasqyron mospërputhje të të dhënave sa i përket seancave të zhvilluara në audio, dhe seancave të zhvilluara prej tij në sallë.
3. Mungesa e Kuadrit Rregullator të Brendshëm: Gjykata ushtron veprimtarinë administrative pa një rregullore të brendshme të miratuar dhe pa një urdhër formal për ndarjen e sallave të gjykimit. Organizimi mbështetet kryesisht në mirëkuptimin informal ndërmjet gjyqtarëve dhe zbatimin e vendimeve të përgjithshme të KLGJ-së.
4. Stabiliteti i Trupës Gjyqësore: Gjatë periudhës së inspektimit, gjykata ka funksionuar me një kapacitet të reduktuar (8 deri në 10 gjyqtarë) nga 15 që është organika e miratuar. Ndryshimet e vazhdueshme të trupës (largime apo transferime, pezullime, dhe leje lindjeje) kanë sjellë nevojën për rindarje masive të çështjeve gjyqësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në saktësinë e statistikave të sistemit.
5. Intensiteti i Lartë i Punës: Pavarësisht problemeve me sistemin dhe organikën, konstatohet një angazhim intensiv, por seancat gjyqësore nuk janë planifikuar e zhvilluar gjatë gjithë ditëve të javës. Janë planifikuar 11,781 seanca gjyqësore dhe janë shpallur 3,483 vendime gjyqësore, shifra këto që tregojnë një përpjekje të lartë për të përballuar fluksin e çështjeve të reja dhe atyre të mbartura.
6. Shfrytëzimi i Infrastrukturës: Megjithëse disponon vetëm 7 salla (prej të cilave 2 të improvizuara), gjykata ka arritur të realizojë pjesën dërrmuese të seancave me sistemin audio-viziv (gjithsej 10,289 seanca gjyqësore).
7. Planifikimi i seancave gjyqësore nga gjyqtarët bëhet në orare tepër të ngushta nga njëra seancë në tjetër, ku varion nga 5 minuta deri në 15 minuta, çka tregon se gjyqtarët nuk i tregojnë vëmendjen e duhur zhvillimit të gjykimit dhe për rrjedhojë menaxhimin sa më të mirë të çështjeve gjyqësore dhe realizimin e këtij procesi, mbi bazën e parimit të transparencës, dhe barazisë së shpërndarjes së çështjeve të planifikuara për gjykim brenda ditës që ato gjykojnë. Konstatohen raste gjithashtu që gjyqtari në kalendarin e planifikimit zgjatjen e një seance gjyqësore e llogarit nga një, dy apo tre minuta (përmendim këtu seancën gjyqësore që ka orë të fillimit

12:20, orë të mbarimit 12:21; orë të fillimit 11:45, orë të mbarimit 11:47; orë të fillimit 12:45, orë të mbarimit 12:48).

8. Për shkak të planifikimit dy herë të një çështje nga gjyqtarët, kemi planifikim të rritur të numrit të seancave të planifikuara, nga ato të zhvilluara në fakt, çka tregon fiktivitet në punën gjyqtarëve.
9. Ka raste që gjyqtarët planifikojnë dy, tre apo katër çështje gjyqësore në të njëjtën orë, duke mos pasur në konsideratë kalendarët e planifikimit, si në rastet kur çështja caktohet për herë të parë, ashtu dhe në rastet kur seanca gjyqësore caktohet nga një seancë e mëparshme. Nisur nga sa kemi relatuar më lart për shkak të këtyre problematikave edhe seancat gjyqësore rezultojnë që të mos zhvillohen në orën e planifikuar.
10. Në seancat e zhvilluara nuk ka përputhje midis orës në të cilën është bërë seanca në fakt me orën në të cilën është planifikuar në kalendarin e seancave nga gjyqtari, për të gjithë çështjet, përfshirë këtu edhe për ato çështje që ora e seancës nuk ka përplasje me orët e tjera të çështjeve gjyqësore.
11. Ka raste që sekretarët gjyqësor me qëllim që të kapin orët e esencave në të njëjtën kohë hapin procesverbalet e seancave gjyqësore, më parë se të vijë ora e zhvillimit të seancës dhe nga krahasimi i procesverbaleve të zhvillimit të seancave, del sikur në këto procesverbale prej tyre punohet në të gjitha në të njëjtën orë.
12. Në disa procesverbale seancash gjyqësore rezulton se ka mospërputhje të datës dhe orës në të cilën është mbajtur seanca gjyqësore nga ajo e realizuar në fakt. Nga verifikimi që u është bërë kalendarëve të planifikimit të seancave sa i përket datës që procesverbali i seancës ka pasqyruar në të, ka rezultuar se gjyqtari nuk ka pasur asnjë seancë të planifikuar për tu zhvilluar në atë datë që ka procesverbali faktik i seancës.
13. Kërkesat për leje nga gjyqtarët Irida Barkaj dhe Anisa (Tepelena) Brinja, dhe për rrjedhojë edhe lejet e miratuara nga ana e Zv/Kryetares së gjykatës, janë bërë e marrë duke mos zbatuar parashikimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht në nenin 23, pika 11, në të cilën ndër të tjera thuhet se: "...11. Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre...etj.", pasi kërkesat nuk janë bërë para 1 (një) muaji nga marrja e lejes dhe se këto miratime lejesh, kanë ndikuar edhe në zhvillimin e seancave, ku gjyqtarja znj. Irida Barkaj, për 2 data, nuk ka zhvilluar 7 gjykime dhe gjyqtarja Anisa (Tepelena) Brinja, për 1(një) datë gjykimi, nuk ka zhvilluar 24 gjykime.

*(Bashkëlidhur raportit të inspektimit ndodhet "aneksi" i cili përmban kalendarin e planifikimeve të seancave si dhe tabelat me të dhëna ndihmëse për realizimin e inspektimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër).*

## 5. KONKLUZIONE

Bazuar në të dhënat e administruara për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, më poshtë paraqiten konkluzionet përmbledhëse:

**5.1.** Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e 9 (nëntë) gjykatave përkatësisht të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Gjirokastrë, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025.

**5.2.** Në funksion të realizimit të inspektimit u administruan të dhënat të cilat mundësojnë njohjen e veprimtarisë së 9 (nëntë) gjykatave subjekt inspektimi përsa i përket: ngarkesës së punës për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025; numrit të çështjeve të përfunduara për periudhën 01.01.2025 - 20.10.2025; organikës së gjykatës; kërkesave/vendimeve për miratimin e lejeve si dhe listat e gatishmërisë për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025; sallave gjyqësore për zhvillimin e gjykimeve për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025; raportet për përdorimin e sistemit audio si dhe kalendarin e seancave të planifikuara për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025 për secilin gjyqtar.

**5.3.** Gjykatat subjekt inspektimi kategorizohen në dy grupe, të përcaktuara si të tilla nëpërmjet vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 147, datë 29.03.202. Përkatësisht:

- Gjykatat e kategorisë së dytë (të mesme): Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë, Berat, Lezhë, Lushnjë;
- Gjykatat e kategorisë së tretë (e ulët): Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjirokastrë, Kukës dhe Sarandë.

**5.4.** Nga të dhënat e administruara në kuadër të kryerjes së inspektimit rezultoi se:

- Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Lezhë janë të organizuar dhe funksionojnë në bazë të “Rregulloreve të Brendshme” të miratuara në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 149, datë 29.03.2023<sup>[168]</sup> dhe nr. 150, datë 29.03.2023<sup>[169]</sup> të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Shkodër, Vlorë nuk ka proceduar me nxjerrjen e një rregulloreje “Për miratimin e strukturës, organikës si dhe përshkrimet e punës” në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 149 dhe nr. 150, datë 29.03.2023.

<sup>168</sup> Për gjykatat e kategorisë së dytë dhe të tretë, pa zyrë shërbimi të cilat janë: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Elbasan, Sarandë dhe Berat.

<sup>169</sup> Për gjykatat e tjera të kategorisë së dytë dhe të tretë, me zyrë shërbimi.

**5.5.** Gjatë periudhës objekt inspektimi u konstatua se vetëm Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka funksionuar me organikë të plotë.

Ndërsa gjykatat e tjera subjekt inspektimi kanë funksionuar me trupë gjyqësore të reduktuar për shkak të transferimeve, pezullimeve/shkarkimeve nga detyra si dhe lejeve të veçanta. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka emëruar gjyqtarë të rinj pranë gjykatave objekt inspektimi në fund të muajit tetor 2025, por në kushtet kur këta gjyqtarë kanë planifikuar seanca pas muajit tetor 2025, kjo veprimtari nuk përfshihet në objektin e inspektimit.

Referuar të dhënave përsa i përket organikës së miratuar dhe trupës gjyqësore efektive në secilën gjykatë ka rezultuar se:

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, e cila ka një organikë të miratuar prej 8 gjyqtarësh, ka funksionuar me 5-6 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë e cila ka një organikë të miratuar prej 7 gjyqtarësh, ka funksionuar me 4-5 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër e cila ka një organikë të miratuar prej 7 gjyqtarësh, ka funksionuar me një organikë të plotë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës e cila ka një organikë të miratuar prej 7 gjyqtarësh, ka funksionuar me 4-7 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e cila ka një organikë të miratuar prej 15 gjyqtarësh, ka funksionuar me 10-13 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier e cila ka një organikë të miratuar prej 21 gjyqtarësh ka funksionuar me 17-18 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e cila ka një organikë të miratuar prej 16 gjyqtarësh ka funksionuar me 12-13 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë e cila ka një organikë të miratuar prej 12 gjyqtarësh ka funksionuar me 9 gjyqtarë;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e cila ka një organikë të miratuar prej 15 gjyqtarësh ka funksionuar me 8-10 gjyqtarë.

**5.6.** Në gjykatat subjekt inspektimi jo të gjitha sallat e gjykimit janë funksionale. Konkretisht është konstatuar se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër një sallë është jofunksionale dhe është kthyer në zyrë arkivi.

Përsa i përket menaxhimit të sallave gjyqësore rezulton se janë konstatuar gjykata në të cilat ndarja dhe përdorimi i sallave kryhet nëpërmjet marrëveshjes të gjyqtarëve sikurse funksionon Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Dibër dhe Berat. Gjithashtu konstatohen edhe raste sikurse funksionon Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë kur urdhri për ndarjen e sallave është formalizuar nëpërmjet një urdhri të posaçëm të Kryetarit të Gjykatës.

Nxjerrja e një urdhri të posaçëm për ndarjen dhe përdorimin e sallave do të mundësonte një organizim më të qartë dhe më funksional të sallave të gjykimit sidomos në ato gjykata ku numri i sallave është i kufizuar në raport me numrin e gjyqtarëve.

**5.7.** Referuar akteve të përcjella përsa i përket listës së gatishmërisë për secilën gjykatë gjatë periudhës 01.01.2025-31.10.2025, konstatohet se caktimi i gjyqtarëve në listën e gatishmërisë është kryer nëpërmjet urdhrave të Kryetarit të Gjykatës.

**5.8.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me përfitimin e lejeve vjetore konstatohet se kërkesat për leje janë paraqitur nga gjyqtarët pranë Kryetarit të Gjykatës. Megjithatë, në të gjitha gjykatat konstatohen raste kur nuk është respektuar afati i paraqitjes së kërkesës për leje vjetore. Përkatësisht, në rastin kur gjyqtarët kanë kërkuar më tepër se 3 (tre) ditë leje, nuk e kanë paraqitur kërkesën të paktën një muaj përpara datës së fillimit të lejes.

Gjithashtu, nga verifikimi i kalendarit të seancave të planifikuara për secilën gjykatë rezulton se në disa raste gjyqtarët kishin planifikuar seanca edhe në datat për të cilat gjyqtarëve iu është miratuar leja vjetore, duke evidentuar mungesë koordinimi nëpërmjet planifikimit të seancave dhe periudhës së lejes.

**5.9.** Gjykatat subjekt inspektimi aplikojnë sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ICMIS i cili përveç të tjerash mundëson dhe hedhjen e të dhënave në lidhje me planifikimin e seancave. Në gjykata funksionon edhe Sistemi i Regjistrimit Audio (RDA).

**5.10.** Gjatë inspektimit u konstatua pasaktësi në të dhënat e informacionit të përcjellë nga gjykatat në lidhje me “kalendarin e seancave të planifikuara” për secilin gjyqtar si dhe mospërputhje të këtyre të dhënave me të dhënat e ndodhura në procesverbalet e seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të gjykatës.

**5.11.** Gjithashtu për të gjitha gjykatat subjekt inspektimi evidentohet se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk pasqyron të dhëna të sakta përsa i përket “kalendarit të planifikimit të seancave” në rastet e çështjeve të rishortuara. Problematika konsiston në faktin se sistemi ia përllogarit gjyqtarit të caktuar së fundmi të gjitha planifikimet e seancave, përfshirë edhe ato të kryera përpara rishortimit të çështjes, duke krijuar kështu një pasqyrim jo të saktë të ngarkesës dhe planifikimit real të seancave për secilin gjyqtar.


**5.12.** Numri total i seancave të planifikuara në nivel gjykatë për gjithë periudhën 01.01.2025-31.10.2025 në secilën prej gjykatave paraqitet si më poshtë:

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Berat: 6522 seanca në total të planifikuara;

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastrë: 6034 seanca të planifikuara;

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Dibër: 5027 seanca të planifikuara;

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Kukës: 4975 seanca të planifikuara;



- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Korçë: 10451 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Fier: 16845 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Vlorë: 12371 seanca të planifikuara; Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Lezhë: 10940 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Shkodër: 11781 seanca të planifikuara.

**5.13.** Referuara të dhënave përsa i përket planifikimeve të seancave brenda një dite pune në të gjitha gjykatat u konstatuan raste të tilla si:

- *E njëjta çështje figuron të jetë planifikuar dy herë në të njëjtën datë, në të njëjtën orë dhe në të njëjtën sallë nga i njëjti gjyqtar;*
- *Dy çështje të ndryshme figurojnë të jenë planifikuar në të njëjtën datë, orë dhe sallë nga i njëjti gjyqtar;*
- *Planifikime seancash me një diferencë shumë të shkurtër kohore nga njëra-tjetra deri edhe prej 2 minutash brenda së njëjtës dite<sup>[170]</sup>.*
- *Diferencë kohore prej më shumë se 15 minutash ndërmjet orës së planifikimit të seancës referuar “kalendarit të planifikimit të seancave” dhe orës së çeljes së seancës referuar “Procesverbaleve të seancave”.*

Në lidhje me konstatimet e sipërcituara vlerësojmë se planifikimi dy herë në të njëjtën datë dhe orë për të njëjtën çështje rrit në mënyrë fiktive numrin e planifikimeve për gjyqtarin përkatës. Po ashtu, planifikimi në intervale shumë të afërta kohore të seancave nga njëra-tjetra vë në dyshim mundësinë reale të zhvillimit efektiv të tyre.

**5.14.** Nga vëzhgimi i shpërndarjes së seancave gjatë ditëve të punës konstatohet një variacion i theksuar si në aspektin e numrit të planifikimeve brenda një ditë të vetme ashtu edhe në shpërndarjen e tyre përgjatë ditëve të javës.

**5.15.** Në veçanti përqendrimi i seancave brenda një dite pune paraqitet i pabalancuar, duke variuar nga 0-1 seanca në një ditë, deri në 39-43 seanca në një ditë tjetër. Nga analiza e planifikimeve në drejtim të numrit të seancave të planifikuar brenda një dite të vetme për një gjyqtar rezultoi se:

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Berat: planifikime deri në 24 seanca në një ditë të vetme;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastrë: planifikime deri në 39 seanca në një ditë të vetme;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Dibër: planifikime deri në 23 seanca në një ditë të vetme;

<sup>170</sup> Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Kukës: planifikime deri në 30 seanca në një ditë të vetme;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Korçë: planifikime deri në 18 seanca në një ditë të vetme;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Fier: planifikime deri në 43 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Vlorë: planifikime deri në 26 seanca në një ditë të vetme;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Lezhë: planifikime deri në 26 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Shkodër: planifikime deri në 39 seanca.

**5.16.** Gjithashtu nga analiza e të dhënave në lidhje me planifikimet në nivel gjyqate konstatohet se planifikimet përqendrohen kryesisht në ditën e hënë, e martë dhe e mërkurë. Dy ditët më të ngarkuara të javës për secilën gjykatë paraqiten si më poshtë:

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Berat: dita e hënë me 2031 seanca të planifikuara (31 % e seancave totale), ndjekur nga dita e martë me 1827 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastrë: dita e martë 1531 seanca, ndjekur nga dita e hënë me 1529 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Dibër: dita e martë 1424 seanca të planifikuar, ndjekur nga dita e enjte me 1270 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Kukës: dita e mërkurë 1660 seanca, ndjekur nga dita e hënë me 1453 seanca të planifikuara;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Korçë: dita e mërkurë me 2505 seanca të planifikuara ndjekur nga dita e martë me 2315 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Fier: dita e hënë me 4092 seanca të planifikuara, ndjekur nga dita e mërkurë me 3962 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Vlorë: dita e hënë 3639 seanca të planifikuara, ndjekur nga dita e martë me 3583 seanca;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Shkodër: dita e hënë me 3175 seanca të planifikuara, ndjekur nga dita e martë me 3116 seanca.

Në të gjitha gjykatat konstatohet se gjatë ditës së premte numri i planifikimeve në nivel gjyqate si dhe për çdo gjyqtar pëson një rënie të konsiderueshme në krahasim me planifikimet gjatë ditëve të tjera të javës. Përjashtim nga ky konstatim përbën rasti i një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Korçë i cili ditën e premte ka planifikuar më shumë seanca se në ditët e tjera të javës.

**5.17.** Përsa i përket përqendrimit të ngarkesës dhe modeleve të organizimit të punës referuar një dite të caktuar të javës në mënyrë të përmbledhur rezultoi sa më poshtë vijon:

- **Modeli A - Planifikim pothuajse çdo ditë pune (5 ditë/javë):** Nuk evidentohen gjyqtarë që të kenë si model të qëndrueshëm pune planifikimin gjatë të pestë ditëve të javës.

- **Modeli B - Planifikim 3 ditë në javë:** Ky model paraqitet si modeli tipik organizativ. Shpërndarje ndërmjet planifikimit të seancave dhe kohës për arsyetim.

Konstatohet se gjyqtarët planifikojnë seanca të hënë, të martë, dhe të enjte ndërsa dita e mërkurë dhe e premte lihet e lirë. Ndërsa tek gjyqtarë të tjerë konstatohet modeli i planifikimit në tre ditët e para të javës, ndërsa nuk planifikon seanca të enjte dhe të premte.

- **Modeli C - Planifikim 4 ditë në javë.** Gjyqtarët planifikojnë katër ditë të javës (të hënë, të martë, të mërkurë, të enjte), por konstatohet se në njërin nga këto ditë planifikohet vetëm 1 seancë<sup>[171]</sup> ose shumë pak.

- **Modeli D - Planifikim 1-2 ditë në javë.** Ky model është zakonisht i pranishëm tek gjyqtarët me volum të ulët seancash për shkak të cilësisë si Kryetar/ZvKryetar Gjykatë.

**5.18.** Përsa i përket planifikimeve të seancave në nivel mujor rezultoi se shpërndarja e seancave nga muaji në muaj për secilën gjykatë karakterizohet gjithashtu nga një variacion i konsiderueshëm midis numrit të seancave të planifikuara në muajin janar me seancat e planifikuara gjatë muajit prill, maj, qershor. Muajt më pak të ngarkuar me planifikime janë muaji janar, muaji gusht edhe muaji shtator.

**5.19.** Lidhur me numrin e seancave të zhvilluara, për çështjet në proces për periudhën e inspektimit, nuk mund të bëhet një analizë për shkak të problematikave të sistemit ICMIS drejtim të saktësisë së të dhënave<sup>[172]</sup>. Për këtë arsye analiza është fokusuar vetëm në drejtim të raportimeve për përdorimin e sistemit audio në lidhje me seancat. Nga analiza e të dhënave për secilën gjykatë rezultoi se për periudhën objekt inspektimi jo të gjitha seancat janë zhvilluar me regjistrim audio. Nga inspektimi rezultoi se ka mospërputhje të të dhënave të përcjella nga gjykata pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë krahasuar me të dhënat e përcjella nga gjykata pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar raporteve për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat.


**5.20.** Referuar analizës së korrelacionit midis ngarkesës, planifikimeve dhe përfundimit të çështjeve rezultoi se: Në disa gjykata konstatohen raste ku ekziston një lidhje e fortë midis ngarkesës - planifikimit - përfundimit të çështjeve. Por gjithashtu konstatohet se në të shumtën e rasteve ekziston një lidhje relativisht e qëndrueshme midis ngarkesës dhe planifikimeve ndërsa në mënyrë të veçantë lidhja midis planifikimit dhe përfundimit të çështjeve paraqitet më e dobët.

**5.21.** Përsa më sipër konkludojmë se mënyra se si gjyqtari organizon dhe planifikon zhvillimin e seancave në raport me ngarkesën përbën një faktor vendimtar në ecurinë e procesit. Në këtë kontekst vlerësojmë se ka vend për përmirësimin e veprimtarisë së

<sup>171</sup>Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

<sup>172</sup> Rishortimet, planifikimi i së njëjtës çështje dy herë në të njëjtën datë, etj.

- Dy çështje të ndryshme figurojnë të jenë planifikuar në të njëjtën datë, orë dhe sallë nga i njëjti gjyqtar.



gjykatave subjekt inspektimi në drejtim të shmangies së mungesës së planifikimeve por edhe mirëmenaxhimit të ngarkesës nëpërmjet një planifikimi efektiv të seancave të shoqëruar me marrjen e masave të nevojshme që këto seanca të jenë realisht produktive.

5.22. Në përfundim vlerësojmë që të mbahet në konsideratë se planifikimi i një numri të lartë seancash, në vetvete dhe i pashoqëruar me zhvillimin e seancave produktive, nuk përbën tregues të një procesi efikas. Planifikimi efektiv i seancave nuk kërkon burime shtesë apo ristrukturime organizative; ai kërkon mbi të gjitha një planifikim të mirëmenaduar, një shpërndarje të balancuar të planifikimeve, si dhe mbajtjen në konsideratë të një tavani ditor dhe mujor planifikimesh me qëllim respektimin njëkohësisht të afateve ligjore, të afateve standarde minimale kohore e sasiore<sup>[173]</sup>, si dhe garantimin e cilësisë së gjykimit.

## 6. REKOMANDIME

### 1. Rekomandime për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese si dhe me qëllim që **gjyqtarët kur planifikojnë seancat të mbajnë në konsideratë këto rekomandime:**

Gjatë veprimtarisë së planifikimit të seancave të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të shmangies të situatave të tilla si:

- E njëjta çështje të mos planifikohet dy herë në të njëjtën datë, orë dhe në të njëjtën sallë;
- Dy çështje të ndryshme të mos planifikohen në të njëjtën datë, orë dhe sallë nga i njëjti gjyqtar;
- Të mos planifikohen seanca me një diferencë shumë të shkurtër kohore nga njëra-tjetra<sup>[174]</sup>.
- Të merren masa për respektimin e orarit të planifikuar të seancave gjyqësore me qëllim shmangien e fillimit me vonesë të seancave<sup>[175]</sup>.

<sup>173</sup> Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 433, datë 22.07.2025 "Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve.

<sup>174</sup> Janë konstatuar planifikime seancash me një diferencë edhe prej 2 minutash brenda së njëjtës ditë.

<sup>175</sup> Konstatohen raste në të cilat evidentohet një diferencë prej më shumë se 15 minutash ndërmjet orës së planifikimit të seancës referuar "kalendarit të planifikimit të seancave" dhe orës së çeljes së seancës referuar "Procesverbaleve të seancave".

- Të respektohet afati i paraqitjes së kërkesave për leje vjetore veçanërisht në rastet kur kërkohet leje më shumë se 3 (tre) ditë. Kërkesat drejtuar Kryetarit të Gjykatës për përfitimin e lejes vjetore (më tepër se tre ditë), duhet të paraqiten të paktën një muaj para përfitimit të lejes.
- Të sigurohet koordinimi me kalendarin e planifikimit të seancave, në mënyrë që të shmanget planifikimi i seancave në periudhën e lejes.
- Të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të shmangies së mungesës së planifikimeve por edhe menaxhimit të ngarkesës nëpërmjet një planifikimi efektiv të seancave, të shoqëruar me marrjen e masave të nevojshme që këto seanca të jenë realisht produktive.
- Të tregohet kujdes i shtuar në drejtim të planifikimit të balancuar të seancave, duke mbajtur në konsideratë përcaktimin e një tavanit ditor dhe mujor planifikimesh me qëllim respektimin njëkohësisht të afateve ligjore, të afateve standarde minimale kohore e sasiore<sup>[176]</sup>, si dhe garantimin e cilësisë së gjykimit.

*Këto rekomandime të zbatohen menjëherë.*

- Kryetari i Gjykatës të marrë masa për formalizimin e menaxhimit të sallave gjyqësore, në funksion të një organizimi më të qartë dhe më funksional për ndarjen dhe përdorimin e tyre.
- Kryetari i Gjykatës të marrë masat e nevojshme që në të dhënat statistikore të kërkuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të pasqyrohen të dhëna të sakta në lidhje me kalendarin e seancave të planifikuara, veçanërisht për rastet e çështjeve të rishortuara.
- Kryetari i Gjykatës të ndërmarrë masat e nevojshme që, në të dhënat statistikore të kërkuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të pasqyrohen të dhëna të sakta në lidhje me raportimin për përdorimin e sistemit audio për seancat (RDA).
- Kryetari i Gjykatës të vlerësojë marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatës në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve me palë të zhvillohen në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio.

*Këto rekomandime të zbatohen brenda muajit shtator 2026.*

- Kancelari i gjykatës të marrë masa për mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave statistikore në lidhje me “kalendarin e planifikimit të seancave”, dhe “raportet për përdorimin e sistemit në lidhje me seancat (RDA)”, në referim, nenit 39, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 98/2016 si dhe vendimit nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”.

*Ky rekomandim të zbatohet menjëherë.*

<sup>176</sup> Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 433, datë 22.07.2025 “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve.

## 1.1. Rekomandime për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Shkodër dhe Vlorë

- Këshilli i Gjykatës<sup>[177]</sup> të rishikojë rregulloren e brendshme të gjykatës duke e përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës, në bazë dhe për zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 149, datë 29.03.2023 dhe nr. 150, datë 29.03.2023.

Këshilli i Gjykatës, të mbajë në vëmendje që në përshkrimet e punës të parashikuara në rregulloren e rekomanduar, të përcaktojë rregulla të hollësishme në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të gjykatës të ngarkuar me hedhjen e të dhënave të planifikimeve të seancave në sistemin e menaxhimit të çështjeve si dhe në procesverbalet e seancave, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe identifikimin e qartë të përgjegjesisë në lidhje me këtë proces.

## 2. Rekomandime për Këshillin e Lartë Gjyqësor

### Rekomandime në lidhje me administrimin e infrastrukturës

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës të vlerësojë marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatave në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve me palë të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio.

*Ky rekomandim të zbatohet brenda vitit 2026.*

### Rekomandime në lidhje me sistemin e teknologjisë së informacionit:

- Të merren masa që sistemi i teknologjisë së informacionit të parandalojë planifikimin e së njëjtës çështje më shumë se një herë, në të njëjtin datë dhe orar.
- Të merren masa në drejtim të përmirësimit të mënyrës së pasqyrit të të dhënave në lidhje me “kalendarin e planifikimeve të seancave”. Në këtë kuadër sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës të përshtatet në mënyrë që planifikimet e seancave t’i atribuohen saktësisht gjyqtarit përkatës në momentin e kryerjes së planifikimit, duke shmangur transferimin automatik të të gjitha planifikimeve tek gjyqtari i caktuar së fundmi.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë masa për t’i siguruar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë akses të plotë (jo të kufizuar) në sistemin e teknologjisë së informacionit përse i përket regjistrimeve audio të seancave.

*Këto rekomandime të zbatohen brenda vitit 2026.*

Rekomandime në lidhje me rregullat standarde për eficiencën dhe cilësinë e drejtësisë në referim të nenit 94, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”:

<sup>177</sup> Në referim të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 94, pika 4, shkronja “e” të ligjit nr. 115/2016, të miratojë udhëzuesin “Për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve”.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 94, pika 4, shkronja “ë” të ligjit nr. 115/2016, të miratojë udhëzuesin “Për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore”.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të vlerësojë nevojën për përcaktimin e standardeve minimale të arsyeshme kohore për vënien në lëvizje të çështjes nëpërmjet planifikimit si dhe për përcaktimin e standardeve minimale të arsyeshme kohore ndërmjet seancave<sup>[178]</sup> me qëllim garantimin e një planifikimi të unifikuar, të matshëm dhe në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit gjyqësor.

*Këto rekomandime të zbatohen brenda vitit 2026.*

#### Rekomandime në lidhje me të dhënat statistikore:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në respektim të nenit 89, shkronja “b”<sup>[179]</sup>, nenit 94, pika 4, shkronja “dh”<sup>[180]</sup> të ligjit nr. 115, datë 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të miratojë rregulla standarde me qëllim paraqitjen në të dhënat statistikore të treguesve të punës për të gjithë gjyqtarët që caktohen në një çështje të rishortuar (jo vetëm për gjyqtarin e caktuar së fundmi).

*Këto rekomandime të zbatohen brenda vitit 2026*

### **3. Rekomandim për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë**

- Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë të marrë masa që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të gjenerojë informacionin statistikor që nevojitet për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>[181]</sup>, në kuadër të përmirësimit të të dhënave statistikore sikurse i kemi përmendur në rekomandimet drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Këto rekomandime të zbatohen brenda vitit 2026.*

<sup>178</sup> Ndërmjet dy seancave të njëpasnjëshme brenda së njëjtës ditë për dy çështje të ndryshme si dhe ndërmjet dy seancave të planifikuara në ditë të ndryshme për të njëjtën çështje civile.

<sup>179</sup> Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme: ...b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë; c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës”.

<sup>180</sup> Rregullat standarde për eficiencën në drejtësi përfshijnë parashikime për: ... dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore”.

<sup>181</sup> Bordi drejtues ushtron kompetencat si vijojnë: ... gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse.

## Propozime


Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

### PROPOZOJMË:


1. Përfundimin e inspektimit tematik me objekt “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, në zbatim të vendimit nr. 57, datë 20.10.2025.
2. Ndjekjen e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në raportin e inspektimit.
3. Të njoftohen Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm: Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të raportit të inspektimit.
4. Njoftimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë me raportin e inspektimit, duke iu dërguar një kopje të këtij raporti.

### INSPEKTORËT

Daniela Sulaj




Lindita Ziguri



Joana Sorraj



Elsa Miha



Erjena Bashari



Elena Pelushi




Julian Zonja



Albert Kazia



Periand Teta



Eugen Nasufi

